2026

LIBRI I ABSTRAKTEVE

Konferenca e Profesionistëve të Kujdesit Shëndetësor:
"Edukimi i Profesionistëve në Epokën Digjitale"

Na kontaktoni events@urdhriinfermierit.org urdhriinfermierit.org

LIBRI I ABSTRAKTEVE

KONFERENCA KOMBËTARE E PROFESIONISTËVE TË SHËNDETËSISË

"Edukimi i Profesionistëve të Kujdesit Shëndetësor në Epokën Digjitale"

Teknologjia • Realiteti Virtual • Inteligjenca Artificiale

TIRANË, SHQIPËRI

12 MAJ 2026

Maritim Hotel Plaza Tirana

ABSTRACT BOOK

NATIONAL CONFERENCE OF HEALTHCARE PROFESSIONALS

"Education of Healthcare Professionals in the Digital Era"

Technology • Virtual Reality • Artificial Intelligence

TIRANA, ALBANIA

MAY 12, 2026

Maritim Hotel Plaza Tirana

TABELA E PËRMBAJTJES

Faqja Web: https://urdhriinfermierit.org/

Rreth Konferencës 16

Fjala Përshëndetëse 18

Komiteti Shkencor 18

Komiteti Organizativ 19

Programi Shkencor i Konferencës 20

Abstraktet Sesioni I 37

Salla 1

Balancimi mes lehtësimit dhe rrezikut: Polifarmacia dhe aderenca ndaj mjekimit te pacientët në kujdes paliativ 38

Irena Laska, Vasien Xhelili

Kompetencat e Lidershipit dhe nevojat e zhvillimit në sistemin shëndetësor shqiptar - një studim cilësor 40

Dhurata Ivziku, Blerina Duka, Anila Jance

Politikat shëndetësore inkluzive dhe ndikimi i tyre në praktikën klinike infermierore: një scoping review e literaturës ndërkombëtare 42

Aurora Kokici, Ippolito Notarnicola, Blerina Duka

Qasjet inovative në kujdesin infermieror për parandalimin e komplikacioneve në njësinë e kujdesit postanestezik 44

Alketa Dervishi, Blerina Duka, Brizida Refatllari, Floreta Kurti, Jonida Stefa

Bashkëpunimi ndërdisiplinor midis infermierëve dhe terapistëve okupacionalë në epokën digjitale: Promovimi i kujdesit të përqendruar te personi dhe autonomisë funksionale 46

Mimoza Doci, Aurora Kokici, Ippolito Notarnicola, Megi Taci

Arsimi i lartë në epokën e AI: Midis inovacionit dhe sfidave akademike 48

Eljo Paja

Zhvillimi i versionit shqip të ECDI2030: Përkthimi, përshtatja kulturore dhe studimi pilot paraprak 49

Jola Çini, Evda Veveçka, Eleni Nastas

Infeksionet urinare te fëmijët në Elbasan, kujdesi infermieror në parandalimin e tyre 52

Shqipe Luta, Albana Sula, Rajmonda Oboni, Elona Hasalla, Juxhin Luta, Esmeralda Vreto

Vlerësimi i ndikimit të faktorëve demografikë dhe shëndetësorë në cilësinë e jetës tek të moshuarit 54

Entela Drizaj, Sabina Tosuni, Jonida Drizaj, Rezarta Stena, Klara Hysenaj, Rajmonda Hida, Argenta Kuburja

Vlerësimi i bioshënuesve të reninës, aldosteronit dhe elektroliteve në hiperaldosteronizmin sekondar 56

Brunilda Mezani, Anila Mitre

Abstraktet Sesioni II 61

Salla 1

Sfidat etike të përdorimit të Inteligjencës artificiale në kujdesin shëndetësor 59

Brizida Refatllari, Albana Lufi, Alketa Dervishi, Floreta Kurti

Mësimdhënia digjitale dhe simulimi klinik në edukimin shëndetësor: sfidat dhe mundësitë nga qendra digjitale simulatore në Fakultetin e Shëndetit, Shqipëri 61

Juljana Xhindoli, Stiliana Brokaj, Mimoza Llavdaniti ,Vasilika Prifti, Erda Tozaj,Erlini Kokalla

Eksplorimi i njohurive dhe qëndrimeve ndaj fraxhilitetit dhe vlerësimit geriatrik të profesionistëve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri 63

Brunilda Elezi, Shqipe Luta, Skender Topi, Kaçe Bahushi, Elira Tashi, Elona Dybeli

Incidenca e AVC në Neurologji 65

Antigoni Bullari , Ilirjana Zekja , Eglita Laci

Inovacioni dhe teknologjia në proceset infermieristike: ndikimi, sfidat dhe perspektivat për praktikën klinike 67

Lutfi Lami

Kujdesi infermieror tek pacientët me astmë bronkiale: integrimi i teknologjisë në praktikën klinike 69

Violeta Zanaj, Joana Bregasi

Vlerësimi i njohurive dhe praktikave të studentëve të infermierisë mbi faktorët e rrezikut dhe vetë-ekzaminimin e gjirit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit 71

Rajmonda Oboni (Hida), Shqipe Luta, Albana Sula, Ilma Toci, Arkida Skenderi , Entela Driza , Venemin Gega, Gjergji Doka

Roli i parametrave të skanimit dhe optimizimi i tyre në cilësinë e imazhit të Angio-CT në diagnostikimin e tromboembolisë pulmonare 73

Hane Peposhi

Transformimi digjital i edukimit infermieror: nga mësimi tradicional te kompetencat e epokës digjitale 75

Silvana Gripshi, Dasilva Taci

Trajtimi i lëndimeve nga armët e zjarrit përmes një fiksatori të jashtëm 77

Elona Hasalla, Ilda Taka, Blerta Hasalla, Shqipe Luta,Elona Dybeli, Albana Sula, Rajmonda Hida, Sulejman Baha

Nga CTA kardiake te angiografia koronare 79

Alket Collaku, Elona Dybeli

Abstraktet Sesioni I 81

Salla 2

Menaxhimi dhe incidenca e infeksioneve në kirurgjinë endoskopike të hipofizës:Studim retrospektiv në QSUT 82

Manjola Pjetri, Valbona Bilali, Klea Kazazi, Alma Cumraku, Anisa Vogli

Optimizimi i triazhit emergjent në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM 127) në Shqipëri përmes inteligjencës artificiale: Një studim i bazuar në praktikë (2020-2024) 84

Indrit Jaupaj, Skënder Brataj, Klejdi Cankja

Roli i E-Health në menaxhimin dhe vlerësimin e dhembjes: Rishikim narrativ 86

Armelda Teta, Mitilda Gugu, Elona Gaxhja, Rezarta Stena, Sabina Tosuni

Roli i PNF në përmirësimin e kontrollit motorik dhe stabilitetit funksional gjatë aktiviteteve të përditshme tek pacientët me probleme muskuloskeletore lumbare 88

Roxhensa Sula, Alta Arapi, Alisia Maliqi

Njohuri mbi aneminë nga mungesë hekuri tek studentët e Universitetit të Vlorës 90

Stiliana Brokaj, Elidon Brokaj, Vasilika Prifti, Juljana Xhindoli

Preeklampsia dhe eklampsia në shtatzani: Studim rastesh retrospektiv në maternitetin “Shtëpia e Lindjes” në Spitalin Rajonal Korçë, 2020-2025 92

Delantina Mulla

Gabimet infermierore në njësinë e kujdesit intensiv: Analizë retrospektive dhe implikimet për sigurinë e pacientit (2018-2023) 94

Arjona Rakipi

Integrimi i densitometrisë DXA, përpunimit digjital të imazhit dhe inteligjencës artificiale në vlerësimin e densitetit kockor 96

Besina Tomani

Simulimi klinik si mjet inovativ në edukimin dhe zhvillimin profesional të infermierëve 98
Elona Karrica
Prevalenca e "burnout"-it tek personeli infermieror në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" 100
Marvina Meta, Erald Vasili
Laparoskopia gjinekologjike: nderhyrja miniinvazive dhe kujdesi infermieror 102
Anjeza Kolaneci, Enida Paluka
Menaxhimi klinik dhe infermieror i hiperbilirubinemisë neonatale – Efektiviteti i fototerapisë në trajtim 104
Ermelinda Xhari
Abstraktet Sesioni II 106
Salla 2
Metodat gjenetike në diagnoztikimin e leukemisë mieloide akute: Teknikat e reja dhe perspektiva për të ardhmen 107
Klajdi Tarko
Ndikimi i ndërhyrjeve të udhëhequra nga infermierët në menaxhimin e diabetit 109
Lediana Bardho (Gega)
Menaxhimi i konvulsioneve febrile në urgjencën pediatrike: Studim rastesh në Spitalin Rajonal Lezhë (2022–2024) 111
Shpresa Molla
Ndikimi i inteligjences artificiale ne sigurine e pacientit gjate ekzaminimit skanerik 113
Bukurie Halili , Sidorela Rexhepi, Theodhor Xhillari , Ilir Lumi
Roli i teknologjise edhe inovacionit në përmiresimin e kujdesit të pacientëve në dializë: Sfidat dhe perspektivat infermierore 115
Aurora Kola
Komunikimi në kujdesin paliativ: sfidat, barrierat dhe implikimet etike në fund të jetës 117
Vasien Xhelili, Kristjana Sheshmina, Estela Skermo, Thimaq Karapanxho
Monitorimi dixhital i vetë-kujdesit post-operator në rinoseptoplastikën me teknikë të mbyllur : Një studim pilot mbi turizmin mjekësor 119
Mario Golemi
Perceptimi i shendetit fizik dhe psikosocial i te moshuarve dhe lidhja me performancen e tyre konjitive. Impakti në rezultatet e cilësisë së jetës 121

Andia Pelari
Home care nursing në epokën digjitale 123
Blerim Maloku
Roli i teknologjisë dhe terapive të avancuara në menaxhimin bashkëkohor të fibrozës kistike tek fëmijët 125
Elisabeta Rista
Ndërtimi i kapaciteteve të lidershipit për të forcuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e kujdesit: Njohuri nga një analizë kombëtare e nevojave në Shqipëri 127
Blerina Duka, Jola Çini, Armela Zylfo, Fabiola Mane, Kujtime Vakeflliu, Alta Arapi
Abstraktet Sesioni I 131
Salla 3
Strategjitë e marketingut të infermierisë për mbajtjen e fuqisë punëtore: Një perspektivë globale 132
Indrit Bimi
Vaksinimi kundër COVID-19, seroprevalenca dhe efektiviteti i vaksinës tek punonjësit e kujdesit shëndetësor në Shqipëri, 2021–2023: Analizë duke përdorur sistemin REDCap 134
Ermioni Dabaj
Edukimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në epokën digjitale 136
Nevila Duraku
Roli dhe rëndësia e teknikëve të radiologjisë në kujdesin shëndetësor modern 138
Mustafë Buzoku
Terapia intensive neonatale dhe rreziku i humbjes së dëgjimit 140
Gentjana Shembitraku
Kujdesi ndaj nënës në periudhën post-partum në epokën moderne 142
Fatbardha Faqolli
Përmirësimi i kujdesit të pacientit përmes praktikës së bazuar në evidencë: Strategjitë dhe ndikimi në shëndetësinë moderne 144
Nada Tërpo
Mbështetja e vendimmarrjes me inteligjencë artificiale në urgjencat paraspitalore: Qasje e bazuar në evidencë ndërkombëtare 146
Rustem Halili, Skënder Brataj, Indrit Jaupaj, Klejdi Cankja
Simulimi klinik si mjet edukimi dhe vlerësimi profesional në trajnimet e urgjencës (ATLS dhe

Midwifery Emergencies) 148

Eralda Doci Kraja

Njohja e simptomës dyadike dhe vete-kujdesi te të moshuarit me gjendje të shumëfishta kronike dhe kujdestarët e tyre joformalë që jetojnë në një vend me të ardhura të ulëta dhe të mesme 150

Fabiola Mane, Giulia Andrea Baldan, Dasilva Taci, Edona Gara, Alta Arapi, Sajmira Aderaj , Gennaro Rocco, Maddalena De Maria

Rreziku biologjik gjatë praktikës laboratorike te studentët e degës teknik laboratori 152

Nairda Mataj, Venemin Gega

Depresioni pas lindjes te nënat në rrethin e Elbasanit, Shqipëri, 2024-2025: Studim transversal 156

Andja Lala, Armelda Teta, Venemin Gega, Behije Gollobërda, Brikena Duka, Ilma Toci

Abstraktet Sesioni II 158

Salla 3

Parimet ligjore dhe legjislacioni shqiptar për profesionistët e infermierisë 159

Erind Thartori, Erikena Kasa, Xhulia Marina

Lindja natyrale dhe avantazhet e saj për nënën dhe fëmijën 161

Nina Nasafuga

Integrimi i telemedicines ne kujdesin infermieror: Nje qasje strategjike per Spitalin Rajonal Gjirokastër 163

Mimoza Llavdaniti, Gligor Llavdaniti, Elisa Baçi, Jani Baçi

Digitalizimi i monitorimit hemodinamik në reanimacion: Aplikimi i teknologjisë MostCare (PRAM) në praktikën klinike 165

Eugen Ismolli

Roli i teknologjisë në monitorimin e parametrave vitalë në NICU: Parashikimi i komplikacioneve tek të porsalindurit 167

Joniada (Kalthi) Sefa

Vlerësimi i rasteve të hospitalizuara për intoksikim nga substancat narkotike në shërbimin e toksikologjisë gjatë periudhës 2020-2024 dhe impakti i tyre në pacientë dhe sistemin shëndetësor 169

Elisabeta Çaushi, Armir Çaushi

Transporti neonatal dhe rëndësia e stabilizimit në urgjencë 171

Alda Elezi

Roli i infermierit dhe mamisë në menaxhimin e urgjencave obstetrikale: Një analizë e rasteve klinike 173

Luiza Lushi, File Bracja,Tatjana Milo
Burnout dhe cilësia e kujdesit: Një sfidë në rritje për sistemin shëndetësor 175
Florentina Idrizaj
Ndjekja e gruas me placenta previa 177
Entela Kampula, Ivia Elezi, Bukurie Çullhaj, Edlira Bashmeta
Cilësia e jetës së pacientëve që jetojnë me Astmë 179
Arta Zogu
Abstraktet Sesioni I 181
Salla 4
Implementimi i sistemeve të standardizuara të triazhit në shërbimet e urgjencës: Evidencë ndërkombëtare dhe sfidat e aplikimit në Shqipëri 182
Arben Beja
Vlerësimi i statusit të vitaminës D sipas moshës dhe gjinisë 184
Aleksandra Lamthi, Admir Nake
Hemoliza në këndvështrimin e infermierëve 186
Venemin Gega, Brunilda Mëhilli, Admir Nake, Ylli Alicka, Rajmonda Hida Oboni,Arkida Skenderi, Ilma Toci, Gjergji Doka, Andja Lala
Përdorimi i inteligjencës artificiale në menaxhimin shëndetësor. 188
Lindita Saja
Standardet e cilësisë dhe sigurisë së pacientit në radiologjinë intervencionuese 190
Besmira Berdufi
Njohuritë e grave shqiptare për Pap testin dhe kancerin e qafës së mitrës 192
Daniela Bimi
Kujdesi dinjitoz gjatë lindjes: një qasje globale 194
Aida Abdurrahmani
Menaxhimi i rasteve komplekse dhe patologjive bashkëshoqëruese në kujdesin shëndetësor parësor 196
Leonora Morava, Stela Kole
Ushqyerja me qumësht gjiri: përfitimet dhe sfidat gjatë gjidhënies – një analizë e faktorëve pengues dhe përvojave të nënave 198
Jurgena Lila
Integrimi i inteligjences artificiale (AI) ne interpretimin e radiografive, me qellim detektimin e

frakturave kockore 200

Sidorela Rexhepi, Bukurie Halili, Grejsi Axhi, Erneda Kaziu

Trajnimi me simulim për infermierët në sistemin emergjent mjekësor: Integrimi i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në kujdesin emergjent 202

Nuhi Mucmata, Skënder Brataj, Indrit Jaupaj, Ermal Haxhiasi

Stresi profesional dhe sindroma e burnout-it në profesionet shëndetësore 203

Eralda Dervishi, Elisabeta Çaushi

Abstraktet Sesioni II 206

Salla 4

Shëndetësia digjitale dhe transformimi i shërbimeve shëndetësore 207

Luljeta Habilaj, Juljana Xhindoli

Barriera dhe mundësitë në implementimin e teknologjisë në fizioterapi në zonat rurale të qarqeve Berat dhe Fier: një qasje e bazuar në praktikën klinike 209

Fatjon Hajdari, Erina Hilaj, Lorenc Cili

Roli kritik i mamisë në identifikimin e hershëm dhe menaxhimin e hemorragjisë postpartum gjatë fazës së katërt të lindjes 211

Blerina Bracellari

Menaxhimi i talasemisë në praktikën klinike: rëndësia e diagnostikimit të hershëm dhe terapive moderne 213

Françeska Gjyshja

Vlerësimi dhe roli i infermierëve lidhur me kujdesin ndaj foshnjave që vuajnë nga hidrocefalia 215

Sabirkë (Çollaku) Bogdani

Roli i Calprotektines fekale në sindromën e zorrës së irrituar 217

Jona Bërdufi

Përdorimi i inteligjencës artificiale në interpretimin e imazheve radiologjike dhe detektimin e frakturave 219

Kristina Çako

Kujdesi rutinë i të porsalindurit në 2 orët e para pas lindjes 221

Rigela Jatagani

Menaxhimi i urgjencave në departamentin e radiologjisë gjatë sezonit veror në Qarkun e Sarandës 223

Flogert Rraku
Ndikimi i teknologjisë digjitale në përmirësimin e kujdesit infermieror te pacientët me diabet mellitus 225
Arjeta Bajraktari
Hiperbilirubinemia neonatale: incidenca, faktorët e rrezikut dhe menaxhimi 227
Emrije Gjata
Abstraktet Sesioni I 229
Salla 5
Rendi i mbushjes së tubave me gjak në flebotomi: rëndësia për cilësinë pre-analitike 230
Emirela Cenomeri, Venemin Gega
Analiza retrospektive e shtrimeve spitalore në Qarkun e Elbasanit (2022–2025) 232
Adrian Beti, Alion Sejdini, Klea Karumi
Rehabilitimi i ecjes nëpermjet robotikes tek pacientet Post-Stroke 234
Kejdi Keci
Studentët e infermierisë dhe udhëheqësit klinik në Shqipëri: si ndikojnë marrëdhëniet në të nxënit dhe rezultatet e praktikës klinike 236
Valbona Lici
Rëndësia e metodës Schroth në trajtimin e pacientëve me skoliozë idiopatike tek mosha e adoleshencës 238
Shefqet Çullhaj
Kujdesi për pacientët e imobilizuar nga trauma: impakti në stafin infermieror dhe qasjet inovative në menaxhim 240
Erdjesa Sena, Rezarta Tota, Xhejni Kurti
Skanimet me rezonancë magnetike në distancë si zgjidhje strategjike për mungesën globale të fuqisë punëtore të teknikëve të imazherisë: përvoja e OMRIA në Shqipëri 242
Elona Dybeli, Alexander Uwer, Alket Collaku
Afrimi i kujdesit paliativ: nga distanca te kujdesi me dhembshuri në zonat rurale të Shqipërisë 244
Kristjana Sheshmina, Klea Gjata, Vasien Xhelili, Thimaq Karapanxho
Strategjite, nderhyrjet per te permiresuar mireqenien e profesionisteve te kujdesit shendetesor dhe per te reduktuar “burnout-in” 246
Gjergji Mance, Mimoza Llavdaniti
Inteligjenca artificiale në imazherinë e gjirit: Roli në vlerësimin e hershëm të karcinomës së gjirit -

rishikim i literaturës 248
Irena Piroli, Gentian Zervoi, Erla Mullalli, Elian Shehi, Enkeleda Karanxha
Kujdesi i përqendruar tek pacienti dhe familja në praktikën logopedike: Aplikimi në çrregullimet e komunikimit me origjinë neurologjike tek adultët 250
Andreson Vrapi
MRI e ekstremiteteve: Roli i Coil-eve të ndryshme, diferencat, pozicionimi dhe përshtatja klinike 252
Oresti Radaku
Abstraktet Sesioni II 254
Salla 5
Hartëzimi i praktikave të telemedicinës së infermierisë: një rishikim i përfshirë i modeleve, rezultateve dhe roleve profesionale 255
Blerina Duka, Jola Çini, Armela Zylfo, Fabiola Mane, Kujtime Vakeflliu, Alta Arapi, Armela Kapaj
Analizat bakterologjike: çelësi për zbulimin e infeksioneve 257
Marinela Zeqiri, Shkëlqim Zeqiri
Përmirësimi i praktikës klinike në edukimin e fizioterapisë përmes realitetit virtual dhe inteligjencës artificiale në epokën digjitale 259
Alta Arapi, Sidita Haxholli, Roxhensa Sula, Alisia Maliqi
Ndikimi i dixhitalizimit në saktësinë dhe sigurinë e trajtimit radioterapeutik me ortovoltazh në tumoret e lëkurës 261
Marsela Prendi, Enes Hafizi, Daniela Bega, Andri Gorjani, Sander Kola
Roli i inteligjencës artificiale në përmirësimin e cilësisë së kujdesit infermieror: një studim empirik mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e personelit infermieror 263
Gloria Bengaj , File Braçja Rajmonda Milloshi, Erind Thartori
Tele-triazhimi dhe dispeçerizimi digjital në sistemin ems 127: ndikimi në kohën e reagimit dhe efikasitetin operacional në Shqipëri 265
Llukan Koti, Skënder Brataj, Indrit Jaupaj, Klejdi Cankja, Gentjana Rexha
Urgjencat e sëmundjeve infektive: Roli i infermierisë në përgatitje, njohje të hershme dhe rezultatet e pacientëve 267
Suzana Sinakoli
Roli i CBCT në planifikimin e implanteve dentare dhe vlerësimin e patologjive shoqeruese 269
Sara Memaj
Përdorimi i realitetit virtual dhe inteligjencës artificiale në edukimin e infermierëve 271

Fabjon Aliaj
Integrimi i kujdesit paliativ në kujdesin shëndetësor parësor në Shqipëri: gatishmëria, mësimet dhe sfidat 273
Estela Skërmo, Klea Gjata, Irena Laska
Menaxhimi i plagëve post-operatore bazuar në evidencë: roli kyç i infermierit në parandalimin e komplikacioneve dhe sigurinë e pacientit 275
Elvira Qosja
Vlerësimi infermieror i modelit dietetik dhe stilit të jetesës që lidhen me marrjen e Vitaminës D tek të moshuarit dhe impakti i tyre në shëndet 277
Irisa Amiti, Anjeza Sejdiraj
Falenderime 279
ISBN 280

Rreth UISH

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë (UISH) është Ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve: infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laboratori, teknik/e imazherie, logopedist/e si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut, është i pavarur, profesional, i depolitizuar, i hapur për të gjithë anëtarët, pavarësisht nga përkatësitë e tyre racore, etnike, fetare apo politike.

Vizioni i UISH

Mbështet, investon për të udhëhequr profesionet e kujdesit shëndetësor, duke ofruar shëndet për të gjithë.

Impakti Global - Siguron ekspertizë, në mënyrë aktive dhe të rregullt, në nivele të larta globale ose rajonale shëndetësore, arsimore, sociale, rregullore.

Fuqizimi i anëtarësisë - në tre shtylla: Praktika Profesionale, rregulloret e planifikimit, Mirëqenia Sociale - Ekonomike për të adresuar sfidat kryesore në nivelet rajonale dhe kombëtare.

Lidershipi strategjik - Siguron udhëheqje strategjike për të avancuar profesionet e kujdesit për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme të popullatës, sistemeve shëndetësore (përfshirë shëndetin dhe kujdesin social).

Rritja innovative - Identifikon, siguron dhe zgjeron kompetencat dhe të ardhurat nga gjenerimi i mundësive, në përputhje me vlerat tona, për të arritur qëllimet e UISH.

Website: https://urdhriinfermierit.org/

Rreth Konferencës

Konferenca e Profesionistëve të Shëndetësisë, e organizuar nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, do të zhvillohet më 12 Maj 2026, pranë ambienteve të Hotel Plaza Tiranë.

Konferenca do të ketë si temë qendrore:

"Edukimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në epokën digjitale: teknologjia, realiteti virtual dhe inteligjenca artificiale"

Ky aktivitet shkencor synon të trajtojë transformimin e edukimit dhe zhvillimit profesional në kujdesin shëndetësor në kontekstin e digjitalizimit dhe inovacionit teknologjik. Në fokus do të jenë integrimi i teknologjive digjitale në procesin mësimor, përdorimi i simulimeve dhe realitetit virtual në trajnimin klinik, si dhe aplikimi i inteligjencës artificiale në praktikën dhe vendimmarrjen profesionale.

Konferenca do të shërbejë si platformë për prezantimin e kërkimeve shkencore, përvojave klinike dhe praktikave inovative nga profesionistë të fushave të ndryshme të shëndetësisë, duke nxitur bashkëpunimin ndërdisiplinar dhe avancimin e standardeve të edukimit në vazhdim.

Përmes prezantimeve orale dhe poster, synohet shkëmbimi i njohurive dhe promovimi i qasjeve bashkëkohore në formimin profesional, në përputhje me zhvillimet globale në teknologjinë shëndetësore.

Blerina Duka

President i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë

Të nderuar kolegë,

Kam nderin dhe kënaqësinë t'ju ftoj në një event shkencor dhe profesional kushtuar edukimit dhe zhvillimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor në epokën digjitale, i cili do të zhvillohet më **12 Maj 2026**, në **Hotel Plaza, Tiranë**.

Ky event, synon të bashkojë profesionistë të kujdesit shëndetësor nga fusha të ndryshme, përfshirë infermierë, mami, mjekë, akademikë, drejtues institucionesh shëndetësore, studentë dhe profesionistë të rinj, për të ndarë njohuri, përvoja dhe qasje inovative në edukimin dhe praktikën shëndetësore.

Në qendër të diskutimeve do të jetë transformimi digjital, duke eksploruar rolin e teknologjisë shëndetësore, realitetit virtual dhe inteligjencës artificiale në rritjen e kompetencave profesionale, përmirësimin e vendimmarrjes klinike dhe garantimin e sigurisë së pacientit.

Përmes sesioneve plenare, paneleve të diskutimit dhe prezantimeve shkencore, ky event përfaqëson një hapësirë dialogu profesional, rritjeje akademike dhe fuqizimi institucional. Ju mirëpresim të na bashkoheni në Tiranë për një event frymëzues, bashkëkohor dhe të pasur me njohuri.

Me respekt,

Blerina Duka

President i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë

KOMITETI SHKENCOR

PhD BLERINA DUKA

PhD EMANUELA PRENDI

PhD ENKELEDA GJINI

PhD ALKETA DERVISHI

PhD JULJANA XHINDOLI

PhD SAJMIRA ADERAJ

PhD ALBANA POLOSKA

PhD VIOLETA ZANAJ

PhD ELONA DYBELI

PhD ALTA ARAPI

KOMITETI ORGANIZATIV

Blerina Duka
President i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë

Lutfi Lami
Zv. President Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Arjona Rakipi
Specialiste e Edukimit në Vazhdim Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Shkëlqim Zeqiri
President Qarku Vlorë Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Shpresa Molla
President Qarku Lezhë Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Shpresa Bici
President Qarku Dibër Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Elisabeta Rista
President Qarku Fier Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Alion Sejdini
President Qarku Elbasan Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Delantina Mulla
Sekretare e Pergjithshme Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Anduela Vaso
President Qarku Tiranë Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Artan Molla
President Qarku Shkodër Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Ermioni Dabaj
President Qarku Durrës Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Laurent Gega
President Qarku Berat Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Mimoza Isufi
President Qarku Korçë Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Etleva Sokoli
President Qarku Kukës Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Ledion Pandos
President Qarku Gjirokastër Urdhri i Infermierit të Shqipërisë

Lorenc Çili
Qarku Berat

Mexhit Marku
Qendra Spitalore Universitare “QSUNT”

PROGRAMI SHKENCOR

Konferenca e Profesionistëve të Kujdesit Shëndetësor

"Edukimi i Profesionistëve të Kujdesit Shëndetësor në Epokën Digitale"

Teknologjia • Realiteti Virtual • Inteligjenca Artificiale

E martë, 12 maj 2026

Hotel Plaza, Tiranë - Shqipëri

08:30 - 09:30 | **REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE**

Holli i pritjes | Recepsion

09:30 - 10:00 | **HAPJA E KONFERENCËS**

Betimi i Infermierit

FJALA E MIRËSEARDHJES

Znj. Blerina DUKA

Presidente e Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë

Shfaqja e videos promovuese

FJALA PËRSHËNDETËSE E MINISTRES SË SHËNDETËSISË

Znj. Evis SALA

Dhënia e vlerësimeve

PUSHIM KAFE NË HOLL

10:00 - 13:00 | **SESIONI I - SESIONE PARALELE : SALLAT : QUEEN GERALDINE 1, QUEEN GERALDINE 2, THE STANDARD, DORA D'ISTRIA, MARIN BARLETI**

13:00 - 14:00 | **PUSHIM DREKE NË HOLL**

14:00 - 17:00 | **SESIONI II - SESIONE PARALELE : SALLAT : QUEEN GERALDINE 1, QUEEN GERALDINE 2, THE STANDARD, DORA D'ISTRIA, MARIN BARLETI**

16:45 - 17:00 | **Konkluzionet e Konferencës. Shpërndarja e Çertifikatave për Pjesëmarrësit**

SESIONI I
SALLA 1 - QUEEN GERALDINE 1

Moderatorë *:* **Sajmira Aderaj, Juljana Xhindoli**

10:00 - 10:20 | "Balancimi mes lehtësimit dhe rrezikut: Polifarmacia dhe aderenca ndaj mjekimit te pacientët në kujdes paliativ"

Referon: **Irena Laska**

10:20 - 10:40 | "Kompetencat e Lidershipit dhe nevojat e zhvillimit në sistemin shëndetësor shqiptar - Një studim cilësor"

Referon: **Dhurata Ivziku**

10:40-11:00| "Politikat shëndetësore inkluzive dhe ndikimi i tyre në praktikën klinike infermierore: Një scoping review e literaturës ndërkombëtare"

Referon: **Aurora Kokici**

11:00-11:20| "Qasjet inovative në kujdesin infermieror për parandalimin e komplikacioneve në njësinë e kujdesit postanestezik"

Referon: **Alketa Dervishi**

11:20-11:40| "Bashkëpunimi ndërdisiplinor midis infermierëve dhe terapistëve okupacionalë në epokën digjitale: Promovimi i kujdesit të përqendruar te personi dhe autonomisë funksionale"

Referon: **Mimoza Doci**

11:40-12:00| "Arsimi i lartë në epokën e AI: Midis inovacionit dhe sfidave akademike"

Referon: **Eljo Paja**

12:00-12:15| "Zhvillimi i versionit shqip të ECDI2030: Përkthimi, përshtatja kulturore dhe studimi pilot paraprak"

Referon: **Jola Çini**

12:15-12:30| "Infeksionet urinare te fëmijët në Elbasan, kujdesi infermieror në parandalimin e tyre"

Referon: **Shqipe Luta**

12:30 - 12:45 |"Vlerësimi i ndikimit të faktorëve demografikë dhe shëndetësorë në cilësinë e jetës tek të moshuarit"

Referon: **Entela Drizaj**

12:45 - 13:00 |" Vlerësimi i bioshënuesve të reninës, aldosteronit dhe elektroliteve në hiperaldosteronizmin sekondar"

Referon: **Brunilda Mezani**

13:00-14:00 | **PUSHIM DREKE NË HOLL**

SESIONI II
SALLA 1 - QUEEN GERALDINE 1

Moderatorë *:* **Anduela Vaso , Lutfi Lami**

14:00 - 14:15 | "Sfidat etike të përdorimit të Inteligjencës artificiale në kujdesin shëndetësor"

Referon: **Brizida Refatllari**

14:15 - 14:30 | "Mësimdhënia digjitale dhe simulimi klinik në edukimin shëndetësor: Sfidat dhe mundësitë nga qendra digjitale simulatore në Fakultetin e Shëndetit, Shqipëri"

Referon: **Juljana Xhindoli**

14:30 - 14:45 | "Eksplorimi i njohurive dhe qëndrimeve ndaj fraxhilitetit dhe vlerësimit geriatrik të profesionistëve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri"

Referon: **Brunilda Elezi**

14:45 - 15:00 | "Incidenca e AVC në Neurologji"

Referon: **Antigoni Bullari**

15:00 - 15:15 | "Inovacioni dhe teknologjia në proceset infermieristike: Ndikimi, sfidat dhe perspektivat për praktikën klinike"

Referon: **Lutfi Lami**

15:15 - 15:30 | "Kujdesi infermieror te pacientët me astmë bronkiale: Integrimi i teknologjisë në praktikën klinike"

Referon: **Violeta Zanaj**

15:30 - 15:45 | "Vlerësimi i njohurive dhe praktikave të studentëve të infermierisë mbi faktorët e rrezikut dhe vetë-ekzaminimin e gjirit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit"

Referon: **Rajmonda Oboni (Hida)**

15:45 - 16:00 | "Roli i parametrave të skanimit dhe optimizimi i tyre në cilësinë e imazhit të Angio-CT në diagnostikimin e tromboembolisë pulmonare"

Referon: **Hane Peposhi**

16:00 - 16:15 | " Transformimi digjital i edukimit infermieror: Nga mësimi tradicional te kompetencat e epokës digjitale"

Referon: **Silvana Gripshi**

16:15 - 16: 30 | " Trajtimi i lëndimeve nga armët e zjarrit përmes një fiksatori të jashtëm"

Referon: **Elona Hasalla**

16:30 - 16: 45 | "Nga CTA kardiake te angiografia koronare"

Referon: **Alket Çollaku**

16:45-17:00 | PYETJE, DISKUTIME DHE KONKLUZIONET E KONGRESIT

SESIONI I
SALLA 2 - QUEEN GERALDINE 2

Moderatorë *:* **Delantina Mulla , Anjeza Kolaneci**

10:00-10:15| "Menaxhimi dhe incidenca e infeksioneve në kirurgjinë endoskopike të hipofizës: Studim retrospektiv në QSUT"

Referon: **Manjola Pjetri**

10:15-10:30| "Optimizimi i triazhit emergjent në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM 127) në Shqipëri përmes inteligjencës artificiale: Një studim i bazuar në praktikë (2020–2024)"

Referon: **Indrit Jaupaj**

10:30-10:45| "Roli i E-Health në menaxhimin dhe vlerësimin e dhembjes: Rishikim narrativ"

Referon: **Armelda Teta**

10:45-11:00| "Roli i PNF në përmirësimin e kontrollit motorik dhe stabilitetit funksional gjatë aktiviteteve të përditshme tek pacientët me probleme muskuloskeletore lumbare"

Referon: **Roxhensa Sula**

11:00-11:15| "Njohuri mbi aneminë nga mungesë hekuri te studentët e Universitetit të Vlorës"

Referon: **Stiliana Brokaj**

11:15-11:30| **"**Preeklampsia dhe eklampsia në shtatzani: Studim rastesh retrospektiv në maternitetin "Shtëpia e Lindjes" në Spitalin Rajonal Korçë, 2020-2025"

Referon: **Delantina Mulla**

11:30-11:45| " Gabimet infermierore në njësinë e kujdesit intensiv: Analizë retrospektive dhe implikimet për sigurinë e pacientit (2018-2023)"

Referon: **Arjona Rakipi**

11:45-12:00| "Integrimi i densitometrisë DXA, përpunimit digjital të imazhit dhe inteligjencës artificiale në vlerësimin e densitetit kockor"

Referon: **Besina Tomani**

12:00-12:15 |"Simulimi klinik si mjet inovativ në edukimin dhe zhvillimin profesional të infermierëve"

Referon: **Elona Karrica**

12:15-12:30|Prevalenca e "burnout"-it te personeli infermieror në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Referon: **Marvina Meta**

12:30-12:45|"Laparoskopia gjinekologjike: Nderhyrja miniinvazive dhe kujdesi infermieror"

Referon: **Anjeza Kolaneci**

12:45-13:00|"Menaxhimi klinik dhe infermieror i hiperbilirubinemisë neonatale-Efektiviteti i fototerapisë në trajtim"

Referon: **Ermelinda Xhari**

13:00-14:00 | PUSHIM DREKE NË HOLL

SESIONI II
SALLA 2 - QUEEN GERALDINE 2

Moderatorë *:* **Shpresa Molla , Elisabeta Rista**

14:00 - 14:15 | "Metodat gjenetike në diagnoztikimin e leukemisë mieloide akute: Teknikat e reja dhe perspektiva për të ardhmen"

Referon: **Klajdi Tarko**

14:15 - 14:30 | "Ndikimi i ndërhyrjeve të udhëhequra nga infermierët në menaxhimin e diabetit"

Referon: **Lediana Bardho (Gega)**

14:30 - 14:45 | "Menaxhimi i konvulsioneve febrile në urgjencën pediatrike: Studim rastesh në Spitalin Rajonal Lezhë (2022–2024)"

Referon: **Shpresa Molla**

14:45 - 15:00 | "Ndikimi i inteligjences artificiale ne sigurine e pacientit gjate ekzaminimit skanerik"

Referon: **Bukurie Halili**

15:00 - 15:15 | "Roli i teknologjise edhe inovacionit në përmiresimin e kujdesit të pacientëve në dializë: Sfidat dhe perspektivat infermierore"

Referon: **Aurora Kola**

15:15 - 15:30 | "Komunikimi në kujdesin paliativ: sfidat, barrierat dhe implikimet etike në fund të jetës"

Referon: **Vasien Xhelili**

15:30 - 15:45 | "Monitorimi dixhital i vetë-kujdesit post-operator në rinoseptoplastikën me teknikë të mbyllur : Një studim pilot mbi turizmin mjekësor"

Referon: **Mario Golemi**

15:45 - 16:00 | "Perceptimi i shendetit fizik dhe psikosocial i te moshuarve dhe lidhja me performancen e tyre konjitive.Impakti në rezultatet e cilësisë së jetës"

Referon: **Andia Pelari**

16:00 - 16:15 | "Home care nursing në epokën digjitale"

Referon: **Blerim Maloku**

16:15 - 16: 30 | "Roli i teknologjisë dhe terapive të avancuara në menaxhimin bashkëkohor të fibrozës kistike tek fëmijët"

Referon: **Elisabeta Rista**

16:30 - 16: 45 | "Ndërtimi i kapaciteteve të lidershipit për të forcuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e kujdesit: Njohuri nga një analizë kombëtare e nevojave në Shqipëri"

Referon: **Blerina Duka**

16:45-17:00 | PYETJE, DISKUTIME DHE KONKLUZIONET E KONGRESI

SESIONI I
SALLA 3 - THE STANDARD

Moderatorë *:* **Ermioni Dabaj , Gentjana Shembitraku**

10:00-10:15| "Strategjitë e marketingut të infermierisë për mbajtjen e fuqisë punëtore: Një perspektivë globale"

Referon: **Indrit Bimi**

10:15-10:30| "Vaksinimi kundër COVID-19, seroprevalenca dhe efektiviteti i vaksinës tek punonjësit e kujdesit shëndetësor në Shqipëri, 2021–2023: Analizë duke përdorur sistemin REDCap"

Referon: **Ermioni Dabaj**

10:30-10:45| "Edukimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në epokën digjitale"

Referon: **Nevila Duraku**

10:45-11:00| "Roli dhe rëndësia e teknikëve të radiologjisë në kujdesin shëndetësor modern"

Referon: **Mustafë Buzoku**

11:00-11:15| "Terapia intensive neonatale dhe rreziku i humbjes së dëgjimit"

Referon: **Gentjana Shembitraku**

11:15-11:30| "Kujdesi ndaj nënës në periudhën post-partum në epokën moderne"

Referon: **Fatbardha Faqolli**

11:30-11:45| "Përmirësimi i kujdesit të pacientit përmes praktikës së bazuar në evidencë: Strategjitë dhe ndikimi në shëndetësinë moderne"

Referon: **Nada Tërpo**

11:45-12:00| "Mbështetja e vendimmarrjes me inteligjencë artificiale në urgjencat paraspitalore: Qasje e bazuar në evidencë ndërkombëtare"

Referon: **Rustem Halili**

12:00-12:15| "Simulimi klinik si mjet edukimi dhe vlerësimi profesional në trajnimet e urgjencës (ATLS dhe Midwifery Emergencies)"

Referon: **Eralda Kraja Doci**

12:15-12:30| "Njohja e simptomës dyadike dhe vete-kujdesi te të moshuarit me gjendje të shumëfishta kronike dhe kujdestarët e tyre joformalë që jetojnë në një vend me të ardhura të ulëta dhe të mesme"

Referon: **Fabiola Mane**

12:30-12:45| "Rreziku biologjik gjatë praktikës laboratorike te studentët e degës teknik laboratori"

Referon: **Nairda Mataj**

12:30-12:45| "Depresioni pas lindjes te nënat në rrethin e Elbasanit, Shqipëri, 2024–2025: Studim transversal"

Referon: **Andja Lala**

13:00-14:00 | **PUSHIM DREKE NË HOLL**

SESIONI II
SALLA 3 - THE STANDARD

Moderatorë *:* **Erind Thartori , Mimoza Llavdaniti**

14:00 - 14:15 | "Parimet ligjore dhe legjislacioni shqiptar për profesionistët e infermierisë"

Referon: **Erind Thartori**

14:15 - 14:30 | "Lindja natyrale dhe avantazhet e saj për nënën dhe fëmijën"

Referon: **Nineta Nasufaga**

14:30 - 14:45 | "Integrimi i telemedicines ne kujdesin infermieror: Nje qasje strategjike per spitalin rajonal Gjirokaster"

Referon: **Mimoza Llavdaniti**

14:45 - 15:00 | "Digitalizimi i monitorimit hemodinamik në reanimacion: Aplikimi i teknologjisë MostCare (PRAM) në praktikën klinike"

Referon: **Eugen Ismolli**

15:00 - 15:15 | "Roli i teknologjisë në monitorimin e parametrave vitalë në NICU: Parashikimi i komplikacioneve tek të porsalindurit"

Referon: **Joniada Sefa**

15:15 - 15:30 | "Vlerësimi i rasteve të hospitalizuara për intoksikim nga substancat narkotike në shërbimin e toksikologjisë gjatë periudhës 2020–2024 dhe impakti i tyre në pacientë dhe sistemin shëndetësor"

Referon: **Elisabeta Çaushi**

15:30 - 15:45 | **"** Transporti neonatal dhe rëndësia e stabilizimit në urgjencë"

Referon: **Alda Elezi**

15:45 - 16:00 | "Roli i infermierit dhe mamisë në menaxhimin e urgjencave obstetrikale: Një analizë e rasteve klinike"

Referon: **Luiza Lushi**

16:00 - 16:15 | "Burnout dhe cilësia e kujdesit: Një sfidë në rritje për sistemin shëndetësor"

Referon: **Florentina Idrizaj**

16:15 - 16: 30 | "Ndjekja e gruas me placenta previa"

Referon: **Entela Kampula**

16:30 - 16: 45 | "Cilësia e jetës së pacientëve që jetojnë me Astmë"

Referon: **Arta Zogu**

16:45-17:00 | PYETJE, DISKUTIME DHE KONKLUZIONET E KONGRESIT

SESIONI I
SALLA 4 - DORA D'ISTRIA

Moderatorë *:* **Lindita Saja, Elona Hasalla**

10:00 - 10:15 | " Implementimi i sistemeve të standardizuara të triazhit në shërbimet e urgjencës: Evidencë ndërkombëtare dhe sfidat e aplikimit në Shqipëri"

Referon: **Arben Beja**

10:15 - 10:30 | "Vlerësimi i statusit të vitaminës D sipas moshës dhe gjinisë"

Referon: **Aleksandra Lamthi**

10:30-10:45 | "Hemoliza në këndvështrimin e infermierëve"

Referon: **Venemin Gega**

10:45-11:00 | "Përdorimi i inteligjencës artificiale në menaxhimin shëndetësor"

Referon: **Lindita Saja**

11:00-11:15| "Standardet e cilësisë dhe sigurisë së pacientit në radiologjinë intervencionuese"

Referon: **Besmira Berdufi**

11:15-11:30| " Njohuritë e grave shqiptare për Pap Testin dhe kancerin e qafës së mitrës"

Referon: **Daniela Bimi**

11:30-11:45| "Kujdesi dinjitoz gjatë lindjes: një qasje globale**"**

Referon: **Aida Abdurrahmani**

11:45 - 12:00| "Menaxhimi i rasteve komplekse dhe patologjive bashkëshoqëruese në kujdesin shëndetësor parësor"

Referon: **Leonora Morava**

12:00 -12:15| "Ushqyerja me qumësht gjiri: përfitimet dhe sfidat gjatë gjidhënies – një analizë e faktorëve pengues dhe përvojave të nënave"

Referon: **Jurgena Lila**

12:15-12:30|"Integrimi i inteligjences artificiale (AI) ne interpretimin e radiografive, me qellim detektimin e frakturave kockore"

Referon: **Sidorela Rexhepi**

12:30-12:45 | "Trajnimi me simulim për infermierët në sistemin emergjent mjekësor: Integrimi i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në kujdesin emergjent"

Referon: **Nuhi Mucmata**

12:45-13:00| "Stresi profesional dhe sindroma e burnout-it në profesionet shëndetësore"

Referon: **Eralda Dervishi**

13:00-14:00 | **PUSHIM DREKE NË HOLL**

SESIONI II
SALLA 4 - DORA D'ISTRIA

Moderatorë *:* **Albana Poloska , Etleva Sokoli**

14:00 - 14:15 | "Shëndetësia digjitale dhe transformimi i shërbimeve shëndetësore"

Referon: **Luljeta Habilaj**

14:15 - 14:30 | "Barriera dhe mundësitë në implementimin e teknologjisë në fizioterapi në zonat rurale të qarqeve Berat dhe Fier: një qasje e bazuar në praktikën klinike"

Referon: **Fatjon Hajdari**

14:30 - 14:45 | "Roli kritik i mamisë në identifikimin e hershëm dhe menaxhimin e hemorragjisë postpartum gjatë fazës së katërt të lindjes"

Referon: **Blerina Bracellari**

14:45 - 15:00 | "Menaxhimi i talasemisë në praktikën klinike: rëndësia e diagnostikimit të hershëm dhe terapive moderne"

Referon: **Françeska Gjyshja**

15:00 - 15:15 | "Vlerësimi dhe roli i infermierëve lidhur me kujdesin ndaj foshnjave që vuajnë nga hidrocefalia"

Referon: **Sabirkë (Çollaku) Bogdani**

15:15 - 15:30 | "Roli i Calprotektines fekale në sindromën e zorrës së irrituar"

Referon: **Jona Bërdufi**

15:30 - 15:45 | "Përdorimi i inteligjencës artificiale në interpretimin e imazheve radiologjike dhe detektimin e frakturave"

Referon: **Kristina Çako**

15:45 - 16:00 | "Kujdesi rutinë i të porsalindurit në 2 orët e para pas lindjes"

Referon: **Rigela Jatagani**

16:00 - 16:15 | "Menaxhimi i urgjencave në departamentin e radiologjisë gjatë sezonit veror në Qarkun e Sarandës"

Referon: **Flogert Rraku**

16:15 - 16: 30 | "Ndikimi i teknologjisë digjitale në përmirësimin e kujdesit infermieror te pacientët me diabet mellitus"

Referon: **Arjeta Bajraktari**

16:30 - 16:45 | "Hiperbilirubinemia neonatale: incidenca, faktorët e rrezikut dhe menaxhimi"

Referon: **Emrije Gjata**

16:45-17:00 | PYETJE, DISKUTIME DHE KONKLUZIONET E KONGRESIT

SESIONI I
SALLA 5 - MARIN BARLETI

Moderatorë *:* **Elona Dybeli , Valbona Lici**

10:00-10:15| "Rendi i mbushjes së tubave me gjak në flebotomi: rëndësia për cilësinë pre-analitike"

Referon: **Emirela Cenomeri**

10:15-10:30| "Analiza retrospektive e shtrimeve spitalore në Qarkun e Elbasanit (2022–2025)"

Referon: **Adrian Beti**

10:30-10:45| "Rehabilitimi i ecjes nëpermjet robotikes tek pacientet Post-Stroke"

Referon: **Kejdi Keci**

10:45-11:00| "Studentët e infermierisë dhe udhëheqësit klinik në Shqipëri: si ndikojnë marrëdhëniet në të nxënit dhe rezultatet e praktikës klinike"

Referon: **Valbona Lici**

11:00-11:15| "Rëndësia e metodës Schroth në trajtimin e pacientëve me skoliozë idiopatike tek mosha e adoleshencës"

Referon: **Shefqet Çullhaj**

11:15-11:30| " Kujdesi për pacientët e imobilizuar nga trauma: impakti në stafin infermieror dhe qasjet inovative në menaxhim"

Referon: **Erdjesa Sena**

11:30-11:45| " kanimet me rezonancë magnetike në distancë si zgjidhje strategjike për mungesën globale të fuqisë punëtore të teknikëve të imazherisë: përvoja e OMRIA në Shqipëri"

Referon: **Elona Dybeli**

11:45 -12:00| "Afrimi i kujdesit paliativ: nga distanca te kujdesi me dhembshuri në zonat rurale të Shqipërisë"

Referon: **Kristjana Sheshmina**

12:00-12:15| "Strategjite, nderhyrjet per te permiresuar mireqenien e profesionisteve te kujdesit shendetesor dhe per te reduktuar Burnout-in"

Referon: **Gjergji Mance**

12:15-12:30| "Inteligjenca artificiale në imazherinë e gjirit: Roli në vlerësimin e hershëm të karcinomës së gjirit - rishikim i literaturës"

Referon: **Irena Piroli**

12:30-12:45| **"**Kujdesi i përqendruar te pacienti dhe familja në praktikën logopedike: Aplikimi në çrregullimet e komunikimit me origjinë neurologjike tek adultët **"**

Referon: **Andreson Vrapi**

12:45-13:00| "MRI e ekstremiteteve: Roli i Coil-eve të ndryshme, diferencat, pozicionimi dhe përshtatja klinike"

Referon: **Oresti Radaku**

13:00-14:00 | **PUSHIM DREKE NË HOLL**

SESIONI II
SALLA 5 - MARIN BARLETI

Moderatorë *:* **Blerina Duka , Alketa Dervishi**

14:00 - 14:15 | "Hartëzimi i praktikave të telemedicinës së infermierisë: një rishikim i përfshirë i modeleve, rezultateve dhe roleve profesionale"

Referon: **Blerina Duka**

14:15 - 14:30 | "Analizat bakterologjike: çelësi për zbulimin e infeksioneve"

Referon: **Marinela Zeqiri**

14:30 - 14:45 | "Përmirësimi i praktikës klinike në edukimin e fizioterapisë përmes realitetit virtual dhe inteligjencës artificiale në epokën digitale"

Referon: **Alta Arapi**

14:45 - 15:00 | "Ndikimi i dixhitalizimit në saktësinë dhe sigurinë e trajtimit radioterapeutik me ortovoltazh në tumoret e lëkurës"

Referon: **Marsela Prendi**

15:00 - 15:15 | "Roli i inteligjencës artificiale në përmirësimin e cilësisë së kujdesit infermieror: një studim empirik mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e personelit infermieror"

Referon: **Gloria Bengaj**

15:15 - 15:30 | "Tele-triazhimi dhe dispeçerizimi digjital në sistemin ems 127: ndikimi në kohën e reagimit dhe efikasitetin operacional në Shqipëri"

Referon: **Llukan Koti**

15:30 - 15:45 | "Urgjencat e sëmundjeve infektive: Roli i infermierisë në përgatitje, njohje të hershme dhe rezultatet e pacientëve"

Referon: **Suzana Sinakoli**

15:45 - 15:55 | "Roli i CBCT në planifikimin e implanteve dentare dhe vlerësimin e patologjive shoqeruese"

Referon: **Sara Memaj**

15:55 - 16:10 | "Përdorimi i realitetit virtual dhe inteligjencës artificiale në edukimin e infermierëve"

Referon: **Fabjon Aliaj**

16:10 - 16:20 | "Integrimi i kujdesit paliativ në kujdesin shëndetësor parësor në Shqipëri: gatishmëria, mësimet dhe sfidat"

Referon: **Estela Skërmo**

16:20 - 16:30 | "Menaxhimi i plagëve post-operatore bazuar në evidencë: roli kyç i infermierit në parandalimin e komplikacioneve dhe sigurinë e pacientit"

Referon: **Elvira Qose**

16:30 - 16: 45 | "Vlerësimi infermieror i modelit dietetik dhe stilit të jetesës që lidhen me marrjen e Vitaminës D tek të moshuarit dhe impakti i tyre në shëndet"

Referon: **Irisa Amiti**

16:45-17:00 | **PYETJE, DISKUTIME DHE KONKLUZIONET E KONGRESIT**

SESION PARALEL

SESIONI I

SALLA 1

ABSTRAKTET

BALANCIMI MES LEHTËSIMIT DHE RREZIKUT: POLIFARMACIA DHE ADERENCA NDAJ MJEKIMIT TE PACIENTËT NË KUJDES PALIATIV

Irena Laska[1], Vasien Xhelili

[1] Drejtor Ekzekutiv Qendra e Kujdesit Paliativ "Mary Potter" Korçë, Shqipëri
E-mail: irenalaska@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrja: Polifarmacia është e zakonshme në kujdesin paliativ dhe lidhet ngushtë me multimorbiditetin dhe kompleksitetin e simptomave. Pacientët me kancer, në faza të avancuara, shpesh kanë nevojë për përdorimin e shumë medikamenteve njëkohësisht për kontrollin e simptomave dhe menaxhimin e sëmundjeve bashkëshoqëruese, duke rritur rrezikun për efekte anësore, barrë terapeutike dhe ulje të aderencës ndaj trajtimit.

Objektivat: Ky studim synon të eksplorojë se si multimorbiditeti ndikon në polifarmaci dhe aderencën ndaj mjekimit te pacientët në kujdes paliativ, si dhe të identifikojë faktorët kryesorë që ndikojnë në menaxhimin e sigurt të medikamenteve.

Metodologjia: Ky studim përshkrues observacional u zhvillua në shërbimin e "Mary Potter" Hospice në Shqipëri. Studimi përfshiu 268 pacientë me kancer në fazë terminale, gjatë vitit 2024. Të dhënat u mblodhën përmes analizës së kartelave të medikamenteve të pacientëve, shënimeve të ekipit multidisiplinar (MDT), feedback-ut të strukturuar nga pacientët dhe kujdestarët, si dhe vëzhgimeve gjatë vizitave në shtëpi.

Rezultatet: Polifarmacia ishte e pranishme në 100% të pacientëve. Multimorbiditeti rriti ndjeshëm barrën e medikamenteve dhe kompleksitetin e përshkrimit të tyre. Aderenca ndaj mjekimit u ndikua shpesh nga frika ndaj efekteve anësore dhe nga kuptimi i kufizuar i përfitimeve të trajtimit. Kujdestarët luajtën një rol kyç në administrimin e medikamenteve dhe në identifikimin e efekteve të padëshiruara. Rishikimi i strukturuar i medikamenteve u shoqërua me përmirësim të kontrollit të simptomave dhe reduktim të distresit te pacientët.

Konkluzionet: Menaxhimi i polifarmacisë në kujdesin paliativ kërkon një balancë të kujdesshme midis lehtësimit të simptomave dhe barrës terapeutike. Një qasje multidisiplinare, që përfshin rishikimin e rregullt të medikamenteve dhe strategjitë e "deprescribing" (ulja graduale ose ndërprerja e medikamenteve të panevojshme), është thelbësore për të përmirësuar sigurinë e trajtimit, për të reduktuar ndërhyrjet e panevojshme dhe për të rritur cilësinë e jetës. Forcimi i komunikimit dhe përfshirja e kujdestarëve janë elementë kyç për përmirësimin e aderencës dhe rezultateve të pacientëve.

Fjalët kyçe: *Kujdesi paliativ, Polifarmacia, Aderenca ndaj mjekimit, Multimorbiditeti, Siguria e pacientit.*

BALANCING RELIEF AND RISK: POLYPHARMACY AND MEDICATION ADHERENCE IN PALLIATIVE CARE PATIENTS

Irena Laska [1], Vasien Xhelili
[1] Executive Director, "Mary Potter" Palliative Care Centre, Korçë, Albania
E-mail: irenalaska@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Polypharmacy is common in palliative care and is closely associated with multimorbidity and symptom complexity. Patients with advanced cancer often require multiple medications simultaneously for symptom control and management of comorbid conditions, increasing the risk of adverse effects, treatment burden, and reduced medication adherence.

Objective: This study aims to explore how multimorbidity influences polypharmacy and medication adherence in palliative care patients, as well as to identify key factors affecting safe medication management.

Methodology: This descriptive observational study was conducted at the "Mary Potter" Hospice in Albania. The study included 268 patients with terminal-stage cancer during 2024. Data was collected through analysis of patients' medication charts, multidisciplinary team (MDT) notes, structured feedback from patients and caregivers, and observations during home visits.

Results: Polypharmacy was present in 100% of patients. Multimorbidity significantly increased medication burden and prescription complexity. Medication adherence was frequently affected by fear of side effects and limited understanding of treatment benefits. Caregivers played a key role in medication administration and in identifying adverse effects. Structured medication review was associated with improved symptom control and reduced patient distress.

Conclusions: Managing polypharmacy in palliative care requires a careful balance between symptom relief and treatment burden. A multidisciplinary approach, including regular medication review and deprescribing strategies, is essential to improve treatment safety, reduce unnecessary interventions, and enhance quality of life. Strengthening communication and involving caregivers are key elements in improving adherence and patient outcomes.

Keywords: *Palliative care, polypharmacy, medication adherence, multimorbidity, patient safety.*

KOMPETENCAT E LIDERSHIPIT DHE NEVOJAT PËR ZHVILLIM NË SISTEMIN SHËNDETËSOR SHQIPTAR - NJË STUDIM CILËSOR

Dhurata Ivziku[1,2], Blerina Duka[3,4], Anila Jance[4]
[1] Departamenti i Profesioneve Shëndetësore, Fondazione Policlinico Universitario Campus Bio-Medico, Romë, Itali
[2] Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë
[3] UISH, Tiranë, Shqipëri
[4] Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri
E-mail: dhurata.ivziku@unicamillus.org

ABSTRAKT

Hyrje: Zhvillimi i kompetencave të lidershipit në organizatat shëndetësore njihet gjithnjë e më shumë si një faktor kyç për garantimin e cilësisë së kujdesit, sigurisë së pacientit dhe qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor. Menaxherët në shëndetësi përballen me mjedise komplekse të karakterizuara nga kufizime burimesh, ndryshime organizative dhe rritje të kërkesave të pacientëve. Megjithatë, në shumë kontekste, përfshirë Shqipërinë, zhvillimi i lidershipit mbetet i pastrukturuar dhe jo i standardizuar.
Qëllimi: Të përshkruhen kompetencat e lidershipit dhe të identifikohen nevojat për zhvillim të lidershipit tek menaxherët e sistemit shëndetësor shqiptar.
Metodat: U përdor një dizajn cilësor përshkrues. U realizuan intervista gjysmë të strukturuara me drejtues institucionesh shëndetësore, menaxherë dhe infermierë të përfshirë në role drejtuese. Kriteret e përfshirjes kërkonin që pjesëmarrësit të kishin përvojë në pozicione menaxheriale ose lidershipi. Në total u zhvilluan 28 intervista. Të dhënat u analizuan përmes analizës induktive të përmbajtjes sipas metodës së Elo dhe Kyngäs. Studimi mori miratim etik nga komiteti përkatës.
Rezultatet: Pjesëmarrësit kishin një moshë mesatare prej 50 vjeç dhe shumica ishin femra. Nga analiza u identifikuan tre tema kryesore:(1) Kompetencat e lidershipit si bazë për menaxhim efektiv, duke theksuar rëndësinë e vendimmarrjes, koordinimit të ekipit, komunikimit dhe sigurimit të cilësisë;(2) Boshllëqe në zhvillimin dhe përgatitjen e lidershipit, përfshirë mungesën e trajnimeve formale, procese të pa standardizuara të edukimit në vazhdim dhe mbështetjen kryesisht në ekspertizën klinike;(3) Nevoja për transformim drejt një modeli modern lidershipi, të bazuar në fleksibilitet, bashkëpunim dhe evidencë shkencore, si dhe adresimin e sfidave si mungesa e stafit, kompleksiteti i sistemit dhe digjitalizimi.
Përfundime: Kompetencat e lidershipit konsiderohen thelbësore për menaxhimin efektiv dhe performancën e sistemit shëndetësor, megjithatë ekzistojnë boshllëqe të konsiderueshme në zhvillimin dhe mbështetjen e tyre institucionale. Gjetjet theksojnë nevojën urgjente për programe të strukturuara trajnimi, kritere të standardizuara për përzgjedhjen e drejtuesve dhe strategji organizative që promovojnë kalimin nga modelet tradicionale hierarkike drejt lidershipit adaptiv dhe të bazuar në kompetenca. Forcimi i kapaciteteve të lidershipit përbën një prioritet kyç për përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor në Shqipëri.
Fjalë kyçe: *lidership, kompetenca, trajnim, Shqipëri, drejtues infermierorë.*

LEADERSHIP COMPETENCIES AND DEVELOPMENT NEEDS IN THE ALBANIAN HEALTH SYSTEM-A QUALITATIVE STUDY

Dhurata Ivziku [1,2] Blerina Duka [3,4], Anila Jance [4]
[1] Department of health Professions, Fondazione Policlinico Universitario Campus Bio-Medico, Rome, Italy
[2] Faculty of Medical Sciences, AAB College, Pristina, Kosovo
[3] UISH, Tirana Albania
[4] Univeristy Barleti, Tirana, Albania
E-mail: dhurata.ivziku@unicamillus.org

ABSTRACT

Background: The development of leadership competencies in healthcare organizations is increasingly recognized as a critical factor for ensuring quality of care, patient safety, and system sustainability. Healthcare managers are required to navigate complex environments characterized by resource constraints, organizational change, and growing patient needs. However, in many contexts, leadership development remains insufficiently structured, particularly in emerging healthcare systems such as Albania. Understanding current competencies and identifying gaps is essential to inform targeted capacity-building strategies.
Aim: To describe leadership competencies and identify needs for leadership development among Albanian healthcare managers.
Methods: A qualitative descriptive design was employed. Semi-structured interviews were conducted with healthcare directors, managers, and nurses who were actively involved in healthcare organizations. Inclusion criteria required participants to hold or have experience in leadership or managerial roles within the healthcare system. A total of 28 interviews were performed. Data were analyzed using inductive content analysis following the approach of Elo and Kyngäs. Ethical approval was obtained from the relevant ethics committee.
Results: Participants had a mean age of 50 years and were predominantly female. Three main themes emerged from the analysis: (1) Leadership competencies as a foundation for effective healthcare management, highlighting the importance of decision-making, team coordination, communication, and quality assurance; (2) Gaps in leadership development and preparation, including lack of formal training, non-standardized continued education processes, and reliance on clinical expertise rather than managerial competencies; (3) Need for transformation towards a modern leadership model, emphasizing flexible, collaborative, and evidence-based leadership, as well as the necessity to address challenges such as workforce shortages, system complexity, and digitalization.
Conclusions: Leadership competencies are perceived as essential for effective healthcare management and system performance; however, significant gaps persist in their development and institutional support. The findings underline the urgent need for structured leadership training programs, standardized selection criteria, and organizational strategies that promote a shift from traditional hierarchical models to adaptive, competency-based leadership. Strengthening leadership capacity represents a key priority for improving healthcare quality and resilience in Albania.

Keywords: *leadership, competencies, training, Albania, nurse leaders.*

POLITIKAT SHËNDETËSORE INKLUZIVE DHE NDIKIMI I TYRE NË PRAKTIKËN KLINIKE INFERMIERORE: NJË SCOPING REVIEW E LITERATURËS NDËRKOMBËTARE

Aurora Kokici [1], Ippolito Notarnicola [2], Blerina Duka [3]
[1] Universiteti i Romës "Tor Vergata", Romë, Itali
Via Cavour 18, 12011 Borgo San Dalmazzo (CN), Italy
[2] Profesor i Asociuar, Departmenti i Mjekësisë dhe Kirurgjisë, Universiteti i Enna "Kore", Itali
[3] Presidente e Urdhrit të Infermierit, Tiranë, Albania
E-mail: kokici.aurora@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Politikat shëndetësore luajnë një rol kyç në formësimin e praktikës klinike infermierore, duke ndikuar drejtpërdrejt në organizimin e shërbimeve, cilësinë e kujdesit dhe sigurinë e pacientëve. Në vitet e fundit, vëmendja është përqëndruar gjithnjë e më shumë te politikat inkluzive, të cilat synojnë forcimin e barazisë, qëndrueshmërisë së fuqisë punëtore dhe kujdesit të orientuar nga personi.
Objektivat: Qëllimi i kësaj scoping review është të eksplorojë dhe të hartëzojë evidencat shkencore mbi ndikimin e politikave shëndetësore inkluzive në praktikën klinike infermierore, me fokus në organizimin e punës, rolin profesional dhe cilësinë e kujdesit.
Metodologjia: U realizua një scoping review sipas udhëzimeve të Joanna Briggs Institute. Kërkimi u krye në databazat PubMed/MEDLINE, CINAHL, Scopus dhe Web of Science, duke përfshirë studime të publikuara nga viti 2020 deri në 2025. U përfshinë artikuj që analizonin politika shëndetësore, qeverisjen e shërbimeve dhe implikimet në praktikën infermierore klinike.
Rezultatet: Literatura e përzgjedhur tregon se politikat inkluzive kontribuojnë në përmirësimin e autonomisë profesionale, bashkëpunimit ndërprofesional, sigurisë së pacientit dhe qëndrueshmërisë së fuqisë punëtore infermierore. Megjithatë, evidentohen edhe sfida të lidhura me zbatimin jo të njëtrajtshëm dhe mungesën e përkthimit efektiv të politikave në praktikë.
Konkluzionet: Politikat shëndetësore inkluzive përfaqësojnë një element strategjik për forcimin e praktikës klinike infermierore. Nevojiten qasje të integruara dhe të bazuara në evidencë për të garantuar ndikim real në kujdesin klinik.

Fjalët kyçe: *Politikat shëndetësore, praktikë infermierore, përfshirje, qeverisje shëndetësore, scoping review.*

INCLUSIVE HEALTH POLICIES AND THEIR IMPACT ON NURSING CLINICAL PRACTICE: A SCOPING REVIEW OF THE INTERNATIONAL LITERATURE.

Aurora Kokici[1] , Ippolito Notarnicola[2] , Blerina Duka[3]
[1] University of Rome "Tor Vergata", Rome, Italy
Via Cavour 18, 12011 Borgo San Dalmazzo (CN), Italy
[2] Department of Medicine and Surgery, University of Enna "Kore", Enna, Italy
[3] President, Albanian Order of Nurses, Tirana, Albania
E-mail: kokici.aurora@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Health policies play a crucial role in shaping nursing clinical practice, directly influencing service organization, quality of care, and patient safety. In recent years, increasing attention has been paid to inclusive health policies aimed at promoting equity, workforce sustainability, and person-centred care.
Objectives: This scoping review aims to map and synthesise the available evidence on the impact of inclusive health policies on nursing clinical practice, with particular attention to work organisation, professional roles, and quality of care.
Methodology: A scoping review was conducted following the Joanna Briggs Institute methodological framework. Searches were performed in PubMed/MEDLINE, CINAHL, Scopus, and Web of Science, including studies published between 2020 and 2025. Articles addressing health policies, healthcare governance, and implications for nursing clinical practice were included.
Results: The reviewed literature indicates that inclusive health policies are associated with improved professional autonomy, enhanced interprofessional collaboration, patient safety, and nursing workforce sustainability. However, significant challenges persist, particularly regarding heterogeneous implementation and the limited translation of policy frameworks into everyday clinical practice.
Conclusions: Inclusive health policies represent a strategic lever for strengthening nursing clinical practice and improving healthcare system performance. Evidence-based and integrated policy approaches are essential to ensure meaningful and sustainable impacts on clinical care.

Keywords: *health policies; nursing practice; inclusion; healthcare governance; scoping review.*

QASJET INOVATIVE NË KUJDESIN INFERMIEROR PËR PARANDALIMIN E KOMPLIKACIONEVE NË NJËSINË E KUJDESIT POSTANESTEZIK

Alketa Dervishi[1], Blerina Duka[2], Brizida Refatllari[1], Floreta Kurti[1], Jonida Stefa[1]

[1] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë
[2] Urdhri i Infermierit të Shqipërisë
E-mail: alketadervishi@umed.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Periudha e hershme postanestezike përfaqëson një fazë kritike në rikuperimin e pacientit pas ndërhyrjeve kirurgjikale. Në këtë periudhë pacientët janë të ekspozuar për komplikacione potenciale, ndër të cilat më të shpeshtat janë depresioni respirator, dhimbja postoperatore dhe çrregullimet neurokonjitive si deliriumi postoperator. Njësia e kujdesit postanestezik (PACU) luan një rol thelbësor në monitorimin intensiv dhe ndërhyrjen e hershme për parandalimin e këtyre komplikacioneve. Qasjet moderne të kujdesit infermieror bazohen në evidenca klinike dhe në përdorimin e strategjive të strukturuara për të përmirësuar sigurinë dhe rezultatet klinike të pacientëve.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të analizojë rolin e strategjive inovative infermierore të bazuara në evidencë në reduktimin e komplikacioneve postanestezike në PACU, me fokus në monitorimin respirator të avancuar, menaxhimin multimodal të dhimbjes dhe identifikimin e hershëm të deliriumit postoperator.

Metodologjia: Bazohet në një rishikim të literaturës shkencore të publikuar gjatë periudhës 2020–2025 në databaza ndërkombëtare si PubMed, Scopus dhe ScienceDirect, duke përfshirë studime klinike, rishikime sistematike dhe udhëzime klinike mbi kujdesin postanestezik.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë se përdorimi i monitorimit respirator të avancuar, si kapnografia dhe monitorimi i vazhdueshëm i oksigjenimit, mundëson identifikimin e hershëm të hipoventilimit dhe depresionit respirator, duke reduktuar rrezikun e komplikacioneve respiratore. Në të njëjtën kohë, menaxhimi multimodal i dhimbjes, i cili kombinon analgjezikë opioidë dhe jo-opioidë, teknika rajonale dhe metoda jo-farmakologjike, ka rezultuar efektiv në përmirësimin e kontrollit të dhimbjes dhe në reduktimin e përdorimit të opioideve.

Konkluzion: Implementimi i instrumenteve të standardizuar të vlerësimit në kujdesin postanestezik, është thelbësor për identifikimin e hershëm të komplikacioneve postanestezike, ndërhyrjen e menjëhershme infermierore, përmirësimin e cilësisë së kujdesit dhe sigurinë e pacientit.

Fjalë kyçe: *PACU, kujdes pas anestezisë, monitorim i frymëmarrjes, menaxhim multimodal i dhimbjes, delirium postoperativ, kujdes infermieror.*

INNOVATIVE NURSING APPROACHES TO PREVENTING COMPLICATIONS IN THE POST-ANESTHESIA CARE UNIT

Alketa Dervishi[1], Blerina Duka[2], Brizida Refatllari[1], Floreta Kurti[1], Jonida Stefa[1]
[1] Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana, Albania
[2] Order of Nurses of Albania
E-mail: alketadervishi@umed.edu.al

ABSTRACT

Introduction: The early post-anesthesia period represents a critical phase in patient recovery following surgical interventions. During this period, patients are exposed to a range of complications, among which the most common are respiratory depression, postoperative pain, and neurocognitive disorders such as postoperative delirium. The Post-Anesthesia Care Unit (PACU) plays a crucial role in intensive monitoring and early intervention to prevent these complications. Modern approaches to nursing care increasingly rely on clinical evidence and structured strategies aimed at improving patient safety and clinical outcomes.

Aim: The aim of this study is to analyze the role of evidence-based nursing strategies in reducing post-anesthetic complications in the PACU, with a focus on advanced respiratory monitoring, multimodal pain management, and early identification of postoperative delirium.

Methodology: The methodology is based on a review of scientific literature published during the period 2020–2025 in international databases such as PubMed, Scopus, and ScienceDirect, including clinical studies, systematic reviews, and clinical guidelines related to post-anesthesia care.

Results: Findings from the literature indicate that the use of advanced respiratory monitoring, such as capnography and continuous oxygenation monitoring, enables early detection of hypoventilation and respiratory depression, thereby reducing the risk of respiratory complications. At the same time, multimodal pain management, which combines opioid and non-opioid analgesics, regional techniques, and non-pharmacological methods, has proven effective in improving pain control and reducing opioid consumption. Additionally, the use of standardized assessment tools for postoperative delirium facilitates early identification of patients at risk and allows timely therapeutic intervention.

Conclusion: In conclusion, the implementation of evidence-based nursing strategies in the PACU significantly contributes to reducing post-anesthetic complications and improving the quality of care for surgical patients.

Keywords: *PACU, post-anesthesia care, respiratory monitoring, multimodal pain management, postoperative delirium, nursing care.*

BASHKËPUNIMI NDËRDISIPLINOR MIDIS INFERMIERËVE DHE TERAPISTËVE OKUPACIONALË NË EPOKËN DIGJITALE: PROMOVIMI I KUJDESIT TË PËRQENDRUAR TE PERSONI DHE AUTONOMISË FUNKSIONALE

Mimoza Doci[1], Aurora Kokici[2], Ippolito Notarnicola[3], Megi Taci[4]

[1] Terapiste Okupacionale, Spitali i Tione di Trento, ASUIT - Trento, Itali
[2] Infermiere, kandidate për PhD, Universiteti "Tor Vergata", Romë, Itali
[3] Profesor i Asociuar, Doktor i Shkencave (PhD), pranë Universitetit "Kore" të Ennës
[4] Infermiere, Praktikuese e Pavarur, Tiranë, Shqipëri
E-mail: mimozadoci3@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Transformimi digjital i sistemeve shëndetësore po riformëson modelet e kujdesit dhe rolet profesionale, duke rritur nevojën për bashkëpunim ndërdisiplinor të orientuar te personi. Në këtë kontekst, infermierët dhe terapistët okupacionalë kanë role plotësuese në promovimin e autonomisë, pjesëmarrjes dhe cilësisë së jetës.

Objektivat: Qëllimi është të theksojë vlerën e bashkëpunimit ndërdisiplinor midis infermierëve dhe terapistëve okupacionalë në epokën digjitale, duke vënë në pah kontributin e Terapisë Okupacionale në një model të integruar kujdesi dhe rëndësinë e punës në ekip për kujdes të përqendruar te personi.

Metodologjia: Punimi ndjek një qasje përshkruese dhe reflektuese, të mbështetur në literaturën bashkëkohore, modele evropiane të asistencës shëndetësore dhe përvoja profesionale të përbashkëta në mjedise klinike e rehabilituese të mbështetura nga teknologjitë digjitale.

Rezultatet: Analiza tregon se bashkëpunimi i strukturuar, i mbështetur nga kartelat elektronike, teleasistenca, teknologjitë asistive dhe mjetet digjitale të vlerësimit, përmirëson koordinimin, vazhdimësinë dhe rezultatet funksionale. Terapia Okupacionale promovon autonominë funksionale dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e jetës së përditshme, ndërsa kujdesi infermieror garanton monitorim klinik, siguri të pacientit dhe vazhdimësi të kujdesit.

Konkluzionet: Bashkëpunimi ndërdisiplinor midis infermierëve dhe terapistëve okupacionalë është një burim strategjik për sisteme më efektive, gjithëpërfshirëse dhe të orientuara te personi. Forcimi i modeleve bashkëpunuese dhe i kompetencave digjitale mund të përmirësojë cilësinë e asistencës dhe rezultatet për pacientët në shëndetësinë digjitale.

Fjalë kyçe: *Terapia Okupacionale, infermieria, bashkëpunimi ndërdisiplinor, shëndetësia digjitale, kujdesi i përqendruar te personi.*

INTERDISCIPLINARY COLLABORATION BETWEEN NURSES AND OCCUPATIONAL THERAPISTS IN THE DIGITAL ERA: PROMOTING PERSON-CENTRED CARE AND FUNCTIONAL AUTONOMY

Mimoza Doci[1], Aurora Kokici[2], Ippolito Notarnicola[3], Megi Taci[4]
[1] Occupational Therapist, ASUIT - Trento, Italy
[2] PhD Cand. Univertitety Tor Vergata, Rome, Italy
[3] Associate Professor, Department of Medicine and Surgery, University of Enna "Kore", Italy
[4] Registered Nurse, Independent Practitioner, Tirana, Albania
E-mail: mimozadoci3@gmail.com

ABSTRAKT

Introduction: The digital transformation of healthcare systems is reshaping care models and professional roles, increasingly emphasizing the need for person-centred interdisciplinary collaboration. In this context, nurses and Occupational Therapists perform complementary and integrated roles in promoting autonomy, participation and quality of life.
Objectives: The aim of this contribution is to highlight the value of interdisciplinary collaboration between nurses and Occupational Therapists in the digital era, emphasizing the specific contribution of Occupational Therapy within an integrated care model and the importance of teamwork in delivering person-centred care.
Methodology: This work is based on a descriptive and reflective approach supported by an analysis of contemporary scientific literature, European healthcare models and shared professional experiences in clinical and rehabilitative settings enhanced by digital technologies.
Results: The analysis indicates that structured collaboration between nurses and Occupational Therapists, supported by digital tools such as electronic health records, telecare systems, assistive technologies and digital assessment instruments, improves care coordination, continuity of care and functional outcomes. Specifically, Occupational Therapy contributes to promoting functional autonomy and participation in daily life activities, while nursing care ensures clinical monitoring, patient safety and continuity of care.
Conclusions: Interdisciplinary collaboration between nurses and Occupational Therapists represents a strategic resource for developing more effective, inclusive and person-centred healthcare systems. Strengthening collaborative models and digital competencies may enhance quality of care and patient outcomes within the current digital healthcare landscape.

Keywords: *Occupational Therapy; Nursing; Interdisciplinary Collaboration; Digital Health; Person-Centred Care.*

ARSIMI I LARTË NË EPOKËN E AI: MIDIS INOVACIONIT DHE SFIDAVE AKADEMIKE

Eljo Paja[1]

[1] Specialist i Kujdesit Shëndetësor (Freelancer), Tiranë, Shqipëri
E-mail: e.paja@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Zhvillimi i shpejtë i inteligjencës artificiale (IA) po transformon arsimin e lartë duke sjellë mjete inovative dhe duke ndryshuar praktikat tradicionale të mësimdhënies dhe të nxënies. Megjithëse IA ofron potencial të madh për rritjen e efikasitetit, personalizimit dhe aksesit, ajo paraqet edhe një sërë sfidash që lidhen me etikën, integritetin akademik dhe gatishmërinë institucionale.
Qëllimi: Ky studim synon të analizojë sfidat kryesore me të cilat përballen institucionet e arsimit të lartë në përshtatjen me risitë e drejtuara nga inteligjenca artificiale, duke u fokusuar në aspektet pedagogjike, etike dhe organizative.
Metodat: Studimi bazohet në një rishikim të literaturës shkencore, duke përfshirë artikuj, raporte dhe publikime akademike të periudhës 2018–2026. Është përdorur një qasje cilësore për të identifikuar, krahasuar dhe sintetizuar temat kryesore që lidhen me integrimin e inteligjencës artificiale në arsimin e lartë.
Rezultatet: Gjetjet tregojnë se inteligjenca artificiale ka një ndikim të rëndësishëm në metodologjitë e mësimdhënies, vlerësimin e studentëve dhe proceset administrative. Megjithatë, sfidat kryesore përfshijnë shqetësimet mbi integritetin akademik, privatësinë e të dhënave, paragjykimin algoritmik dhe mungesën e trajnimit të mjaftueshëm të stafit akademik. Gjithashtu, evidentohet një hendek midis zhvillimit të shpejtë teknologjik dhe krijimit të politikave institucionale dhe kuadrove rregullatore efektive.
Përfundimi: Integrimi i inteligjencës artificiale në arsimin e lartë kërkon një qasje të balancuar dhe strategjike, që ndërthur inovacionin teknologjik me konsideratat etike, trajnimin e stafit dhe reformimin e kurrikulave. Institucionet duhet të hartojnë politika të qarta dhe të investojnë në zhvillimin profesional për të siguruar përdorimin e përgjegjshëm dhe efektiv të teknologjive të inteligjencës artificiale.

Fjalë kyçe: *Inteligjenca artificiale, arsimi i lartë, sfidat, inovacioni, integriteti akademik, transformimi digjital.*

HIGHER EDUCATION IN THE AGE OF AI: BETWEEN INNOVATION AND ACADEMIC CHALLENGES

Eljo Paja [1]
[1] Health Care Specialist (Freelance), Tirana, Albania
E-mail: e.paja@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: The rapid advancement of artificial intelligence (AI) is reshaping higher education by introducing innovative tools and transforming traditional teaching and learning practices. While AI offers significant potential to improve efficiency, personalization, and accessibility, it also presents a range of challenges related to ethics, academic integrity, and institutional readiness.
Aim: This study aims to analyze the main challenges faced by higher education institutions in adapting to AI-driven innovations, focusing on pedagogical, ethical, and organizational aspects.
Methods: The study is based on a comprehensive literature review of scientific articles, reports, and academic publications published between 2018 and 2026. A qualitative approach was used to identify, compare, and synthesize key themes related to the integration of AI in higher education.
Results: The findings indicate that AI has a significant impact on teaching methodologies, student assessment, and administrative processes. However, major challenges include concerns about academic integrity, data privacy, algorithmic bias, and the lack of adequate training among academic staff. Additionally, a gap was identified between the rapid technological development and the establishment of effective institutional policies and regulatory frameworks.
Conclusion: The integration of AI in higher education requires a balanced and strategic approach that combines technological innovation with ethical considerations, staff training, and curriculum reform. Institutions must develop clear policies and invest in capacity building to ensure the responsible and effective use of AI technologies.

Keywords: *Artificial intelligence, higher education, challenges, innovation, academic integrity, digital transformation*

ZHVILLIMI I VERSIONIT SHQIP TË ECDI2030: PËRKTHIMI, PËRSHTATJA KULTURORE DHE STUDIMI PILOT PARAPRAK

Jola Çini[1], Evda Veveçka[1], Eleni Nastas[2]

[1] Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri
[2] Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe të Shëndetit, Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri
E-mail: j.xharo@umb.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Fëmijët të cilët marrin një kujdes të mirë shëndetësor, ushqyerje të mirë, stimulim të hershëm, kujdes dhe mbrojtje në vitet e para të jetës zakonisht kanë zhvillim më të mirë konjitiv, gjuhësor dhe psikosocial. ECDI2030 është një instrument i zhvilluar ndërkombëtarisht i krijuar për të vlerësuar fushat kryesore të zhvillimit të fëmijërisë së hershme. Për të siguruar përdorimin e duhur në Shqipëri, instrumenti kërkon jo vetëm përkthim gjuhësor, por edhe përshtatje kulturore.
Objektivat: Ky projekt synon të zhvillojë versionin shqip të ECDI2030 përmes përkthimit dhe përshtatjes kulturore, dhe fillimin e punës paraprake (studim pilot) për të vlerësuar qartësinë, pranueshmërinë dhe fizibilitetin e instrumentit të përshtatur në kontekstin shqip.
Metodologjia: Procesi përfshiu përkthimin e ECDI2030 origjinal në shqip, i ndjekur nga rishikimi për të siguruar saktësinë gjuhësore dhe përshtatshmërinë kulturore. Vëmendje e veçantë iu kushtua ruajtjes së kuptimit të elementëve origjinal duke përshtatur formulimin me kontekstin lokal. Pas përfundimit të versionit të përkthyer, filloi puna për studimin pilot, për të shqyrtuar kuptueshmërinë e elementëve, interpretimin e të intervistuarve dhe aspektet praktike të administrimit.
Rezultatet: Përkthimi dhe përshtatja fillestare kulturore e ECDI2030 në shqip është përfunduar me sukses. Studimi pilot është duke u zhvilluar dhe ka ofruar një mundësi për të vëzhguar se si funksionon instrumenti i përshtatur në praktikë. Vëzhgimet e hershme sugjerojnë se faza pilot është e vlefshme për identifikimin e elementëve që mund të përfitojnë nga sqarimi ose përmirësimi i mëtejshëm.
Konkluzionet: Zhvillimi i versionit shqip të ECDI2030 ka përparuar ndjeshëm përmes përkthimit, përshtatjes kulturore dhe fillimit të studimit pilot. Këto hapa ofrojnë një bazë të fortë për përmirësimin e mëtejshëm dhe vërtetimin e ardhshëm të instrumentit. Pasi të finalizohet, ECDI2030 në gjuhën shqipe do të shërbejë si një burim i rëndësishëm për kërkimin, vlerësimin dhe zhvillimin e politikave në zhvillimin e fëmijërisë së hershme.

Fjalë kyçe: *ECDI2030; fëmijëria, zhvillimi, përshtatja kulturore.*

DEVELOPMENT OF THE ALBANIAN VERSION OF THE ECDI2030: TRANSLATION, CULTURAL ADAPTATION, AND PRELIMINARY PILOT STUDY

Jola Çini[1], Evda Veveçka[1], Eleni Nastas[2]
[1] Department of Technical Medical Sciences, Barleti University, Tirana, Albania
[2] Department of Medical and Health Sciences, Barleti University, Tirana, Albania
E-mail: j.xharo@umb.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Children who receive good health, adequate nutrition, early stimulation, learning opportunities, care and protection in initial years of life tend to have better cognitive, language and psychosicial development. ECDI2030 is an internationally developed instrument designed to assess key domains of early childhood development. To ensure its appropriate use in Albania, the instrument requires not only linguistic translation but also cultural adaptation.
Objectives: This project aimed to develop the Albanian version of the ECDI2030 through translation and cultural adaptation, and to initiate preliminary pilot work to assess the clarity, acceptability, and feasibility of the adapted instrument in the Albanian context.
Methodology: The process included translation of the original ECDI2030 into Albanian, followed by review and refinement to ensure linguistic accuracy and cultural appropriateness. Attention was given to maintaining the meaning of the original items while adapting wording to the local context. Following completion of the translated version, preliminary pilot work was initiated to examine item comprehensibility, respondent interpretation, and practical aspects of administration.
Results: The translation and initial cultural adaptation of the ECDI2030 into Albanian have been completed successfully. Preliminary pilot work is underway and has provided an important first opportunity to observe how the adapted instrument functions in practice. Early observations suggest that the pilot phase is valuable for identifying items that may benefit from further clarification or refinement.
Conclusions: The development of the Albanian version of the ECDI2030 has progressed substantially through translation, cultural adaptation, and the initiation of preliminary pilot work. These steps provide a strong foundation for further refinement and future validation of the instrument. Once finalized, the Albanian ECDI2030 may serve as an important resource for research, assessment, and policy development in early childhood development.

Keywords: *ECDI2030; childhood, development, cultural adaptation.*

INFEKSIONET URINARE TEK FËMIJËT NË ELBASAN: ROLI I KUJDESIT INFERMIEROR NË PARANDALIMIN E TYRE

Shqipe Luta[1], Albana Sula, Rajmonda Oboni, Elona Hasalla, Juxhin Luta, Esmeralda Vreto
[1] Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
E-mail: shqipeluta@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Infeksionet e traktit urinar (ITU) tek fëmijët përbëjnë ndër patologjitë më të shpeshta bakteriale në moshën pediatrike. Ato mund të prekin segmente të ndryshme të traktit urinar dhe shpesh paraqiten pa një lokalizim të qartë klinik. Diagnostikimi i vonuar dhe trajtimi i papërshtatshëm mund të çojnë në komplikacione serioze, përfshirë dëmtime të përhershme të funksionit renal.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit adekuat të infeksioneve urinare tek fëmijët, si dhe të theksojë rolin e kujdesit infermieror në parandalimin e tyre.
Metodologjia: Studimi ka karakter përshkrues dhe bazohet në analizën e literaturës dhe praktikave klinike. Objektivat kryesore përfshijnë: Identifikimin e faktorëve që ndikojnë në shfaqjen dhe përhapjen e infeksioneve urinare tek fëmijët; Vlerësimin e rolit të infermierit në edukimin shëndetësor të fëmijëve dhe familjarëve; Përshkrimin e metodave dhe procedurave diagnostikuese të përdorura për identifikimin e këtyre infeksioneve.
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi i duhur i infeksioneve urinare reduktojnë ndjeshëm rrezikun e komplikacioneve renale. Edukimi shëndetësor dhe ndërhyrjet parandaluese të realizuara nga infermierët kanë një ndikim të rëndësishëm në uljen e incidencës dhe rikthimit të infeksioneve.
Përfundimet: Parandalimi i infeksioneve urinare tek fëmijët kërkon një qasje të integruar që përfshin diagnostikim të hershëm, trajtim të përshtatshëm dhe edukim të vazhdueshëm të prindërve. Kujdesi infermieror luan një rol kyç në promovimin e praktikave higjieno-sanitare, në monitorimin e simptomave dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e trajtimit në kohë. Përveç trajtimit me antibiotikë, mund të konsiderohen edhe qasje mbështetëse në përputhje me udhëzimet klinike.

Fjalë kyçe: *Infeksionet urinare, pediatri, diagnostikimi i hershëm, kujdesi infermieror, parandalimi, nefrologji.*

URINARY TRACT INFECTIONS IN CHILDREN IN ELBASAN: THE ROLE OF NURSING CARE IN THEIR PREVENTION

Shqipe Luta[1], Albana Sula, Rajmonda Oboni, Elona Hasalla, Juxhin Luta, Esmeralda Vreto
[1] University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
E-mail: shqipeluta@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Urinary tract infections (UTIs) in children are among the most common bacterial diseases in pediatric age. They may affect different parts of the urinary tract and often present without clear clinical localization. Delayed diagnosis and inappropriate treatment may lead to serious complications, including permanent renal damage.
Aim: The aim of this study is to highlight the importance of early diagnosis and appropriate treatment of urinary tract infections in children, as well as to emphasize the role of nursing care in their prevention.
Methodology: This is a descriptive study based on the analysis of literature and clinical practices. The main objectives include: Identifying factors influencing the occurrence and spread of urinary tract infections in children; Evaluating the role of nurses in health education and counseling of children and their families; Describing diagnostic methods and procedures used in the identification of these infections.
Results: The findings indicate that early diagnosis and appropriate treatment of urinary tract infections significantly reduce the risk of renal complications. Health education and preventive interventions performed by nurses play a crucial role in reducing both the incidence and recurrence of infections.
Conclusions: The prevention of urinary tract infections in children requires an integrated approach that includes early diagnosis, appropriate treatment, and continuous parental education. Nursing care plays a key role in promoting hygienic practices, monitoring symptoms, and increasing awareness of timely treatment. In addition to antibiotic therapy, supportive approaches may also be considered in accordance with clinical guidelines.

Keywords: *urinary tract infections, pediatrics, early diagnosis, nursing care, prevention, nephrology.*

VLERËSIMI I NDIKIMIT TË FAKTORËVE DEMOGRAFIKË DHE SHËNDETËSORË NË CILËSINË E JETËS TEK TË MOSHUARIT

Entela Drizaj[1], Sabina Tosuni, Jonida Drizaj, Rezarta Stena, Klara Hysenaj, Rajmonda Hida, Argenta Kuburja

[1] Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" / Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Mjekësore
E-mail: entela.drizaj@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Vlerësimi i cilësisë së jetës në moshën geriatrike është thelbësor pasi kjo moshë karakterizohet nga ndryshime fiziologjike, rritje të prevalencës së sëmundjeve kronike, ndryshime në rolet sociale dhe shpesh nga sfida ekonomike. Vlerësimi i CJ në këtë popullatë nuk është vetëm një çështje e interesit akademik, por edhe një domosdoshmëri për të informuar politikat e kujdesit shëndetësor për të zbatuar ndërhyrje efektive që synojnë krijimin e një mjedisi mbështetës dhe të përshtatshëm për të moshuarit.

Objektivi: Objektivi këtij studimi është të vlerësojë ndikimin e faktorëve demografikë dhe shëndetësorë në cilësinë e jetës në moshën geriatrike.

Metodologjia: Ky studim i tipit tranversal u krye në të moshuarit e qytetit të Elbasanit. Një pyetësor i strukturuar WHOQOL-BREF, i përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe, u administrua nëpërmjet intervistave direkte dhe shpërndarjes së pyetësorit nëpërmjet Google Form. Kampioni i studimit përbëhej nga 101 individë të moshës mbi 65 vjeç. Pyetësori përbëhej nga 26 pyetje të ndara në katër fusha të vlerësimit: fusha fizike, psikologjike, sociale, mjedisore. Të dhënat u analizuan për të përcaktuar rezultatet e CJ në secilën fushë si dhe për të identifikuar korrelacionet me variablat demografike (gjinia, mosha, arsimi, statusi martesor) dhe ato shëndetësore (prania e sëmundjeve kronike).

Rezultate: Rezultatet paraprake tregojnë se cilësia e jetës së përgjithshme ishte mesatare, me ndryshime të konsiderueshme midis fushave të vlerësimit. Faktorët si sëmundjet kronike, niveli i arsimit dhe statusi ekonomik kishin një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e jetës së të moshuarve. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve shprehën pakënaqësi lidhur me gjendjen e tyre fizike dhe mjedisore.

Konkluzione: Ky studim ofron një pasqyrë fillestare të cilësisë së jetës së të moshuarve në qytetin e Elbasanit, duke theksuar nevojën për politika dhe ndërhyrje që synojnë përmirësimin e mirëqenies fizike, psikologjike dhe sociale të kësaj popullate të ndjeshme. Nevojiten studime të mëtejshme me mostra më të mëdha për të konfirmuar këto gjetje dhe për të eksploruar faktorët e tjerë ndikues.

Fjalë kyçe: *Cilësia e jetës, mosha geriatrike, WHOQOL-BREF, sëmundje kronike, mirëqenie.*

ASSESSMENT OF THE IMPACT OF DEMOGRAPHIC AND HEALTH FACTORS ON THE QUALITY OF LIFE IN THE ELDERLY

[1] Entela Drizaj, Sabina Tosuni, Jonida Drizaj, Rezarta Stena, Klara Hysenaj, Rajmonda Hida, Argenta Kuburja
[1] University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani", Faculty of Technical and Medical Sciences
E-mail: entela.drizaj@uniel.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Assessing quality of life in geriatric age is essential as this age is characterized by physiological changes, increased prevalence of chronic diseases, changes in social roles and often by economic challenges. Assessing QOL in this population is not only a matter of academic interest, but also a necessity to inform healthcare policies to implement effective interventions aimed at creating a supportive and appropriate environment for the elderly.
The objective of this study is to assess the impact of demographic and health factors on quality of life in geriatric age.
Methodology: This cross-sectional study was conducted in the elderly of the city of Elbasan. A structured WHOQOL-BREF questionnaire, translated and adapted into Albanian, was administered through direct interviews and distribution of the questionnaire via Google Form. The study sample consisted of 101 individuals aged over 65 years. The questionnaire consisted of 26 questions divided into four assessment domains: physical, psychological, social, and environmental domains. Data were analyzed to determine the CJ scores in each domain as well as to identify correlations with demographic variables (gender, age, education, marital status) and health variables (presence of chronic diseases).
Results: Preliminary results indicate that overall quality of life was average, with significant differences between assessment domains. Factors such as chronic diseases, level of education, and economic status had a significant impact on the quality of life of the elderly. A significant portion of respondents expressed dissatisfaction with their physical and environmental conditions.
Conclusions: This study provides an initial overview of the quality of life of the elderly in the city of Elbasan, highlighting the need for policies and interventions aimed at improving the physical, psychological, and social well-being of this vulnerable population. Further studies with larger samples are needed to confirm these findings and explore other influencing factors.

Keywords: *Quality of life, geriatric age, WHOQOL-BREF, chronic disease, well-being.*

VLERËSIMI I BIOSHËNUESVE TË RENINËS, ALDOSTERONIT DHE ELEKTROLITEVE NË HIPERALDOSTERONIZMIN SEKONDAR

Brunilda Mezani [1,3], Anila Mitre [1,2]

[1] Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës, Shqipëri,
[2] Drejtoreshë Imunologjike dhe Mjekësore në rrjetin e Laboratorëve IntermediKa,
[3] Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazherisë, Universiteti Western Balkans, Tiranë, Shqipëri,
E-mail: brunilda.mezani@wbu.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Hiperaldosteronizmi sekondar është një gjendje e karakterizuar nga prodhimi i tepërt i aldosteronit, nxitur nga aktivizimi i sistemit reninë-angiotensinë-aldosteron (RAAS), ndaj çrregullimeve të tilla si stenoza e arteries renale, pamjaftueshmëria e zemrës ose cirroza, tumoret. Diferencimi i saktë nga hiperaldosteronizmi primar është thelbësor për menaxhimin e duhur. Shënuesit biokimikë (biomarker), veçanërisht aktiviteti i reninës plazmatike, nivelet e aldosteronit dhe elektrolitet në serum, luajnë një rol qendror në diagnozë.

Metodologjia: Ky studim vlerëson dobinë diagnostikuese të aktivitetit të reninës plazmatike (PRA), përqendrimit të aldosteronit në serum dhe parametrave kryesorë të elektroliteve (nivelet e natriumit dhe kaliumit) tek pacientët me hiperaldosteronizëm sekondar të dyshuar. Ne studim perfshihen një grup pacientësh që paraqiten me hipertension dhe çekuilibër të lëngjeve. Analizat hormonale kryen duke përdorur teknika të standardizuara duke mundesuar matjen e niveleve te elektroliteve përmes analizuesve të automatizuar biokimikë. Raporti aldosteron-reninë (ARR) analizohet dhe interpretohet së bashku me gjetjet klinike.

Rezultatet: Pacientët me hiperaldosteronizëm sekondar karakterizohen nga aktivitet të reninës plazmatike dukshëm të lartë dhe nivele të rritura të aldosteronit, me një raport aldosteron-reninë relativisht të ulët ose normal krahasuar me hiperaldosteronizmin primar. Analiza e elektroliteve shpesh zbuloi hiponatremi të lehtë ose normonatremi dhe hipokalemi.

Përfundimi: Vlerësimi i biomarkuesve të reninës, aldosteronit dhe elektroliteve ofron një qasje klinikisht të rëndësishme për diagnostikimin e hiperaldosteronizmit sekondar. Nivelet e larta të reninës në lidhje me rritjen e aldosteronit dallojnë format sekondare nga ato primare, ndërsa çekuilibrat e elektroliteve mbështesin dyshimin klinik. Një strategji gjithëpërfshirëse diagnostikuese që përfshin profilizimin hormonal dhe kontekstin klinik është thelbësore për diagnozë të saktë dhe menaxhim optimal të pacientit.

Fjale kyçe: *Hiperaldosteronizmin sekondar, biomarker, reninës, aldosteron, elektrolit.*

EVALUATION OF RENIN, ALDOSTERONE, AND ELECTROLYTE BIOMARKERS IN SECONDARY HYPERALDOSTERONISM

Brunilda Mezani [1,3], Anila Mitre [1,2]

[1] Biology Department, Faculty of Natural Sciences, University of the Tirana, Albania,

[2] Immunological and Medical Director at the Intermedica Laboratories network,

[3] Department of Medical Laboratory Sciences and Imaging, Western Balkans University, Tirana, Albania

E-mail: brunilda.mezani@wbu.edu.al

ABSTRACT

Background: Secondary hyperaldosteronism is a condition characterized by excessive aldosterone production driven by activation of the renin-angiotensin-aldosterone system (RAAS), often secondary to disorders such as renal artery stenosis, heart failure, or cirrhosis, tumor. Accurate differentiation from primary hyperaldosteronism is essential for appropriate management. Biochemical markers, particularly plasma renin activity, aldosterone levels, and serum electrolytes, play a central role in diagnosis.

Methods: This study evaluates the diagnostic utility of plasma renin activity (PRA), serum aldosterone concentration, and key electrolyte parameters (sodium and potassium levels) in patients with suspected secondary hyperaldosteronism. A cohort of patients presenting with hypertension and/or fluid imbalance was assessed. Hormonal assays were performed using standardized immunoassay techniques, and electrolyte levels were measured through automated biochemical analyzers. The aldosterone-to-renin ratio (ARR) was calculated and interpreted alongside clinical findings.

Results: Patients with secondary hyperaldosteronism demonstrated significantly elevated plasma renin activity and increased aldosterone levels, with a relatively low or normal aldosterone-to-renin ratio compared to primary hyperaldosteronism. Electrolyte analysis frequently revealed with hyponatremia or normonatremia and hypokalemia.

Conclusion: The assessment of renin, aldosterone, and electrolyte biomarkers provides a reliable and clinically relevant approach for diagnosing secondary hyperaldosteronism. Elevated renin levels in conjunction with increased aldosterone distinguish secondary from primary forms, while electrolyte imbalances support clinical suspicion. A comprehensive diagnostic strategy incorporating hormonal profiling and clinical context is essential for accurate diagnosis and optimal patient management.

Keywords: *Secondary Hyperaldosteronism, Biomarkers, Renin, Aldosterone, Electrolyte.*

SESION PARALEL

SESIONI II

SALLA 1

ABSTRAKTET

SFIDAT ETIKE TË PËRDORIMIT TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR

Brizida Refatllari[1], Albana Lufi[2], Alketa Dervishi[1], Floreta Kurti[1]

[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë
[2]Spitali Universitar i Traumës, Tiranë
E-mail: fbrizida@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Inteligjenca artificiale (IA) është një teknologji inovative me potencial për të transformuar shërbimet e kujdesit shëndetësor duke riformësuar plotësisht mënyrën sesi diagnostikohen, trajtohen dhe monitorohen pacientët. Megjithatë, krahas përfitimeve, lindin sfida të rëndësishme etike, ligjore dhe sociale që prekin besimin, përgjegjësinë dhe drejtësinë në kujdesin shëndetësor.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë implikimet dhe sfidat etike të përdorimit të IA në kujdesin shëndetësor. Studimi analizon mënyrën sesi IA lidhet me parimet themelore etike, si autonomia, të bërit mirë, të mos dëmtuarit dhe drejtësia.
Metodologjia: Ky studim u bazua mbi një rishikim të literaturës duke përfshirë artikuj në gjuhën angleze të publikuar pas vitit 2018 në databaza si PubMed, Scopus, Web of Science për të sintetizuar njohuritë mbi dilemat morale që shoqërojnë përfshirjen e IA në praktikat e kujdesit shëndetësor.
Rezultatet: Studimi tregoi se adoptimi i IA në kujdesin shëndetësor paraqet sfida të rëndësishme etike, të cilat përfshijnë efektet mbi autonominë e pacientit, vështirësitë në marrjen e konsentit informativ, privatësinë dhe ruajtjen e të dhënave, potencialin për ndërveprim të reduktuar njerëzor në kujdesin ndaj pacientit, pabarazitë sociale, neglizhencë ndaj vlerave humane. Disa nga vlerat më shumë të evidentura në studimet e kryera, në të cilat mishërohen parimet etike themelore janë: siguria, ku të mos dëmtuarit është një prioritet kryesor; vetëdrejtimi, i cili pasqyron lirinë, autonominë, dinjitetin dhe privatësinë; dashamirësia, e lidhur me të bërit mirë përgjegjshmërinë, besimin. transparencën, solidaritetin; universalizmi i udhëhequr nga parimi i drejtësië dhe qëndrueshmëria afatgjatë.
Konluzionet: Inteligjenca artificiale ka potencial të madh për të përmirësuar sistemet shëndetësore, por zbatimi i saj kërkon mbikëqyrje të fortë etike. Integrimi i parimeve etike në zhvillimin dhe përdorimin e IA është thelbësor për të siguruar drejtësi, besim dhe përgjegjësi. IA duhet të plotësojë, jo të zëvendësojë gjykimin njerëzor duke ruajtur vlerat themelore njerëzore në kujdesin shëndetësor.

Fjalët kyçe: *Inteligjenca artificiale, kujdesit shëndetësor, autonomia, parimeve etike.*

ETHICAL CHALLENGES OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN HEALTHCARE

Brizida Refatllari[1], Albana Lufi[2], Alketa Dervishi[1], Floreta Kurti[1]
[1]Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana
[2]University Hospital of Trauma, Tirana
E-mail: fbrizida@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Artificial Intelligence (AI) is an innovative technology with the potential to transform healthcare services by fundamentally reshaping the ways in which patients are diagnosed, treated, and monitored. However, alongside its benefits, significant ethical, legal, and social challenges arise, affecting trust, accountability, and fairness within healthcare systems.
Aim: The aim of this study is to examine the ethical implications and challenges associated with the use of AI in healthcare. The study analyzes how AI relates to fundamental ethical principles such as autonomy, beneficence, non-maleficence, and justice.
Methodology: This study is based on a literature review including English-language articles published after 2018 in databases such as PubMed, Scopus, and Web of Science. The purpose was to synthesize existing knowledge on the moral dilemmas associated with the integration of AI into healthcare practices.
Results: The study found that the adoption of AI in healthcare presents significant ethical challenges, including its impact on patient autonomy, difficulties in obtaining informed consent, concerns regarding privacy and data protection, the potential reduction of human interaction in patient care, social inequalities, and neglect of human values. Among the most prominent values identified in the reviewed studies, reflecting core ethical principles, are: security, where non-maleficence (avoiding harm) is a primary priority; self-direction, which reflects freedom, autonomy, dignity, and privacy; benevolence, associated with doing good, responsibility, trust, transparency, and solidarity; universalism, guided by the principle of justice and long-term sustainability.
Conclusions: Artificial intelligence has great potential to improve healthcare systems; however, its implementation requires strong ethical oversight. Integrating ethical principles into the development and application of AI is essential to ensure fairness, trust, and accountability. AI should complement, not replace human judgment, while preserving fundamental human values in healthcare.

Keywords: *Artificial Intelligence (AI), Healthcare, Patient Autonomy, Ethical Principles.*

MËSIMDHËNIA DIGJITALE DHE SIMULIMI KLINIK NË EDUKIMIN SHËNDETËSOR: SFIDAT DHE MUNDËSITË NGA QENDRA DIGITALE SIMULATORE NË FAKULTETIN E SHËNDETIT, SHQIPËRI

Juljana Xhindoli[1], Stiliana Brokaj[1], Mimoza Llavdaniti[2], Vasilika Prifti[1], Erda Tozaj[1], Erlini Kokalla[1]

[1]Departamenti i Kujdesit Shëndetësor Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Albania

[2]Departmententi i Infermierisë, Universiteti E. Cabej, Gjirokastër

E-mail: juljana.xhindoli@univlora.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Edukimi i profesionistëve të shëndetit po transformohet nga integrimi i teknologjive digjitale dhe simulimit klinik, të cilat po redefinojnë mënyrën e zhvillimit të kompetencave profesionale. Në këtë kontekst, përdorimi i simulimit nuk është më vetëm një mjet didaktik, por një komponent strategjik i sistemeve moderne të edukimit shëndetësor.

Qëllimi: Ky studim synon të analizojë sfidat dhe mundësitë e implementimit të mësimdhënies digjitale dhe simulimit klinik në Shqipëri, duke u fokusuar në përvojën e Qendrës Digitale Simulatore për profesionistët e shëndetit në FSH si një model inovativ në edukimin shëndetësor.

Metodologjia: Studimi ka një qasje analitike dhe përshkruese, duke analizuar organizimin e mësimdhënies, përdorimin e teknologjive simulatore dhe integrimin e tyre në kurrikulë. Janë shqyrtuar praktikat institucionale, përvojat e stafit akademik dhe ndikimi në përgatitjen profesionale të studentëve, në raport me rekomandimet ndërkombëtare për edukimin digjital dhe simulimin klinik.

Rezultatet: Gjetjet tregojnë se përdorimi i simulimit klinik dhe teknologjive digjitale ka përmirësuar ndjeshëm mësimnxënien aktive, zhvillimin e aftësive praktike dhe vetëbesimin profesional të studentëve. Qendra Digitale Simulatore përfaqëson një infrastrukturë kyçe që mundëson trajnimin në kushte të kontrolluara dhe të standardizuara. Megjithatë, sfidat kryesore lidhen me nevojën për standardizim të praktikave, trajnim të vazhdueshëm të stafit dhe integrim më të plotë të teknologjisë në vlerësimin akademik.

Konkluzione: Mësimdhënia e bazuar në simulim dhe teknologji digjitale paraqet një potencial të madh për modernizimin e edukimit shëndetësor në Shqipëri. Modeli i zbatuar në Fakultetin e Shëndetit demonstron se, përmes investimeve strategjike dhe inovacionit pedagogjik, është e mundur të arrihet një përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, për një zhvillim të qëndrueshëm kërkohet adresimi i sfidave strukturore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale.

Fjalë kyçe: *simulim klinik, edukim infermieror, kompetenca profesionale, qender simulimi, vlerësim klinik.*

DIGITAL AND SIMULATION-BASED EDUCATION IN HEALTH SCIENCES: CHALLENGES AND OPPORTUNITIES FROM THE DIGITAL SIMULATION CENTER AT THE FACULTY OF HEALTH, ALBANIA

Juljana Xhindoli[1], Stiliana Brokaj[1], Mimoza Llavdaniti[2], Vasilika Prifti[1], Erda Tozaj[1], Erlini Kokalla[1]

[1]Faculty of Health, University of Vlora "Ismail Qemali",
[2]Department of Nursing, University of Gjirokastra,
E-mail: juljana.xhindoli@univlora.edu.al

ABSTRACT

Background: Health professional education is undergoing significant transformation driven by the integration of digital technologies and clinical simulation, which are redefining how professional competencies are developed. In this context, simulation-based education is no longer considered only a teaching tool, but a strategic component of modern healthcare education systems.

Aim: This study aims to analyze the challenges and opportunities of implementing digital and simulation-based education in Albania, with a specific focus on the experience of the Digital Simulation Center for Health Professionals at the Faculty of Health (FSH) as an innovative model in health sciences education.

Methods: A descriptive and analytic approach was used to examine the organization of teaching, the integration of simulation technologies into the curriculum, and their impact on students' professional preparation. Institutional practices, academic staff experiences, and student learning outcomes were analyzed in relation to international recommendations on digital and simulation-based education.

Results: Findings indicate that the integration of clinical simulation and digital technologies has significantly enhanced active learning, practical skills acquisition, and students'professional confidence. The Digital Simulation Center represents a key infrastructure that enables standardized and controlled clinical training. However, major challenges include the need for standardization of simulation practices, continuous faculty development, and deeper integration of technology into formal assessment processes.

Conclusions: Digital and simulation-based education presents substantial potential for modernizing health professional education in Albania. The model implemented at the Faculty of Health demonstrates that, through strategic investment and pedagogical innovation, alignment with international standards is achievable. Nevertheless, sustainable development requires addressing structural challenges and strengthening institutional capacities.

Keywords: *digital education; clinical simulation; nursing education; health sciences; Albania; simulation center*

EKSPLORIMI I NJOHURIVE DHE QËNDRIMEVE NDAJ FRAXHILITETIT DHE VLERËSIMIT GERIATRIK TË PROFESIONISTËVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI

Brunilda Elezi[1], Shqipe Luta[1], Skender Topi[1], Kaçe Bahushi[1], Elira Tashi[1], Elona Dybeli[1]

[1] Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore, Universiteti i Elbasanit
E-mail: brunilda.elezi@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Një qasje gjithëpërfshirëse e njohur si Vlerësim Gjithëpërfshirës Geriatrik (VGJ) është thelbësore për përmirësimin e kujdesit për të moshuarit, veçanërisht ata që konsiderohen në rrezik për fraxhilitet. Kujdesi efektiv geriatrik varet nga qëndrimet dhe njohuritë e anëtarëve të stafit të kujdesit shëndetësor në lidhje me VGJ dhe fraxhilitetin.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë njohuritë e ofruesve të kujdesit shëndetësor në lidhje me VGJ dhe perspektivat e tyre mbi fraxhilitetin te pacientët e moshuar.
Metodologjia: Një studim cross-sectional i profesionistëve të kujdesit shëndetësor nga fusha të ndryshme që morën pjesë në një projekt kombëtar të financaur nga AKKSHI mbi VGJ dhe fraxhilitetin u krye gjatë një harku kohor prej një viti. U përdor një pyetësor i standardizuar që vlerëson ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve për fraxhilitetin, qëndrimet ndaj zbatimit të tij në praktikë dhe kuptimin e VGJ-së. SPSS (versioni 26.0) u përdor për të analizuar të dhënat, dhe statistikat përshkruese u përdorën për të vlerësuar nivelet e njohurive dhe qëndrimeve pozitive dhe për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme të gjetjeve.
Rezultatet: Në studim morën pjesë gjithsej 649 profesionistë të kujdesit shëndetësor, ku shumica ishin infermierë (64%). Rreth 70% raportuan se nuk përdorin asnjë formë vlerësimi ose instrumenti sipas profilit të tyre të punës për fraxhilitetin te të rriturit e moshuar. 63.5% e pjesëmarrësve raportuan se nuk kishin marrë kurrë trajnim të dedikuar për geriatrinë. Ekziston një qasje pozitive në lidhje me zbatimin e fraxhilitetit te të moshuarit si screening rutinë nga 58.1% e pjesëmarrësve.
Konkluzione: Këto rezultate tregojnë një hendek midis praktikës klinike standarde dhe asaj që profesionistët mjekësorë besojnë se është thelbësore për kujdesin dhe trajtimin e pacientëve të moshuar. Shumë mund të jenë më pak të sigurt në këtë fushë sepse nuk kanë marrë trajnim të specializuar në geriatri dhe nuk përdorin shpesh metoda të vlerësimit të fraxhilitetit. Megjithatë, dëshira e përgjithshme për të vazhduar me futjen e kontrollit të fraxhilitetit është pozitive. Përmirësimi i kujdesit për të moshuarit mund të jetë i mundur duke u ofruar punonjësve trajnime të fokusuara dhe qasje më të lehtë në burime të dobishme.

Fjalë kyçe: *Njohuri, profesionistë të kujdesit shëndetësor, të moshuar të rritur, CGA, brishtësi, Shqipëria.*

EXPLORING KNOWLEDGE AND ATTITUDES TOWARD FRAILTY AND GERIATRIC ASSESSMENT AMONG HEALTHCARE PROFESSIONALS IN ALBANIA

Brunilda Elezi[1], Shqipe Luta[1], Skender Topi[1], Kaçe Bahushi[1], Elira Tashi[1], Elona Dybeli[1]
[1] Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan
E-mail: brunilda.elezi@uniel.edu.al

ABSTRACT

Introduction: A comprehensive approach known as Comprehensive Geriatric Assessment (CGA) is essential for improving care for older adults, particularly those who are considered at risk of frailty. Effective geriatric care depends upon healthcare staff members' attitudes and knowledge regarding CGA and frailty.

Purpose: The aim of this study is to evaluate health care providers' knowledge regarding CGA and their perspectives on frailty in older patients.

Methodology: A cross-sectional study of healthcare professionals from various backgrounds who participated in a national project on CGA and frailty was conducted over a period of one year. A standardized questionnaire assessing participants' awareness of frailty, attitudes toward its application in practice, and understanding of CGA is being carried out. SPSS (version 26.0) was used to analyze the data, and descriptive statistics were employed to estimate levels of knowledge and positive attitudes and to provide an overview of the findings.

Results: A total of 649 healthcare professionals participated in the study, with the majority being nurses (64%). About 70% reported that they do not use any form of assessment or instrument according to their work profile for frailty in older adults.63.5% of participants reported that they had never received training dedicated to geriatrics. There is a positive approach regarding the implementation of frailty in the elderly as routine screening by 58.1% of participants.

Conclusions: These results indicate a gap between standard clinical practice and what medical professionals believe is crucial for the care and treatment of elderly patients. Many may be less confident in this area because they have not obtained specialized training in geriatrics and do not often use frailty assessment methods. However, the general desire to proceed with the introduction of frailty screening is positive. Enhancing care for elderly people may be possible by providing workers with focused training and easier access to useful resources.

Keywords: *Knowledge, healthcare professionals, older adults, CGA, frailty, Albania.*

INCIDENCA E AVC NË NEUROLOGJI

Antigoni Bullari[1], Ilirjana Zekja[2], Eglita Laci[3]
[1] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
[2] QSUNT; Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
[3] Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
E-mail: antigonibullari7@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Aksidenti cerebrovaskular (AVC), apo insulti cerebral, është një dëmtim neurologjik fokal akut, jo konvulsiv, që zgjat më shumë se 24 orë dhe shkakton pasoja neurologjike si hemiplegjia, afazia, koma, hemipareza etj. Ai është shkaku i tretë kryesor i vdekjes në botë, si dhe shkaku kryesor i aftësisë së kufizuar në moshën e rritur.

Objektivat: Identifikimi i incidencës së AVC në pavionet e shtrimit në Neurologji.

Metodologjia: Studim retrospektiv.

Rezultatet: U morën në studim pacientët e shtruar në pavionet e Neurologjisë në QSUNT gjatë periudhës 03.04.2025-14.05.2025. Nga 61 shtrime në pavion, 20 prej tyre ishin me diagnozë hyrëse AVC, përkatësisht 32,7%. Në 20 pacientët, raporti femër:mashkull ishte 45%:55%, të grupmoshës 51–88 vjeç, me një mesatare prej 74,8 vjeç (75 vjeç).

Konkluzionet: AVC ka një incidencë të lartë të shtrimeve në neurologji, duke kryesuar si patologjia më e shpeshtë në këtë pavion. Incidenca është më e lartë tek meshkujt sesa tek femrat, përkatësisht 11 meshkuj dhe 9 femra, e cila përputhet me studimin e vitit 2019 mbi AVC në pavionin e Neurologjisë, ku raporti femër:mashkull ishte 44%:56%. Numri i lartë i pacientëve gjithashtu tregon domosdoshmërinë e ndërhyrjes logopedike për këta pacientë, si për problematikat e gëlltitjes dhe të përtypjes, ashtu edhe për komunikimin.

Fjalë kyçe: *AVC, ishemi, neurologji, logopedi.*

INCIDENCE OF CVA IN NEUROLOGY

Antigoni Bullari[1], Ilirjana Zekja[2], Eglita Laci[3]
[1] University of Medicine Tirana, Faculty of Medical Technical Sciences, Tirana, Albania,
[2] University of Medicine Tirana, Faculty of Medical Technical Sciences, Tirana, Albania
[3] University Hospital Center "Mother Teresa", Neurology Department, Tirana, Albania
E-mail: antigoni.bullari@umed.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Cerebrovascular accident, or CVA, is an acute, non-convulsive focal neurological injury that lasts more than 24 hours, which causes neurological consequences such as hemiplegia, aphasia, coma, hemiparesis, etc. It is the third leading cause of death in the world, but also the leading cause of disability in adulthood.

Objectives: Identification of the incidence of CVA in Neurology wards

Methodology: Retrospective study

Results: Patients admitted to Neurology at QSUNT during the period 03.04.2025-14.05.2025 were studied. In 61 admissions to the ward, 20 of them had an initial diagnosis of CVA, respectively 32.7%. In 20 patients, the female:male ratio was 45%-55% of the age group 51-88 years, with an average of 74.8 years (75 years).

Conclusions: Strokes have a high incidence of hospitalizations in neurology, leading as a pathology in this ward. The incidence is higher in males than in females, respectively 11 males and 9 females, which is again confirmed as in the 2019 study conducted in Neurology on Stroke where statistics showed a female:male ratio of 44%:56%. The high number of patients in this ward also indicates the necessity of speech therapy intervention in these patients for both swallowing and feeding problems, and for communication.

Keywords: *Stroke, Ischemia, Neurology, Speech Therapy, CVA*

INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA NË PROCESET INFERMIERISTIKE: NDIKIMI, SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT PËR PRAKTIKËN KLINIKE

Lutfi Lami [1]
[1] Zëvendës president i UISH
E-mail: lutfi.lami@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Transformimi digjital po ndryshon rrënjësisht ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe rolin e infermierëve. Rritja e kompleksitetit të kujdesit, sëmundjet kronike dhe mungesa e burimeve njerëzore vendosin infermierinë në qendër të inovacionit teknologjik. Sistemet elektronike të regjistrave mjekësorë (EHR/EMR), pajisjet inteligjente, monitorimi në distancë dhe tele-mjekësia mundësojnë dokumentim të saktë, koordinim multidisiplinar dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë, duke rritur sigurinë e pacientit dhe përmirësuar vazhdimësinë e kujdesit.
Qëllimi: Analizimi i rolit dhe ndikimit të teknologjisë në proceset infermieristike, vlerësimi i përfitimeve klinike, sfidave të zbatimit dhe perspektivave për zhvillim në realitetin shqiptar.
Objektivat: Të identifikohen teknologjitë kryesore që transformojnë kujdesin infermieristik. Të analizohen përfitimet dhe sfidat e EHR/EMR dhe pajisjeve digjitale. Të shqyrtohet ndikimi i inovacionit në kompetencat dhe vendimmarrjen e infermierëve. Të përcaktohen pritshmëritë dhe strategjitë për zhvillimin e infermierisë digjitale në Shqipëri.
Metodologjia: Studimi bazohet në analizë përshkruese të praktikës bashkëkohore dhe evidencës ndërkombëtare, duke fokusuar fazat kryesore të kujdesit: vlerësimi, diagnoza, planifikimi, zbatimi dhe vlerësimi i ndërhyrjeve infermieristike. Janë përfshirë teknologji si kartela shëndetësore elektronike, monitorimi i parametrave vitalë, pajisjet e veshshme, NPWT, tele-mjekësia, teknologjitë në diabet, kateterizimi dhe sterilizimi modern.
Rezultatet dhe Përfundimet: Teknologjia përmirëson sigurinë, redukton gabimet klinike dhe rrit vazhdimësinë e kujdesit, ndërsa infermierët janë përdorues kryesorë dhe vendimtarë në monitorim, dokumentim dhe edukim të pacientëve. Në Shqipëri, sfidat kryesore përfshijnë mungesën e standardizimit dhe trajnimin jo të unifikuar. Integrimi i suksesshëm kërkon investime të qëndrueshme, zhvillim profesional të vazhdueshëm dhe përfshirje aktive të infermierëve. Kombinimi i inovacionit teknologjik me humanizmin infermieror përfaqëson një mundësi reale për përmirësimin e sistemit shëndetësor dhe afrimin me standardet evropiane.

Fjalë kyçe: *Inovacioni teknologjik; Proceset infermieristike; Shëndetësia digjitale; Siguria e pacientit; Kartela shëndetësore elektronike (EHR).*

INNOVATION AND TECHNOLOGY IN NURSING PROCESSES: IMPACT, CHALLENGES AND PERSPECTIVES FOR CLINICAL PRACTICE

Lutfi Lami[1]
[1] Vice President of UISH
E-mail: lutfi.lami@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Digital transformation is fundamentally changing the delivery of health care and the role of nurses. The increase in the complexity of care, chronic diseases and the lack of human resources place nursing at the center of technological innovation. Electronic health record systems (EHR/EMR), smart devices, remote monitoring and telemedicine enable accurate documentation, multidisciplinary coordination and evidence-based decision-making, increasing patient safety and improving continuity of care.

Aim: To analyze the role and impact of technology in nursing processes, to evaluate clinical benefits, implementation challenges and perspectives for development in the Albanian context.

Objectives: To identify the main technologies that transform nursing care. To analyze the benefits and challenges of EHR/EMR and digital devices. To examine the impact of innovation on nurses' competencies and decision-making. To determine expectations and strategies for the development of digital nursing in Albania.

Methodology: The study is based on a descriptive analysis of contemporary practice and international evidence, focusing on the main phases of care: assessment, diagnosis, planning, implementation and evaluation of nursing interventions. Technologies included are electronic health records, monitoring of vital parameters, wearable devices, NPWT, telemedicine, technologies in diabetes, catheterization and modern sterilization.

Results and Conclusions: Technology improves safety, reduces clinical errors and increases continuity of care, while nurses are key users and decision-makers in monitoring, documentation and patient education. In Albania, the main challenges include lack of standardization and non-unified training. Successful integration requires sustainable investments, continuous professional development and active involvement of nurses. The combination of technological innovation with nursing humanism represents a real opportunity for improving the health system and approaching European standards.

Keywords: *Technological innovation; Nursing processes; Digital health; Patient safety; Electronic health records (EHR)*

KUJDESI INFERMIEROR TEK PACIENTËT ME ASTMË BRONKIALE: INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË NË PRAKTIKËN KLINIKE

Violeta Zanaj[1], Joana Bregasi [2]

[1] Departamentin i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
[2] PMN , Infermiere
E-mail: violetazanaj@uamd.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Astma bronkiale është një sëmundje inflamatore kronike e rrugëve të frymëmarrjes, e karakterizuar nga obstruksion i kthyeshëm i fluksit ajror, hiperreaktivitet bronkial dhe episode të përsëritura të fishkëllimës, dispnesë, shtrëngimit torakal dhe kollës. Ajo përbën një problem të rëndësishëm të shëndetit publik global, me prevalencë në rritje për shkak të faktorëve mjedisorë, gjenetikë dhe të stilit të jetesës. Ndikimi i saj në cilësinë e jetës së pacientëve dhe në sistemet shëndetësore është i konsiderueshëm, duke kërkuar ndërhyrje të koordinuara dhe të vazhdueshme.

Qëllimi: Qëllimi i këtij projekti është të paraqesë një analizë të integruar të anatomisë së sistemit respirator, patofiziologjisë së astmës bronkiale, faktorëve të rrezikut, manifestimeve klinike, klasifikimit dhe strategjive parandaluese, me theks të veçantë në rolin e kujdesit infermieror në menaxhimin e kësaj patologjie.

Metodologjia: Punimi bazohet në rishikim të literaturës bashkëkohore shkencore mbi astmën bronkiale, duke analizuar burime të përditësuara lidhur me aspektet klinike dhe praktikat e kujdesit infermieror në menaxhimin e sëmundjes. Janë përfshirë udhëzime ndërkombëtare dhe artikuj shkencorë që trajtojnë qasjet moderne të trajtimit dhe kujdesit.

Rezultatet: Analiza thekson rëndësinë e diagnostikimit të hershëm, kontrollit të faktorëve nxitës dhe respektimit të trajtimit farmakologjik dhe jo - farmakologjik. Kujdesi infermieror luan rol kyç në vlerësimin sistematik të pacientit, edukimin shëndetësor, administrimin korrekt të medikamenteve dhe ndërhyrjen emergjente gjatë krizave astmatike. Gjithashtu, përfshirja aktive e pacientit në vetëmenaxhimin e sëmundjes dhe ndjekja e rregullt klinike kontribuojnë në përmirësimin e rezultateve shëndetësore.

Përfundime: Menaxhimi efektiv i astmës kërkon një qasje multidisiplinare dhe parandaluese, ku edukimi i pacientit dhe monitorimi i vazhdueshëm kontribuojnë në reduktimin e morbiditetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Zbatimi i protokolleve të bazuara në evidencë është thelbësor për kontroll optimal të sëmundjes dhe minimizimin e komplikacioneve, duke përfshirë edhe reduktimin e shtrimeve spitalore dhe emergjencave respiratore.

Fjalë kyçe: *Astma bronkiale, sistemi respirator, inflamacioni i rrugëve të frymëmarrjes, kujdesi infermieror.*

NURSING CARE IN PATIENTS WITH BRONCHIAL ASTHMA: INTEGRATION OF TECHNOLOGY INTO CLINICAL PRACTICE

Violeta Zanaj[1], Joana Bregasi[2]
[1] Department of Medical Technical Sciences Aleksander Moisiu University, Durrës
[2]Registered Nurse
E-mail: violetazanaj@uamd.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Bronchial asthma is a chronic inflammatory disease of the airways, characterized by reversible airflow obstruction, bronchial hyperreactivity, and recurrent episodes of wheezing, dyspnea, chest tightness, and cough. It represents an important global public health problem, with increasing prevalence due to environmental, genetic, and lifestyle factors. Its impact on patients' quality of life and on healthcare systems is considerable, requiring coordinated and continuous interventions.
Aim: The aim of this project is to present an integrated analysis of the anatomy of the respiratory system, the pathophysiology of bronchial asthma, risk factors, clinical manifestations, classification, and preventive strategies, with particular emphasis on the role of nursing care in the management of this pathology.
Methodology: The study is based on a review of contemporary scientific literature on bronchial asthma, analyzing updated sources related to clinical aspects and nursing care practices in disease management. International guidelines and scientific articles addressing modern approaches to treatment and care have been included.
Results: The analysis highlights the importance of early diagnosis, control of triggering factors, and adherence to pharmacological and non-pharmacological treatment. Nursing care plays a key role in the systematic assessment of the patient, health education, correct administration of medications, and emergency intervention during asthmatic crises. Furthermore, the active involvement of the patient in self-management of the disease and regular clinical follow-up contribute to the improvement of health outcomes.
Conclusions: Effective asthma management requires a multidisciplinary and preventive approach, where patient education and continuous monitoring contribute to the reduction of morbidity and improvement of quality of life. The implementation of evidence-based protocols is essential for optimal disease control and minimization of complications, including the reduction of hospital admissions and respiratory emergencies.

Keywords: *Bronchial asthma; respiratory system; airway inflammation; nursing care.*

VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE PRAKTIKAVE TË STUDENTËVE TË INFERMIERISË MBI FAKTORËT E RREZIKUT DHE VETË-EKZAMINIMIN E GJIRIT PËR ZBULIMIN E HERSHËM TË KANCERIT TË GJIRIT

Rajmonda Oboni (Hida)[1], Shqipe Luta[1], Albana Sula[1], Ilma Toci [1], Arkida Skenderi[1], Entela Driza[1], Venemin Gega[1], Gjergji Doka[1]

[1] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani
E-mail: mondahida86@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Kanceri i gjirit përbën një nga problemet kryesore të shëndetit publik në nivel global dhe është tumori malinj më i shpeshtë tek gratë. Zbulimi i hershëm përmes identifikimit të faktorëve të rrezikut dhe praktikave parandaluese, si vetë-ekzaminimi i gjirit (VEGj), është thelbësor për përmirësimin e rezultateve klinike. Studentët e infermierisë luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e edukimit shëndetësor dhe ndërgjegjësimit në komunitet.

Qëllimi: Të vlerësojë nivelin e njohurive dhe praktikave të studentëve të infermierisë të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan lidhur me faktorët e rrezikut dhe vetë-ekzaminimin e gjirit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit.

Metodologjia: Studimi kishte një dizajn transversal (cross-sectional) dhe u realizua në një kampion të rastësishëm prej 352 studentësh. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori të strukturuar, të shpërndarë në mënyrë elektronike, i cili përfshinte të dhëna socio-demografike, si dhe pyetje mbi njohuritë dhe praktikat e lidhura me kancerin e gjirit dhe VEGj.

Rezultatet: Mosha e pjesëmarrësve varionte nga 18 deri në 44 vjeç, ku 65, 3% i përkisnin programit të Infermierisë së Përgjithshme. Shumica dërrmuese (95, 4%) raportuan se kishin informacion mbi kancerin e gjirit, kryesisht nga studimet universitare (62,2%), ndërsa profesionistët e shëndetit dhe rrjetet sociale përbënin burime dytësore (10,2% secila). Histori familjare të kancerit të gjirit u raportua nga 8,3% e studentëve, ndërsa mbi 51% identifikuan saktë faktorët kryesorë të rrezikut. Sa i përket VEGj, 71, 1% kishin dëgjuar për këtë praktikë, por vetëm 31,1% e praktikonin atë, ndërsa 45,7% nuk e kryenin në mënyrë të rregullt.

Konkluzione: Megjithëse studentët zotërojnë një nivel të kënaqshëm njohurish mbi faktorët e rrezikut për kancerin e gjirit, këto njohuri nuk reflektohen në mënyrë të mjaftueshme në praktikë. Rritja e ndërhyrjeve edukative dhe organizimi i trajnimeve praktike janë të domosdoshme për përmirësimin e zbatimit të VEGj.

Fjalë kyçe: *Kancer gjiri, vetë-ekzaminim i gjirit, studentë infermierie, faktorë rreziku, praktikë.*

ASSESSMENT OF NURSING STUDENTS' KNOWLEDGE AND PRACTICES REGARDING RISK FACTORS AND BREAST SELF-EXAMINATION FOR THE EARLY DETECTION OF BREAST CANCER

Rajmonda Oboni (Hida)[1*], Shqipe Luta[1], Albana Sula[1], Ilma Toci [1], Arkida Skenderi[1], Entela Driza[1], Venemin Gega[1], Gjergji Doka[1]
[1]Faculty of Technical Medical Sciences, Aleksandër Xhuvani University of Elbasan
E-mail: mondahida86@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Breast cancer represents one of the leading global public health concerns and remains the most common malignancy among women. Early detection through the identification of risk factors and the promotion of preventive practices, such as breast self-examination (BSE), is essential for improving clinical outcomes. Nursing students constitute a key group in promoting health education and raising awareness within the community.
Aim: To assess the level of knowledge and practices of nursing students at "Aleksandër Xhuvani" University in Elbasan regarding breast cancer risk factors and breast self-examination for early detection.
Methodology: A cross-sectional study design was employed, involving a randomly selected sample of 352 students. Data collected a structured electronic questionnaire, which included socio-demographic characteristics, as well as questions assessing knowledge of breast cancer risk factors and BSE practices.
Results: Participants' ages ranged from 18 to 44 years, with 65.3% enrolled in the General Nursing program. The majority (95.4%) reported having information about breast cancer, primarily acquired through university studies (62.2%), while healthcare professionals and social media were cited as secondary sources (10.2% each). A family history of breast cancer was reported by 8.3% of participants, and over 51% correctly identified the main risk factors. Regarding BSE, 71.1% had heard of the practice; however, only 31.1% reported performing it, and 45.7% did not practice it regularly.
Conclusions: Although nursing students demonstrate a satisfactory level of knowledge regarding breast cancer risk factors, this knowledge is not proportionally reflected in regular BSE practice. Enhanced educational interventions and practical training are necessary to improve the implementation of this preventive measure.

Keywords: *Breast cancer, breast self-examination, nursing students, risk factors, practice.*

ROLI I PARAMETRAVE TË SKANIMIT DHE OPTIMIZIMI I TYRE NË CILËSINË E IMAZHIT TË ANGIO-CT NË DIAGNOSTIKIMIN E TROMBOEMBOLISË PULMONARE

Hane Peposhi[1]

[1] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjeksisë, Tiranë, Shqipëri
E-mail: hanepeposhi@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Tromboembolia pulmonare (TEP) është një patologji e shpeshtë dhe potencialisht kërcënuese për jetën, veçanërisht nëse nuk diagnostikohet në kohë. Në shumicën e rasteve, diagnoza e TEP nuk mund të vendoset vetëm mbi bazën e të dhënave klinike, duke e bërë imazherinë një komponent thelbësor diagnostik. Angio-Tomografia e Kompjuterizuar Pulmonare (CTPA) konsiderohet metoda më e besueshme për diagnostikimin e TEP. Rritja e numrit të detektorëve në skanerët CT lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së imazhit dhe performancës diagnostike.
Qëllimi: Qëllimi është vlerësimi i parametrave të cilësisë së imazhit përmes krahasimit të dy skanerëve CT me 16 dhe 128 detektorë në ekzaminimet CTPA.
Materiale dhe Metoda: Studimi përfshiu 35 ekzaminime Angio-CT me kontrast intravenoz, të realizuara me indikacion për TEP. Prej tyre, 17 imazhe u përfituan nga skaneri CT me 16 detektorë dhe 18 nga skaneri CT me 128 detektorë (GE Revolution 128 slice dhe Siemens Somatom HD 16 slice), në Urgjencën e Spitalit Universitar "Nënë Tereza", Tiranë. Analiza u krye duke vendosur ROI në arterien pulmonare kryesore dhe duke matur densitetin (HU), devijacionin standard (SD), si dhe raportet SNR dhe CNR.
Rezultatet: Skaneri me 128 detektorë prodhoi 73% imazhe me cilësi shumë të mirë diagnostike, krahasuar me 27% të skanerit me 16 detektorë. Gjithashtu, skaneri me 128 detektorë tregoi kohë më të shkurtër skanimi dhe vlera më të larta të SNR dhe CNR, duke reflektuar cilësi më të lartë imazhi dhe kontrast më të mirë vaskular.
Konkluzionet: Skanerët CT me numër më të madh detektorësh ofrojnë cilësi më të mirë imazhi dhe performancë më të lartë diagnostike në CTPA. Megjithatë, skanerët me më pak detektorë mbeten të besueshëm për diagnozë, pavarësisht ndikimit të faktorëve klinikë dhe teknikë në cilësinë e imazhit.

Fjalë kyçe: *Tromboemboli pulmonare, CTPA, cilësi imazhi, SNR, CNR.*

THE ROLE OF SCANNING PARAMETERS AND THEIR OPTIMIZATION IN THE QUALITY OF ANGIO-CT IMAGES IN THE DIAGNOSIS OF PULMONARY THROMBOEMBOLISM

Hane Peposhi[1]
[1] Faculty of Medical Technical Sciences, University of Medicine, Tirana, Albania
E-mail: hanepeposhi@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Pulmonary thromboembolism (PTE) is a frequent and potentially life-threatening pathology, especially if not diagnosed in time. In most cases, the diagnosis of PTE cannot be established based on clinical data alone, making imaging an essential diagnostic component. Computed Tomography of Pulmonary Angio-Gamma (CTPA) is considered the most reliable method for the diagnosis of PTE. The increase in the number of detectors in CT scanners is directly related to the improvement of image quality and diagnostic performance.
Purpose: The aim of this study is to evaluate the image quality parameters by comparing two CT scanners with 16 and 128 detectors in CTPA examinations.
Materials and Methods: The study included 35 Angio-CT examinations with intravenous contrast, performed with the indication for TEP. Of these, 17 images were obtained from the CT scanner with 16 detectors and 18 from the CT scanner with 128 detectors (GE Revolution 128 slice and Siemens Somatom HD 16 slice), in the Emergency Department of the University Hospital "Mother Teresa", Tirana. The analysis was performed by placing the ROI on the main pulmonary artery and measuring the density (HU), standard deviation (SD), as well as the SNR and CNR ratios.
Results: The 128-detector scanner produced 73% images with very good diagnostic quality, compared to 27% of the 16-detector scanner. Also, the 128-detector scanner showed shorter scan times and higher SNR and CNR values, reflecting higher image quality and better vascular contrast.
Conclusions: CT scanners with a higher number of detectors provide better image quality and higher diagnostic performance in CTPA. However, scanners with fewer detectors remain reliable for diagnosis, despite the influence of clinical and technical factors on image quality.

Keywords: *Pulmonary thromboembolism, CTPA, image quality, SNR, CNR.*

TRANSFORMIMI DIGJITAL I EDUKIMIT INFERMIEROR: NGA MËSIMI TRADICIONAL TE KOMPETENCAT E EPOKËS DIGJITALE

Silvana Gripshi[1], Dasilva Taci
[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Western Balkans
E-mail: silvana.gripshi@wbu.edu.al

ABSTRACT

Hyrje: Transformimi digjital po ndryshon rrënjësisht strukturën dhe funksionimin e sistemeve shëndetësore, duke gjeneruar kërkesa të reja dhe komplekse për edukimin infermieror. Zhvendosja nga paradigma tradicionale e edukimit, e fokusuar në përvetësimin e njohurive teorike dhe praktikën klinike të strukturuar, drejt një modeli të integruar digjital kërkon rikonceptim të kompetencave profesionale.
Objektivat: Ky studim synon të analizojë dimensionet kryesore të transformimit digjital në edukimin infermieror dhe të identifikojë kompetencat thelbësore të infermierit në epokën digjitale.
Metodologjia: Studimi bazohet në një analizë konceptuale të mbështetur në sintezën integruese të kornizave ndërkombëtare të shëndetit dhe arsimit digjital, përfshirë dokumente strategjike të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), Komisionit Evropian (EC) dhe Këshillit Ndërkombëtar të Infermierëve (ICN). Studimi kontribuon në zhvillimin e një modeli konceptual të integruar të kompetencave digjitale për edukimin infermieror. Ky model bazohet në analizën e komponentëve kryesorë të transformimit digjital.
Rezultatet: Gjetjet evidentojnë se kompetencat digjitale përfshijnë jo vetëm aftësi teknike, si dokumentimi elektronik dhe siguria kibernetike, por edhe mendim kritik, kompetencë në përdorimin e inteligjencës artificiale, etikë digjitale, vendimmarrje të bazuar në të dhëna dhe bashkëpunim ndërprofesional në mjedise digjitale. Gjetjet sugjerojnë domosdoshmërinë e rikonceptimit pedagogjik drejt një modeli të orientuar nga studenti, me fokus në zhvillimin e kompetencave përmes metodave aktive dhe të integruara.
Konkluzione: Transformimi digjital i edukimit infermieror përfaqëson një ndryshim paradigme drejt formimit të një profili profesional të përshtatur me kërkesat e sistemeve shëndetësore të dixhitalizuara. Megjithatë, si studim konceptual, modeli i propozuar kërkon validim empirik në kontekste të ndryshme arsimore.

Fjalë kyçe: *transformim digjital, edukim infermieror, kompetenca digjitale, edukimi i bazuar në kompetenca.*

DIGITAL TRANSFORMATION OF NURSING EDUCATION: FROM TRADITIONAL LEARNING TO DIGITAL-ERA COMPETENCIES

Silvana Gripshi[1], Dasilva Taci
[1] Faculty of Technical Medical Sciences, Western Balkans University
E-mail: silvana.gripshi@wbu.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Digital transformation is fundamentally reshaping the structure and functioning of healthcare systems, generating new and complex demands for nursing education. The shift from a traditional educational paradigm - focused on theoretical knowledge acquisition and structured clinical practice - toward an integrated digital model requires a reconceptualization of professional competencies.
Objectives: This study aims to analyze the key dimensions of digital transformation in nursing education and to identify the essential competencies required of nurses in the digital era.
Methodology: The study is based on a conceptual analysis supported by an integrative synthesis of international digital health and education frameworks, including strategic documents from the World Health Organization (WHO), the European Commission (EC), and the International Council of Nurses (ICN). The study contributes to the development of an integrated conceptual model of digital competencies for nursing education, grounded in the analysis of the core components of digital transformation.
Results: Findings indicate that digital competencies extend beyond technical skills such as electronic documentation and cybersecurity. They also include critical thinking, proficiency in the use of artificial intelligence, digital ethics, data-driven decision-making, and interprofessional collaboration within digital environments. The findings highlight the necessity for pedagogical reconceptualization toward a student-centered model, emphasizing the development of competencies through active and integrated learning methods.
Conclusions: The digital transformation of nursing education represents a paradigm shift toward preparing a professional profile aligned with the demands of digitalized healthcare systems. However, as a conceptual study, the proposed model requires empirical validation across diverse educational contexts.

Keywords: *Digital transformation, nursing education, digital competencies, competency-based education.*

TRAJTIMI I LËNDIMEVE NGA ARMËT E ZGJARRIT PËRMES NJË FIKSATORI TË JASHTËM

Elona Hasalla[1], Ilda Taka, Blerta Hasalla, Shqipe Luta, Elona Dybeli, Albana Sula, Rajmonda Hida, Sulejman Baha

[1]Universiteti "Aleksandër Xhuvani"Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan
Departamenti i Lëndëve Paraklinike; Departamenti i Specialiteteve Mjekësore Teknike
Departamenti i Infermieristikes; Departamenti i Lendeve Klinike; Universiteti i Firences Itali;
E-mail: elona_hasalla@yahoo.com

ABSTARKT

Hyrje: Incidenca e plagëve me armë zjarri është rritur në mënyrë të konsiderueshme në vëndin tonë, sidomos pas vitit 1997. Dëmtimet me armë zgjarri, edhe pse me energji të vogël kinetike shkatarrojnë indet e buta dhe duhet të trajtohen si fraktura të mbyllura.

Nëse dëmtimi ka shkatuar fraktura të paqëndrueshme, ato duhet të trajtohen nëpërmjet stabilizimit të brëndshëm,kurse frakturat e qëndrueshme duhet të trajtohen nëpërmjet mbështetjes funksionale.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të nënvizojë rëndësinë e përdorimit të fiksatorit ekstern në dëmtimet nga armët e zgjarrit, si dhe rritjes së cilësisë së trajtimit të këtyre pacientëve.

Metodologjia: Studimi jonë është retrospektiv dhe i përket periudhës janar 2020 deri në qershor 2025. Ne kemi marrë në studim 43 pacientë me fraktura të shkaktuara nga armët e zgjarrit.Trajtimi themelor ka qënë imobilizimit i tyre me fiksator ekstern, i ndjekur nga mjekimi i plagëve dhe aplikimi i terapisë së përgjithshme. Nga këta pacientë kanë qënë: meshkuj 32-81 %, (nën 18 vj); 3- 7 %; femra 8-19%. Mosha :maksimale 67 vjeç ;minimale 5 vjeç;mesatare 31 vjeç.Raporti femra / meshkuj 1;4,34.

Konkluzione: Në të gjitha rastet e paraqitura u arrit bashkimi biologjik i kockave për një periudhë kohore maksimale prej 12 muajsh. Përdorimi i fiksatorit ekstern në trajtimin e këtyre pacientëve ishte i domosdoshëm dhe u pa si trajtimi më i mirë i mundshëm.

Rëndësi ka edhe mjekimi i plagëve dhe përdorimi i terapisë adekuate për përmirësimin sa më të shpjetë të pacientëve.

Rekomadime: Trajtimi i frakturave të hapura në plagët me armë zgjarri është kompleks dhe kërkon bashkëpunimin e të gjithë personelit mjekësor.

Përdorimi i fiksatorit të jashtëm siguron zgjidhjen optimale për imobilizimin e frakturës dhe fillimin sa më të shpejtë të proçesit të osteosintezës.

Mjekimi i plagës dhe aplikimi i terapisë adekuate janë kushti themelor për shërimin sa më të shpejtë të pacientit.

Fjalë kyçe: *Frakturë e hapur, plagë, armë zgjarri, fiksator ekstern, osteosintezë.*

TREATMENT OF FIREARM INJURIES USING AN EXTERNAL FIXATOR

Elona Hasalla[1], Ilda Taka, Blerta Hasalla, Shqipe Luta, Elona Dybeli, Albana Sula, Rajmonda Hida, Sulejman Baha

[1]University "Aleksandër Xhuvani", Faculty of Medical Technical Sciences, Elbasan
Department of Preclinical Subjects; Department of Medical Technical Specialties;
Department of Nursing; Department of Clinical Subjects; University of Florence, Italy
E-mail: elona_hasalla@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: The incidence of firearm-related injuries has increased significantly in our country, especially after 1997. Gunshot injuries, even those with low kinetic energy, damage soft tissues and should be treated as closed fractures. If the injury has caused unstable fractures, they should be managed through internal stabilization, whereas stable fractures should be treated with functional support.

Aim: The aim of this study is to highlight the importance of using external fixation in firearm-related injuries, as well as improving the quality of treatment for these patients.

Methodology: Our study is retrospective and covers the period from January 2020 to June 2025. We included 43 patients with fractures caused by firearms. The primary treatment consisted of immobilization using an external fixator, followed by wound management and general therapy. Among these patients: males 32 (81%); under 18 years old: 3 (7%); females 8 (19%). Age: maximum 67 years; minimum 5 years; mean 31 years. Female-to-male ratio: 1:4.34.

Conclusions: In all presented cases, biological bone union was achieved within a maximum period of 12 months. The use of external fixation in treating these patients was essential and proved to be the best possible treatment. Wound care and appropriate therapy are also important for faster patient recovery.

Recommendations: The treatment of open fractures from firearm injuries is complex and requires collaboration among all medical staff. The use of an external fixator provides an optimal solution for fracture immobilization and allows early initiation of the osteosynthesis process. Proper wound management and appropriate therapy are fundamental conditions for rapid patient recovery.

Keywords: *Open fracture, wound, firearm injury, external fixator, osteosynthesis .*

NGA CTA KARDIAKE TE ANGIOGRAFIA KORONARE

Alket Collaku[1], Elona Dybeli[2]
[1] European Hospital Tirana, GVM Care & Research Group, Tiranë, Shqipëri
[1] Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
[2] Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Shqipëri
E-mail: alket_collaku@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Angiografia me Tomografi të Kompjuterizuar e arterieve koronare (CTA) është shfaqur si një metodë e fuqishme jo-invazive për vlerësimin e sëmundjes së arterieve koronare (CAD). Ky studim kishte si qëllim të krahasojë gjetjet e CTA me angiografinë koronare invazive (ICA), e konsideruar si standardi i artë, gjatë një eksperience 10-vjeçare.
Metodologjia: U krye një studim retrospektiv mbi rastet ku pacientët iu nënshtruan si CTA-së ashtu edhe ICA-së brenda një periudhe kohore të krahasueshme klinike. Shkalla e stenozës në arteriet kryesore koronare u kategorizua dhe rezultatet e CTA u krahasuan me gjetjet e ICA-së. U llogarit saktësia diagnostike, përfshirë sensitivitetin, specificitetin, vlerën parashikuese pozitive (PPV) dhe vlerën parashikuese negative (NPV), për dedektimin e stenozave sinjifikante.
Rezultatet: CTA tregoi sensitivitet të lartë dhe NPV të lartë në përjashtimin e CAD sinjifikante, duke shfaqur një përputhje të fortë me ICA-në në shumicën e rasteve. Teknika ishte veçanërisht e besueshme në sëmundjen një dhe dy vazale, ndërsa specifika u ul në prani të kalcifikimeve të shumta ose artefakteve nga lëvizja. Pavarësisht këtyre kufizimeve, CTA uli vazhdimisht nevojën për procedura invazive të panevojshme.
Konkluzione: CTA ka një korrelacion të fortë me ICA në zbulimin e CAD sinjifikante dhe mund të shërbejë si një filtër efektiv përpara teknikave invazive. Në praktikën klinike të përditshme, CTA ofron një alternativë të sigurt, të saktë dhe miqësore për pacientin, e cila e plotëson, por nuk e zëvendëson plotësisht vlerën diagnostike të ICA-së.

Fjalë kyçe: *CTA, ICA, arteriet koronare, kalcifikimi, pllakat e buta.*

FROM CARDIAC CTA TO CORONARY ANGIOGRAPHY

Alket Collaku [1], Elona Dybeli [2]
[1] European Hospital Tirana, GVM Care & Research Group, Tirana, Albania
[1] University of Medicine Tirana, Albania
[2] University of Elbasan "Aleksander Xhuvani", Elbasan, Albania
E-mail: alket_collaku@yahoo.com

ABSTRACT

Background: Coronary Computed Tomography Angiography (CTA) has emerged as a powerful non-invasive tool for evaluation of coronary artery disease (CAD). This study aimed to corelate CTA findings with Invasive Coronary Angiography (ICA), consider the gold standard, over a 10 year experience.
Methods: We retrospectively reviewed cases in which patients underwent both CTA and ICA within a comparable clinical timeframe. Degree of stenosis in major coronary arteries was categorized, and CTA results were compared with ICA findings. Diagnostic accuracy, including sensitivity, specificity, positive predictive value (PPV), and negative predictive value (NPV), was calculated for detection of significant stenosis (≥50%).
Results: CTA demonstrated high sensitivity and NPV in ruling out significant CAD, showing strong concordance with ICA in the majority of cases. The technique was particularly reliable in single- and double-vessel disease, whereas specificity decreased in the presence of extensive calcification or motion artifacts. Despite these limitations, CTA consistently reduced the need for unnecessary invasive procedures.
Conclusion: CTA correlates strongly with ICA in the detection of significant CAD and can serve as an effective gatekeeper to invasive testing. In routine clinical practice, CTA offers a safe, accurate, and patient-friendly alternative that complements but does not fully replace the diagnostic value of ICA.

Keywords: *CTA, ICA, coronary arteries, calcification, soft plaques.*

SESION PARALEL

SESIONI I

SALLA 2

ABSTRAKTET

MENAXHIMI DHE INCIDENCA E INFEKSIONEVE NË KIRURGJINË ENDOSKOPIKE TË HIPOFIZËS: STUDIM RETROSPEKTIV NË QSUT

Manjola Pjetri[1], Valbona Bilali[2], Klea Kazazi[3], Alma Cumraku[3], Anisa Vogli[3]
[1]Shërbimi i Neurokirurgjisë, QSUT
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
E-mail: manjolapjetri@hotmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Kirurgjia endoskopike transnazale e hipofizës është një teknikë minimale invazive që ka revolucionarizuar trajtimin e patologjive hipofizare, duke ofruar përfitime të shumta klinike si reduktimi i dhimbjes postoperatore, shërimi më i shpejtë dhe kohë më të shkurtër qëndrimi në spital. Megjithëse incidenca e infeksioneve postoperative është relativisht e ulët në këtë lloj kirurgjie, ato mbeten një komplikacion i rëndësishëm që mund të rrisë morbiditetin dhe të ndikojë në rezultatet klinike. Menaxhimi adekuat i këtyre infeksioneve kërkon monitorim të kujdesshëm, respektim rigoroz të protokolleve të sterilitetit dhe një koordinim efektiv midis anëtarëve të ekipit multidisiplinar, ku roli i infermierisë është kyç.

Objektivat: Ky studim synon të vlerësojë incidencën e infeksioneve postoperative pas kirurgjisë endoskopike të hipofizës dhe të analizojë praktikat e menaxhimit infektiv, me fokus të veçantë në kontributin e infermierisë në bllokun operator. Synimi është gjithashtu të evidentojë praktikat më të mira dhe faktorët që ndihmojnë në parandalimin e komplikacioneve infektive.

Metodologjia: U realizua një studim retrospektiv i bazuar në analizën e kartelave klinike të pacientëve të operuar për patologji të hipofizës me qasje endoskopike në Shërbimin e Neurokirurgjisë, QSUT, gjatë periudhës 2019–2025. Të dhënat përfshinin incidencën e infeksioneve, kohën postoperatore të shfaqjes së simptomave infektive, praktikat e sterilitetit dhe monitorimin infermieror.

Rezultatet: Analiza tregoi një incidencë të ulët të infeksioneve postoperative, kryesisht të lidhura me respektimin e protokolleve të sterilitetit dhe monitorimin e vazhdueshëm infermieror, përfshirë vlerësimin e parametrave vitalë, kujdesin për plagët dhe edukimin e pacientit për higjienën postoperatore. Roli aktiv i infermierisë rezultoi vendimtar për identifikimin e hershëm të shenjave infektive dhe ndërhyrjen e shpejtë terapeutike.

Konkluzionet: Zbatimi korrekt i protokolleve të sigurisë dhe roli i dedikuar i infermierisë janë thelbësore për parandalimin e infeksioneve postoperative dhe përmirësimin e sigurisë së pacientit. Përforcimi i praktikave standarde dhe edukimi i vazhdueshëm i stafit infermieror kontribuon në rezultate klinike më të mira dhe ul nevojën për komplikacione infektive.

Fjalë kyçe: *Kirurgji endoskopike, hipofizë, infeksione postoperative, bllok operator, infermieri.*

MANAGEMENT AND INCIDENCE OF INFECTIONS IN ENDOSCOPIC PITUITARY SURGERY: A RETROSPECTIVE STUDY AT QSUT

Manjola Pjetri[1], Valbona Bilali[2], Klea Kazazi[3], Alma Cumraku[3], Anisa Vogli[3]
[1] Neurosurgery Department, UHC "Mother Teresa"
[2]Faculty of Medical Technical Sciences
E-mail: manjolapjetri@hotmail.com

ABSTRACT

Introduction: Transnasal endoscopic pituitary surgery is a minimally invasive technique that has revolutionized the management of pituitary pathologies, offering multiple clinical benefits such as reduced postoperative pain, faster recovery, and shorter hospital stays. Although the incidence of postoperative infections is relatively low in this type of surgery, they remain a significant complication that can increase morbidity and affect clinical outcomes. Proper management of these infections requires careful monitoring, strict adherence to sterilization protocols, and effective coordination within the multidisciplinary team, with the nursing role being crucial.

Objectives: This study aims to assess the incidence of postoperative infections following endoscopic pituitary surgery and to analyze infection management practices, with a particular focus on the contribution of nursing in the operating room. The study also seeks to identify best practices and factors that help prevent infectious complications.

Methods: A retrospective study was conducted based on the review of medical records of patients who underwent endoscopic pituitary surgery at the Neurosurgery Department, QSUT, between 2019 and 2025. Data collected included the incidence of infections, the postoperative timing of infection signs, adherence to sterilization protocols, and nursing monitoring activities.

Results: The analysis showed a low incidence of postoperative infections, primarily associated with adherence to sterilization protocols and continuous nursing monitoring, including assessment of vital signs, wound care, and patient education regarding postoperative hygiene. The active role of nursing was pivotal in the early detection of infection signs and prompt therapeutic intervention.

Conclusions: Proper implementation of safety protocols and a dedicated nursing role are essential for preventing postoperative infections and improving patient safety. Strengthening standardized practices and providing continuous education for nursing staff contributes to better clinical outcomes and reduces the risk of infectious complications.

Keywords: E*ndoscopic surgery, pituitary gland, postoperative infections, operating room, nursing.*

OPTIMIZIMI I TRIAZHIT EMERGJENT NË QENDRËN KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE (QKUM 127) NË SHQIPËRI PËRMES INTELIGJENCËS ARTIFICIALE: NJË STUDIM I BAZUAR NË PRAKTIKË (2020–2024)

Indrit Jaupaj[1 2], Skënder Brataj [2 1], Klejdi Cankja [2 1]
[1] Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM), Tiranë, Shqipëri
[2] Shoqata Shqiptare e Urgjencës Mjekësore dhe Katastrofave (SHSHUMK-AAEMD), Shqipëri
E-mail: indritjaupajij@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Triazhi emergjent është mekanizmi kryesor për vlerësimin e pacientëve në sistemin shëndetësor. Rritja e volumit të thirrjeve dhe kompleksiteti i rasteve paraqesin sfida për stafin e triazhit në nivelin telefonik, paraspitalor dhe spitalor. Gjatë periudhës 2020–2024, Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore (127) përpunoi rreth 2,664,646 kërkesa për ndihmë, duke reflektuar ngarkesën e lartë të sistemit.
Qëllimi: Të vlerësohet ndikimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në përmirësimin e saktësisë së triazhit, mbështetjen e vendimmarrjes klinike dhe optimizimin e burimeve në urgjencë.
Metodologjia: Studim përshkrues bazuar në analizën e të dhënave të triazhit telefonik për vitin 2020 deri në 2024; rishikim narrativ i literaturës ndërkombëtare mbi aplikimet e IA në triazh, përfshirë analitikën parashikuese, algoritme të analizës së të dhënave me inteligjencë artificiale dhe sistemet e mbështetjes së vendimeve; dhe shqyrtim i kontekstit shqiptar, duke përfshirë funksionimin e QKUM dhe SHSHUMK-AAEMD.
Rezultatet: Analiza tregon saktësi të lartë për kodet që kanë më tepër përparësi (Kodi Jeshil: 92.7%; Kodi i Kuq: 80.4%). Megjithatë, evidentohen hapësira për optimizim për Kodin e Verdhë, ku 28.5% e rasteve riklasifikohen si Kod Jeshil në terren, duke treguar over-triage. Integrimi i IA pritet të rrisë saktësinë e kategorizimit me 20–30%, të reduktojë over/undertriage me 15–25%, të ulë kohën e përgjigjes me 10–20% dhe të përmirësojë konsistencën në vendimmarrje klinike me mbi 25%.
Përfundimi: Sistemi aktual performon mirë në identifikimin e rasteve kritike, por kërkon përmirësim në rastet me urgjencë të ndërmjetme. Inteligjenca Artificiale përfaqëson një mjet kyç për reduktimin e over-triage dhe standardizimin e vendimmarrjes klinike. Implementimi i saj kontribuon në rritjen e sigurisë së pacientit dhe optimizimin e burimeve, duke përfaqësuar një hap strategjik drejt modernizimit të Qendrës Kombëtare të Urgjencës në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *Triazh emergjencë, Inteligjencë Artificiale, Triazh telefonik, Vendimmarrje klinike, Shërbimi paraspitalo, Siguria e pacientit.*

OPTIMIZATION OF EMERGENCY TRIAGE AT THE NATIONAL EMERGENCY MEDICAL CENTER (QKUM 127) IN ALBANIA THROUGH ARTIFICIAL INTELLIGENCE: A PRACTICE-BASED STUDY (2020–2024)

Indrit Jaupaj[12], Skënder Brataj[21], Klejdi Cankja[21]
[1] National Emergency Medical Center (QKUM), Tirana, Albania
[2] Albanian Association of Emergency Medicine and Disasters (SHSHUMK-AAEMD), Albania
E-mail: indritjaupajij@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Emergency triage is the primary mechanism for patient assessment within the healthcare system. The increasing volume of emergency calls and the growing complexity of cases pose significant challenges for triage staff at telephone, prehospital, and hospital levels. During the period 2020–2024, the Emergency Medical Coordination Unit (127) processed approximately 2,664,646 emergency requests, reflecting a high workload and sustained pressure on the system.
Objective: To evaluate the impact of Artificial Intelligence (AI) on improving triage accuracy, supporting clinical decision-making, and optimizing resource utilization in emergency care.
Methods: This is a descriptive study based on the analysis of telephone triage data from 2020 to 2024. A narrative review of international literature was conducted focusing on AI applications in triage, including predictive analytics, machine learning algorithms, and clinical decision support systems. The study also considers the Albanian emergency care context, including the functioning of the National Emergency Coordination Center (QKUM) and the Emergency Medical Service system.
Results: The analysis demonstrates high accuracy in high-priority triage categories, with Green Code accuracy at 92.7% and Red Code accuracy at 80.4%. However, gaps are identified in the Yellow Code category, where 28.5% of cases are reclassified as Green in the field, indicating over-triage. The integration of AI is projected to improve classification accuracy by 20–30%, reduce over- and under-triage by 15–25%, decrease response time by 10–20%, and enhance consistency in clinical decision-making by more than 25%.
Conclusion: The current triage system performs well in identifying critical cases; however, improvement is needed in intermediate urgency categories. Artificial Intelligence represents a key tool for reducing over-triage and standardizing clinical decision-making. Its implementation is expected to enhance patient safety, optimize resource utilization, and represent a strategic step toward the modernization of the National Emergency Coordination Center in Albania

Keywords: *Emergency triage, Artificial Intelligence, Telephone triage, Clinical decision-making, Prehospital care, Patient safety.*

ROLI I E-HEALTH NË MENAXHIMIN DHE VLERËSIMIN E DHEMBJES: RISHIKIM NARRATIV

Armelda Teta[1], Mitilda Gugu[1], Elona Gaxhja[1], Rezarta Stena[1] Sabina Tosuni[1]

[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
E-mail: armelda.teta@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrja: Menaxhimi dhe vlerësimi i dhembjes konsiderohen komponentë kyç të kujdesit infermieror, por natyra subjektive e dhembjes, ngarkesa e punës dhe pasaktësitë në dokumentim e bëjnë këtë proces sfidues. Teknologjitë e e-Health po shfaqen si mjete të vlefshme për të mbështetur praktikën infermierore dhe për të përmirësuar menaxhimin e dhembjes klinike.
Objektivi: Ky rishikim kishte si synim të eksploronte ndikimin e teknologjive të përdorura në menaxhimin e dhembjes, efektivitetin e tyre dhe barrierat që lidhen me zbatimin e këtyre mjeteve.
Metodologjia: U shqyrtua literatura ndërkombëtare e 5 viteve të fundit në CINAHL, MEDLINE/Pubmed, Scopus, dhe Google Scholar, duke përdorur fjalë kyçe si *"nursing", "pain assessment", "pain management", "e-Health"* dhe *"telehealth"*. Janë përfshirë studime që kanë trajtuar përdorimin e mjeteve dixhitale në menaxhimin e dhimbjes dhe janë përjashtuar artikujt jo të plotë, editoriale dhe botimet pa evidenca.
Rezultatet: Gjetjet nga literatura evidentojnë përdorimin e shkallëve elektronike të vlerësimit të dhembjes, aplikacionet mobile (m-health), telemjekësinë dhe kartelat elektronike mjekësore. Përdorimi i tyre përmirëson standardizimin dhe saktësinë e vlerësimit, monitorimin në kohë reale dhe përfshirjen e pacientëve duke rritur komunikimin ndërdisiplinor. Barrierat kryesore të implementimit janë mungesa e qasjes dixhitale nga stafi, vështirësitë në zbatim, dhe siguria ruajtjes së të dhënave.
Konkluzioni: Integrimi i teknologjive e-Health në praktikën klinike ka tendencë të përmirësojë cilësinë e kujdesit ndaj pacientëve. Përdorimi i këtyre mjeteve dixhitale në praktikën infermierore forcon menaxhimin e dhembjes dhe ndikon pozitivisht në rezultatet klinike. Megjithatë, nevojiten studime të mëtejshme për të vlerësuar efiktivitetin afatgjatë dhe strategjitë optimale të përdorimit.

Fjalë kyçe: *e-Health, telehealth, menaxhim dhembje, vlerësim i dhembjes, infermierë.*

THE ROLE OF E-HEALTH IN PAIN MANAGEMENT AND ASSESSMENT: A NARRATIVE REVIEW

Armelda Teta[1], Mitilda Gugu[1], Elona Gaxhja[1], Rezarta Stena[1], Sabina Tosuni[1]
[1]Faculty of Medical and Technical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"
E-mail: armelda.teta@uniel.edu.al

ABSTRACT

Background: Pain management and assessment are considered key components of nursing care; however, the subjective nature of pain, heavy workload, and inconsistencies in documentation make this process challenging. e- Health technologies are emerging as valuable tools to support nursing practice and improve clinical pain management.
Objective: This review aimed to explore the impact of technologies used in pain management, their effectiveness, and the barriers associated with implementing these tools.
Methodology: International literature from the past five years was reviewed using the databases CINAHL, MEDLINE/PubMed, Scopus, and Google Scholar. Keywords such as "nursing," "pain assessment," "pain management," "e-Health," and "telehealth" were used. Studies addressing the use of digital tools in pain management were included, while incomplete articles, editorials, and publications lacking empirical evidence were excluded.
Results: The findings highlight the use of electronic pain assessment scales, mobile health (m Health) applications, telemedicine, and electronic health records. Their use enhances the standardization and accuracy of assessments, enables real-time monitoring, and improves patient engagement while strengthening interdisciplinary communication. The main barriers to implementation include limited digital access among staff, challenges in practical integration, and concerns regarding data security.
Conclusion: The integration of e-Health technologies into clinical practice shows potential to improve the quality of patient care. The use of these digital tools in nursing practice strengthens pain management and positively influences clinical outcomes. However, further research is needed to evaluate long-term effectiveness and identify optimal implementation strategies.

Keywords: *e-Health, telehealth, pain management, pain assessment, nurses*

ROLI I PNF NË PËRMIRËSIMIN E KONTROLLIT MOTORIK DHE STABILITETIT FUNKSIONAL GJATË AKTIVITETEVE TË PËRDITSHME TEK PACIENTËT ME PROBLEME MUSKULOSKELETORE LUMBARE

Roxhensa Sula[1], Alta Arapi[2], Alisia Maliqi[3]

[1] Universiteti Aldent, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
[2] Urdhri i Infermierit të Shqipërisë
[3]Studente në Master Shkencor në Fizioterapi Klinike, Universiteti Aldent
E-mail: roxhensa.sula@ual.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Stabiliteti lumbopelvik dhe kontrolli postural janë të rëndësishme për funksionimin fiziologjik gjatë aktiviteteve të jetës së përditshme (ADL) si dhe parandalimin e dhimbjeve kronike lumbare. Facilitimi Neuromuskulor Proprioceptiv (PNF) është një teknikë manuale fizioterapeutike e cila ndihmon në përmirësimin e koordinimit neuromuskular dhe balancës.
Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë efektin e teknikave të PNF-së në përmirësimin e stabilitetit lumbopelvik, kontrollit postural dhe performancës funksionale tek të rriturit me probleme muskuloskeletore lumbare.
Metodologjia: Ky studim është studim eksperimental me 30 pjesëmarrës, të ndarë në dy grupe (eksperimental dhe kontrolli). Çdo pjesëmarrës mori rreth 20 seanca trajtimi për rreth 8 javë. Vlerësimet përfshinë teste të balancës statike dhe dinamike, koordinimin neuromuskular dhe performancën funksionale. Analiza statistikore përfshiu krahasime para dhe pas midis grupeve të marrë në studim, me nivel domethënieje $p<0.05$.
Rezultate: Grupi që iu aplikua PNF-ja tregoi përmirësime të rëndësishme në stabilitetin lumbopelvik, balancës dhe koordinimit muskulor krahasuar me grupin e kontrollit ($p<0.01$).
Konkluzione: PNF-ja është efikase në rikthimin e kontrollit postural dhe stabilitetit lumbopelvik duke e vlerësuar këtë metodë të rëndësishme në përfshirjen e tij në protokollet klinike rehabilituese.

Fjalët kyçe: *PNF, kontroll postural, stabilitet lumbopelvik, koordinim neuromuskulor.*

THE ROLE OF PNF IN IMPROVING MOTOR CONTROL AND FUNCTIONAL STABILITY DURING ACTIVITIES OF DAILY LIVING IN PATIENTS WITH LUMBAR MUSCULOSKELETAL DISORDERS

Roxhensa Sula[1], Alta Arapi[2], Alisia Maliqi[3]
[1] Aldent University, Faculty of Technical Medical Sciences, Department of Nursing and Physiotherapy
[2] Order of Nurses of Albania
[3] MSc Student in Clinical Physiotherapy, Aldent University
E-mail: roxhensa.sula@ual.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Lumbopelvic stability and postural control are essential for proper physiological functioning during activities of daily living (ADL), as well as for the prevention of chronic low back pain. Proprioceptive Neuromuscular Facilitation (PNF) is a manual physiotherapy technique that contributes to improving neuromuscular coordination and balance.
Aim: This study aims to evaluate the effect of PNF techniques on improving lumbopelvic stability, postural control, and functional performance in adults with lumbar musculoskeletal disorders.
Methodology: This study is an experimental study involving 30 participants, divided into two groups (experimental and control). Each participant received approximately 20 treatment sessions over a period of 8 weeks. Assessments included tests of static and dynamic balance, neuromuscular coordination, and functional performance. Statistical analysis included pre and post-intervention comparisons between groups, with a significance level of $p<0.05$.
Results: The group treated with PNF demonstrated significant improvements in lumbopelvic stability, balance, and neuromuscular coordination compared to the control group ($p<0.01$).
Conclusions: PNF is effective in restoring postural control and lumbopelvic stability, highlighting this method as an important component for inclusion in clinical rehabilitation protocols.

Keywords: *PNF, postural control, lumbopelvic stability, neuromuscular coordination.*

NJOHURI MBI ANEMINË NGA MUNGESA E HEKURIT TEK STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË VLORËS

Stiliana Brokaj[1]; Elidon Brokaj[2]; Vasilika Prifti[2]; Juljana Xhindoli[2]

[1]Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" Shqipëri
E-mail: stela.brokaj@univlora.edu.al

ABSTRAKT

Përmbledhje: Anemia nga mungesa e hekurit është një problem publik global, që prek vajzat adoleshente, gratë shtatzëna dhe fëmijët në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme në të gjithë botën, veçanërisht në rajonin afrikan dhe rajonin e Azisë Juglindore, dhe njihet si një sfidë e madhe për botën dhe shoqërinë. Në vendin tonë, shifrat e anemisë nga mungesë hekuri janë gjithashtu shqetësuese. Sipas Institutit të Shëndetit Publik të Shqipërisë, përqindja e fëmijëve që vuajnë nga anemia është rreth 20-25%. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë gjendje janë sëmundje të tjera, ushqyerja e dobët dhe humbja e gjakut për shkak të menstruacioneve ose sëmundjeve të tjera.
Qëllimi: Për të vlerësuar prevalencën e anemisë nga mungesë hekuri tek studentët e Universitetit të Vlorës. Për të zhvilluar dhe zbatuar një program edukimi për ushqyerjen, me qëllim përmirësimin e niveleve të hekurit dhe parandalimin e anemisë.
Metodologjia: Një studim cross-sectional për të përmirësuar efektivitetin e edukimit mbi njohuritë dhe njohuritë në lidhje me përmirësimin e niveleve të tij.
Rezultatet: Të dhënat nga analiza e rezultateve të studimit të studentëve tregojnë se ekziston një marrëdhënie e rëndësishme midis edukimit shëndetësor dhe diagnozës së përmirësuar. Rreth 20% e studentëve që morën edukim shëndetësor mbi të ushqyerit e tyre në lidhje me aneminë arritën nivele të mira të hekurit në trup dhe rritën aftësitë e tyre njohëse dhe rezultate të mira në fund të vitit akademik.
Diskutime: Krijimi i programeve edukative dhe të personalizuara do të jetë një ndihmë e madhe në përmirësimin e simptomave të anemisë nga mungesa e hekurit dhe përmirësimin e arritjeve të studentëve.

Fjalë kyçe: *Program arsimor, anemi nga mungesa e hekurit, cilësia e jetës, student*.

KNOWLEDGE ON IRON DEFICIENCY ANEMIA AMONG STUDENTS OF THE UNIVERSITY OF VLORA

Stiliana Brokaj[1]; Elidon Brokaj[2], Vasilika Prifti[2] , Juljana Xhindoli[2]
Department of Health Care, Faculty of Health, University of Vlora "Ismail Qemali" Albania
E-mail: stela.brokaj@univlora.edu.al

ABSTRACT

Abstract: Iron deficiency anemia is a global public problem, affecting adolescent girls, pregnant women and children in low- and middle-income countries worldwide, especially in the African region and the Southeast Asian region, and is recognized as a major challenge for the world and society. In our country, the figures of iron deficiency anemia are also worrying. According to the Institute of Public Health of Albania, the percentage of children suffering from anemia is about 20-25%. The main factors that contribute to this condition are other diseases, poor nutrition, and blood loss due to menstruation or other diseases.

Applications: To assess the prevalence of iron deficiency anemia among University of Vlora students. To develop and implement a nutrition education program, with the aim of improving iron levels and preventing anemia.

Methodology: A cross-sectional study to improve the effectiveness of education on knowledge and knowledge regarding the improvement of its levels.

Results: Data from the analysis of student study results shows that there is a significant relationship between health education and improved diagnosis. About 20% of students who received health education on their nutrition related to anemia achieved good levels of iron in the body and increased their cognitive abilities and good results at the end of the academic year.

Discussions: Creating educational and personalized programs will be a great help in improving the symptoms of iron deficiency anemia and improving student achievement.

Keywords: *Educational Program, Iron Deficiency Anemia, Quality of Life, Student.*

PREEKLAMPSIA DHE EKLAMPSIA NË SHTATZANI: STUDIM RASTESH RETROSPEKTIV NË MATERNITETIN "SHTËPIA E LINDJES" NË SPITALIN RAJONAL KORÇË, 2020-2025

Delantina Mulla[1]
[1] Urdhri i Infermierit të Shqipërisë
"Shtëpia e Lindjes", Korcë, Shqipëri
E-mail: delantinamulla@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Preeklampsia dhe eklampsia përbëjnë ndër komplikacionet më të rënda të shtatzanisë, të shoqëruara me rrezik të lartë për sëmundshmërinë dhe vdekjen maternofetal. Diagnostikimi i hershëm dhe menaxhimi i saktë klinik luan një kyç në parandalimin e zhvillimit të formave më të rënda.
Qëllimi: Të vlerësohet frekuenca, karakteristikat klinike dhe menaxhimi i rasteve me preeklampsi dhe eklampsi në Maternitetin "Shtëpia e Lindjes", Korcë gjatë periudhës 2020–2025, si dhe roli i kujdesit të mamisë në identifikimin dhe trajtimin e hershëm.
Metodologjia: U realizua një studim retrospektiv përshkrues në në Maternitetin "Shtëpia e Lindjes", Korcë , duke përfshirë 186 raste me çrregullime hipertensive të shtatzanisë, nga të cilat 162 raste (87.1%) preeklampsi dhe 24 raste (12.9%) eklampsi të konfirmuara klinikisht. U analizuan kartelat mjekësore për periudhën 2020–2025, duke përfshirë të dhëna mbi moshën gestacionale, faktorët e riskut, simptomat klinike, ndërhyrjet terapeutike dhe rezultatet maternofetale.
Rezultatet: Preeklampsia përbënte formën më dominuese të çrregullimeve hipertensive të shtatzanisë me 87.1% të rasteve, ndërsa eklampsia u paraqit në 12.9%, kryesisht në pacientet me ndjekje jo të rregullt antenatale ose referim të vonuar në spital. Komplikacione më të shpeshta përfshinin lindje preterm (38%), në Maternitetin "Shtëpia e Lindjes", Korcë mos zhvillim të fetusit (22%) dhe shtrime në terapi intensive neonatale (28%). Mortaliteti maternel ishte i rrallë (<1%), ndërsa morbiditeti i rëndë u vërejt kryesisht në rastet e eklampsisë. Menaxhimi me magnezium-sulfat, antihipertensivë dhe ndërhyrje emergjente obstetrikale rezultoi vendimtar në stabilizimin e pacienteve. Roli i mamisë ishte thelbësor në identifikimin e hershëm të shenjave paralajmëruese në mbi 60% të rasteve të referuara në kohë reale.
Përfundime: Preeklampsia dhe eklampsia mbeten patologji me risk të lartë që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm dhe ndërhyrje të shpejtë të stafit multidisiplinar. Përmirësimi i kujdesit antenatal dhe forcimi i rolit të mamisë në triazhin dhe ndjekjen e shtatzanive me risk të lartë kontribuon ndjeshëm në uljen e komplikacioneve maternofetale.

Fjalë kyçe: *Preeklampsi, eklampsi, shtatzani me risk të lartë, kujdes antenatal, mami, emergjenca obstetrikale*

PREECLAMATION AND ECLAMATION IN PREGNANCY: A RETROSPECTIVE CASE STUDY IN THE MATERNITY "HOUSE OF BIRTH" OF KORÇA REGIONAL HOSPITAL, 2020–2025

Delantina Mulla [1]
[1] Order of the Nurse of Albania
[1] "House of Birth", Korca, Albania
E-mail: delantinamulla@gmail.com

ABSTRACT

Introduction : Preeclampsia and eclampsia are among the most severe complications of pregnancy, associated with a high risk of maternal and fetal morbidity and mortality. Early diagnosis and appropriate clinical management play a key role in preventing progression to more severe forms.
Objective: To evaluate the frequency, clinical characteristics, and management of cases with preeclampsia and eclampsia at the Maternity Hospital "Shtëpia e Lindjes", Korçë, during the period 2020–2025, as well as the role of midwifery care in early identification and management.
Methodology: A retrospective descriptive study was conducted at the Maternity Hospital "Shtëpia e Lindjes", Korçë, including 186 cases of hypertensive disorders of pregnancy, of which 162 cases (87.1%) were preeclampsia and 24 cases (12.9%) were eclampsia, clinically confirmed. Medical records from 2020–2025 were reviewed, including data on gestational age, risk factors, clinical manifestations, therapeutic interventions, and maternal-fetal outcomes.
Results: Preeclampsia was the predominant form of hypertensive disorders of pregnancy, accounting for 87.1% of cases, while eclampsia was observed in 12.9%, mainly among patients with irregular antenatal follow-up or delayed hospital referral. The most common complications included preterm birth (38%), intrauterine growth restriction (22%), and admissions to neonatal intensive care units (28%). Maternal mortality was rare (<1%), while severe morbidity was more frequently observed in cases of eclampsia. Management with magnesium sulfate, antihypertensive therapy, and emergency obstetric interventions proved crucial in patient stabilization. The role of the midwife was essential in the early identification of warning signs in over 60% of cases referred in a timely manner.
Conclusions: Preeclampsia and eclampsia remain high-risk conditions requiring continuous monitoring and prompt multidisciplinary intervention. Improving antenatal care and strengthening the role of midwives in triage and management of high-risk pregnancies significantly contributes to reducing maternal and fetal complications.

Keywords:
Preeclampsia, eclampsia, high-risk pregnancy, antenatal care, midwife, obstetric emergencies.

GABIMET INFERMIERORE NË NJËSINË E KUJDESIT INTENSIV: ANALIZË RETROSPEKTIVE DHE IMPLIKIMET PËR SIGURINË E PACIENTIT (2018-2023)

Arjona Rakipi[1]
[1] Urdhri i Infermierit të Shqipërisë
E-mail: arjona.rakipi@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Njësitë e terapisë intensive (ICU) përfaqësojnë një nga mjediset më komplekse dhe kërkuese në kujdesin shëndetësor modern, ku pacientët kritikë kërkojnë monitorim të vazhdueshëm dhe ndërhyrje terapeutike të avancuara. Në këtë kontekst me rrezik të lartë, gabimet infermierore mbeten një shqetësim i rëndësishëm, me potencial për të ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë e pacientit dhe rezultatet klinike. Kuptimi dhe analiza sistematike e këtyre gabimeve janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së kujdesit.

Qëllimi: Ky studim synon të identifikojë dhe analizojë gabimet më të shpeshta infermierore në praktikën e ICU gjatë periudhës 2018-2023, si dhe të vlerësojë ndikimin e faktorëve njerëzorë, organizativë dhe teknologjikë, me fokus të veçantë në strategjitë parandaluese.

Metodologjia: Është realizuar një studim retrospektiv përshkrues, i bazuar në analizën e rasteve klinike të identifikuara në ICU gjatë periudhës 2018-2023. Gabimet janë analizuar përmes metodës së Analizës Root Cause, duke u klasifikuar sipas tipit, frekuencës dhe faktorëve kontribues.

Rezultatet: Gabimet infermierore u klasifikuan si vijon: 1. Gabime në administrimin e medikamenteve (doza, rruga, koha, shpejtësia e infuzionit) - 45%, 2. Gabime në monitorimin klinik dhe interpretimin e shenjave vitale - 20%, 3. Mosrespektimi i protokolleve procedurale (p.sh., procedurat vaskulare, heqja e pajisjeve invazive pa kriteret e duhura) - 15%, 4. Shkelje të teknikës aseptike dhe infeksione të lidhura me kujdesin shëndetësor - 10%, 5. Gabime në menaxhimin e pajisjeve mjekësore - 5%, 6. Gabime në komunikim dhe dokumentim klinik - 5%.

Faktorët kryesorë kontribues përfshinin mbingarkesën në punë, lodhjen fizike dhe psikologjike, presionin kohor, mungesën e standardizimit të proceseve dhe variabilitetin në zbatimin e protokolleve klinike.

Përfundime: Gabimet infermierore në ICU janë rezultat i një ndërveprimi kompleks midis faktorëve njerëzorë, organizativë dhe sistemikë. Edhe pse administrimi i medikamenteve mbetet fusha me rrezikun më të lartë, gabime të rëndësishme evidentohen gjithashtu në monitorimin e pacientit, respektimin e procedurave, kontrollin e infeksioneve dhe komunikimin klinik. Përmirësimi i sigurisë së pacientit kërkon zbatimin e ndërhyrjeve të bazuara në evidencë, përfshirë administrimin elektronik të medikamenteve(eMAR), verifikimin me barkod, pompat e infuzionit, protokollet e standardizuara dhe listat e kontrollit të sigurisë.

Fjalë kyçe: *Siguria e pacientit; njësia e kujdesit intensiv; gabime infermierore; teknologji shëndetësore;*

NURSING ERRORS IN THE INTENSIVE CARE UNIT: A RETROSPECTIVE ANALYSIS AND IMPLICATIONS FOR PATIENT SAFETY (2018–2023)

Arjona Rakipi[1]
[1] Order of Nurses of Albania
E-mail: arjona.rakipi@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Intensive Care Units (ICUs) represent one of the most complex and demanding environments in modern healthcare, where critically ill patients require continuous monitoring and advanced therapeutic interventions. In this high-risk context, nursing errors remain a significant concern, with the potential to directly affect patient safety and clinical outcomes. Understanding and systematically analyzing these errors is essential for improving the quality of care.
Aim: This study aims to identify and analyze the most common nursing errors in ICU practice during the period 2018–2023, as well as to assess the impact of human, organizational, and technological factors, with a particular focus on preventive strategies.
Methodology: A retrospective descriptive study was conducted, based on the analysis of clinical cases identified in the ICU during the period 2018–2023. Errors were analyzed using the Root Cause Analysis method and classified according to type, frequency, and contributing factors.
Results: Nursing errors were classified as follows: Medication administration errors (dose, route, timing, infusion rate) – 45%; 2. Errors in clinical monitoring and interpretation of vital signs – 20%; 3. Non-compliance with procedural protocols (e.g., vascular procedures, removal of invasive devices without proper criteria) – 15%; 4. Violations of aseptic technique and healthcare-associated infections – 10%; 5. Errors in the management of medical devices – 5%; 6. Errors in communication and clinical documentation – 5%.The main contributing factors included workload overload, physical and psychological fatigue, time pressure, lack of process standardization, and variability in the implementation of clinical protocols.
Conclusions: Nursing errors in the ICU result from a complex interaction between human, organizational, and systemic factors. Although medication administration remains the highest-risk area, significant errors are also observed in patient monitoring, adherence to procedures, infection control, and clinical communication. Improving patient safety requires the implementation of evidence-based interventions, including electronic medication administration (eMAR), barcode verification, infusion pumps, standardized protocols, and safety checklists.

Keywords: *Patient safety; intensive care unit; nursing errors; healthcare technology.*

INTEGRIMI I DENSITOMETRISË DXA, PËRPUNIMIT DIGJITAL TË IMAZHIT DHE INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË VLERËSIMIN E DENSITETIT KOCKOR

Besina Tomani[1]

[1]Spitali Rajonal Berat, Shqipëri
E-mail: b.tomani@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Osteoporoza përfaqëson një nga patologjitë më të shpeshta metabolike të kockës, me ndikim të rëndësishëm klinik dhe socio-ekonomik për shkak të rritjes së rrezikut për fraktura. Densitometria me Dual-Energy X-ray Absorptiometry (DXA) konsiderohet standardi referencë për vlerësimin e densitetit mineral kockor (BMD). Zhvillimet e fundit në përpunimin digjital të imazhit dhe inteligjencën artificiale (AI) po përmirësojnë ndjeshëm interpretimin e të dhënave densitometrike, duke rritur saktësinë dhe riprodhueshmërinë diagnostike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë efektivitetin e integrimit të teknologjisë DXA me përpunimin digjital të imazhit dhe qasjet e bazuara në AI në identifikimin e osteoporozës dhe osteopenisë, si dhe në stratifikimin e rrezikut për fraktura.

Metodologjia: U realizua një studim përshkrues dhe analitik mbi 279 pacientë (mosha mesatare 60 vjeç; 95% femra), të referuar nga shërbimet e reumatologjisë, onkologjisë dhe ortopedisë. Analiza densitometrike u krye në femurin bilateral, vertebrat lumbare (L1-L4) dhe rajonin radiokarpal. Vlerësimi u bazua në T-score dhe parametra të tjerë densitometrikë, të përpunuar përmes metodave të analizës digjitale dhe algoritmeve të avancuara.

Rezultatet: Treguan një prevalencë prej 28.7% për osteoporozë dhe 52.7% për osteopeni, duke konfirmuar ndjeshmërinë e lartë të DXA në zbulimin e hershëm të demineralizimit kockor. U identifikuan faktorë të rëndësishëm rreziku, përfshirë hipovitaminozën D, menopauzën e hershme, indeksin e ulët të masës trupore (BMI), multiparitetin dhe historinë e trajtimit me kimioterapi.

Konkluzione: Integrimi i densitometrisë DXA me përpunimin digjital të imazhit dhe inteligjencën artificiale përfaqëson një qasje të avancuar në diagnostikimin dhe menaxhimin e osteoporozës. Kjo paradigmë e re mundëson vlerësim më të saktë, standardizim më të mirë dhe personalizim të kujdesit, duke kontribuar në përmirësimin e parandalimit dhe trajtimit të komplikacioneve të lidhura me humbjen e densitetit kockor.

Fjalë kyçe: *DXA, osteoporoza, osteopenia, inteligjenca artificiale, përpunimi i imazhit, densiteti mineral kockor, T-score.*

INTEGRATION OF DXA DENSITOMETRY, DIGITAL IMAGE PROCESSING, AND ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN THE ASSESSMENT OF BONE DENSITY

Besina Tomani [1]
[1] Regional Hospital of Berat, Berat, Albania
E-mail: b.tomani@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Osteoporosis represents one of the most common metabolic bone disorders, with significant clinical and socio-economic impact due to the increased risk of fractures. Dual-Energy X-ray Absorptiometry (DXA) is considered the gold standard for the assessment of bone mineral density (BMD). Recent advances in digital image processing and artificial intelligence (AI) are significantly improving the interpretation of densitometric data, enhancing diagnostic accuracy and reproducibility.
Objective: The aim of this study is to evaluate the effectiveness of integrating DXA technology with digital image processing and AI-based approaches in identifying osteoporosis and osteopenia, as well as in fracture risk stratification.
Methodology: A descriptive and analytical study was conducted on 279 patients (mean age 60 years; 95% female), referred from rheumatology, oncology, and orthopedic services. Densitometric analysis was performed on the bilateral femur, lumbar vertebrae (L1–L4), and the radiocarpal region. Assessment was based on T-scores and other densitometric parameters, processed through digital analysis methods and advanced algorithms.
Results: The results showed a prevalence of 28.7% for osteoporosis and 52.7% for osteopenia, confirming the high sensitivity of DXA in the early detection of bone demineralization. Significant risk factors were identified, including vitamin D deficiency, early menopause, low body mass index (BMI), multiparity, and a history of chemotherapy.
Conclusion: The integration of DXA densitometry with digital image processing and artificial intelligence represents an advanced approach in the diagnosis and management of osteoporosis. This new paradigm enables more accurate assessment, better standardization, and personalized care, contributing to improved prevention and treatment of complications associated with bone density loss.

Keywords: *DXA, osteoporosis, osteopenia, artificial intelligence, image processing, bone mineral density, T-score.*

SIMULIMI KLINIK SI MJET INOVATIV NË EDUKIMIN DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË INFERMIERËVE

Elona Karrica[1]

[1]Infermiere dhe Pedagoge
E-mail: elona.karrica@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrja: Edukimi infermieror përballet sot me sfida të reja që lidhen me zhvillimet teknologjike, rritjen e kërkesave për sigurinë e pacientit dhe nevojën për aftësi praktike të avancuara tek infermierët dhe studentët e infermierisë. Në këtë kontekst, simulimi klinik është shfaqur si një metodë bashkëkohore dhe efektive për të përgatitur profesionistët e shëndetit në situata të ndryshme klinike, duke lejuar praktikë të sigurt pa rrezik për pacientin.

Qëllimi: Ky studim synon të evidentojë rolin e simulimit klinik si një mjet inovativ për përmirësimin e aftësive profesionale, sigurisë klinike dhe zhvillimin e kompetencave të infermierëve dhe studentëve të infermierisë. Synohet gjithashtu të identifikohen avantazhet e përdorimit të teknologjive digjitale, role-play dhe skenarëve realistë në procesin mësimor.

Metodologjia: Studimi bazohet në një rishikim të literaturës shkencore bashkëkohore mbi simulimin klinik në edukimin infermieror. U shqyrtuan studime që përfshijnë përdorimin e manekinëve të avancuar, skenarëve klinikë realistë, role-play dhe teknologjive digjitale si pjesë e procesit mësimor, duke analizuar efektet e tyre mbi aftësitë klinike, komunikimin ndërprofesional dhe sigurinë e pacientit.

Rezultatet: Evidencat tregojnë se simulimi klinik ndikon pozitivisht në rritjen e vetëbesimit profesional, përmirësimin e aftësive klinike dhe komunikimit ndërprofesional, si dhe në reduktimin e gabimeve klinike. Ai mundëson zhvillim të kompetencave kritike, vendimmarrje të shpejtë dhe menaxhim efikas të situatave komplekse, duke krijuar një ambient të sigurt mësimor pa rrezik për pacientin.

Konkluzione: Integrimi i simulimit klinik në edukimin infermieror përfaqëson një hap strategjik drejt përmirësimit të cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe përgatitjes së infermierëve për sfidat reale klinike. Në kontekstin shqiptar, është e nevojshme të investohet në infrastrukturë, financim dhe trajnim të stafit akademik për të siguruar implementim të qëndrueshëm të kësaj metode inovative dhe për të mbështetur zhvillimin profesional të infermierëve.

Fjalë kyçe: *Simulim klinik, edukim infermieror, zhvillim profesional, siguria e pacientit, aftësi klinike.*

CLINICAL SIMULATION AS AN INNOVATIVE TOOL IN NURSING EDUCATION AND PROFESSIONAL DEVELOPMENT

Elona Karrica[1]
[1] Nurse and Lecture
E-mail: elona.karrica@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Nursing education today faces new challenges related to technological advancements, increasing demands for patient safety, and the need for advanced practical skills among nurses and nursing students. In this context, clinical simulation has emerged as a contemporary and effective method for preparing healthcare professionals for diverse clinical situations, allowing safe practice without risk to patients.

Objective: This study aims to highlight the role of clinical simulation as an innovative tool for enhancing professional skills, clinical safety, and the development of competencies among nurses and nursing students. It also seeks to identify the benefits of using digital technologies, role-play, and realistic clinical scenarios in the learning process.

Methods: The study is based on a review of contemporary scientific literature on clinical simulation in nursing education. Studies involving high-fidelity manikins, realistic clinical scenarios, role-play, and digital technologies were examined to assess their impact on clinical skills, interprofessional communication, and patient safety.

Results: Evidence indicates that clinical simulation positively influences professional self-confidence, improves clinical skills and interprofessional communication, and reduces clinical errors. It facilitates the development of critical competencies, rapid decision-making, and efficient management of complex situations, creating a safe learning environment without patient risk. Simulation also enhances reflective practice, teamwork, and adherence to clinical protocols.

Conclusions: Integrating clinical simulation into nursing education represents a strategic step toward improving the quality of healthcare and preparing nurses for real-world clinical challenges. In the Albanian context, investment in infrastructure, funding, and faculty training is essential to ensure sustainable implementation of this innovative method and to support ongoing professional development of nurses.

Keywords: *Clinical simulation, nursing education, professional development, patient safety, clinical skills*

PREVALENCA E "BURNOUT" TE PERSONELI INFERMIEROR NË QËNDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"

Marvina Meta [1], Erald Vasili [2]
[1] Shërbimi Gastrohepatologji, QSUNT
[2] Spitali GVM
E-mail: marvimeha@hotmail.com
E-mail: eraldvasili@hotmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Burnouti tek infermierët është një problem serioz dhe në rritje në mjediset shëndetësore, që ndikon si në mirëqenien personale të stafit infermieror, ashtu edhe në cilësinë e kujdesit ndaj pacientëve. Ai karakterizohet nga lodhje emocionale e vazhdueshme, humbje e motivimit, ndjenja e paaftësisë profesionale dhe distancim emocional ndaj pacientëve. Shkaqet kryesore lidhen me ngarkesën e madhe të punës, oraret e gjata, mungesën e burimeve njerëzore, presionin emocional nga kujdesi për pacientët kritikë dhe mungesën e mbështetjes institucionale.
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë nivelin e burnout-it tek stafi infermieror i Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë si dhe të identifikojë faktorët individualë dhe organizativë që ndikojnë në shfaqjen e tij, për të sugjeruar masa parandaluese dhe mbështetëse për mirëqenien profesionale të infermierëve.
Metodologjia: Popullata e synuar përfshiu të gjithë infermierët e punësuar në shërbimet klinike të QSUT gjatë periudhës Qershor - Gusht 2025. Madhësia e kampionit ishte 400 pjesëmarrës në studim. Kampioni u përzgjodh përmes metodës së kampionimit konvenient, duke përfshirë infermierët që u ftuan dhe pranuan të merrnin pjesë në mënyrë vullnetare përmes një pyetësori online (Google Forms) gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave.
Rezultatet: Burnout-i rezulton i pranishëm në 11.3% të stafit infermieror të QSUT, duke përfaqësuar një nivel të moderuar të shterimit profesional dhe një tregues shqetësues për ngarkesën emocionale të këtij grupi punonjësish.
Konkluzionet: Burnout-i është një fenomen kompleks që reflekton vështirësitë e përditshme të punës në shërbimet shëndetësore dhe kërkon qasje institucionale për ta menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme. Faktorët organizativë, si orët e gjata të punës dhe turnet e alternuara, luajnë një rol të rëndësishëm në shfaqjen e burnout-it, duke ndikuar më shumë sesa karakteristikat personale të individëve.

Fjalë kyçe: *Burnout, infermierë, stres profesional, mirëqenie në punë, sistem shëndetësor, Shqipëri.*

PREVALENCE OF BURNOUT AMONG NURSING STAFF AT THE UNIVERSITY HOSPITAL CENTER "MOTHER TERESA"

Marvina Meta[1], Erald Vasili[2]
[1] Gastrohepatology Service, UHC "Mother Teresa"
[2] GVM Hospital
E-mail: marvimeha@hotmail.com

ABSTRACT

Introduction: Burnout among nurses is a serious and growing issue in healthcare settings, affecting both the personal well-being of nursing staff and the quality of patient care. It is characterized by persistent emotional exhaustion, loss of motivation, feelings of professional inadequacy, and emotional detachment from patients. The main contributing factors include heavy workload, long working hours, shortage of human resources, emotional pressure from caring for critically ill patients, and lack of institutional support.

Aim: This study aims to assess the level of burnout among nursing staff at the University Hospital Center "Mother Teresa" in Tirana and to identify individual and organizational factors influencing its occurrence, in order to propose preventive and supportive measures for nurses' professional well-being.

Methodology: The target population included all nurses employed in clinical services at UHC "Mother Teresa" during the period June–August 2025. The sample size consisted of 400 participants. A convenience sampling method was used, including nurses who were invited and voluntarily agreed to participate through an online questionnaire (Google Forms) during the data collection period.

Results: Burnout was found to be present in 11.3% of the nursing staff at UHC "Mother Teresa", representing a moderate level of professional exhaustion and a concerning indicator of the emotional burden experienced by this group of healthcare workers.

Conclusions: Burnout is a complex phenomenon reflecting the daily challenges of working in healthcare services and requires institutional approaches for sustainable management. Organizational factors, such as long working hours and rotating shifts, play a significant role in the occurrence of burnout, having a greater impact than individual characteristics.

Keywords: *Burnout, nurses, occupational stress, workplace well-being, healthcare system, Albania.*

LAPAROSKOPIA GJINEKOLOGJIKE: NDËRHYRJA MINIINVAZIVE DHE KUJDESI INFERMIEROR

Anjeza Kolaneci[1], Enida Paluka [1]
[1] S.U.O. GJ "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, Shqipëri

E-mail: akolaneci@outlook.com

ABSTRAKT

Hyrja : Laparoskopia gjinekologjike është një metodë miniinvazive që përdoret për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të sistemit riprodhues femëror. Kjo teknikë ka përparësi të shumta krahasuar me kirurgjinë konvencionale, duke përfshirë reduktimin e dhimbjes postoperatore, shërim më të shpejtë dhe periudha më të shkurtra qëndrimi në spital. Kujdesi infermieror para dhe pas ndërhyrjes është kyç për suksesin e procedurës dhe sigurinë e pacientit.
Objektivat : Të analizojë rëndësinë e kujdesit infermieror në periudhën pre dhe post-laparoskopike. Të evidentojë praktikat më të mira për përmirësimin e shërimit dhe reduktimin e komplikacioneve. Të nxisë ndërgjegjësimin e stafit mjekësor dhe infermieror mbi rolin e tyre në kujdesin perioperativ.
Metodologjia : Studimi është retrospektiv dhe përfshin 50 pacientë që i janë nënshtruar laparoskopsisë gjinekologjike në S.U.O. GJ "Mbretëresha Geraldine". Të dhënat u mblodhën nga kartelat mjekësore dhe vëzhgimet klinike të periudhës pre dhe postoperatore. Analiza përfshinte monitorimin e parametrave vitalë, dhimbjes, shenjave të infeksionit dhe kënaqësinë e pacientit me kujdesin infermieror.
Rezultatet: 92% e pacientëve raportuan dhimbje minimale postoperatore. Komplikacionet Unregjistruan në vetëm 4% të rasteve. Kujdesi infermieror i strukturuar para dhe pas ndërhyrjes kontribuoi në reduktimin e kohës së shtrimit në spital dhe përmirësimin e shërimit.
Konkluzionet : Laparoskopia gjinekologjike, e kombinuar me një kujdes infermieror të mirëstrukturuar, është një procedurë e sigurt dhe efektive. Kujdesi i kujdesshëm perioperativ ndikon drejtpërdrejt në reduktimin e komplikacioneve dhe përmirësimin e përvojës së pacientit. Edukimi dhe përgatitja e stafit infermieror janë elementë kyç për suksesin e ndërhyrjes.

Fjalë kyçe : *Laparoskopi, Kujdes infermieror, Miniinvazive, Perioperativ, Gjinekologji*

GYNECOLOGICAL LAPAROSCOPY: THE MINIMALLY INVASIVE PROCEDURE AND NURSING CARE

Anjeza Kolaneci[1], Enida Paluka [1]
[1] University Hospital of Obstetric and Gynaecology "Queen Geraldine", Tirana, Albania
E-mail: akolaneci@outlook.com

ABSTRACT

Introduction: Gynecological laparoscopy is a minimally invasive method used for the diagnosis and treatment of female reproductive system disorders. This technique offers multiple advantages over conventional surgery, including reduced postoperative pain, faster recovery, and shorter hospital stays. Nursing care before and after the procedure is crucial for the success of the surgery and patient safety.
Objectives: To analyze the importance of nursing care in the pre- and post-laparoscopic period. To identify best practices to improve recovery and reduce complications. To raise awareness among medical and nursing staff about their role in perioperative care.
Methodology: The study is retrospective and includes 50 patients who underwent gynecological laparoscopy at S.U.O. GJ "Mbretëresha Geraldine". Data was collected from medical records and clinical observations during the pre- and postoperative periods. Analysis included monitoring vital signs, pain, signs of infection, and patient satisfaction with nursing care.
Results: 92% of patients reported minimal postoperative pain. Complications were recorded in only 4% of cases. Structured nursing care before and after surgery contributed to reduced hospital stay and improved recovery.
Conclusions: Gynecological laparoscopy combined with well-structured nursing care is a safe and effective procedure. Careful perioperative management directly impacts the reduction of complications and improves patient experience. Education and preparation of nursing staff are key elements for the success of the intervention.

Keywords: *Laparoscopy, Nursing care, minimally invasive, Perioperative, Gynecology*

MENAXHIMI KLINIK DHE INFERMIEROR I HIPERBILIRUBINEMISË NEONATALE – EFEKTIVITETI I FOTOTERAPISË NË TRAJTIM

Ermelinda Xhari[1]

[1] Kujdesi Intensiv Neonatologjik, Spitali Universitar "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë
E-mail: ermelindaxhari2000@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Hiperbilirubinemia neonatale është një nga patologjitë më të shpeshta në periudhën e hershme të jetës së foshnjës, e cila nëse nuk trajtohet në kohë, mund të çojë në komplikacione serioze neurologjike si kernikterusi.
Objektivat: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë efektivitetin klinik të fototerapisë në uljen e niveleve të bilirubinës te neonatët, si dhe të evidentojë rolin e mamisë dhe personelit infermieror në monitorimin, kujdesin dhe zbatimin korrekt të procedurës terapeutike.
Metodologjia: Studimi është konceptuar si hulumtim retrospektiv dhe praktik, i zhvilluar në repartin e neonatologjisë të Maternitetit "Mbretëresha Geraldinë" në periudhën 30 Qershor deri në 3 Tetor 2025. Të dhënat janë mbledhur përmes një formulari të zgjeruar observimi, duke përfshirë nivelin e bilirubinës para dhe pas fototerapisë, kohëzgjatjen e fototerapisë, peshën e lindjes, ditën e jetës në momentin e paraqitjes, përdorimin e antibiotikëve, terapitë shtesë, statusin e hidratimit dhe përgjigjen klinike ndaj trajtimit. Analiza statistikore përfshinte analizën e korrelacionit midis niveleve fillestare të bilirubinës dhe kohëzgjatjes së fototerapisë.
Rezultatet: Nivelet më të larta të bilirubinës u vunë re më shpesh gjatë ditëve të para të jetës, veçanërisht tek të porsalindurit me peshë lindjeje midis 1800 dhe 2500 g. Një korrelacion pozitiv u identifikua midis niveleve fillestare të bilirubinës dhe kohëzgjatjes së fototerapisë tek të porsalindurit që merrnin terapi me antibiotikë ($r = 0.24$), duke treguar një tendencë drejt kohëzgjatjes më të gjatë të trajtimit me vlera më të larta fillestare të bilirubinës. Në raste të caktuara u kërkuan terapi shtesë mbështetëse, duke përfshirë plotësimin e lëngjeve, albuminën, plazmën, terapinë me imunoglobulina dhe transfuzionin e gjakut. Dehidratimi u identifikua si një faktor i rëndësishëm që ndikon në përgjigjen ndaj trajtimit.
Konkluzioni: Fototerapia është një trajtim efektiv dhe i sigurt për hiperbilirubineminë neonatale kur zbatohet në mënyrë korrekte dhe shoqërohet me monitorim të vazhdueshëm infermieror.
Kujdesi infermieror luan një rol kritik në zbulimin e hershëm të komplikacioneve, menaxhimin e hidratimit dhe sigurimin e rezultateve optimale të trajtimit.

Fjalë kyçe: *Hiperbilirubinemi neonatale, fototerapi, kujdes infermieror, mami, neonatologji.*

CLINICAL AND NURSING MANAGEMENT OF NEONATAL HYPERBILIRUBINEMIA AND EFFECTIVENESS OF PHOTOTHERAPY IN TREATMENT OUTCOMES

Ermelinda Xhari [1]

[1] Neonatology resuscitation, Queen Geraldine University Hospital

E-mail: ermelindaxhari2000@gmail.com

ABSTRACT

Background: Neonatal hyperbilirubinemia is one of the most common conditions during the early postnatal period and, if not managed appropriately, may lead to severe neurological complications, including kernicterus.

Objectives: This study aimed to evaluate the clinical effectiveness of phototherapy in reducing bilirubin levels in neonates and to assess the role of nursing care in monitoring, supportive interventions, and overall treatment outcomes.

Methods: A retrospective observational study was conducted in the Neonatology Department of "Queen Geraldine" Maternity Hospital between June 30 and October 3, 2025. Data were collected using an extended observational form, including initial and post-treatment bilirubin levels, duration of phototherapy, birth weight, day of life at presentation, use of antibiotics, additional therapies, hydration status, and clinical response to treatment. Statistical analysis included correlation analysis between initial bilirubin levels and duration of phototherapy.

Results: Higher bilirubin levels were most frequently observed during the first days of life, particularly in neonates with birth weights between 1800 and 2500 g. A positive correlation was identified between initial bilirubin levels and duration of phototherapy in neonates receiving antibiotic therapy ($r = 0.24$), indicating a tendency toward longer treatment duration with higher initial bilirubin values. Additional supportive therapies were required in selected cases, including fluid supplementation, albumin, plasma, immunoglobulin therapy, and blood transfusion. Dehydration was identified as a significant factor influencing treatment response.

Conclusions: Phototherapy is an effective and safe treatment for neonatal hyperbilirubinemia when applied correctly and accompanied by continuous nursing monitoring. Nursing care plays a critical role in early detection of complications, hydration management, and ensuring optimal treatment outcomes.

Keywords: *Neonatal hyperbilirubinemia, phototherapy, nursing care, neonatology.*

SESION PARALEL

SESIONI II

SALLA 2

ABSTRAKTET

METODAT GJENETIKE NË DIAGNOZTIKIMIN E LEUKEMISË MIELOIDE AKUTE: TEKNIKAT E REJA DHE PERSPEKTIVA PËR TË ARDHMEN

Klajdi Tarko[1]

[1]Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,
E-mail: klajditarko01@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Leukemia Mieloide Akute (LMA) është një sëmundje malinje biologjikisht heterogjene, ku karakterizimi gjenotipik përbën një element thelbësor për diagnozën e saktë, vlerësimin prognostik dhe përzgjedhjen e terapisë. Integrimi i metodave citogjenetike dhe molekulare ka transformuar ndjeshëm praktikën klinike, duke mundësuar identifikimin e anomalive kromozomale, mutacioneve gjenetike, transkripteve të fuzionuara dhe monitorimin e sëmundjes minimale reziduale (MRD).
Objektivat: Ky studim synon të vlerësojë rolin dhe performancën e metodave bashkëkohore të analizës gjenomike në LMA, duke analizuar ndikimin e tyre në diagnozë, prognozë, vendimmarrje terapeutike dhe monitorimin e MRD.
Metodologjia: Studimi bazohet në një rishikim të literaturës bashkëkohore mbi teknikat diagnostike standarde dhe të avancuara, përfshirë kariotipizimin konvencional, hibridizimin in situ me fluoreshencë (FISH), teknikat e bazuara në PCR dhe panelet e Next Generation Sequencing (NGS) të fokusuara në ADN dhe ARN. Gjithashtu, analizohet performanca e këtyre metodave në raport me kohën e daljes së rezultateve dhe rëndësinë e tyre në vendimmarrjen klinike.
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se përdorimi i metodave citogjenetike dhe molekulare rrit ndjeshëm saktësinë diagnostike dhe mundëson identifikimin e spektrit të plotë të alteracioneve gjenetike. Identifikimi i mutacioneve dhe translokacioneve specifike, si RUNX1-RUNX1T1, NPM1, FLT3-ITD dhe TP53, ndihmon në stratifikimin e rrezikut dhe përzgjedhjen e terapisë së përshtatshme. Monitorimi molekular i MRD ka treguar vlerë të lartë në vlerësimin e përgjigjes ndaj trajtimit dhe parashikimin e rikthimit të sëmundjes. Megjithatë, pavarësisht avancimit të teknikave si NGS, metodat tradicionale si kariotipizimi, FISH dhe PCR mbeten thelbësore në praktikën diagnostike.
Konkluzione: Testimi gjenomik përbën një komponent kyç në menaxhimin modern të LMA, duke mundësuar diagnozë më të saktë dhe terapi të personalizuar. Perspektivat e ardhshme përfshijnë integrimin e qasjeve multi-omike dhe zhvillimin e metodave më të shpejta dhe të aksesueshme për detektimin e MRD.

Fjalë kyçe: *LMA, diagnozë gjenomike, FISH, NGS, variacione gjenetike, MRD.*

GENETIC METHODS IN THE DIAGNOSIS OF ACUTE MYELOID LEUKEMIA: NEW TECHNIQUES AND FUTURE PERSPECTIVES

Klajdi Tarko[1]
[1]University of Medicine, Tirana, Faculty of Technical Medical Sciences
E-mail: klajditarko01@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Acute Myeloid Leukemia (AML) is a biologically heterogeneous malignant disease in which genotypic characterization represents a fundamental component for accurate diagnosis, prognostic assessment, and therapeutic decision-making. The integration of cytogenetic and molecular techniques has significantly transformed clinical practice, enabling the identification of chromosomal abnormalities, gene mutations, fusion transcripts, and the monitoring of measurable residual disease (MRD).

Aim: This study aims to evaluate the role and performance of contemporary genomic analysis methods in AML, focusing on their impact on diagnosis, prognosis, therapeutic decision-making, and MRD monitoring.

Methodology: The study is based on a descriptive review of recent literature addressing both standard and advanced diagnostic techniques, including conventional karyotyping, fluorescence in situ hybridization (FISH), PCR-based methods, and Next Generation Sequencing (NGS) panels targeting DNA and RNA. Particular attention is given to the performance of these methods in relation to turnaround time and their relevance in urgent clinical decision-making.

Results: Findings indicate that the application of cytogenetic and molecular methods significantly improves diagnostic accuracy and enables the comprehensive detection of genetic alterations. The identification of key mutations and chromosomal translocations, such as RUNX1-RUNX1T1, NPM1, FLT3-ITD, and TP53, plays a crucial role in risk stratification and therapy selection. Furthermore, molecular MRD monitoring has demonstrated high value in evaluating treatment response and predicting disease relapse. Despite the advancement of NGS technologies, conventional methods such as karyotyping, FISH, and PCR remain essential components of AML diagnostic workflows.

Conclusions: Genomic testing represents a cornerstone in modern AML management, supporting precise diagnosis and personalized treatment strategies. Future perspectives include the integration of multi-omics approaches and the development of faster, more accessible methods for MRD detection.

Keywords: *AML; genomic diagnosis; FISH; NGS; genetic variations; MRD.*

NDIKIMI I NDËRHYRJEVE TË UDHËHEQURA NGA INFERMIERËT NË MENAXHIMIN E DIABETIT

Lediana Bardho (Gega)[1]

[1] Shërbimi i Endokrinologjisë QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
E-mail: ediana.bardho@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrja: Menaxhimi efikas i Diabetit Mellitus kërkon jo vetëm terapi medikamentoze, por edhe një angazhim të lartë të pacientit në vetë-kujdes. Roli i infermierit si edukator shëndetësor është përcaktues në këtë proces, duke shërbyer si ura lidhëse mes trajtimit klinik dhe stilit të jetës së pacientit.
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë ndikimin e ndërhyrjeve edukative të udhëhequra nga infermierët në kontrollin e glicemisë dhe në rritjen e aderencës ndaj mjekimit te pacientët diabetikë.
Metodologjia: U realizua një studim i kombinuar, retrospektiv dhe prospektiv, i shtrirë në një periudhë 2-vjeçare. Mostra përbëhet nga 100 pacientë (Diabet Tip 1 dhe Tip 2) të trajtuar në QSUT dhe në kabinetet e edukimit të spitaleve rajonale. Mbledhja e të dhënave u krye përmes analizës së kartelave mjekësore, monitorimit të librezave të të dhënave glicemike dhe realizimit të seancave periodike të edukimit të udhëhequra nga infermierët.
Rezultatet: Analiza e të dhënave tregoi se ndjekja prospektive 2-vjeçare e shoqëruar me edukim sistematik rezultoi në një përmirësim domethënës të vlerave të Hemoglobinës së Glikozuar (HbA1c) krahasuar me të dhënat retrospektive. Pacientët shfaqën një rritje të vetëbesimit në administrimin e insulinës dhe një ndërgjegjësim më të lartë për regjimin ushqimor, duke reduktuar rastet e urgjencave nga hipo/hiperglicemia.
Konkluzionet: Ndërhyrjet e strukturuara infermierore në kabinetet e edukimit janë thelbësore për menaxhimin e suksesshëm të diabetit. Prania e infermierit edukator në spitalet rajonale dhe ato universitare rrit cilësinë e jetës së pacientit dhe redukton komplikacionet afatgjata të sëmundjes.

Fjalët kyçe: *Diabet Mellitus, ndërhyrje infermierore, kabinet edukimi, kontroll glicemik, studim prospektiv-retrospektiv.*

THE IMPACT OF NURSE-LED INTERVENTIONS IN DIABETES MANAGEMENT

Lediana Bardho (Gega)[1]
[1] Endocrinology Service, University Hospital Center "Mother Teresa", Tirana, Albania
E-mail: lediana.bardho@yahoo.com

ABSTRACT

Background: Effective management of Diabetes Mellitus requires not only pharmacological therapy but also strong patient engagement in self-care. The role of nurses as health educators is crucial in this process, acting as a bridge between clinical treatment and patients' daily lifestyle management.
Aim: This study aims to evaluate the impact of nurse-led educational interventions on glycemic control and treatment adherence among diabetic patients.
Methods: A combined retrospective and prospective study design was conducted over a two-year period. The sample consisted of 100 patients (Type 1 and Type 2 Diabetes Mellitus) treated at the University Hospital Center and in education units of regional hospitals. Data collection included medical record review, monitoring of patients' glycemic logs, and implementation of structured, periodic nurse-led educational sessions.
Results: Data analysis demonstrated that the two-year prospective follow-up, combined with systematic education, resulted in a significant improvement in Glycated Hemoglobin (HbA1c) levels compared to retrospective data. Patients showed increased confidence in insulin administration and greater awareness of dietary management, leading to a reduction in emergency cases related to hypo- and hyperglycemia.
Conclusions: Structured nurse-led interventions in educational settings are essential for successful diabetes management. The presence of trained nurse educators in both regional and university hospitals improves patients' quality of life and reduces long-term complications associated with the disease.

Keywords: *Diabetes Mellitus, nursing interventions, education units, glycemic control, prospective-retrospective study*

MENAXHIMI I KONVULSIONEVE FEBRILE NË URGJENCËN PEDIATRIKE: STUDIM RASTESH NË SPITALIN RAJONAL LEZHË (2022–2024)

Shpresa Molla[1]

[1]Materniteti Lezhë
[1]Presidente e UISH Qarku Lezhë
E-mail: mollashpresa@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Konvulsionet febrile përbëjnë një nga urgjencat më të shpeshta pediatrike, duke prekur kryesisht fëmijët e moshës 6 muaj deri në 5 vjeç. Ato zakonisht lidhen me rritjen e temperaturës trupore dhe, megjithëse shpesh janë beninje, kërkojnë vlerësim dhe menaxhim të menjëhershëm për të parandaluar komplikacione të mundshme dhe për të siguruar një prognozë të favorshme.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë incidencën, tipologjinë e konvulsioneve febrile dhe efektivitetin e trajtimit në urgjencën pediatrike të Spitalit Rajonal Lezhë gjatë periudhës 2022–2024.

Metodologjia: U realizua një studim retrospektiv përshkrues, i cili përfshiu 124 raste fëmijësh të paraqitur me konvulsione febrile në urgjencën pediatrike gjatë periudhës 2022–2024. U analizuan në mënyrë sistematike të dhënat klinike të pacientëve, duke përfshirë moshën, tipologjinë e krizave, kohëzgjatjen e tyre, ndërhyrjet terapeutike të aplikuara dhe ecurinë klinike. Të dhënat u siguruan nga kartelat mjekësore dhe regjistrat e urgjencës, duke garantuar një vlerësim të plotë dhe të besueshëm të rasteve.

Rezultatet: Nga këto raste, 74% paraqitën konvulsione toniko-klonike të gjeneralizuara, 18% konvulsione kryesisht tonike dhe 8% konvulsione me komponent dominues klonik. Trajtimi në kohë, i realizuar brenda minutave të para në urgjencë, u aplikua në 92% të rasteve. Si rezultat, ndërprerja e krizës pa komplikacione u arrit në 89% të pacientëve, ndërsa 28% kërkuan hospitalizim për monitorim të mëtejshëm. Komplikacionet ishin minimale (<5%) dhe nuk u evidentuan dëmtime neurologjike afatgjata.

Përfundime: Konvulsionet febrile në Spitalin Rajonal Lezhë paraqiten kryesisht si forma toniko-klonike dhe kanë prognozë shumë të mirë kur menaxhohen në kohë. Ndërhyrja e shpejtë dhe protokollet e standardizuara në urgjencë pediatrike luajnë një rol kyç në reduktimin e komplikacioneve dhe përmirësimin e rezultateve klinike.

Fjalë kyçe: *Konvulsione febrile, urgjencë pediatrike, trajtim emergjent, prognozë, Lezhë.*

MANAGEMENT OF FEBRILE SEIZURES IN PEDIATRIC EMERGENCY: A CASE STUDY AT THE REGIONAL HOSPITAL OF LEZHË (2022–2024)

Shpresa Molla[1]
[1]Maternity Hospital Lezhë
[1]President of the Albanian Order of Nurses, Lezhë Region
E-mail: mollashpresa@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Febrile seizures represent one of the most common pediatric emergencies, primarily affecting children aged 6 months to 5 years. They are usually associated with elevated body temperature and, although often benign, require prompt evaluation and management to prevent potential complications and ensure a favorable prognosis.
Objective: The aim of this study is to evaluate the incidence, types of febrile seizures, and the effectiveness of treatment in the pediatric emergency department of the Regional Hospital of Lezhë during the period 2022–2024.
Methodology: A retrospective descriptive study was conducted, including 124 pediatric cases presenting with febrile seizures in the pediatric emergency department during the period 2022–2024. Clinical data were systematically analyzed, including age, seizure type, duration, therapeutic interventions, and clinical outcomes. Data were obtained from medical records and emergency department registers, ensuring a comprehensive and reliable evaluation of cases.
Results: Among the analyzed cases, 74% presented with generalized tonic-clonic seizures, 18% with predominantly tonic seizures, and 8% with seizures with a predominantly clonic component. Timely treatment, administered within the first minutes of presentation in the emergency setting, was achieved in 92% of cases. As a result, seizure termination without complications was achieved in 89% of patients, while 28% required hospitalization for further monitoring. Complications were minimal (<5%), and no long-term neurological sequelae were observed.
Conclusions: Febrile seizures at the Regional Hospital of Lezhë predominantly present as generalized tonic-clonic forms and have an excellent prognosis when managed promptly. Rapid intervention and standardized protocols in pediatric emergency care play a key role in reducing complications and improving clinical outcomes.

Keywords: *Febrile seizures, pediatric emergency, emergency treatment, prognosis, Lezhë.*

NDIKIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË SIGURINË E PACIENTIT GJATË EKZAMINIMIT SKANERIK

Bukurie Halili[1], Sidorela Rexhepi[1], Theodhor Xhillari[1], Ilir Lumi[1]

[1] Spitali Universitar i Traumës.

E-mail: bukri.hailili@hotmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Integrimi i inteligjencës artificiale (IA) në radiologji ka sjellë ndryshime të rëndësishme në mënyrën e realizimit dhe interpretimit të ekzaminimeve me tomografi të kompjuterizuar (CT). Studime të fundit kanë treguar se algoritmet e bazuara në machine learning dhe deep learning mund të përmirësojnë saktësinë diagnostike, të optimizojnë parametrat e skanimit dhe të kontribuojnë në reduktimin e dozës së rrezatimit, duke rritur kështu sigurinë e pacientit.

Objektivat: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin e inteligjencës artificiale në përmirësimin e sigurisë së pacientit gjatë ekzaminimeve skanerike, duke u fokusuar në optimizimin e dozës së rrezatimit, përmirësimin e cilësisë së imazhit dhe saktesine diagnostike.

Metodologjia: Ky studim bazohet në një rishikim të literaturës shkencore të publikuar në vitet e fundit në databaza ndërkombëtare të radiologjisë, duke përfshirë artikuj të indeksuar në PubMed dhe në revistën European Radiology. U analizuan studime që vlerësojnë përdorimin e algoritmeve të IA në rikonstruksionin e imazheve skanerike, në optimizimin e protokolleve të skanimit dhe në detektimin automatik të patologjive.

Rezultatet: Rezultatet e studimeve tregojnë se përdorimi i algoritmeve të IA mund të reduktojë ndjeshëm dozën e rrezatimit duke ruajtur cilësi të lartë diagnostike të imazhit. Keto sisteme optimizojne pozicionimin e pacientit,selektimin te zones se skanimit (duke shmangur"overscanning"), perzgjedhjen e parametrave teknike dhe rekontruksione me cilesi te larte imazhi duke ulur artefaktet e si rrjedhoje minimizimin e gabimeve diagnostike.

Konkluzionet: Integrimi i inteligjencës artificiale në ekzaminimet skanerike përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në radiologjinë moderne. Përdorimi i këtyre teknologjive mund të rrisë sigurinë e pacientit përmes reduktimit të dozës së rrezatimit dhe përmirësimit të cilësisë diagnostike. Megjithatë, implementimi i tyre në praktikën klinike kërkon vleresim të vazhdueshëm, standardizim të protokolleve dhe mbikëqyrje nga profesionistët e radiologjisë.

Fjalë kyçe: *Inteligjeca artificiale, siguria e pacientit, CT,cilësi imazhi.*

THE IMPACT OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE ON PATIENT SAFETY DURING SCANER EXAMINATION

Bukurie Halili[1], Sidorela Rexhepi[1], Theodhor Xhillari[1], Ilir Lumi[1]

Radiologic technologist, University Trauma Hospital.
E-mail: bukri.hailili@hotmail.com

ABSTRACT

Introduction: The integration of artificial intelligence (AI) into radiology has brought significant changes to the way we perform and interpretation of computerized tomography examinations (CT). Recent studies have shown that machine learning-based algorithms can improve diagnostic accuracy, optimize scan settings and contribute to reducing radiation dose, thus enhancing patient safety.

Objectives: The purpose of this paper is to analyze the role of artificial intelligence in improving patient safety during scanner examinations, focusing on optimizing radiation dose, improving image quality and more accurate diagnosis of pathology.

Methodology: This study is based on a review of scientific literature published in recent years in international radiology databases, including PubMed indexed articles and the European Radiology magazine. Studies assessing the use of AI algorithms in reconstruction of scanning images, optimization of scanning protocols and automatic detection of pathologies.

Results: The results of the studies show that the use of AI algorithms can significantly reduce radiation dose while maintaining high diagnostic image quality. These systems optimize patient positioning, scan area selection (avoiding "overscanning"), selection of technical parameters and high-quality image reconstructions by reducing artifacts and consequently minimizing diagnostic errors.

Conclusions: Integration of artificial intelligence into scanning examinations represents an important development in modern radiology. Using these technologies can increase patient safety through reducing the dose of radiation and improving the diagnostic quality. However, their implementation in clinical practice requires continuous assessment, standardization of protocols and supervision by radiology professionals.

Keywords: *Artificial intelligence, patient safety, CT, image quality.*

ROLI I TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT NË PËRMIRËSIMIN E KUJDESIT TË PACIENTËVE NË DIALIZË: SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT INFERMIERORE.

Aurora Kola[1]

[1] QSUNT, pavioni i Hemodializës
E-mail: aurora_kola@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Ne dekadat e fundit, digjitalizimi i sistemeve shëndetësore ka sjellë transformime të rëndësishme në mënyrën e ofrimit të kujdesit ndaj pacientëve, vecanërisht në trajtimin e sëmundjeve kronike. Hemodializa, si procedurë jetike për pacientët me insuficensë renale kronike, kërkon monitorim të vazhdueshëm, saktësi të lartë dhe përdorim të teknologjive të avancuara. Integrimi i inovacionit dhe teknologjisë digjitale ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së kujdesit, por duke sjellë dhe sfida të reja në praktikën infermierore.

Qëllimi: Ky studim synon të analizojë rolin e teknologjisë dhe inovacionit ne përmirësimin e kujdesit ndaj pacientëve në dialize si dhe të evidentojë sfidat e stafit infermieror në përdorimin e tyre në praktiken klinike.

Metodologjia: Studimi mbështetët në një qasje deskriptive-analitike, duke kombinuar rishikimin e literatures bashkëkohore me mbledhjen e të dhënave nëpërmjet një pyetësori të strukturuar. Pyetësori synon të vleresojë përceptimet e infermiereve mbi përdorimin e teknologjisë në dializë, përfitimet e saj, sfidat e hasura dhe nevojat për trajnim profesional.

Rezultatet: Gjetjet tregojnë se integrimi i teknologjisë në procesin e dializes përmirëson ndjeshëm monitorimin e pacientit, rrit sigurinë klinike dhe lehtëson dokumentimin e të dhenave. Infermierët me trajnim në përdorimin e teknologjive shfaqin qëndrime më pozitive dhe kompetenca më të larta në përdorimin e saj. Megjithatë, evidentohen sfida të lidhura me nevojën për trajnim të vazhdueshëm. Gjithashtu, theksohet rëndësia e ruajtjes së një balance të qëndrueshme midis përdorimit të teknologjisë dhe ofrimit të kujdesit human ndaj pacientit.

Konkluzione: Integrimi i teknologjisë digjitale në praktikën infermierore në hemodializë përfaqëson një komponent thelbësor në përmirësimin e cilësisë së kujdesit. Megjithatë, efektiviteti i tyre varet nga aftësia e stafit infermieror për t'i integruar në mënyrë të sigurtë dhe efikase në praktikën e përditshme. Investimi në trajnime të vazhdueshm edhe zhvillim professional mbetët një faktor kyç në përpërballimin e sfidave dhe për shfrytëzimin maksimal të potencialit të teknologjise në shërbimet shëndetësore.

Fjalë kyçe: *Hemodializë, teknologji digjitale, kujdes infermieror, siguria e pacientit, shëndeti digjital.*

THE ROLE OF TECHNOLOGY AND INNOVATION IN IMPROVING PATIENT CARE IN DIALYSIS: NURSING CHALLENGES AND PERSPECTIVES

Aurora Kola [1]
[1] UHC "Mother Teresa" Hemodialysis Unit
E-mail: aurora_kola@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: In recent decades, the digitalization of healthcare systems has brought significant transformations in the way patient care is delivered, particularly in the treatment of chronic diseases. Hemodialysis, as a life-sustaining procedure for patients with chronic renal failure, requires continuous monitoring, high accuracy, and the use of advanced technologies. The integration of innovation and digital technology has significantly contributed to improving the quality and safety of care, while also introducing new challenges in nursing practice.
Purpose: this study aims to analyze the role of technology and innovation in improving patient care in dialysis, as well as to identify the challenges faced by nursing staff in their use within clinical practice.
Methodology: the study is based on a descriptive-analytical approach, combining a review of contemporary literature with data collection through a structured questionnaire. The questionnaire aims to assess nurses' perceptions of the use of technology in dialysis, its benefits, the challenges encountered, and the need for professional training.
Results: the findings indicate that the integration of technology in the dialysis process significantly improves patient monitoring, enhances clinical safety, and facilitates data documentation. Nurses trained in the use of technology demonstrate more positive attitudes and higher competence in its application. However, challenges related to the need for continues training are also identified. Furthermore, the importance of maintaining a sustainable balance between the use of technology and the provision of human-centered patient care is emphasized.
Conclusions: the integration of digital technology in nursing practice in hemodialysis represents a key component in improving the quality of care. However, its effectiveness depends on the ability of nursing staff to integrate it safely and efficiently into daily practice. Investment in continuous training and professional development remains a key factor in addressing challenges and maximizing the potential of technology in healthcare services.

Keywords: *Hemodialysis, digital technology, nursing care, patient safety, digital health.*

KOMUNIKIMI NË KUJDESIN PALIATIV: SFIDAT, BARRIERAT DHE IMPLIKIMET ETIKE NË FUND TË JETËS

Vasien Xhelili[12], Kristjana Sheshmina[2], Estela Skermo[3], Thimaq Karapanxho[4]

[1] Spitali "Teni Konomi" Korçë
[2] Qendra "Mary Potter", Korçë
E-mail: xhelilivasien@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Komunikimi efektiv përbën një komponent thelbësor në kujdesin paliativ, veçanërisht në fazat e avancuara të sëmundjes dhe në fund të jetës, ku vendimmarrja klinike dhe etike bëhet gjithnjë e më komplekse. Në praktikën e përditshme, profesionistët shëndetësorë përballen me sfida të shumta që ndikojnë në cilësinë e kujdesit dhe respektimin e parimeve etike.
Qëllimi: Ky punim synon të identifikojë dhe analizojë barrierat kryesore të komunikimit në kujdesin paliativ, si dhe të vlerësojë implikimet etike që lidhen me këto sfida në fund të jetës.
Metodologjia: Punimi bazohet në një analizë përshkruese dhe rishikim të literaturës bashkëkohore mbi komunikimin në kujdesin paliativ. Janë shqyrtuar faktorët kulturorë, emocionalë dhe institucionalë që ndikojnë në procesin e komunikimit midis profesionistëve të shëndetit, pacientëve dhe familjarëve.
Rezultatet: Analiza evidenton se barrierat kryesore përfshijnë frikën për të shkaktuar vuajtje emocionale, mungesën e trajnimit formal në komuikim, si dhe presionin e familjarëve për të kufizuar informacionin ndaj pacientit. Këto faktorë çojnë shpesh në komunikim jo transparent dhe joefektiv, duke ndikuar negativisht në vendimmarrjen klinike. Si pasojë, rritet rreziku për trajtime të panevojshme dhe përkeqësim i cilësisë së jetës së pacientëve dhe familjarëve të tyre. Gjithashtu, këto vështirësi cenojnë autonominë e pacientit dhe vështirësojnë vendimmarrjen e përbashkët.
Përfundime: Përmirësimi i komunikimit në kujdesin paliativ është një domosdoshmëri klinike dhe një përgjegjësi etike. Integrimi i trajnimeve të strukturuara mbi komunikimin dhe etikën në edukimin e profesionistëve të shëndetit, si dhe zhvillimi i politikave institucionale që mbështesin komunikimin e hapur dhe empatik, janë thelbësore për garantimin e një kujdesi të përqendruar tek pacienti dhe për ruajtjen e dinjitetit në fund të jetës.

Fjalët kyçe: *Kujdesi paliativ; komunikimi; etikë mjekësore; fundi i jetës; autonomia e pacientit; vendimmarrja e përbashkët; kujdesi infermieror.*

COMMUNICATION IN PALLIATIVE CARE: CHALLENGES, BARRIERS AND ETHICAL IMPLICATIONS AT THE END OF LIFE

Vasien Xhelili[1], Kristjana Sheshmina[2], Estela Skermo[3], Thimaq Karapanxho[4]
[1] Teni Konomi Hospital, Korça
[2] Mary Potter Center, Korça
E-mail: xhelilivasien@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Effective communication constitutes an essential component in palliative care, especially in the advanced stages of disease and at the end of life, where clinical and ethical decision-making becomes increasingly complex. In daily practice, healthcare professionals face numerous challenges that directly affect the quality of care and the respect of fundamental ethical principles.
Aim: This paper aims to identify and analyze the main barriers to communication in palliative care, as well as to assess the ethical implications related to these challenges at the end of life.
Methodology: The study is based on a descriptive analysis and a review of contemporary literature on communication in palliative care. Cultural, emotional, and institutional factors influencing the communication process between healthcare professionals, patients, and family members have been examined.
Results: The analysis highlights that the main barriers include fear of causing emotional distress, lack of formal training in communication, as well as family pressure to limit information provided to the patient. These factors often lead to non-transparent and ineffective communication, negatively affecting clinical decision-making. As a result, the risk of unnecessary treatments increases, along with a deterioration in the quality of life of patients and their families. Furthermore, these difficulties undermine patient autonomy and complicate shared decision-making.
Conclusions: Improving communication in palliative care is both a clinical necessity and an ethical responsibility. The integration of structured training on communication and ethics into the education of healthcare professionals, as well as the development of institutional policies that support open and empathetic communication, are essential to ensure patient-centered care and to preserve dignity at the end of life.

Keywords: *Palliative care; communication; medical ethics; end of life; patient autonomy; shared decision-making; nursing care.*

MONITORIMI DIXHITAL I VETË-KUJDESIT POST-OPERATOR NË RINOSEPTOPLASTIKËN ME TEKNIKË TË MBYLLUR: NJË STUDIM PILOT MBI TURIZMIN MJEKËSOR.

Mario Golemi[1]

[1] Keit Day Hospital
E-mail: golemim410@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Rinoseptoplastika është aktualisht një nga ndërhyrjet kirurgjikale më të kërkuara për korrigjimin estetik dhe funksional. Teknika e mbyllur ofron benefite maksimale për pacientin, si mungesa e cikatriceve të dukshme, trauma e reduktuar indore dhe përdorimi i suturave absorbuese endonazale. Për shkak të kësaj qasjeje mini-invazive, hospitalizimi zgjat vetëm disa orë pas ndërhyrjes deri në maksimumi një natë. Rrjedhimisht, ndjekja post-operatore përgjatë javëve dhe muajve të parë zhvendoset tërësisht në shtëpi. Për pacientët e turizmit mjekësor, ky tranzicion kërkon një kujdes infermieror të specializuar në distancë (tele-infermieria) për të udhëzuar pacientin dhe për të garantuar ecurinë e rikuperimit.
Objektivat: Vlerësimi i efikasitetit të platformave digjitale në menaxhimin post-operator të 50 pacientëve, kryesisht shtetas të huaj, duke monitoruar edukimin mbi vetë-kujdesin nazal dhe pajtueshmërinë me terapinë pa prezencë fizike.
Metodologjia: Studim vëzhgues (nëntor 2025 – mars 2026) me 50 pacientë (30 femra, 20 meshkuj, grupmoshat 18–35 vjeç), ku 80% jetonin jashtë Shqipërisë (Itali, Zvicër, Kosovë, Gjermani). Të gjithë pacientët nënshkruan pëlqimin e informuar për përdorimin e platformave digjitale. Ndjekja u realizua përmes video-konsultave. Kujdesi infermieror konsistoi në edukimin për: teknikën e fashimit, shpëlarjet me solucion fiziologjik, menaxhimin e koagulave, aplikimin e pomadave për masazh dhe marrjen korrekte të antibiotikëve.
Rezultatet: Monitorimi digjital konfirmoi se 100% e pacientëve e realizuan saktë pastrimin dhe fashimin pas udhëzimeve virtuale. Menaxhimi në distancë i hemorragjive të lehta dhe koagulave ishte i suksesshëm në 100% të rasteve. Për 40 pacientët ndërkombëtarë, tele-infermieria eliminoi kërkimin e asistencës mjekësore lokale gjatë javëve të para, pasi absorbimi i suturave dhe masazhet u monitoruan në distancë. Kënaqësia ishte maksimale (98%) falë aksesit të vazhdueshëm me stafin.
Konkluzionet: Tele-infermieria është jetike për menaxhimin e turizmit mjekësor në kirurgjinë plastike. Ajo garanton edukimin e pacientit për vetë-kujdes specifik, rrit sigurinë klinike dhe pozicionon infermierin si urë lidhëse thelbësore mes klinikës dhe pacientit gjatë muajve të rikuperimit.

Fjalë kyçe: *Rinoseptoplastikë, teknikë e mbyllur, tele-infermieria, kujdes post-operator, turizëm mjekësor.*

DIGITAL MONITORING OF POST-OPERATIVE SELF-CARE IN CLOSED RHINOSEPTOPLASTY: A PILOT STUDY ON MEDICAL TOURISM.

Mario Golemi[1]

[1] Keit Day Hospital
E-mail: golemim410@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Rhinoseptoplasty is currently one of the most commonly requested surgical procedures for aesthetic and functional correction. The closed technique offers maximum benefits for the patient, such as the absence of visible scars, reduced tissue trauma, and the use of absorbable endonasal sutures. Due to this minimally invasive approach, hospitalization lasts only a few hours after the procedure up to a maximum of one night. Consequently, post-operative follow-up during the first weeks and months is entirely shifted to the home setting. For medical tourism patients, this transition requires specialized remote nursing care (tele-nursing) to guide patients and ensure proper recovery.

Objectives: To evaluate the effectiveness of digital platforms in the post-operative management of 50 patients, mainly foreign nationals, by monitoring education on nasal self-care and adherence to therapy without physical presence.

Methodology: An observational study (November 2025 – March 2026) involving 50 patients (30 females, 20 males, aged 18–35), of whom 80% lived outside Albania (Italy, Switzerland, Kosovo, Germany). All patients provided informed consent for the use of digital platforms. Follow-up was conducted through video consultations. Nursing care consisted of education on: dressing techniques, saline nasal irrigation, management of clots, application of ointments for massage, and correct administration of antibiotics.

Results: Digital monitoring confirmed that 100% of patients correctly performed cleaning and dressing following virtual instructions. Remote management of mild bleeding and clots was successful in 100% of cases. For the 40 international patients, tele-nursing eliminated the need to seek local medical assistance during the first weeks, as suture absorption and massages were monitored remotely. Satisfaction was very high (98%) due to continuous access to the staff.

Conclusions: Tele-nursing is essential for managing medical tourism in plastic surgery. It ensures patient education for specific self-care, increases clinical safety, and positions the nurse as a crucial link between the clinic and the patient during the recovery period.

Keywords: *Rhinoseptoplasty, closed technique, tele-nursing, post-operative care, medical tourism.*

PERCEPTIMI I SHËNDETIT FIZIK DHE PSIKOSOCIAL I TË MOSHUARVE DHE LIDHJA ME PERFORMANCËN E TYRE KONJITIVE: IMPAKTI NË REZULTATET E CILËSISË SË JETËS

Andia Pelari[1]

[1] Kompania TOSHA - çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë
E-mail: andiapelari1@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Plakja është një proces i natyrshëm biologjik, por mënyra se si ajo përjetohet ndikohet nga faktorë të ndryshëm që përfshijnë shëndetin fizik, mirëqenien emocionale dhe mbështetjen sociale. Për të moshuarit, shëndeti fizik merr një kuptim edhe më të gjerë, pasi ai lidhet me drejtperdrejt me autonominë, pavarësinë dhe aftësinë për të ruajtur një cilësi të pranueshme jete. Në periudhën e plakjes, organizmi përjeton ndryshime të natyrshme fiziologjike që prekin pothuajse të gjitha sistemet e trupit.

Qëllimi: Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë lidhjen mes perceptimit të shëndetit fizik dhe psikosocial të të moshuarve me performancën e tyre kognitive, si dhe të vlerësojë impaktin e kësaj marrëdhënieje në cilësinë e jetës. Studimi synon të ofrojë një kuptim të thelluar mbi mënyrën se si faktorët fizikë dhe psikosocialë ndikojnë në funksionet mendore të individëve të moshës së tretë dhe se si kjo pasqyrohet në mirëqenien e tyre të përgjithshme.

Gjithashtu, studimi ka për qëllim të kontribuojë në literaturën shkencore vendase dhe ndërkombëtare mbi plakjen, duke sjellë të dhëna empirike që reflektojnë realitetin shqiptar dhe sfidat mbi të cilat përballet ky grupmoshë. Rezultatet mund të shërbejnë si bazë për rekomandime praktike dhe ndërhyrje në politikat shëndetësore dhe sociale që mbështesin të moshuarit.

Në studim janë marrë 100 të moshuar mbi 65 vjeç në Vlorë.

Për të dhënat e vazhduara të variablave: cilësia e jetës me 4 komponentet e saj (Fizike, Emocionale, Sociale dhe Mjedisore), perceptimi global, mirëqenia dhe distresi, mosha, BMI, numri i sëmundjeve kronike, janë përshkruar nëpërmjet mesatares dhe devijimit standard.

Konkluzione: Analizimi i cilësisë së jetës së të moshuarve, perceptimi i cilësisë dhe faktorëve ndikues në aftësinë e tyre kognitive në studimin tonë rezultoi i suksesshëm, pasi të gjithë individët ishin të gatshëm të merrnin pjesë në anketim dhe t'u përgjigjeshin pyetjeve të drejtuara nga ana jonë.

Fjalë kyçe: *Shëndeti fizik, mirëqenia psikosociale, performanca kognitive, cilësia e jetës, të moshuarit.*

PERCEPTION OF PHYSICAL AND PSYCHOSOCIAL HEALTH IN OLDER ADULTS AND ITS RELATIONSHIP WITH COGNITIVE PERFORMANCE: IMPACT ON QUALITY-OF-LIFE OUTCOMES

Andia Pelari[1]
[1] TOSHA Company - Occupational Health and Safety
E-mail: andiapelari1@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Aging is a natural biological process, yet its experience is strongly influenced by multiple factors including physical health, emotional well-being, and social support. Among the elderly, these dimensions are closely related to cognitive performance and directly shape quality of life. Examining the interaction betëeen these aspects is essential for understanding real needs and for designing more effective policies and interventions for this age group.
Aim: The aim of this study is to identify the relationships betëeen physical health, psychosocial ëell-being, and cognitive performance among the elderly, as ëell as to provide recommendations for improving their quality of life.
Methodology: The study ëas conducted ëith a sample of 100 elderly individuals randomly selected in the city of Vlora. Data ëere collected through a structured questionnaire that included elements on physical health, psychosocial dimensions, and the MMSE test for cognitive function assessment. Data analysis ëas carried out using descriptive and comparative statistical methods to identify main trends and interrelationships among variables.
Results: Physical health was perceived at a mainly moderate level, reflecting the presence of chronic diseases but also partial ability for their management. Social support emerged as a decisive factor in emotional well-being individual ëith strong family and social netëorks reported higher quality of life. MMSE test results shoëed that nearly half of the participant maintained normal cognitive functions, ëhile the remainder displayed mild or evident cognitive decline, often associated ëith social isolation and chronic conditions.
Conclusions: The study confirmed that physical health, psychosocial status, and cognitive performance are closely interrelated and jointly determine the quality of life of the elderly. A comprehensive healthcare approach is recommended, combining medical interventions social support and mentally stimulating activities. Such a model may contribute to promoting active and dignified aging ëithin Albanian society.

Keywords: *Physical health, psychosocial ëell-being, cognitive performance, quality of life, elderly.*

HOME CARE NURSING NË EPOKËN DIGJITALE

Blerim Maloku[1]

[1] Medical Care LAMI
E-mail: blerim_maloku@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Home Care (kujdesi shëndetësor në shtëpi) përfaqëson një nga format më të rëndësishme dhe në rritje të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, veçanërisht për të moshuarit, pacientët me sëmundje kronike dhe individët me nevoja afatgjata për kujdes. Ndryshimet demografike, rritja e jetëgjatësisë dhe mbingarkesa e sistemeve spitalore kanë rritur ndjeshëm rëndësinë e këtij modeli kujdesi. Epoka digjitale ka sjellë transformime thelbësore në cilësinë e Home Care.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ndikimin e teknologjisë digjitale në shërbimet e Home Care, duke kombinuar evidencën shkencore me përvojën profesionale dhjetëvjeçare të autorit si infermier/e në këtë fushë, si dhe të evidentojë ndryshimet konkrete të vërejtura në praktikën e përditshme klinike.

Metodologjia: Studimi është i natyrës përshkruese dhe analitike, i bazuar në rishikimin e literaturës shkencore bashkëkohore dhe në vëzhgime empirike të mbledhura gjatë punës shumëvjeçare në Home Care. Analiza fokusohet në periudhën e tranzicionit nga dokumentimi tradicional me kartela manuale drejt dosjeve elektronike shëndetësore, si dhe në integrimin e teknologjive të komunikimit, përfshirë videokonsultimet me mjekët.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë se digjitalizimi i Home Care ka sjellë përmirësime të dukshme në cilësinë e shërbimit, efikasitetin e dokumentimit dhe koordinimin ndërmjet profesionistëve të shëndetësisë. Kalimi nga kartela në dorë në dosje elektronike ka reduktuar gabimet, ka përmirësuar gjurmueshmërinë e të dhënave dhe ka lehtësuar ndjekjen afatgjatë të pacientëve. Përdorimi i videokonsultave me mjekun ka mundësuar vendimmarrje më të shpejtë klinike dhe ndërhyrje më efektive në kohë reale.

Diskutim dhe Përfundim: Pavarësisht përfitimeve të shumta, digjitalizimi shoqërohet me sfida që lidhen me aftësitë digjitale, sigurinë e të dhënave dhe nevojën për trajnime të vazhdueshme. Megjithatë, bazuar në evidencën shkencore dhe përvojën profesionale, Home Care në epokën digjitale përfaqëson një model të qëndrueshëm dhe efektiv të kujdesit shëndetësor, duke forcuar rolin e infermierit në ofrimin e kujdesit cilësor në shtëpi.

Fjalë kyçe: *Home Care, kujdes shëndetësor në shtëpi, dosje elektronike shëndetësore, telemjekësi, videokonsultim.*

HOME CARE NURSING IN THE DIGITAL ERA

Blerim Maloku[1]
[1] Medical Care LAMI;
E-mail: blerim_maloku@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Home Care (home healthcare) represents one of the most important and rapidly growing forms of healthcare service delivery, particularly for the elderly, patients with chronic diseases, and individuals with long-term care needs. Demographic changes, increased life expectancy, and the overload of hospital systems have significantly increased the importance of this model of care. The digital era has brought fundamental transformations in the quality of Home Care services.

The aim: This paper is to analyze the impact of digital technology on Home Care services by combining scientific evidence with the author's ten-year professional experience as a nurse in this field, as well as to highlight the concrete changes observed in daily clinical practice.

Methodology: This is a descriptive and analytical study based on a review of contemporary scientific literature and empirical observations collected during many years of work in Home Care. The analysis focuses on the transition period from traditional documentation using manual paper records to electronic health records, as well as on the integration of communication technologies, including video consultations with physicians.

Results: The findings indicate that the digitalization of Home Care has led to significant improvements in service quality, documentation efficiency, and coordination among healthcare professionals. The transition from handwritten records to electronic health records has reduced errors, improved data traceability, and facilitated long-term patient follow-up. The use of video consultations with physicians has enabled faster clinical decision-making and more effective real-time interventions.

Discussion and Conclusion: Despite its many benefits, digitalization is accompanied by challenges related to digital skills, data security, and the need for continuous training. However, based on scientific evidence and professional experience, Home Care in the digital era represents a sustainable and effective model of healthcare delivery, strengthening the role of nurses in providing quality care at home.

Keywords: *Home Care, home healthcare, electronic health records, telemedicine, video consultation.*

ROLI I TEKNOLOGJISË DHE TERAPIVE TË AVANCUARA NË MENAXHIMIN BASHKËKOHOR TË FIBROZËS KISTIKE TEK FËMIJËT

Elisabeta Rista[1]

[1]Presidente e Urdhrit të Infermierit, Qarku Fier
E-mail: elisrista@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Fibroza kistike është një sëmundje gjenetike kronike që prek kryesisht sistemin respirator dhe gastrointestinal tek fëmijët, duke shkaktuar prodhim të mukusit të trashë dhe ngjitës. Mutacionet në gjenin CFTR çojnë në çrregullim të transportit të klorit dhe natriumit në qelizat epiteliale, duke rezultuar në infeksione respiratore të shpeshta, insuficiencë pankreatike dhe çrregullime të rritjes. Përparimet në diagnostikim dhe trajtim kanë rritur ndjeshëm jetëgjatësinë dhe cilësinë e jetës së pacientëve pediatrikë me fibrozë kistike.

Qëllimi: Ky punimi është të përshkruajë karakteristikat klinike, diagnostikimin, trajtimin dhe rolin e kujdesit multidisiplinar në menaxhimin e fibrozës kistike tek fëmijët, me fokus të veçantë në rëndësinë e ndërhyrjeve të hershme dhe kujdesit infermieror.

Metodologjia: Ky punim është realizuar përmes një rishikimi narrativ të literaturës bashkëkohore mbi fibrozën kistike tek fëmijët. U analizuan artikuj shkencorë të viteve të fundit dhe udhëzime klinike ndërkombëtare lidhur me etiologjinë, diagnostikimin dhe menaxhimin terapeutik.

Të dhënat u sistemuan për të evidentuar qasjet më të përditësuara në trajtim dhe kujdesin multidisiplinar, me theks në rolin e ekipit infermieror dhe edukimin e familjes.

Rezultatet tregojnë se diagnostikimi i hershëm përmes skriningut neonatal dhe testit të djersës mundëson fillimin e shpejtë të trajtimit dhe parandalimin e komplikimeve. Menaxhimi përfshin terapi respiratore, përdorimin e bronkodilatorëve, mukolitikëve dhe antibiotikëve, si dhe trajtimin e insuficiencës pankreatike me enzima dhe dietë të përshtatur. Terapitë moderne me modifikatorë të CFTR kanë përmirësuar ndjeshëm prognozën.

Konkluzionet: Fibroza kistike mbetet një sfidë e rëndësishme pediatrike, por përparimet në diagnostikim dhe terapi kanë transformuar menaxhimin e saj. Kujdesi i koordinuar multidisiplinar, roli aktiv i infermierit dhe edukimi i familjes janë faktorë kyç për përmirësimin e rezultateve klinike dhe cilësisë së jetës tek fëmijët me fibrozë kistike.

Fjalë kyçe: *Fibroza kistike pediatrike, Teknologjitë digjitale në shëndetësi, Kujdesi multidisiplinar, Terapitë inovative CFTR*

THE ROLE OF TECHNOLOGY AND ADVANCED THERAPIES IN THE CONTEMPORARY MANAGEMENT OF CYSTIC FIBROSIS IN CHILDREN

Elisabeta Rista[1]
[1]President of the Order of Nurses, Fier Region
E-mail: elisrista@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Cystic fibrosis is a chronic genetic disease that primarily affects the respiratory and gastrointestinal systems in children, leading to the production of thick and sticky mucus. Mutations in the CFTR gene cause disruption of chloride and sodium transport in epithelial cells, resulting in frequent respiratory infections, pancreatic insufficiency, and growth disorders. Advances in diagnosis and treatment have significantly increased life expectancy and improved the quality of life of pediatric patients with cystic fibrosis.

The aim: This paper is to describe the clinical characteristics, diagnosis, treatment, and the role of multidisciplinary care in the management of cystic fibrosis in children, with particular focus on the importance of early interventions and nursing care.

Methodology: This paper was conducted through a narrative review of contemporary literature on cystic fibrosis in children. Recent scientific articles and international clinical guidelines related to etiology, diagnosis, and therapeutic management were analyzed. The data were systematized to highlight the most updated approaches to treatment and multidisciplinary care, with emphasis on the role of the nursing team and family education.

Results: The findings indicate that early diagnosis through neonatal screening and the sweat test enables timely initiation of treatment and prevention of complications. Management includes respiratory therapy, the use of bronchodilators, mucolytics and antibiotics, as well as treatment of pancreatic insufficiency with enzyme therapy and an appropriate diet. Modern therapies with CFTR modulators have significantly improved prognosis.

Conclusions: Cystic fibrosis remains a major pediatric challenge; however, advances in diagnosis and therapy have transformed its management. Coordinated multidisciplinary care, the active role of nurses, and family education are key factors in improving clinical outcomes and quality of life in children with cystic fibrosis.

Keywords: *Pediatric cystic fibrosis, Digital health technologies, Multidisciplinary care, Innovative CFTR therapies.*

NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË LIDERSHIPIT PËR TË FORCUAR QËNDRUESHMËRINË DHE CILËSINË E KUJDESIT: NJOHURI NGA NJË ANALIZË KOMBËTARE E NEVOJAVE NË SHQIPËRI

Blerina Duka[1], Jola Çini [2] Armela Zylfo[3], Fabiola Mane[4], Kujtime Vakeflliu[5], Alta Arapi [6]
[1] Presidente e Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë
[2] Departamenti i Mjekësisë, Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri
[3] Departamenti i Mjekësisë, Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri.
[4] Departamenti i Mjekësisë, Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri
[5] Departamenti i Mjekësisë, Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri
[6] Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri
E-mail: dep.mjeksi-tek@umb.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Qëndrueshmëria dhe cilësia e kujdesit mbahen përmes udhëheqjes vizionare dhe të fuqizuar në infermieri dhe mami. Në Shqipëri, një vend me të ardhura të ulëta–mesatare, i sfiduar nga migrimi i fuqisë punëtore, mundësi të kufizuara për avancim në karrierë dhe mungesë e arsimit pasuniversitar, zhvillimi i kapaciteteve të forta drejtuese është kritik. Investimi në liderët e ardhshëm, të cilët mund të nxisin inovacionin, të menaxhojnë ndryshimin dhe të ruajnë standardet e cilësisë, është i domosdoshëm për të mbajtur infermierët brenda sistemit kombëtar shëndetësor. Ky studim synoi të eksplorojë kompetencat drejtuese të profesionistëve të shëndetësisë, gatishmërinë e tyre të vetëperceptuar dhe interesin për arsimim pasuniversitar në menaxhim dhe udhëheqje.

Metodat: U realizua një studim përshkrues, ndërsektorial (cross-sectional) në periudhën Shtator–Tetor 2025 me profesionistë të shëndetësisë në nivel kombëtar. Një pyetësor anonim online shqyrtoi vetëvlerësimin e lidershipit, besimin në vetvete, identitetin profesional, përshtatshmërinë e trajnimit dhe interesin për arsimim formal. Për analizën e të dhënave sasiore u përdorën statistika përshkruese.

Rezultatet: Në studim morën pjesë gjithsej 394 profesionistë (81.5% femra; 66.2% infermierë; 13.2% mami). Vetëm 22% aktualisht mbajnë role koordinuese, ndërsa 44% e konsideruan trajnimin e tyre të pamjaftueshëm për të përmbushur përgjegjësitë drejtuese. Mesatarja e vetëbesimit në udhëheqjen e të tjerëve ishte 65%, me një nivel mesatar të identitetit drejtues (M = 4.4/7). Kompetencat më të zhvilluara përfshinin komunikimin efektiv (62%), vendimmarrjen (50%) dhe menaxhimin e kohës (58%). Fushat prioritare për zhvillim të mëtejshëm ishin vendimmarrja etike (53%), menaxhimi i ekipit (50%) dhe udhëheqja në politika dhe sistem shëndetësor (47%). E rëndësishme është se 83% shprehën interes për të ndjekur një Master Shkencor në Lidership dhe Menaxhim, të motivuar nga avancimi në karrierë (55%), zhvillimi akademik (21%) dhe përmirësimi i cilësisë së kujdesit (21%).

Përfundime: Gjetjet theksojnë nevojën urgjente për investim në edukimin dhe ndërtimin e kapaciteteve drejtuese tek infermierët dhe mamitë në Shqipëri. Forcimi i programeve pasuniversitare në lidership mund të nxisë reziliencën profesionale, të përmirësojë cilësinë e kujdesit dhe të zbusë migrimin e fuqisë punëtore. Përgatitja e liderëve të ardhshëm të infermierisë me kompetenca strategjike, etike dhe digjitale është themelore për një sistem shëndetësor të qëndrueshëm, të fokusuar te pacienti dhe të gatshëm për të ardhmen.

Fjalë kyçe: *Udhëheqje, infermieri dhe mami, qëndrueshmëri, cilësia e kujdesit*

BUILDING LEADERSHIP CAPACITY TO STRENGTHEN RESILIENCE AND QUALITY OF CARE: INSIGHTS FROM A NATIONAL NEEDS ANALYSIS IN ALBANIA

Blerina Duka[1], Jola Çini [2] Armela Zylfo[3], Fabiola Mane[4], Kujtime Vakeflliu[5], Alta Arapi [6]

[1] President of the Albanian Order of Nurses

[2] Department of Medicine, Barleti University, Tirana, Albania

[3] Department of Medicine, Barleti University, Tirana, Albania

[4] Department of Medicine, Barleti University, Tirana, Albania

[5] Department of Medicine, Barleti University, Tirana, Albania

[6] Albanian Order of Nurses, Tirana, Albania

E-mail: dep.mjeksi-tek@umb.edu.al

ABSTRACT

Background: Resilience and quality of care are sustained through visionary and empowered nursing and midwifery leadership. In Albania, a low-middle-income country challenged by workforce migration, limited career advancement, and scarce postgraduate education, developing strong leadership capacity is critical. Investing in future leaders who can drive innovation, manage change, and uphold quality standards is essential to retain nurses within the national health system. This study aimed to explore healthcare professionals' leadership competencies, self-perceived readiness, and interest in postgraduate education in management and leadership.

Methods: A descriptive, cross-sectional survey was conducted in September-October 2025 among healthcare professionals nationwide. An anonymous online questionnaire investigated leadership self-assessment, confidence, identity, training adequacy, and interest in formal education. Descriptive statistics were applied to analyze quantitative responses.

Results: A total of 394 professionals participated (81.5% female; 66.2% nurses; 13.2% midwives). Only 22% currently hold coordinating roles, and 44% considered their training insufficient to meet leadership responsibilities. The mean self-confidence in leading others was 65%, with a moderate leadership identity score (M = 4.4/7). Competencies most developed included effective communication (62%), decision-making (50%), and time management (58%). Priority areas for further development were ethical decision-making (53%), team management (50%), and policy and system leadership (47%). Importantly, 83% expressed interest in pursuing a Master of Science in Leadership and Management, motivated by career advancement (55%), academic growth (21%), and improving care quality (21%).

Conclusions: The findings underscore an urgent need to invest in leadership education and capacity building among Albanian nurses and midwives. Strengthening postgraduate leadership

pathways can foster resilience, enhance care quality, and mitigate workforce migration. Preparing future nurse leaders with strategic, ethical, and digital competencies is fundamental for a sustainable, patient-focused, and future-ready health system.

Keywords: *Leadership, Nursing and Midwifery, Resilience, Quality of Care.*

SESION PARALEL

SESIONI I

SALLA 3

ABSTRAKTET

STRATEGJITË E MARKETINGUT TË INFERMIERISË PËR MBAJTJEN E FUQISË PUNËTORE: NJË PERSPEKTIVË GLOBALE

Indrit Bimi[1]

[1] Universiteti i Durrësit "Aleksander Moisiu", Shqipëri

E-mail: indritbimi@uamd.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Fuqia punëtore globale e infermierisë përballet me një krizë kritike të mbajtjes së personelit, me Këshillin Ndërkombëtar të Infermierëve (2021) që parashikon një mungesë prej 13 milion infermierësh deri në vitin 2030. Lodhja e tepërt, personeli i pasigurt dhe rritja e kufizuar në karrierë nxisin largimin e infermierëve në të gjithë botën (Dall'Ora et al., 2020; Lasater et al., 2021).

Metodologjia: Një rishikim integrues i literaturës u krye duke përdorur PubMed, CINAHL dhe Scopus, duke mbuluar artikuj të rishikuar nga kolegët dhe dokumente politikash të botuara midis viteve 2017 dhe 2023.

Rezultatet: Provat identifikojnë katër strategji kryesore të mbajtjes së punonjësve: marketingu i brendshëm që nxit angazhimin organizativ; krijimi i markës së punëdhënësit që komunikon propozimet e vlerës përmes platformave dixhitale; përmirësimet e mjedisit të sigurt të punës që zvogëlojnë qëllimin për t'u larguar; dhe programet e zhvillimit profesional që mbështesin përparimin në karrierë. Ndërhyrjet për ndërtimin e qëndrueshmërisë kanë rezultuar gjithashtu efektive, veçanërisht pas pandemisë (Labrague & De los Santos, 2021).

Përfundime: Zbatimi i kornizave të marketingut në menaxhimin e fuqisë punëtore infermierore është një strategji e zbatueshme dhe e bazuar në prova për uljen e fluktuacionit në nivel global. Organizatat e kujdesit shëndetësor duhet t'i përshtatin fushatat e mbajtjes së personelit sipas kontekseve të tyre socio-ekonomike dhe kulturore.

Fjalë kyçe: *Mbajtja e infermierisë, marketingu i fuqisë punëtore, marka e punëdhënësit, ndërrimi i infermierëve, infermieria globale.*

NURSING MARKETING STRATEGIES FOR WORKFORCE RETENTION: A GLOBAL PERSPECTIVE

Indrit Bimi[1]
[1]University of Durrës "Aleksandër Moisiu", Albania
E-mail: indritbimi@uamd.edu.al

ABSTRACT

Introduction: The global nursing workforce is facing a critical retention crisis, with the International Council of Nurses (2021) projecting a shortage of 13 million nurses by 2030. Burnout, unsafe staffing levels, and limited career advancement opportunities are key drivers of nurse attrition worldwide (Dall'Ora et al., 2020; Lasater et al., 2021).
Methodology: An integrative literature review was conducted using PubMed, CINAHL, and Scopus databases, including peer-reviewed articles and policy documents published between 2017 and 2023.
Results: The evidence identifies four key workforce retention strategies: internal marketing that enhances organizational engagement; employer branding that communicates value propositions through digital platforms; improvements in safe work environments that reduce turnover intention; and professional development programs that support career progression. Resilience-building interventions have also proven effective, particularly in the post-pandemic context (Labrague & De los Santos, 2021).
Conclusions: The application of marketing frameworks in nursing workforce management represents a feasible and evidence-based strategy to reduce global nurse turnover. Healthcare organizations should tailor retention strategies to their specific socio-economic and cultural contexts.

Keywords: *Nursing retention, workforce marketing, employer branding, nurse turnover, global nursing.*

VAKSINIMI KUNDËR COVID-19, SEROPREVALENCA DHE EFEKTIVITETI I VAKSINËS TEK PUNONJËSIT E KUJDESIT SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI, 2021–2023: ANALIZË DUKE PËRDORUR SISTEMIN REDCAP

Ermioni Dabaj[1]
[1]Presidente e UISH, Qarku Durrës
E-mail: e.dabaj@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Profesionistët e shëndetit janë ekspozuar në mënyrë disproporcionale ndaj SARS-CoV-2 që nga fillimi i pandemisë COVID-19. Në Shqipëri, studime prospektive kohorte të kryera midis 2021 dhe 2023 kanë prodhuar dëshmi të rëndësishme mbi seroprevalencën, mbulimin e vaksinimit kundër COVID-19 dhe gripit sezonal, si dhe efikasitetin e vaksinave kundër varianteve Omicron.
Objektivat: Të vlerësohet efikasiteti i vaksinave COVID-19 te profesionistët e shëndetit dhe të integrohen kronologjikisht gjetjet për të informuar strategjitë e vaksinimit në këtë popullatë.
Metodat: Të dhënat nga tre spitale në Shqipëri, të mbledhura midis shkurtit 2021 dhe nëntorit 2023, u menaxhuan dhe analizuan duke përdorur sistemin REDCap. U përfshinë të dhëna sociodemografike, profesionale dhe shëndetësore, historia e vaksinimit dhe infeksioni i mëparshëm me SARS-CoV-2. U kryen teste serologjike për antitrupat anti–SARS-CoV-2 spike protein dhe teste PCR për infeksion simptomatik. Përdorimi i vaksinave dhe seroprevalenca u analizuan me regresion logjistik multivariat, ndërsa efikasiteti i vaksinës u vlerësua me modele regresioni Cox për rrezikun proporcional.
Rezultatet: Në fillim të vitit 2021, 72% e profesionistëve të shëndetit ishin seropozitivë për SARS-CoV-2, me prevalencë më të lartë tek infermierët, mamitë dhe stafi mbështetës. Deri në qershor 2022, 88.9% kishin marrë dy doza të vaksinës COVID-19, ndërsa vetëm 19.1% kishin marrë dozën përforcuese. Përdorimi i dozës përforcuese ishte më i ulët tek gratë, profesionistët e rinj dhe stafi jo-mjekësor. Gjatë qarkullimit të varianteve Omicron BA.1/BA.2 (janar–maj 2022), efikasiteti i vaksinës u vlerësua në 34% për serinë primare dhe 88% për dozën përforcuese. Në sezonin 2022–2023, mbulimi i serisë primare mbeti i lartë (93.6%), ndërsa përdorimi i dozës përforcuese dhe vaksinës së gripit sezonal mbeti i ulët (20% dhe 23.7%). Besimi në sigurinë dhe efikasitetin e vaksinës ishte një faktor kyç për marrjen e vaksinës.
Konkluzione: Megjithëse mbulimi i vaksinimit primar kundër COVID-19 ishte i lartë, marrja e dozave përforcuese dhe vaksinës së gripit sezonal te profesionistët e shëndetit mbeti nën optimal. Dozat përforcuese ofruan mbrojtje të konsiderueshme kundër infeksionit Omicron, duke theksuar nevojën për strategji të synuara vaksinimi që adresojnë ndryshimet sipas moshës, gjinisë dhe rolit profesional.

Fjalë kyçe: *COVID-19, efikasiteti i vaksinës, profesionistët e shëndetit, seroprevalenca SARS-CoV-2, doza përforcuese, REDCap.*

COVID-19 VACCINATION, SEROPREVALENCE, AND VACCINE EFFECTIVENESS AMONG HEALTHCARE PROFESSIONALS IN ALBANIA, 2021–2023: ANALYSIS USING THE REDCAP SYSTEM

Ermioni Dabaj[1]
[1]President, UISH, Durrës, Albania
E-mail: e.dabaj@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Healthcare professionals have been disproportionately exposed to SARS-CoV-2 since the onset of the COVID-19 pandemic. In Albania, prospective cohort studies conducted between 2021 and 2023 have provided important evidence on seroprevalence, COVID-19 and seasonal influenza vaccine coverage, and vaccine effectiveness against Omicron variants.
Objectives: To evaluate the effectiveness of COVID-19 vaccines among healthcare professionals and to chronologically integrate findings to inform vaccination strategies for this population.
Methods: Data from three hospitals in Albania, collected between February 2021 and November 2023, were managed and analyzed using the REDCap system. Sociodemographic, professional, and health-related data, vaccination history, and prior SARS-CoV-2 infection were included. Serological tests for anti–SARS-CoV-2 spike protein antibodies and PCR tests for symptomatic infection were performed. Vaccine uptake and seroprevalence were analyzed using multivariable logistic regression, while vaccine effectiveness was assessed using Cox proportional hazards models.
Results: At the beginning of 2021, 72% of healthcare professionals were seropositive for SARS-CoV-2, with higher prevalence among nurses, midwives, and support staff. By June 2022, 88.9% had received two doses of the COVID-19 vaccine, while only 19.1% had received a booster dose. Booster uptake was lower among women, younger professionals, and non-clinical staff. During circulation of the Omicron BA.1/BA.2 variants (January–May 2022), vaccine effectiveness was estimated at 34% for the primary series and 88% for the booster dose. In the 2022–2023 season, primary series coverage remained high (93.6%), while booster and seasonal influenza vaccine uptake remained low (20% and 23.7%, respectively). Confidence in vaccine safety and effectiveness was a key determinant of vaccine uptake.
Conclusions: Although primary COVID-19 vaccine coverage was high, booster and seasonal influenza vaccine uptake among healthcare professionals remained suboptimal. Booster doses provided significant protection against Omicron infection, highlighting the need for targeted vaccination strategies addressing age, sex, and professional role differences.

Keywords: *COVID-19, vaccine effectiveness, healthcare professionals, SARS-CoV-2 seroprevalence, booster dose, REDCap*.

EDUKIMI I PROFESIONISTËVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË EPOKËN DIGJITALE

Nevila Duraku[1]
[1] UET
E-mail: nevila_xibri@qsut.gov.al

ABSTRAKT

Hyrje: Ritmi i shpejtë i inovacionit digjital po transformon shumë aspekte të kujdesit shëndetësor, përfshirë mënyrën se si profesionistët edukohen dhe trajnohen. Mjete si platformat e mësimit online, simulimet virtuale dhe inteligjenca artificiale nuk janë më thjesht opsione shtesë, por po bëhen pjesë qendrore e procesit mësimor. Ato ofrojnë mënyra të reja për profesionistët e shëndetësisë për të aksesuar njohuri, për të zhvilluar aftësi dhe për të qëndruar të përditësuar në një fushë që evoluon vazhdimisht.
Qëllimi: Ky studim synon të shqyrtojë ndikimin e teknologjive digjitale në edukimin shëndetësor, duke u fokusuar si në mundësitë që ato ofrojnë, ashtu edhe në sfidat që shoqërojnë përdorimin e tyre.
Metodat: U përdor një qasje deskriptive, e mbështetur në literaturën aktuale dhe përvojat praktike që lidhen me mësimin digjital në fushën e shëndetësisë. Analiza u përqendrua në mënyrën e përdorimit të këtyre teknologjive, përfitimet që ato sjellin dhe vështirësitë me të cilat përballen institucionet dhe pedagogët.
Rezultatet: Mjetet digjitale po krijojnë mundësi për një mësim më fleksibël dhe të personalizuar, duke lehtësuar aksesin në burime cilësore dhe duke mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Megjithatë, integrimi i tyre nuk është pa sfida. Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme, pabarazitë në aksesin ndaj teknologjisë dhe nevoja për përgatitje më të mirë të pedagogëve mbeten pengesa të rëndësishme. Po ashtu, ekziston shqetësimi për ruajtjen e balancës midis njohurive teorike dhe përvojës praktike, si dhe për mbajtjen e dimensionit njerëzor që është thelbësor në kujdesin ndaj pacientit.
Konkluzione: Epoka digjitale ofron potencial të madh për përmirësimin e edukimit në kujdesin shëndetësor, por ky potencial mund të realizohet vetëm përmes një qasjeje të kujdesshme dhe të balancuar. Kombinimi i metodave tradicionale me inovacionin digjital, investimi në burime dhe mbështetja e pedagogëve janë hapa kyç për ndërtimin e një sistemi edukimi më efektiv dhe të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: *Edukimi shëndetësor, epoka digjitale, inteligjenca artificiale, mësimi online, edukimi i vazhdueshëm professional.*

EDUCATION OF HEALTHCARE PROFESSIONALS IN THE DIGITAL ERA

Nevila Duraku[1]
[1] European University of Tirana
E-mail: nevila_xibri@qsut.gov.al

ABSTRACT

Introduction: The fast transition of digital innovation is reshaping many aspects of healthcare, including how professionals are educated and trained. Tools such as online learning platforms, virtual simulations, and artificial intelligence are no longer optional additions but are becoming central to the learning process. They offer new ways for healthcare professionals to access knowledge, develop skills, and stay up to date in a field that evolves rapidly.
Aim: This study explores how digital technologies are influencing healthcare education, with a focus on both the opportunities they create and the challenges they bring.
Methods: A descriptive approach was adopted, drawing on current literature and practical experiences related to digital learning in healthcare. The analysis focused on understanding how these technologies are used, what benefits they offer, and what difficulties institutions and educators encounter.
Results: Digital tools are opening doors to more flexible and personalized learning, making it easier for professionals to access high-quality resources and continue their development over time. At the same time, their integration is not without difficulties. Limited infrastructure, unequal access to technology, and the need for better preparation of educators remain important barriers. There is also an ongoing concern about preserving the balance between theoretical knowledge and hands-on clinical experience, as well as maintaining the human connection that is essential in-patient care.
Conclusion: The digital era offers real potential to improve healthcare education, but this potential can only be realized through thoughtful and balanced implementation. Combining traditional teaching with digital innovation, investing in resources, and supporting educators are key steps toward building a more effective and sustainable educational system.

Keywords: *Healthcare education, digital era, artificial intelligence, online learning, continuous professional development*

ROLI DHE RËNDËSIA E TEKNIKËVE TË RADIOLOGJISË NË KUJDESIN SHËNDETËSOR MODERN

Mustafë Buzoku [1]

[1]Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë
E-mail: mustafe.buzoku@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Teknikët e radiologjisë janë një komponent thelbësor i sistemit shëndetësor, duke kontribuar drejtpërdrejt në diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e sëmundjeve përmes imazherisë mjekësore. Me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe rritjen e kërkesës për ekzaminime, roli i tyre është bërë gjithnjë e më kompleks dhe i rëndësishëm. Ata operojnë pajisje të avancuara diagnostike dhe sigurojnë cilësi të lartë të imazhit duke respektuar standardet e sigurisë së pacientit.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të analizojë rolin, përgjegjësitë dhe rëndësinë e teknikëve të radiologjisë në kujdesin shëndetësor, si dhe sfidat dhe zhvillimet e ardhshme të profesionit.
Metodologjia: Studimi bazohet në një qasje përshkruese dhe analitike, duke u mbështetur në analizën e praktikës klinike dhe literaturës përkatëse. Janë shqyrtuar funksionet e teknikëve në modalitete të ndryshme imazherike si radiografia, CT, MRI, ekografia, mjekësia nukleare dhe radiologjia intervencionuese, si dhe aspektet etike dhe profesionale të punës së tyre.
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se teknikët e radiologjisë luajnë rol kyç në sigurimin e imazheve diagnostike të sakta, në mbrojtjen e pacientëve nga rrezatimi dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të rehatshëm gjatë procedurave. Ata kontribuojnë në bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe në përmirësimin e rezultateve klinike. Megjithatë, ata përballen me sfida si ekspozimi ndaj rrezatimit, ngarkesa e lartë e punës, mungesa e stafit dhe nevoja për përditësim të vazhdueshëm profesional.
Diskutim: Avancimet teknologjike, përfshirë inteligjencën artificiale dhe imazherinë e avancuar, po transformojnë rolin e teknikëve të radiologjisë. Këto zhvillime kërkojnë adaptim të vazhdueshëm dhe rritje të kompetencave profesionale, duke ofruar njëkohësisht mundësi për përmirësimin e cilësisë diagnostike dhe efikasitetit të shërbimeve.
Konkluzione: Teknikët e radiologjisë janë të domosdoshëm për funksionimin efektiv të kujdesit shëndetësor modern. Investimi në edukimin, mirëqenien dhe zhvillimin profesional të tyre është thelbësor për përmirësimin e cilësisë së kujdesit dhe sigurisë së pacientit.

Fjalë kyçe: *Teknikët e radiologjisë, imazheria mjekësore, diagnostikimi, siguria e pacientit, inteligjenca artificiale, kujdesi shëndetësor.*

THE ROLE AND IMPORTANCE OF RADIOLOGIC TECHNOLOGISTS IN MODERN HEALTHCARE

Mustafë Buzoku [1]
[1]AAB College, Pristina, Kosovo
E-mail: mustafe.buzoku@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Radiologic technologists play a central role in modern healthcare, contributing directly to the diagnosis and management of a wide range of diseases through medical imaging. As technology continues to advance and the demand for imaging grows, their responsibilities have expanded significantly. Beyond operating sophisticated equipment, they are also responsible for ensuring image quality, maintaining patient safety, and supporting the overall diagnostic process.
Objective: This study aims to explore the role and responsibilities of radiologic technologists in everyday clinical practice, as well as to highlight the challenges they face and the evolving nature of their profession.
Methodology: A descriptive and analytical approach was used, drawing on clinical practice and relevant literature. The study examines the work of technologists across different imaging modalities, including radiography, CT, MRI, ultrasound, nuclear medicine, and interventional radiology, while also considering the ethical and professional aspects of their role.
Results: The findings show that radiologic technologists are essential in producing accurate diagnostic images and ensuring patient safety throughout imaging procedures. They also play an important role in patient communication and in supporting multidisciplinary collaboration. However, their work is often demanding, involving exposure to radiation, high workloads, staff shortages, and the need to continuously adapt to new technologies.
Discussion: Ongoing advancements in imaging technologies, particularly artificial intelligence, are reshaping the field of radiology. While these innovations offer opportunities to improve efficiency and diagnostic accuracy, they also require technologists to continuously update their skills and adapt to new ways of working.
Conclusion: Radiologic technologists are vital to the effective functioning of modern healthcare. Supporting their professional development, improving working conditions, and embracing technological progress are key to ensuring high-quality patient care.

Keywords: R*adiologic technologists, medical imaging, patient care, workload, artificial intelligence, healthcare.*

TERAPIA INTENSIVE NEONATALE DHE RREZIKU I HUMBJES SË DËGJIMIT

Gentjana Shembitraku[1]

[1]Shërbimin i Neonatologjisë pranë SUOGJ ‘ Koço Gliozheni”
E-mail: gentagita@hotmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Në vitin 1990 në SHBA u formuan programet e para për të depistuar dëgjimin tek foshnjat e sapolindura. Kërkimet treguan që përafërsisht 1/650 foshnje kan humbje të dëgjimit të shkallëve të ndryshme. Testi i depistimit tek të sapolindurit ndihmon në identifikimin e foshnjeve që kan humbje të përhershme të dëgjimit sa më herët të jetë e mundur. Kjo do të thotë që prindërit mund të marrin mbështetjen dhe këshillat që u nevojiten që në fillim.

Objektivat: Faktorët e rrezikut për humbje të dëgjimit janë: Foshnjat e lindura para kohe, foshnjat me peshë të vogël. Foshnjat që kan pikëzim të ulët të apgarit në momentin e lindjes. Foshnjat që kan hiperbilirubinemi. Sindromat e shoqëruar me humbje të dëgjimit. Infeksionet të tilla si citomegalovirusi, sifilizi, herpes, toksoplasmoza. Për shkak të uljes së vdekshmërisë del detyrë kryesore apilikimi i këtij testi për depistimin e dëgjimit sepse foshnjat e shtruara në NICU janë shumë herë më të riskuar për të bërë probleme të dëgjimit sesa foshnjat e tjera.

Metodologjia: Për depistim përdoret OAE (Otoakustike emission measures) Vleresimi i dëgjimit nëpermjet emisioneve otoakustike. Kjo mënyre ekzaminimi mat përgjigjen otoakustike të veshit të brëndshëm (koklear) nëpermjet një stimuli të jashtëm. Ky test realizohet nëpërmjet një kufjeve të vogla në veshin e të sapolindurit. Foshnja është duke fjetur dhe tingujt gjenerohen nëpërmjet sondës. Koklea i merr i përpunon dhe dërgon stimulin në SNQ. Që aty vjen sinjali në vesh dhe kapet nga aparati. Testi zgjat 5-10 minuta. Në terapinë intesive neonatologjike përdoret ABR (potencialet e evokuar auditive të trungut të prurit) janë potenciale që gjenerohen në trungun e trurit pas një stimuli akustik të paraqitur në vesh dhe që matet me disa elektroda të vendosur në scalp. Testi i ABR përdoret në depistimin neonatal të dëgjimit për të përcaktuar nëse fëmija dëgjon ose jo mbi një vlerë te caktuar të pragut të dëgjimit.

Konkluzioni: Rezultati i screening Pass (rezultat pozitiv që foshnja nuk ka probleme me dëgjimin) ose Fail (rezultat negativ që tregon që foshnja duhet ti nënshtrohet dhe një herë ekzaminimit). Gjatë periudhës shtator 2025 deri në muajin shkurt 2026 ne SUOGJ ‘Koço Gliozheni’ i janë nënshtruar testimit rreth 300 foshnje të sapolindura të cilët kan qëne në terapi intensive neonatale, dhe nga këto vetëm 7 foshnja kan rezultuar me rezultatin Fail.

Fjalë kyçe: Humbje *të dëgjimit, depistim, foshnjat e sapolindura, OAE, ABR.*

NEONATAL INTENSIVE CARE AND THE RISK OF HEARING LOSS

Gentjana Shembitraku[1]
[1] Neonatology Service at "Koço Gliozheni" University Obstetrics and Gynecology Hospital (SUOGJ)
E-mail: gentagita@hotmail.com

ABSTRACT

Introduction : In 1990, the first programs to screen hearing in newborn babies were formed in the USA. Research showed that approximately 1/650 babies have hearing loss of varying degrees. Newborn screening tests help identify babies who have permanent hearing loss as early as possible. This means that parents can get the support and advice they need from the beginning.

Objectives : Risk factors for hearing loss are: Premature babies, low birth weight babies. Babies with low Apgar scores at birth. Babies with hyperbilirubinemia. Syndromes associated with hearing loss. Infections such as cytomegalovirus, syphilis, herpes, and toxoplasmosis. Due to the reduction in mortality, the main task is to apply this test for hearing screening because babies admitted to the NICU are many times more at risk of developing hearing problems than other babies.

Methodology: OAE (Otoacoustic emission measures) is used for screening. This examination method measures the otoacoustic response of the inner ear (cochlear) through an external stimulus. This test is performed through a small earphone in the newborn's ear. The baby is sleeping and the sounds are generated through the probe. The cochlea receives, processes and sends the stimulus to the CNS. From there, the signal comes to the ear and is captured by the device. The test lasts 5-10 minutes. In neonatal intensive care, ABR (auditory brainstem evoked potentials) are potentials that are generated in the brainstem after an acoustic stimulus is presented to the ear and that are measured with several electrodes placed on the scalp. The ABR test is used in neonatal hearing screening to determine whether or not the child hears above a certain threshold value of hearing.

Conclusion: Screening result Pass (positive result indicating that the baby has no hearing problems) or Fail (negative result indicating that the baby should be screened again). During the period from September 2025 ti February 2026, around 300 newborn babies who were in NICU were tested at the SUOGJ 'Koço Gliozheni' , and of these, only 7 babies resulted in Fail result.

Keywords: *Hearing loss, screening, newborn babies, OAE, ABR.*

KUJDESI NDAJ NËNËS NË PERIUDHËN POST PARTUM NË EPOKËN MODERNE

Fatbardha Faqolli[1]

[1] Kujdesi Intensiv - Reanimacioni dhe Neonatologji, Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni", Tiranë, Shqipëri
Klinika QELIZA, Tiranë, Shqipëri
E-mail: fatbardhafaqolli94@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Kujdesi ndaj nënës gjatë periudhës post partum përbën një element thelbësor të kujdesit maternal modern, duke ndikuar në shëndetin fizik, psikologjik dhe social të gruas pas lindjes. Periudha post partum shtrihet nga lindja deri në disa javë ose muaj pas saj dhe konsiderohet një fazë kritike ku nënat përjetojnë ndryshime fiziologjike dhe psikologjike të mëdha, të cilat kërkojnë monitorim të vazhdueshëm dhe mbështetje multidimensionale për të parandaluar komplikimet dhe për të përmirësuar mirëqenien e tyre. ACOG rekomandon që kujdesi postnatal të individualizohet dhe të përfshijë monitorim të hershëm dhe të vazhdueshëm deri në 12 javë ose më tej pas lindjes.
Objektivat: Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë ndikimin e kujdesit post partum të strukturuar në përmirësimin e rezultateve shëndetësore të nënës, përfshirë ripërtëritjen fizike, mbështetjen psikologjike dhe përforcimin e aftësive për kujdesin ndaj fëmijës.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim kritikor të literaturës shkencore të publikuar kryesisht në pesë vitet e fundit (2019–2025), duke përfshirë artikuj shqyrtues dhe studime origjinale që analizojnë modele të kujdesit post partum në nivel global dhe ndikimet e tyre në shëndetin e nënës dhe të foshnjës.
Rezultatet: Evidenca tregon se kujdesi post partum që përfshin vlerësim të shëndetit fizik dhe psikologjik, mbështetje për ushqyerjen me gji, edukim rreth vetëkujdesit dhe mbështetje sociale lidhet me rezultate më të mira të shëndetit maternal, përmirësim të mirëqenies emocionale dhe ulje të simptomave të depresionit postnatal. Studimet gjithashtu nënvizojnë nevojën për planifikim të kujdesit përtej gjashtë javëve tradicionale dhe integrimin e shërbimeve digjitale dhe telehealth për zgjerimin e mbështetjes.
Konkluzione: Kujdesi post partum i strukturuar dhe i vazhdueshëm është vendimtar për përmirësimin e shëndetit fiziko-psikologjik të nënës dhe për përforcimin e lidhjes me foshnjën. Adoptimi i modeleve të kujdesit të individualizuar, edukimi i nënave dhe përfshirja e mbështetjes sociale mund të kontribuojë në një tranzicion më të lehtë drejt prindërimit dhe reduktimin e komplikimeve afatgjata.

Fjalë kyçe: *Kujdes post partum, shëndeti maternal, mirëqenia e nënës, mbështetje psikologjike, edukim postnatal, modele të kujdesit.*

CARE OF THE MOTHER DURING THE POSTPARTUM PERIOD IN THE MODERN ERA

Fatbardha Faqolli [1]

[1] Intensive Care – Resuscitation and Neonatology, University Obstetric-Gynecologic Hospital "Koço Gliozheni", Tirana, Albania
QELIZA Clinic, Tirana, Albania
E-mail: fatbardhafaqolli94@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Care of the mother during the postpartum period is a fundamental aspect of modern maternal care, impacting the physical, psychological, and social health of women after childbirth. The postpartum period extends from birth to several weeks or months afterward and is considered a critical phase during which mothers experience significant physiological and psychological changes. These changes require continuous monitoring and multidimensional support to prevent complications and improve overall well-being. The American College of Obstetricians and Gynecologists (ACOG) recommends that postpartum care be individualized and include early and continuous follow-up up to 12 weeks or longer after delivery.

Objectives: The aim of this study is to examine the impact of structured postpartum care on improving maternal health outcomes, including physical recovery, psychological support, and the enhancement of skills for infant care.

Methodology: This paper is based on a critical review of the scientific literature published mainly in the last five years (2019–2025), including review articles and original studies that analyze postpartum care models globally and their impact on maternal and neonatal health.

Results: Evidence shows that postpartum care, which includes assessment of physical and psychological health, support for breastfeeding, education on self-care, and social support, is associated with better maternal health outcomes, improved emotional well-being, and reduced symptoms of postpartum depression. Studies also highlight the need for care planning beyond the traditional six-week period and the integration of digital health and telehealth services to expand support.

Conclusions: Structured and continuous postpartum care is crucial for improving the physical and psychological health of mothers and strengthening the mother-infant bond. The adoption of individualized care models, maternal education, and the inclusion of social support can contribute to an easier transition to parenthood and reduce long-term complications.

Keywords: *Postpartum care, maternal health, maternal well-being, psychological support, postnatal education, care models.*

PËRMIRËSIMI I KUJDESIT TË PACIENTIT PËRMES PRAKTIKËS SË BAZUAR NË EVIDENCË: STRATEGJITË DHE NDIKIMI NË SHËNDETËSINË MODERNE

Nada Tërpo[1]

[1] Kujdesit Shëndetesor Parësor
Njësia vendore e Kujdesit Shëndetësor Korçë
E-mail: nadaterpo@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Kujdesi shëndetësor i bazuar në evidencë përbën një komponent thelbësor në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe në orientimin e vendimmarrjes në sistemin shëndetësor. Përdorimi sistematik i të dhënave dhe evidencave të mbledhura nga institucionet shëndetësore mundëson vlerësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe identifikimin e problematikave kryesore të shëndetit publik. Institucionet që merren me përpunimin dhe analizimin e evidencave shëndetësore kanë një rol të rëndësishëm në mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave që lidhen me semundshmërinë, sëmundjet infektive, vaksinimin, lindjet, kujdesin shëndetësor në banesë.
Qëllimi: Qëllimi i kësaj teme është të analizojë rëndësinë e përdorimit të evidencave shëndetësore në planifikimin dhe përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Gjithashtu, synon të evidentojë rolin e përpunimit të të dhënave që vijnë nga qendrat shëndetësore në monitorimin e treguesve kryesorë të shëndetit të popullatës dhe në identifikimin e nevojave reale të komunitetit.
Metodologji: Studimi bazohet në analizën e të dhënave sekondare të raportuara nga qendrat shëndetësore dhe të përpunuara në institucionin përkatës. Të dhënat përfshijnë indikatorë të ndryshëm shëndetësorë si semundshmëria, raportimi i sëmundjeve infektive, programet e vaksinimit, numri i lindjeve, kujdesi shëndetësor në banesë, kontrolli mjekësor bazë, shërbimet e konsultorit të nënës dhe fëmijës, si dhe evidencat mbi sëmundjet kronike jo të transmetueshme dhe numrin e banorëve.
Rezultate: Analiza e evidencave shëndetësore mundëson identifikimin e trendeve epidemiologjike dhe vlerësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës. Përpunimi i të dhënave të mbledhura nga qendrat shëndetësore ndihmon në evidentimin e shpërndarjes së sëmundjeve infektive dhe kronike, nivelin e mbulimit të vaksinimit, si dhe në monitorimin e treguesve të rëndësishëm si lindjet, kujdesi për nënën dhe fëmijën dhe kontrolli mjekësor bazë.
Konkluzione: Përdorimi i evidencave të sakta dhe të përditësuara përbën një element kyç në zhvillimin e politikave dhe strategjive efektive të shëndetit publik. Kujdesi shëndetësor i bazuar në evidencë ndihmon në rritjen e efikasitetit të sistemit shëndetësor, në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në orientimin e burimeve drejt nevojave reale të popullatës.

Fjalë kyçe: *Monitorimi shëndetësor, planifikim i bazuar në evidencë , shërbime parësore.*

IMPROVING PATIENT CARE THROUGH EVIDENCE-BASED PRACTICE: STRATEGIES AND IMPACT IN MODERN HEALTHCARE

Nada Tërpo[1]
[1] Primary Health Care
Local Health Unit Korçë
E-mail: nadaterpo@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Evidence-based healthcare constitutes an essential component in improving the quality of health services and in guiding decision-making in the health system. The systematic use of data and evidence collected by health institutions enables the assessment of the population's health status and the identification of the main public health issues. Institutions involved in the processing and analysis of health evidence play an important role in collecting and interpreting data related to morbidity, infectious diseases, vaccination, births, and home healthcare.
Aim: The aim of this topic is to analyze the importance of using health evidence in planning and improving primary healthcare services. It also aims to highlight the role of processing data coming from health centers in monitoring the key health indicators of the population and in identifying the real needs of the community.
Methodology: The study is based on the analysis of secondary data reported by health centers and processed in the relevant institution. The data include various health indicators such as morbidity, reporting of infectious diseases, vaccination programs, number of births, home healthcare, basic medical check-ups, maternal and child clinic services, as well as evidence on non-communicable chronic diseases and the number of inhabitants.
Results: The analysis of health evidence enables the identification of epidemiological trends and the assessment of the population's health status. The processing of data collected from health centers helps to highlight the distribution of infectious and chronic diseases, the level of vaccination coverage, as well as in monitoring important indicators such as births, maternal and childcare, and basic medical check-ups.
Conclusions: The use of accurate and up-to-date evidence constitutes a key element in the development of effective public health policies and strategies. Evidence-based healthcare contributes to increasing the efficiency of the health system, improving the quality of services, and directing resources toward the real needs of the population.

Keywords: *Health monitoring, evidence-based planning, primary healthcare services.*

MBËSHTETJA E VENDIMMARRJES ME INTELIGJENCË ARTIFICIALE NË URGJENCAT PARASPITALORE: QASJE E BAZUAR NË EVIDENCË NDËRKOMBËTARE

Rustem Halili[1] Skënder Brataj [2] Indrit Jaupaj [2], Klejdi Cankja[2]

[1]Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM), Tiranë, Shqipëri
[2]Shoqata Shqiptare e Urgjencës Mjekësore dhe Katastrofave (SHSHUMK-AAEMD), Shqipëri
E-mail: rustemhalili29@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Urgjencat paraspitalore janë ndër mjediset më sfiduese në kujdesin shëndetësor, ku vendimet duhet të merren shpejt dhe shpesh me informacion të kufizuar. Në këtë realitet, inteligjenca artificiale (AI) po shfaqet gjithnjë e më shumë si një mbështetje praktike për profesionistët, duke ndihmuar në analizimin e të dhënave në kohë reale dhe në identifikimin më të saktë të rasteve kritike.

Qëllimi: Ky studim synon të paraqesë dhe të analizojë rolin e sistemeve të bazuara në AI në mbështetjen e vendimmarrjes në urgjencat paraspitalore, me fokus në përmirësimin e triazhimit, reduktimin e gabimeve dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin e rasteve.

Metodologjia: U realizua një rishikim narrativ i literaturës ndërkombëtare të viteve 2020-2024, duke përfshirë studime mbi përdorimin e algoritmeve të machine learning dhe sistemeve të mbështetjes klinike në EMS. Analiza u përqendrua në mënyrën se si këto teknologji ndikojnë në kategorizimin e rasteve, vendimmarrjen klinike dhe organizimin e kujdesit emergjent.

Rezultatet: Gjetjet nga literatura tregojnë se sistemet e bazuara në AI mund të arrijnë nivele të larta saktësie në identifikimin e urgjencave kritike dhe në përcaktimin e prioritetit të rasteve. Përdorimi i tyre shoqërohet me më pak gabime klinike dhe me vendimmarrje më të qëndrueshme, veçanërisht në situata komplekse dhe me presion kohor. Gjithashtu, këto sisteme ndihmojnë në standardizimin e procesit të triazhimit dhe në përmirësimin e organizimit të punës në ekip.

Konkluzione: Mbështetja e vendimmarrjes me inteligjencë artificiale po hap një drejtim të ri në urgjencat paraspitalore. Potenciali për të përmirësuar cilësinë e kujdesit dhe sigurinë e pacientit është i dukshëm, megjithatë mbetet e nevojshme që këto teknologji të vlerësohen më tej në praktikë, duke marrë parasysh edhe aspektet etike dhe besueshmërinë e tyre.

Fjalë kyçe: *Inteligjencë artificiale, vendimmarrje klinike, urgjenca paraspitalor, EMS, triazhim, machine learning.*

ARTIFICIAL INTELLIGENCE–SUPPORTED DECISION-MAKING IN PREHOSPITAL EMERGENCIES: AN EVIDENCE-BASED INTERNATIONAL APPROACH

Rustem Halili[1], Skënder Brataj[2], Indrit Jaupaj[2], Klejdi Cankja[2]
[1] National Medical Emergency Center (QKUM), Tirana, Albania
[2] Albanian Association of Medical Emergency and Disasters (SHSHUMK-AAEMD), Albania
E-mail: rustemhalili29@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Prehospital emergencies are among the most challenging environments in healthcare, where decisions must be made rapidly and often with limited information. In this context, artificial intelligence (AI) is increasingly emerging as a practical support tool for professionals, helping analyze real-time data and more accurately identify critical cases.
Aim: This study aims to present and analyze the role of AI-based systems in supporting decision-making in prehospital emergencies, with a focus on improving triage, reducing errors, and increasing efficiency in case management.
Methodology: A narrative review of international literature from 2020–2024 was conducted, including studies on the use of machine learning algorithms and clinical decision support systems in Emergency Medical Services (EMS). The analysis focused on how these technologies influence case categorization, clinical decision-making, and the organization of emergency care.
Results: Findings from the literature indicate that AI-based systems can achieve high levels of accuracy in identifying critical emergencies and determining case priority. Their use is associated with fewer clinical errors and more consistent decision-making, especially in complex and time-pressured situations. Additionally, these systems contribute to the standardization of the triage process and improve teamwork organization.
Conclusions: AI-supported decision-making is opening a new direction in prehospital emergency care. The potential to improve quality of care and patient safety is evident; however, further evaluation in practice is necessary, taking into account ethical considerations and system reliability.

Keywords: *Artificial intelligence, clinical decision-making, prehospital emergency, EMS, triage, machine learning.*

SIMULIMI KLINIK SI MJET EDUKIMI DHE VLERËSIMI PROFESIONAL NË TRAJNIMET E URGJENCËS (ATLS DHE MIDWIFERY EMERGENCIES)

Eralda Doci Kraja[1]

[1] Klinika "Mamushe"
E-mail: eraldakraja@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Simulimi klinik është një metodë inovative në edukimin shëndetësor që mundëson zhvillimin e aftësive praktike dhe vendimmarrjes klinike në një mjedis të sigurt. Ai përdoret gjerësisht në programe si ATLS dhe trajnimet për emergjencat obstetrike për profesionistët shëndetësorë, duke reduktuar rrezikun për pacientët dhe duke rritur cilësinë e trajnimit përmes praktikës së përsëritur.
Objektivat: Të vlerësohet roli i simulimit klinik si mjet edukimi dhe vlerësimi profesional në përmirësimin e kompetencave në situata emergjente.
Metodologjia: Ky punim është një rishikim i literaturës bazuar në artikuj të indeksuar në PubMed dhe PMC gjatë 5–10 viteve të fundit. U analizuan studime që lidhen me simulimin në ATLS dhe në edukimin e midwives, duke u fokusuar në ndikimin në njohuri, aftësi dhe performancë klinike, si dhe në zhvillimin e aftësive jo-teknike si komunikimi dhe puna në ekip.
Rezultatet: Gjetjet tregojnë se simulimi klinik përmirëson ndjeshëm njohuritë teorike, aftësitë praktike dhe vetëbesimin e profesionistëve. Në trajnimet ATLS, simulimi ndihmon në përmirësimin e vendimmarrjes në trauma, ndërsa në edukimin e midwives kontribuon në menaxhimin më efektiv të emergjencave obstetrike. Gjithashtu, simulimi rezulton i vlefshëm si mjet vlerësimi për kompetencat klinike dhe jo-teknike, duke mundësuar feedback të strukturuar dhe identifikimin e boshllëqeve në njohuri.
Konkluzionet: Simulimi klinik është një komponent thelbësor në edukimin modern shëndetësor, duke kontribuar në përgatitjen më të mirë të profesionistëve për situata reale klinike. Integrimi i tij në programet trajnuese dhe vlerësuese rekomandohet për të rritur cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe sigurinë e pacientit.

Fjalë kyçe: *simulim klinik, ATLS, emergjenca obstetrike, edukim profesional, vlerësim klinik.*

CLINICAL SIMULATION AS A TOOL FOR EDUCATION AND PROFESSIONAL ASSESSMENT IN EMERGENCY TRAINING (ATLS AND MIDWIFERY EMERGENCIES)

Eralda Doci Kraja[1]
[1] "Mamushe" clinic
E-mail: eraldakraja@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Clinical simulation is an innovative method in healthcare education that enables the development of practical skills and clinical decision-making in a safe environment. It is widely used in programs such as ATLS and obstetric emergency training for healthcare professionals.
Objectives: To evaluate the role of clinical simulation as an educational and professional assessment tool in improving competencies in emergency situations.
Methodology: This study is a literature review based on articles indexed in PubMed and PMC over the last 5–10 years. Studies related to simulation in ATLS and midwifery education were analyzed, focusing on their impact on knowledge, skills, and clinical performance.
Results: Findings indicate that clinical simulation significantly improves theoretical knowledge, practical skills, and professional confidence. In ATLS training, simulation enhances trauma decision-making, while in midwifery education it improves the management of obstetric emergencies. Additionally, simulation proves to be an effective tool for assessing both technical and non-technical competencies.
Conclusions: Clinical simulation is an essential component of modern healthcare education, contributing to better preparation of professionals for real-life clinical situations. Its integration into training and assessment programs is recommended to improve the quality of healthcare delivery.

Keywords: *Clinical simulation, ATLS, obstetric emergencies, professional education, clinical assessment.*

NJOHJA E SIMPTOMËS DYADIKE DHE VETËKUJDESI TEK TË MOSHUARIT ME GJENDJE TË SHUMËFISHTA KRONIKE DHE KUJDESTARËT E TYRE JOFORMALË QË JETOJNË NË NJË VEND ME TË ARDHURA TË ULËTA DHE TË MESME

Fabiola Mane[1], Giulia Andrea Baldan[1], Dasilva Taci[1], Edona Gara[1], Alta Arapi[2], Sajmira Aderaj[3] Gennaro Rocco[4], Maddalena De Maria[5]

[1] Departamenti i Biomjekësisë dhe Parandalimit, Universiteti i Romës Tor Vergata, Romë, Itali;
[2] Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri.
[3] Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Kolegji AAB, Prishtina, Kosovë;
[4] Qendra Ndërkombëtare për Kërkime Infermierore Montianum Universiteti Katolik i Zojës së Këshillit të Mirë Tiranë (AL) - Qendra e Ekselencës për Kulturën dhe Kërkimin Infermieror, Urdhri i Profesioneve të Infermierisë të Romës, Itali;
[5] Profesor i Asociuar, Departamenti i Shkencave të Jetës, Shëndetit dhe Profesioneve të Shëndetit, Universiteti Link Campus, Romë, Itali;
E-mail: fabiola.mane@students.uniroma2.eu

ABSTRAKT

Hyrje: Sëmundjet e shumëfishta kronike (MCC) përbëjnë një sfidë të rëndësishme për sistemet shëndetësore, veçanërisht në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme (LMIC). Tek të moshuarit, kujdestarët joformalë janë jetikë për vetëkujdesin efektiv të pacientit. Njohja diadike e simptomave është e rëndësishme në ndërhyrjet e hershme, përmirësimin e rezultateve klinike, rrit sjelljet e vetëkujdesit, por hulumtimi mbetet i kufizuar brenda këtyre konteksteve.
Objektivat: Të vlerësohet shkalla e përputhshmërisë diadike në njohjen e simptomave midis të moshuarve me MCC dhe kujdestarëve të tyre që jetojnë në Shqipëri, një LMIC.
Metodologjia: Ky studim transversal multicentrik, analizoi 420 diade pacient-kujdestar të rekrutuar midis viteve 2023 dhe 2024 në mjedise ambulatore dhe komunitare në Shqipëri. Pacientët ishin ≥65 vjeç me të paktën dy sëmundje kronike, ndërsa u përjashtuan ata me kancer ose demencë. Njohja e simptomave u vlerësua përmes versionit shqiptar të Self-Care of Chronic Illness Inventory dhe versionit për kujdestarë. Përgjigjet u ndanë në "njohje të ngadaltë" (pikët 0-2) dhe "njohje të shpejtë" (3-5). Konkordanca u përcaktua kur të dy anëtarët e diadës ishin në të njëjtën kategori., ndërsa mospërputhja ndodhi kur ato ndryshonin.
Rezultatet: Pacientët (mosha mesatare 74 vjeç; SD = 6,24), kryesisht të diagnostikuar me diabet (75%) dhe hipertension (23.3%), dhe kujdestarët (mosha mesatare 48 vjeç; SD = 15,61), kryesisht femra (68.1%) dhe kryesisht vajza ose bashkëshorte, raportuan 50.5% diskordancë diadike në njohjen e simptomave. Kjo shkallë mospajtimi është më e lartë krahasuar me vendet me të ardhura

të larta, duke sugjeruar mungesë sinkronizimi dhe komunikimi në menaxhimin e sëmundjes.
Përfundime: Një hendek kritik komunikimi brenda kontekstit LMIC u shfaq në dyshet pacient-kujdestar të MCC-ve. Ndërhyrjet infermierore duhet të kalojnë nga edukimi i përqendruar te pacienti në atë të përqendruar te diadat, duke synuar edukimin e përbashkët dhe sinkronizimin e njohjes së simptomave. Kjo qasje mund të përmirësojë vetëkujdesin dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike multiple.

Fjalë kyçe: *diade, kujdestarë informalë, LMIC, gjendje të shumëfishta kronike, kujdes për veten, njohje e simptomave*.

DYADIC SYMPTOM RECOGNITION AND SELF-CARE IN OLDER ADULTS WITH MULTIPLE CHRONIC CONDITIONS AND THEIR INFORMAL CAREGIVERS LIVING IN A LOW- AND MIDDLE-INCOME COUNTRY

Fabiola Mane[1], Giulia Andrea Baldan[1], Dasilva Taci[1], Edona Gara[1], Alta ArapI[2], Sajmira Aderaj[3], Gennaro Rocco[4], Maddalena De Maria[5]

[1] Department of Biomedicine and Prevention, University of Rome Tor Vergata, Rome, Italy;
[2] Order of Nurses of Albania, Tirana, Albania.
[3] Faculty of Medical Sciences, AAB College, Prishtina, Kosovo;
[4] International Center for Nursing Research Montianum Catholic University of Our Lady of Good Counsel
Tirana (AL) - Center of Excellence for Nursing Culture and Research, Order of Nursing Professions of Rome, Italy;
[5] Associate Professor, Department of Life Sciences, Health and Health Professions, Link Campus University, Rome, Italy;
E-mail: fabiola.mane@students.uniroma2.eu

ABSTRACT

Background: Multiple chronic conditions (MCCs) pose a significant challenge in Low- and Middle-Income Countries (LMICs), especially among the elderly where informal caregivers are vital to effective patient self-care. Although dyadic symptom recognition enhances self-care behaviors, research remains limited within these contexts.

Aim: To evaluate the degree of dyadic concordance in symptom recognition among older adults with MCCs and their caregivers living in Albania, a LMIC.

Methods: This multicenter cross-sectional study analyzed 420 patient-caregiver dyads recruited between 2023 and 2024 in outpatient and community settings in Albania. Patients aged ≥65 years with at least two chronic conditions were enrolled, excluding those with cancer or dementia. Caregivers were included if identified by patients as the primary unpaid informal caregiver and excluded if <18 years old. Dyadic symptom recognition speed was assessed using the Albanian versions of the Self-Care of Chronic Illness Inventory and its caregiver version. Responses were dichotomized into "slow recognition" (scores 0–2) and "fast recognition" (3–5). Dyadic concordance was defined as both members falling into the same category, while discordance occurred when they differed.

Results: Patients (mean age 74; SD= 6,24), mostly diagnosed with diabetes (75%) and hypertension (23.3%), and caregivers (mean age 48; SD= 15,61), mostly female (68.1%) and primarily daughters or spouses, reported 50.5% dyadic discordance in symptom recognition. This disagreement rate is higher than in similar high-income cohorts, suggesting poor dyadic synchronization and a lack of shared understanding in recognizing clinical changes.

Conclusions: A critical communication gap within the LMIC context emerged in MCCs patient-

caregiver dyads. Nursing interventions should transition from patient-centered to day-centered education, focusing on synchronizing symptom monitoring to improve the management of MCCs.

Keywords: *Dyad, informal caregivers, LMIC, chronic conditions, self-care, symptom recognition.*

RREZIKU BIOLOGJIK GJATË PRAKTIKËS LABORATORIKE TE STUDENTËT E DEGËS TEKNIK LABORATORI

Nairda Mataj [1], Venemin Gega [2]

[1] Poliklinika e Specialiteteve Nr. 2, Tiranë
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
E-mail: nairdamata30@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Rreziku biologjik përfaqëson një nga sfidat kryesore me të cilat përballen studentët gjatë praktikës në laboratorët klinikë dhe institucionet shëndetësore. Ekspozimi ndaj lëngjeve biologjike, shpimi aksidental me age, mosrespektimi i protokolleve të biosigurisë dhe përdorimi jo i rregullt i mjeteve mbrojtëse personale përbëjnë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë profesionale.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte nivelin e praktikave të biosigurisë, përdorimin e mjeteve mbrojtëse dhe incidencën e ngjarjeve aksidentale gjatë praktikës profesionale tek studentët e programit Teknik Laboratori.

Metodologjia: U realizua një studim përshkrues i tipit transversal (cross-sectional), ku u përfshinë 103 studente të programit Teknik Laboratori. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori online të standardizuar. Analiza statistikore u krye me metoda përshkruese, duke përpunuar variabla që lidhen me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, informimin mbi protokollet e biosigurisë, ekspozimet aksidentale dhe perceptimin e rrezikut biologjik.

Rezultatet: Shumica e pjesëmarrësve ishin femra (86.4%), ndërsa mosha mesatare e gjithë grupit të pjesëmarrësve (N = 103) ishte 20.2 vjeç. Të gjithë pjesëmarrësit raportuan përdorimin e përparëses gjatë praktikës, ndërsa 83.5% përdorën doreza rregullisht. Incidentet më të shpeshta të raportuara përfshinin derdhjen aksidentale të lëngjeve biologjike, shpimin me age, gërvishtjet dhe thyerjen e epruvetave. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve, studentët nuk zotëronin informacion të plotë mbi procedurat e menaxhimit të incidenteve dhe raportimit zyrtar.

Konkluzionet: Studentët tregojnë njohuri të përgjithshme të mira mbi rëndësinë e mjeteve mbrojtëse, por evidentohet mungesë në formimin praktik dhe në zbatimin e standardizuar të protokolleve të biosigurisë gjatë praktikës profesionale. Ngjarjet e raportuara theksojnë nevojën për rritjen e trajnimit, mbikëqyrjes dhe edukimit të vazhdueshëm mbi rreziqet biologjike. Rekomandohet forcimi i moduleve të biosigurisë, zbatimi rigoroz i protokolleve dhe organizimi i trajnimeve periodike për minimizimin e rrezikut të ekspozimit.

Fjalë kyçe: *Rrezik biologjik, praktikë laboratorike, teknik laboratori, studentë.*

BIOLOGICAL RISK DURING LABORATORY PRACTICE AMONG MEDICAL LABORATORY TECHNICIAN STUDENTS

Nairda Mataj [1], Venemin Gega [2]
[1] Polyclinic of Specialties No. 2, Tirana
[2]Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"
E-mail: nairdamata30@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Biological risk represents one of the main challenges faced by students during their practice in clinical laboratories and healthcare institutions. Exposure to biological fluids, accidental needlestick injuries, non-adherence to biosafety protocols, and irregular use of personal protective equipment constitute significant factors that directly influence professional safety. The aim of this study was to evaluate the level of biosafety practices, the use of protective equipment, and the incidence of accidental events during professional practice among students of the Medical Laboratory Technician program.

Methodology: A descriptive cross-sectional study was conducted, including 103 students of the Medical Laboratory Technician program. Data were collected through a standardized online questionnaire. Statistical analysis was performed using descriptive methods, processing variables related to the use of personal protective equipment, knowledge of biosafety protocols, accidental exposures, and the perception of biological risk.

Results: The majority of participants were female (86.4%), and the mean age of the entire group (N = 103) was 20.2 years. All participants reported using a laboratory coat during practice, while 83.5% regularly used gloves. The most frequently reported incidents included accidental spills of biological fluids, needlestick injuries, minor scratches, and breakage of test tubes. In a considerable number of cases, students lacked sufficient knowledge regarding incident management procedures and official reporting protocols.

Conclusions: Students demonstrated generally good theoretical knowledge regarding the importance of protective equipment; however, deficiencies were evident in practical skills and in the standardized implementation of biosafety protocols during professional practice. The reported incidents highlight the need for enhanced training, supervision, and continuous education on biological risks. Strengthening biosafety modules, rigorous adherence to protocols, and organizing periodic training sessions are recommended to minimize the risk of occupational exposure.

Keywords: *Biological risk, laboratory practice, medical laboratory technician, students.*

DEPRESIONI PAS LINDJES TE NËNAT NË RRETHIN E ELBASANIT, SHQIPËRI, 2024–2025: STUDIM TRANSVERSAL

[1]Andja Lala, Armelda Teta, Venemin Gega, Behije Gollobërda, Brikena Duka, Ilma Toci
[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
E-mail: andja.lala@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Depresioni pas lindjes (PPD) është një çrregullim i shpeshtë i shëndetit mendor të nënës, i cili mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e saj, lidhjen nënë–foshnjë, ushqyerjen me gji dhe zhvillimin e foshnjës. Në shumë mjedise, simptomat depresive pas lindjes mbeten të nënvlerësuara, pavarësisht rëndësisë së tyre klinike dhe të shëndetit publik.
Qëllimi: Të vlerësohet shpeshtësia e simptomave depresive pas lindjes dhe disa faktorë të përzgjedhur të lidhur me to te nënat në rrethin e Elbasanit gjatë viteve 2024–2025.
Metodat: U realizua një studim transversal me 53 nëna në periudhën pas lindjes, të ndjekura në shërbimet e shëndetit të nënës dhe fëmijës në rrethin e Elbasanit gjatë viteve 2024–2025. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori të strukturuar mbi karakteristikat sociodemografike, obstetrikale dhe psikosociale. Simptomat depresive u vlerësuan me Edinburgh Postnatal Depression Scale (EPDS), ku një rezultat ≥13 u konsiderua tregues i mundshëm për depresion pas lindjes. U përdorën statistika përshkruese dhe analiza bivariable.
Rezultatet: Mosha mesatare e nënave ishte 27.8 ± 5.4 vjeç. Nga 53 nënat e përfshira, 41.5% ishin primipare, 34.0% kishin lindur me prerje cezariane, 28.3% raportuan shtatzëni të paplanifikuar dhe 22.6% raportuan mbështetje të ulët sociale të perceptuar. Vlera mesatare e EPDS ishte 9.1 ± 4.8, ndërsa 10 nëna (18.9%) rezultuan pozitive për depresion të mundshëm pas lindjes. Përqindje më të larta të PPD-së së mundshme u vunë re te nënat me shtatzëni të paplanifikuar (33.3% kundrejt 13.2%), me mbështetje të ulët sociale (41.7% kundrejt 12.2%), me vështirësi në ushqyerjen me gji (30.8% kundrejt 11.5%) dhe me histori të mëparshme problemesh emocionale (45.5% kundrejt 14.3%). Këto gjetje tregojnë se nënat me vulnerabilitet psikosocial, veçanërisht ato me mbështetje të kufizuar sociale dhe me vështirësi emocionale të mëparshme, kishin më shumë gjasa të raportonin simptoma depresive pas lindjes.
Përfundime: Simptomat depresive pas lindjes ishin të shpeshta në këtë kampion nënash nga rrethi i Elbasanit. Këto gjetje mbështesin nevojën për skrining rutinë dhe mbështetje të hershme psikosociale gjatë periudhës pas lindjes, sidomos te gratë me faktorë rreziku psikosocialë dhe riprodhues.

Fjalë kyçe: *Depresioni pas lindjes, shëndeti mendor i nënës, EPDS, gratë pas lindjes, Shqipëria.*

POSTPARTUM DEPRESSION AMONG MOTHERS IN ELBASAN DISTRICT, ALBANIA, 2024–2025: A CROSS-SECTIONAL STUDY

[1]**Andja Lala, Armelda Teta, Venemin Gega, Behije Gollobërda, Brikena Duka, Ilma Toci**
[1]Faculty of Medical and Technical Sciences University of Elbasan "Aleksander Xhuvani"
E-mail: andja.lala@uniel.edu.al

ABSTRACT

Background: Postpartum depression (PPD) is a common maternal mental health disorder that can negatively affect maternal well-being, mother–infant bonding, breastfeeding, and infant development. In many settings, postpartum depressive symptoms remain underdetected despite their clinical and public health importance.
Objective: To assess the frequency of postpartum depressive symptoms and selected associated factors among mothers in Elbasan district during 2024–2025.
Methods: A cross-sectional study was conducted among 53 postpartum mothers attending maternal and child health services in Elbasan district during 2024–2025. Data were collected using a structured questionnaire on sociodemographic, obstetric, and psychosocial characteristics. Depressive symptoms were screened using the Edinburgh Postnatal Depression Scale (EPDS), with a score ≥13 indicating probable postpartum depression. Descriptive statistics and bivariate analyses were used.
Results: The mean maternal age was 27.8 ± 5.4 years. Of the 53 mothers, 41.5% were primiparous, 34.0% had cesarean delivery, 28.3% reported an unplanned pregnancy, and 22.6% reported low perceived social support. The mean EPDS score was 9.1 ± 4.8, and 10 mothers (18.9%) screened positive for probable postpartum depression. Higher proportions of probable PPD were observed among mothers with unplanned pregnancy (33.3% vs 13.2%), low social support (41.7% vs 12.2%), breastfeeding difficulties (30.8% vs 11.5%), and previous emotional problems (45.5% vs 14.3%). These findings indicate that mothers with psychosocial vulnerability, particularly limited social support and prior emotional difficulties, were more likely to report postpartum depressive symptoms.
Conclusions: Postpartum depressive symptoms were frequent in this sample of mothers from Elbasan district. These findings support the need for routine screening and early psychosocial support during the postpartum period, especially among women with psychosocial and reproductive risk factors.

Keywords: *Postpartum depression, maternal mental health, EPDS, postpartum women, Albania.*

SESION PARALEL

SESIONI II

SALLA 3

ABSTRAKTET

PARIMET LIGJORE DHE LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR PROFESIONISTËT E INFERMIERISË

Erind Thartori [1], Erikena Kasa[1], Xhulia Marina[2]

[1]Qëndra Spitalore Universitare Nënë Tëreza, Tiranë
[2]Spitali Amerikan, Tiranë
E-mail: thartorierind@hotmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Profesioni i infermierit përbën një komponent thelbësor të sistemit shëndetësor dhe ushtrimi i tij kërkon një kuadër të qartë ligjor që garanton cilësinë e kujdesit, sigurinë e pacientit dhe mbrojtjen profesionale të infermierit. Në Shqipëri profesioni i infermierit rregullohet nga një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore që përcaktojnë kompetencat, përgjegjësitë dhe standartet etike të profesionit.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë parimet ligjore dhe kuadrin legjislativ që rregullon profesionin e infermierit në Republikën e Shqipërisë, duke evidentuar rolin e tyre në praktikën profesionale, sigurinë juridike të infermierit dhe mbrojtjen e të drejtave të pacientit.

Metodologjia: Studimi bazohet në një analizë përshkruese dhe krahasuese të legjislacionit shqiptar në fuqi, përfshirë ligjet themelore të kujdesit shëndetësor, aktet rregullatore të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë si dhe dispozitat përkatëse të kodit civil dhe penal. Janë shqyrtuar gjithashtu dhe udhëzime ndërkombëtare lidhur me profesionin e infermierisë.

Rezultatet: Analiza tregon se legjislacioni shqiptar ofron një bazë të konsoliduar për ushtrimin e profesionit të infermierit duke përcaktuar qartë kriteret e licensimit, autonomine profesionale, përgjegjësinë ligjore dhe disiplinore, si dhe rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm. Gjithashtu konstatohet nevoja për forcimin e zbatimit praktik tëlegjislacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të infermierëve mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore.

Konkluzione: Njohja dhe zbatimi korrekt i kuadrit dhe parimeve ligjore janë thelbësore për rritjen e rolit të infermierit dhe mbrojtjen profesionale të tyre. Forcimi i edukimit ligjor dhe etik të infermierëve kontribuon drejtperdrejtë në sigurinë e pacientit dhe në funksionimin efektiv të sistemit shëndetësor.

Fjalë kyçe: *Infermieri, legjislacion shëndetësor, etike profesionale, siguria e pacientit.*

LEGAL PRINCIPLES AND ALBANIAN LEGISLATION FOR NURSING PROFESSIONALS

Erind Thartori [1], Erikena Kasa[1] , Xhulia Marina[2]
[1]Hospital Center Mother Teresa, Tiranë
[2]American Hospital, Tiranë
E-mail: thartorierind@hotmail.com

ABSTRACT

Introduction: The nursing profession constitutes an essential component of the health system and its exercise requires a clear legal framework that guarantees the quality of care, patient safety and professional protection of the nurse. In Albania, the nursing profession is regulated by a series of laws and by-laws that define the competencies, responsibilities and ethical standards of the profession.

Purpose: The purpose of this paper is to analyze the legal principles and legislative framework that regulate the nursing profession in the Republic of Albania, highlighting their role in professional practice, the legal security of the nurse and the protection of patient rights.

Methodology: The study is based on a descriptive and comparative analysis of the Albanian legislation in force, including the basic laws on healthcare, the regulatory acts of the Order of the Nurses of Albania, the Code of Ethics and Deontology, as well as the relevant provisions of the civil and criminal codes. International guidelines related to the nursing profession have also been reviewed.

Results: The analysis shows that the Albanian legislation provides a consolidated basis for the practice of the nursing profession by clearly defining the licensing criteria, professional autonomy, legal and disciplinary responsibility, as well as the importance of continuous education. It is also noted the need to strengthen the practical implementation of the legislation and increase the awareness of nurses on their legal rights and obligations.

Conclusions: Knowledge and correct implementation of the legal framework and principles are essential for enhancing the role of nurses and their professional protection. Strengthening the legal and ethical education of nurses directly contributes to patient safety and the effective functioning of the health system.

Keywords: *Nursing, health legislation, professional ethics, patient safety.*

LINDJA NATYRALE DHE AVANTAZHET E SAJ PËR NËNËN DHE FËMIJËN

Nina Nasafuga[1]

[1]Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni", Tiranë
E-mail: ninetanasufaga@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrja: Lindja natyrale përbën një proces fiziologjik kyç në jetën riprodhuese të gruas dhe ka implikime të rëndësishme për shëndetin e nënës dhe të fëmijës.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë avantazhet kryesore të lindjes natyrale në krahasim me lindjen cezariane, duke analizuar ndikimet klinike dhe shëndetësore për nënën dhe të porsalindurin.
Objektivat: Objektivat përfshijnë identifikimin e përfitimeve të lindjes natyrale në aspektin e rikuperimit postpartum, reduktimin e komplikacioneve maternale, përfitimet neonatalë dhe vlerësimin e ndikimit të metodës së lindjes në fillimin e ushqyerjes me gji dhe adaptimin mikrobiotik neonatal.
Metodologjia: Metodologjia e përdorur bazohet në një rishikim sistematik të literaturës shkencore të publikuar kryesisht në pesë vitet e fundit (2019–2025), duke analizuar studime origjinale, meta-analiza dhe udhëzime klinike që trajtojnë rezultatet për nënën dhe fëmijën në lidhje me mënyrën e lindjes. Artikujt e përzgjedhur përfshijnë krahasime ndërmjet lindjes natyrale dhe cezarianes, si dhe studime që evidentojnë përfitimet specifike të lindjes vaginale.
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se lindja natyrale shoqërohet me kohë më të shkurtër rikuperimi për nënën, reduktim të infeksioneve postoperatore, ulje të rrezikut të trombozës dhe hemorragjisë në krahasim me lindjen cezariane. Për fëmijën, lindja natyrale lidhet me një fillim më të favorshëm të ushqyerjes me gji, adaptim respirator më të mirë dhe kolonizim mikrobiotik optimal. Studimet gjithashtu theksojnë se lindja cezariane pa indikacion mjekësor lidhet me rritje të komplikacioneve kirurgjikale dhe kohë më të gjatë rikuperimi.
Përfundime: Në përfundim kur është e sigurt dhe e dëshiruar nga gruaja, lindja natyrale ofron përfitime klinike të rëndësishme dhe duhet të promovohet si mënyra e zgjedhur e lindjes. Kjo qasje mund të përmirësojë rezultatet shëndetësore për nënën dhe foshnjën dhe të reduktojë barrën e komplikacioneve.

Fjalë kyçe: *lindje natyrale, vaginal delivery, shëndeti neonatal, rikuperim postpartum, komplikacione obstetrike.*

NATURAL CHILDBIRTH AND ITS BENEFITS FOR THE MOTHER AND THE BABY

Nina Nasafuga [1]
[1] University Obstetric-Gynecological Hospital "Koço Gliozheni", Tirana
E-mail: ninetanasufaga@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Natural childbirth represents a key physiological process in a woman's reproductive life and has important implications for the health of both the mother and the child.
Aim: The aim of this study is to examine the main advantages of natural childbirth compared to cesarean delivery, by analyzing the clinical and health outcomes for the mother and the newborn.
Objectives: The objectives include identifying the benefits of natural childbirth in terms of postpartum recovery, reduction of maternal complications, neonatal benefits, and evaluating the impact of the mode of delivery on breastfeeding initiation and neonatal microbiotic adaptation.
Methodology: The methodology is based on a systematic review of scientific literature published mainly in the last five years (2019–2025), analyzing original studies, meta-analyses, and clinical guidelines addressing maternal and neonatal outcomes in relation to the mode of delivery. The selected articles include comparisons between natural childbirth and cesarean section, as well as studies highlighting the specific benefits of vaginal delivery.
Results: The results indicate that natural childbirth is associated with shorter maternal recovery time, reduced postoperative infections, and lower risk of thrombosis and hemorrhage compared to cesarean delivery. For the newborn, natural childbirth is linked to more favorable initiation of breastfeeding, better respiratory adaptation, and optimal microbiotic colonization. Studies also emphasize that cesarean delivery without medical indication is associated with increased surgical complications and longer recovery time.
Conclusions: In conclusion, when safe and desired by the woman, natural childbirth offers significant clinical benefits and should be promoted as the preferred mode of delivery. This approach can improve health outcomes for both the mother and the newborn and reduce the burden of complications.

Keywords: *Natural childbirth, vaginal delivery, neonatal health, postpartum recovery, obstetric complications.*

INTEGRIMI I TELEMJEKËSISË NË KUJDESIN INFERMIEROR: NJË QASJE STRATEGJIKE PËR SPITALIN RAJONAL GJIROKASTËR

Mimoza Llavdaniti[1], Gligor Llavdaniti, Elisa Baçi[2], Jani Baçi[3]

[1]Departamenti i Infermierisë, Universiteti I Gjirokastrës'Eqerem Çabej" Shqipëri.
[2,3]Spitali Rajonal, "Omer Nishani", Gjirokastër
E-mail: mimoza_llavdaniti@yahoo.it

ABSTRAKT

Hyrje: Telemedicina ka njohur një zhvillim të ndjeshëm në dekadat e fundit, duke kaluar nga një mjet eksperimental në një komponent thelbësor të sistemeve moderne shëndetësore. Fillimet e saj datojnë në vitet 1960 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si një përgjigje ndaj nevojës për komunikim në distancë, veçanërisht në zonat e izoluara, me aplikime të hershme në tele-radiologji dhe tele-psikiatri. Në Evropë, telemedicina është zhvilluar më tej përmes mbështetjes nga korniza ligjore dhe mekanizma të strukturuar rimbursimi. Në Shqipëri, ajo mbetet kryesisht në fazën e projekteve pilot, e kufizuar nga mungesa e infrastrukturës teknologjike, niveli i ulët i dixhitalizimit dhe mungesa e protokolleve të standardizuara. Në këtë kontekst, Spitali Rajonal Gjirokastër përballet me sfida të lidhura me aksesin në kujdes, veçanërisht për pacientët nga zonat rurale.

Qëllimi: Ky studim synon të analizojë rolin e telemedicinës në kujdesin infermieror dhe të propozojë qasje strategjike për implementimin dhe menaxhimin e saj në trajtimin e pacientëve me sëmundje kronike në zona urbane dhe rurale.

Metodologjia: Studimi bazohet në një rishikim përshkrues të literaturës bashkëkohore, duke analizuar evidencat mbi përfitimet dhe sfidat e telemedicinës, si dhe mundësitë praktike të aplikimit të saj në kontekstin shqiptar.

Rezultatet: Gjetjet tregojnë se telemedicina përmirëson vazhdimësinë e kujdesit infermieror, rrit efikasitetin e monitorimit të pacientëve kronikë dhe redukton referimet e panevojshme drejt shërbimeve terciare. Ajo kontribuon gjithashtu në rritjen e kënaqësisë së pacientëve dhe në uljen e kostove shëndetësore. Infermierët luajnë një rol kyç në menaxhimin e kujdesit në distancë dhe në koordinimin e komunikimit ndërprofesional.

Konkluzione: Integrimi i telemedicinës në kujdesin infermieror përfaqëson një qasje inovative me potencial të lartë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, veçanërisht në zonat me akses të kufizuar, duke kontribuar në modernizimin e sistemit shëndetësor në nivel rajonal.

Fjalë kyçe: *Telemedicine, kujdes në distancë, infermieri, sëmundje kronike, Spitali Rajonal Gjirokastër.*

INTEGRATION OF TELEMEDICINE IN NURSING CARE: A STRATEGIC APPROACH FOR THE REGIONAL HOSPITAL OF GJIROKASTËR

Mimoza Llavdaniti[1], Gligor Llavdaniti, Elisa Baçi[2], Jani Baçi[3]
[1]Department of Nursing, University of Gjirokastër "Eqerem Çabej", Albania
[2,3]Regional Hospital "Omer Nishani", Gjirokastër, Albania
E-mail: mimoza_llavdaniti@yahoo.it

ABSTRACT

Introduction: Telemedicine has experienced significant development in recent decades, evolving from an experimental tool into a fundamental component of modern healthcare systems. Its origins date back to the 1960s in the United States, emerging as a response to the need for remote communication, particularly in isolated areas, with early applications in teleradiology and telepsychiatry. In Europe, telemedicine has further advanced through supportive legal frameworks and structured reimbursement mechanisms. In Albania, telemedicine remains largely in the pilot phase, limited by insufficient technological infrastructure, low levels of digitalization, and the absence of standardized protocols. In this context, the Regional Hospital of Gjirokastër faces challenges related to healthcare access, especially for patients living in rural areas.

Aim: This study aims to analyze the role of telemedicine in nursing care and to propose strategic approaches for its implementation and management in the treatment of patients with chronic diseases in both urban and rural settings.

Methodology: The study is based on a descriptive review of contemporary literature, analyzing evidence on the benefits and challenges of telemedicine, as well as practical opportunities for its implementation in the Albanian context.

Results: Findings indicate that telemedicine improves continuity of nursing care, enhances the efficiency of monitoring patients with chronic conditions, and reduces unnecessary referrals to tertiary healthcare centers. It also contributes to increased patient satisfaction and reduced healthcare costs. Nurses play a key role in managing remote care and coordinating communication between patients and the multidisciplinary healthcare team.

Conclusions: The integration of telemedicine into nursing care represents an innovative approach with high potential to improve the quality of healthcare services, particularly in areas with limited access, contributing to the modernization of the healthcare system at the regional level.

Keywords: *Telemedicine; remote care; nursing; chronic diseases; Regional Hospital of Gjirokastër.*

DIGJITALIZIMI I MONITORIMIT HEMODINAMIK NË REANIMACION: APLIKIMI I TEKNOLOGJISË MOST-CARE (PRAM) NË PRAKTIKËN KLINIKE.

Eugen Ismolli[1]

[1]Reparti i Terapisë Intensive, Spitali Amerikan 3
E-mail: eugenismolli9@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Digjitalizimi i kujdesit intensiv ka transformuar mënyrën e monitorimit dhe trajtimit të pacientëve në gjendje kritike. Sistemi Most-Care, i bazuar në metodën PRAM (Pressure Recording Analytical Method), mundëson analizë në kohë reale të parametrave hemodinamikë përmes valës arteriale pa pasur nevojë për kalibrim të jashtëm.
Qëllimi: Të vlerësohet përdorimi klinik dhe ndikimi i monitorimit me Most-Care në optimizimin e menaxhimit hemodinamik të pacientët në terapi intensive.
Materialet dhe Metodat: Në studim u përfshinë 32 pacientë të shtruar në repartin e reanimacionit me diagnoza të ndryshme, dhe kryesisht: sepsis, insuficiencë respiratore, gjendje shoku, insuficiencë kardiake, si edhe pacientë postkirurgjie madhore. Monitorimi u realizua përmes linjës arteriale, duke regjistruar në mënyrë të vazhdueshme parametrat hemodinamikë si: Cardiac Output (CO), Cardiac Index (CI), Stroke Volume (SV), Stroke Volume Variation (SVV), Systemic Vascular Resistance (SVR) dhe Mean Arterial Pressure (MAP). Të dhënat u përdorën për të udhëhequr terapinë me lëngje dhe përdorimin e vazopresorëve sipas parimeve të Goal-Directed Fluid Therapy.
Rezultatet: Përdorimi i Most-Care mundësoi identifikimin e hershëm të instabilitetit hemodinamik në 75% të rasteve. Në 68% të pacientëve, vendimmarrja terapeutike u modifikua bazuar në parametra dinamikë si SVV dhe CI. U vu re përmirësim i stabilitetit hemodinamik (MAP > 65 mmHg) brenda 6 orëve në shumicën e pacientëve.
Konkluzione: Most-Care përfaqëson një mjet inovativ për monitorim hemodinamik minimalisht invaziv dhe në kohë reale, duke ndihmuar në vendimmarrje më të saktë klinike dhe në përmirësimin e menaxhimit të pacientëve kritikë.

Fjalë kyçe: *Monitorim Hemodinamik, Most-Care, PRA, Kujdes Intensiv, Dixhitalizim, Goal Directed Fluid Therapy, Cardiac output.*

DIGITALIZATION OF HEMODYNAMIC MONITORING IN INTENSIVE CARE: APPLICATION OF MOST-CARE (PRAM) TECHNOLOGY IN CLINICAL PRACTICE

Eugen Ismolli[1]
[1]Intensive Care Unit, American Hospital 3
E-mail: eugenismolli9@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: The digitalization of intensive care has transformed the way critically ill patients are monitored and managed. The Most-Care system, based on the Pressure Recording Analytical Method (PRAM), enables real-time analysis of hemodynamic parameters through the arterial waveform without the need for external calibration.
Objective: To evaluate the clinical use and impact of Most-Care monitoring in optimizing hemodynamic management in intensive care patients.
Materials and Methods: The study included 32 patients admitted to the intensive care unit with various diagnoses, primarily sepsis, respiratory failure, shock states, heart failure, and post-major surgery conditions. Monitoring was performed via an arterial line, continuously recording hemodynamic parameters such as Cardiac Output (CO), Cardiac Index (CI), Stroke Volume (SV), Stroke Volume Variation (SVV), Systemic Vascular Resistance (SVR), and Mean Arterial Pressure (MAP). The collected data was used to guide fluid therapy and vasopressor administration according to Goal-Directed Fluid Therapy principles.
Results: The use of Most-Care enabled early identification of hemodynamic instability in 75% of cases. In 68% of patients, therapeutic decision-making was modified based on dynamic parameters such as SVV and CI. Improvement in hemodynamic stability (MAP >65 mmHg) was observed within 6 hours in the majority of patients.
Conclusions: Most-Care represents an innovative, minimally invasive tool for real-time hemodynamic monitoring, supporting more accurate clinical decision-making and improving the management of critically ill patients.

Keywords: *Hemodynamic monitoring, Most-Care, PRAM, intensive care, digitalization, goal-directed fluid therapy, cardiac output.*

ROLI I TEKNOLOGJISË NË MONITORIMIN E PARAMETRAVE VITALË NË NICU: PARASHIKIMI I KOMPLIKACIONEVE TEK TË PORSALINDURIT

Joniada (Kalthi) Sefa[1]

[1]Reanimacioni Neonatal, Pavioni i Obstetrikë-Gjinekologjisë, Spitali Amerikan
E-mail: joniada.sefa@spitaliamerikan.com

ABSTRAKT

Hyrja: Të porsalindurit, veçanërisht prematurët, janë të ekspozuar ndaj rrezikut të lartë për zhvillimin e komplikacioneve si sepsisi neonatal, apnea dhe çrregullimet respiratore. Monitorimi i vazhdueshëm i parametrave vitalë përbën një element kyç në kujdesin intensiv neonatal, duke mundësuar identifikimin e hershëm të ndryshimeve klinike.
Objektivat: Të vlerësohet roli i monitorimit të parametrave vitalë në parashikimin e hershëm të komplikacioneve tek të porsalindurit në njësinë e kujdesit intensiv neonatal (NICU).
Metodologjia: Ky është një studim përshkrues i bazuar në analizën e praktikës klinike dhe literaturës bashkëkohore mbi monitorimin e parametrave vitalë në neonatologji. Janë shqyrtuar ndryshimet në frekuencën kardiake, respiratore, saturimin e oksigjenit dhe temperaturën, si indikatorë të mundshëm të përkeqësimit klinik.
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se ndryshimet në parametrat vitalë shpesh paraprijnë manifestimin klinik të komplikacioneve. Përdorimi i teknologjive moderne të monitorimit dhe algoritmeve inteligjente rrit ndjeshmërinë në zbulimin e hershëm të sepsisit, episodeve apneike dhe destabilizimit hemodinamik, duke mundësuar ndërhyrje më të shpejta dhe efektive.
Konkluzionet: Monitorimi i vazhdueshëm dhe interpretimi i saktë i parametrave vitalë janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve klinike në neonatologji. Integrimi i teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së cilësisë së kujdesit neonatal.

Fjalë Kyçe: *Neonatologji, parametra vitalë, NICU, komplikacione, monitorim.*

THE ROLE OF TECHNOLOGY IN MONITORING VITAL PARAMETERS IN THE NICU: PREDICTION OF COMPLICATIONS IN NEWBORNS

Joniada (Kalthi) Sefa[1]
Neonatal Resuscitation, Obstetrics-Gynecology Department, American Hospital, Albania
E-mail: joniada.sefa@spitaliamerikan.com

ABSTRACT

Introduction: Newborns, especially preterm infants, are at high risk of developing complications such as neonatal sepsis, apnea, and respiratory disorders. Continuous monitoring of vital parameters represents a key element in neonatal intensive care, enabling early identification of clinical changes.
Objectives: To evaluate the role of monitoring vital parameters in the early prediction of complications in newborns in the Neonatal Intensive Care Unit (NICU).
Methodology: This is a descriptive study based on the analysis of clinical practice and contemporary literature on monitoring vital parameters in neonatology. Changes in heart rate, respiratory rate, oxygen saturation, and temperature were examined as potential indicators of clinical deterioration.
Results: The findings show that changes in vital parameters often precede the clinical manifestation of complications. The use of modern monitoring technologies and intelligent algorithms increases sensitivity in the early detection of sepsis, apneic episodes, and hemodynamic instability, enabling faster and more effective interventions.
Conclusions: Continuous monitoring and accurate interpretation of vital parameters are essential for improving clinical outcomes in neonatology. The integration of digital technologies and artificial intelligence represents an important step toward enhancing the quality of neonatal care.

Keywords: *Neonatology, vital parameters, NICU, complications, monitoring.*

VLERËSIMI I RASTEVE TË HOSPITALIZUARA PËR INTOKSIKIM NGA SUBSTANCAT NARKOTIKE NË SHËRBIMIN E TOKSIKOLOGJISË GJATË PERIUDHËS 2020–2024 DHE IMPAKTI I TYRE NË PACIENTË DHE SISTEMIN SHËNDETËSOR

Elisabeta Çaushi[1]; Armir Çaushi[2]

[1] Qendra e Konsultave Ambulatore - QSUNT
[2] Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme - QSUNT
E-mail: Elisabeta.Caushi@qsut.gov.al

ABSTRAKT

Hyrje: Përdorimi i substancave narkotike përbën një sfidë në rritje për shëndetin publik dhe sistemin shëndetësor. Rritja e rasteve të intoksikimit ka ndikuar drejtpërdrejt në ngarkesën e shërbimeve të specializuara, veçanërisht në Toksikologji, duke kërkuar analiza të mirëfillta mbi profilin klinik dhe demografik të pacientëve të prekur.
Qëllimi: Të vlerësohen rastet e hospitalizuara për intoksikim nga substancat narkotike gjatë periudhës 2020–2024 dhe të identifikohen faktorët kryesorë demografikë dhe klinikë të lidhur me këto raste.
Metodologjia: Studim retrospektiv mbi të dhënat klinike të pacientëve të hospitalizuar në Shërbimin e Toksikologjisë. U analizuan variabla si lloji i substancës, pasojat klinike, kohëzgjatja e qëndrimit spitalor dhe nevoja për trajtim intensiv. Analiza statistikore u përdor për identifikimin e trendeve dhe krahasimin ndërmjet grupeve.
Rezultatet: U përfshinë 1032 pacientë. Substancat më të shpeshta ishin: kokaina (32%), abstinenca multisubstancore (28%) dhe opioidet (24%). Shpërndarja gjeografike dominohej nga zonat urbane, me Tiranën (53%) dhe Durrësin (12%). Meshkujt përbënin 94% të rasteve, ndërsa grupmosha 16–45 vjeç përfaqësonte 91% të totalit. U vu re rritje e përdorimit multisubstancor dhe rasteve që kërkojnë trajtim më kompleks.
Konkluzione: Intoksikimet nga substancat narkotike janë në rritje, veçanërisht tek të rinjtë dhe në zonat urbane. Rritja e përdorimit të kokainës dhe opioideve, si dhe fenomeni i përdorimit multisubstancor, paraqesin sfida të rëndësishme për menaxhimin klinik dhe sistemin shëndetësor.

Fjalë kyçe: *Intoksikim akut, Substanca narkotike, Abstinencë, Trajtim intensiv, Profil demografik, Ngarkesa spitalore.*

ASSESSMENT OF HOSPITALIZED CASES OF NARCOTIC SUBSTANCE INTOXICATION IN THE TOXICOLOGY SERVICE DURING 2020–2024 AND THEIR IMPACT ON PATIENTS AND THE HEALTHCARE SYSTEM

Elisabeta Çaushi[1]; Armir Çaushi[2]
[1] Outpatient Consultation Center, QSUNT
[2] Internal Medicine Emergency Department, QSUNT
E-mail: Elisabeta.Caushi@qsut.gov.al

ABSTRACT

Introduction: The use of narcotic substances represents a growing challenge for public health and healthcare systems. The increasing number of intoxication cases has directly impacted the workload of specialized services, particularly Toxicology, highlighting the need for in-depth analysis of the clinical and demographic profiles of affected patients.
Aim: To evaluate hospitalized cases of narcotic substance intoxication during the period 2020–2024 and to identify the main demographic and clinical factors associated with these cases.
Methodology: A retrospective study was conducted based on clinical data of patients hospitalized in the Toxicology Service. Variables analyzed included type of substance, clinical outcomes, length of hospital stay, and need for intensive care. Statistical analysis was used to identify trends and perform group comparisons.
Results: A total of 1,032 patients were included. The most involved substances were cocaine (32%), polysubstance withdrawal (28%), and opioids (24%). Geographic distribution was predominantly urban, with Tirana accounting for 53% and Durrës for 12% of cases. Males represented 94% of patients, while the age group 16–45 years comprised 91% of the total. An increase in polysubstance use and cases requiring more complex management was observed.
Conclusions: Narcotic substance intoxications are increasing, particularly among young individuals and in urban areas. The rise in cocaine and opioid use, as well as poly substance use, poses significant challenges for clinical management and the healthcare system.

Keywords: *Acute intoxication, narcotic substances, withdrawal, intensive care, demographic profile, hospital burden.*

TRANSPORTI NEONATAL DHE RËNDËSIA E STABILIZIMIT NË URGJENCË

Alda Elezi [1]

[1] Materniteti i Qytetit të Korçës, Shqipëri
E-mail: Aldaelezi81@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Transporti neonatal përbën një komponent thelbësor të sistemit të kujdesit shëndetësor për të porsalindurit që kërkojnë trajtim të specializuar në qendra terciare. Stabilizimi para transportit është faktor kyç për uljen e komplikacioneve dhe përmirësimin e rezultateve klinike.

Objektivat: Të vlerësohet rëndësia e stabilizimit paraprak të neonatit dhe roli i ekipit multidisiplinar në ruajtjen e parametrave jetësorë optimalë gjatë transportit.

Metodologjia: Punim përshkrues i bazuar në literaturë profesionale dhe protokolle klinike mbi transportin neonatal, duke analizuar komponentët e sistemit, indikacionet e transportit, pajisjet bazë dhe masat stabilizuese sipas qasjes ABCDE.

Rezultatet: Tregojnë se stabilizimi adekuat i rrugëve ajrore, frymëmarrjes, qarkullimit, temperaturës dhe ekuilibrit metabolik para nisjes ul ndjeshëm komplikacionet gjatë transferimit. Përdorimi i inkubatorëve transportues, monitorimit të vazhdueshëm dhe ndërhyrjeve terapeutike të standardizuara rrit sigurinë dhe mbijetesën neonatale. Indikacionet më të shpeshta për transport janë distresi respirator, prematuriteti ekstrem, sepsisi neonatal dhe anomalitë kongjenitale.

Konkluzionet: Suksesi i transportit neonatal lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e stabilizimit paraprak dhe koordinimin efektiv ndërmjet njësisë dërguese, ekipit të transportit dhe qendrës pritëse. Stabilizimi mbetet faktori më kritik përcaktues i rezultatit klinik. Kur është e mundur, transporti intrauterin mbetet alternativa më e sigurt.

Fjalë kyçe: *Transport neonatal, stabilizim, urgjencë, prematuritet, monitorim.*

NEONATAL TRANSPORT AND THE IMPORTANCE OF STABILIZATION IN EMERGENCY CARE

Alda Elezi[1]
[1] Korca Maternity Hospital, Albania
E-mail: Aldaelezi81@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Neonatal transport is an essential component of healthcare systems for newborns requiring specialized care in tertiary centers. Pre-transport stabilization is a key factor in reducing complications and improving clinical outcomes.

Objectives: To evaluate the importance of pre-transport stabilization of the neonate and the role of the multidisciplinary team in maintaining optimal vital parameters during transport.

Methodology: This is a descriptive study based on professional literature and clinical protocols on neonatal transport, analyzing system components, transport indications, essential equipment, and stabilization measures according to the ABCDE approach.

Results: Findings indicate that adequate stabilization of the airway, breathing, circulation, temperature, and metabolic balance prior to transport significantly reduces complications during transfer. The use of transport incubators, continuous monitoring, and standardized therapeutic interventions increases neonatal safety and survival. The most common indications for transport include respiratory distress, extreme prematurity, neonatal sepsis, and congenital anomalies.

Conclusions: The success of neonatal transport is directly related to the quality of pre-transport stabilization and effective coordination between the referring unit, transport team, and receiving center. Stabilization remains the most critical determinant of clinical outcomes. When feasible, in utero transport remains the safest option.

Keywords: *Neonatal transport, stabilization, emergency, prematurity, monitoring.*

ROLI I INFERMIERIT DHE MAMISË NË MENAXHIMIN E URGJENCAVE OBSTETRIKALE: NJË ANALIZË E RASTEVE KLINIKE.

Luiza Lushi[1], File Bracja[2], Tatjana Milo[3]

[1] Shoqata e Diabetit në Shqipëri
[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Europian i Tiranës
[2] Organizata Brainstorm, Tiranë
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
[3] Departamenti i Gjinekologjisë, Spitali Bashkiak Tropojë
E-mail: luizalushi@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Urgjencat obstetrikale përfaqësojnë një ndër sfidat më të mëdha në kujdesin shëndetësor maternal, duke qenë shkak kryesor i morbiditetit dhe mortalitetit për nënën dhe neonatin. Menaxhimi efektiv i këtyre gjendjeve kërkon identifikim të hershëm, ndërhyrje të menjëhershme dhe koordinim të strukturuar të ekipit multidisiplinar, ku roli i infermierit dhe mamisë është thelbësor.

Qëllimi: Të vlerësohet roli i infermierit dhe mamisë në menaxhimin e urgjencave obstetrikale dhe ndikimi i ndërhyrjeve të tyre në përmirësimin e rezultateve klinike maternale dhe neonatale.

Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim narrativ të literaturës bashkëkohore dhe në analizën përshkruese-analitike të tre rasteve klinike nga praktika, përkatësisht hemorragjia postpartum, preeklampsia e rëndë dhe distocia e shpatullave. Analiza është kryer në përputhje me protokollet aktuale obstetrikale dhe praktikat infermierore.

Rezultate: Gjetjet tregojnë se ndërhyrja e hershme dhe e strukturuar infermierore ndikon drejtpërdrejt në stabilizimin e pacientes dhe në reduktimin e komplikacioneve. Në rastin e hemorragjisë postpartum, ndërhyrja e menjëhershme me terapi intravenoze, uterotonikë dhe monitorim intensiv rezultoi në kontroll efektiv të gjakderdhjes. Në rastin e preeklampsisë së rëndë, monitorimi i vazhdueshëm dhe administrimi i magnezium sulfatit parandaluan progresionin në eklampsi. Ndërsa në distocinë e shpatullave, aplikimi korrekt i manovrave obstetrikale mundësoi përfundimin e sigurt të lindjes pa pasoja neurologjike për neonatin. Analiza e rasteve evidenton rëndësinë e reagimit të shpejtë, zbatimit të protokolleve dhe bashkëpunimit efektiv ndërprofesional.

Përfundime: Infermierët dhe mamitë kanë një rol kyç në menaxhimin e urgjencave obstetrikale, duke kontribuar në uljen e rrezikut për jetën e nënës dhe foshnjës. Rritja e kapaciteteve profesionale përmes trajnimit të vazhdueshëm, zbatimi i protokolleve standarde dhe përforcimi i bashkëpunimit multidisiplinar janë elementë thelbësorë për përmirësimin e cilësisë së kujdesit dhe rezultateve klinike.

Fjalë kyçe: *Urgjenca obstetrikale, kujdes infermieror, hemorragji postpartum, preeklampsi, distoci e shpatullave, menaxhim klinik.*

THE ROLE OF NURSES AND MIDWIVES IN THE MANAGEMENT OF OBSTETRIC EMERGENCIES: A CLINICAL CASE ANALYSIS

Luiza Lushi[1], File Bracja[2], Tatjana Milo[3]

[1] Diabetes Association of Albania; Faculty of Medical Sciences, European University of Tirana, Albania

[2] Brainstorm Organization, Tirana; Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana, Albania

[3] Department of Gynecology, Tropojë Municipal Hospital, Albania

E-mail: luizalushi@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Obstetric emergencies represent one of the greatest challenges in maternal healthcare, being a leading cause of morbidity and mortality for both mother and neonate. Effective management of these conditions requires early identification, immediate intervention, and structured coordination of a multidisciplinary team, where the role of nurses and midwives is essential.

Aim: To evaluate the role of nurses and midwives in managing obstetric emergencies and the impact of their interventions on improving maternal and neonatal clinical outcomes.

Methodology: This study is based on a narrative review of contemporary literature and a descriptive-analytical analysis of three clinical cases from practice, specifically postpartum hemorrhage, severe preeclampsia, and shoulder dystocia. The analysis was conducted in accordance with current obstetric protocols and nursing practices.

Results: Findings indicate that early and structured nursing intervention directly influences patient stabilization and reduces complications. In the case of postpartum hemorrhage, immediate intervention with intravenous therapy, uterotonics, and intensive monitoring resulted in effective hemorrhage control. For severe preeclampsia, continuous monitoring and administration of magnesium sulfate prevented progression to eclampsia. In shoulder dystocia, correct application of obstetric maneuvers enabled safe delivery without neurological consequences for the neonate. Case analysis highlights the importance of rapid response, adherence to protocols, and effective interprofessional collaboration.

Conclusions: Nurses and midwives play a key role in managing obstetric emergencies, contributing to the reduction of life-threatening risks for both mother and child. Enhancing professional competencies through continuous training, implementing standard protocols, and strengthening multidisciplinary collaboration are essential elements for improving the quality of care and clinical outcomes.

Keywords: *Obstetric emergency, nursing care, postpartum hemorrhage, preeclampsia, shoulder dystocia, clinical management.*

BURNOUT DHE CILËSIA E KUJDESIT: NJË SFIDË NË RRITJE PËR SISTEMIN SHËNDETËSOR

Florentina Idrizaj[1]

[1] Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"
E-mail: florentinaidrizaj12@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Stresi profesional dhe burnout janë sfida të rëndësishme në sistemet shëndetësore, me ndikim në mirëqenien psikosociale të profesionistëve dhe në cilësinë e kujdesit të pacientëve. Burnout një sindromë multi-dimensionale e karakterizuar nga lodhje emocionale, depersonalizim dhe ndjenja e mospërmbushjes personale, si pasojë e ekspozimit të zgjatur ndaj stresit kronik në vendin e punës.

Qëllimi: Ky punim synon të identifikojë faktorët kryesorë që kontribuojnë në zhvillimin e stresit profesional dhe burnout-it, si dhe të vlerësojë strategjitë efektive për parandalimin dhe menaxhimin e tyre.

Metodologjia bazohet në rishikimin e literaturës shkencore ndërkombëtare, duke përfshirë studime kuantitative, cilësore dhe meta-analiza. Studimet tregojnë se faktorët determinues përfshijnë mbingarkesën e punës, oraret e zgjatura, mungesën e burimeve njerëzore dhe materiale, dhe kërkesat e larta emocionale të lidhura me kujdesin ndaj pacientëve. Faktorët organizativë, si mungesa e mbështetjes institucionale, lidershipi joefektiv dhe konfliktet ndërpersonale, rrisin rrezikun për burnout.

Konkluzione: Pasojat manifestohen në ulje të performancës profesionale, rritje të rrezikut për gabime mjekësore, reduktim të kënaqësisë në punë dhe incidencë më të lartë të çrregullimeve të shëndetit mendor, përfshirë ankthin, depresionin dhe lodhjen kronike.

Përfundime: Menaxhimi efektiv i stresit profesional dhe burnout-it përfshin: ndërhyrjet në nivel individual, si teknikat e menaxhimit të stresit dhe zhvillimi i reziliencës, të kombinohuara me ndërhyrje organizative që synojnë përmirësimin e kushteve të punës, forcimin e mbështetjes institucionale dhe promovimin e ekuilibrit punë–jetë. Implementimi i strategjive të bazuara në evidenca është thelbësor për garantimin e mirëqenies së profesionistëve dhe ofrimin e një kujdesi shëndetësor cilësor dhe të sigurt.

Fjalë Kyce: *Stresi professional, burnout, pacientë, lidershipi joefektiv.*

PROFESSIONAL STRESS AND BURNOUT IN HEALTHCARE PROFESSIONS

Florentina Idrizaj[1]
[1] University Obstetric-Gynecological Hospital "Queen Geraldine"
E-mail: florentinaidrizaj12@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Professional stress and burnout represent significant challenges in healthcare systems, impacting both the psychosocial well-being of professionals and the quality of patient care. Burnout is a multidimensional syndrome characterized by emotional exhaustion, depersonalization, and a reduced sense of personal accomplishment, resulting from prolonged exposure to chronic workplace stress.
Aim: This paper aims to identify the main factors contributing to the development of professional stress and burnout, as well as to evaluate effective strategies for their prevention and management.
Methodology: The study is based on a review of international scientific literature, including quantitative and qualitative studies, as well as meta-analyses. Findings indicate that key determinants include workload overload, long working hours, lack of human and material resources, and high emotional demands related to patient care. Organizational factors such as lack of institutional support, ineffective leadership, and interpersonal conflicts further increase the risk of burnout.
Conclusions: The consequences are reflected in decreased professional performance, increased risk of medical errors, reduced job satisfaction, and a higher incidence of mental health disorders, including anxiety, depression, and chronic fatigue.
Final Remarks: Effective management of professional stress and burnout involves both individual-level interventions, such as stress management techniques and resilience development, and organizational interventions aimed at improving working conditions, strengthening institutional support, and promoting work–life balance. The implementation of evidence-based strategies is essential to ensure the well-being of healthcare professionals and the delivery of safe and high-quality care.

Keywords: *Professional stress, burnout, patients, ineffective leadership.*

NDJEKJA E GRUAS ME PLACENTA PREVIA

Entela Kampula[1], Ivia Elezi, Bukurie Çullhaj, Edlira Bashmeta

[1] Shërbimi i patologjisë, Materniteti "Koço Gliozheni" Tiranë
E-mail: entelakampula@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Placenta previa është një komplikacion i rëndësishëm obstetrik, ku placenta vendoset pjesërisht ose plotësisht mbi orificiumin intern të qafës së mitrës, duke penguar lindjen normale. Kjo gjendje shoqërohet shpesh me hemorragji pa dhimbje në tremujorin e tretë dhe paraqet rrezik të konsiderueshëm për nënën dhe fetusin. Me rritjen e faktorëve të rrezikut si lindjet cezariane, mosha e avancuar e nënës dhe shtatzënitë multiple, incidenca e saj është në rritje.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ndjekjen klinike dhe infermierore të grave me placenta previa, duke theksuar rëndësinë e diagnostikimit të hershëm, menaxhimit të duhur dhe parandalimit të komplikacioneve.
Metodologjia: Studimi është bazuar në rishikimin e literaturës dhe analizën e praktikave klinike në menaxhimin e placenta previa. Janë shqyrtuar aspektet patofiziologjike, faktorët e rrezikut, klasifikimet, simptomat, metodat diagnostikuese si ekografia dhe MRI, si dhe ndërhyrjet mjekësore dhe infermierore në trajtimin e kësaj patologjie.
Rezultatet / Diskutimi: Rezultatet tregojnë se diagnostikimi i hershëm përmes imazherisë dhe monitorimi i vazhdueshëm janë kyç për reduktimin e komplikacioneve si hemorragjia, prematuriteti dhe shoku hipovolemik. Roli i infermierisë është thelbësor në vlerësimin e gjendjes së pacientes, monitorimin e parametrave jetësorë dhe mbështetjen emocionale. Menaxhimi multidisiplinar përmirëson ndjeshëm rezultatet klinike.
Konkluzione: Placenta previa kërkon një qasje të integruar dhe të kujdesshme për të parandaluar komplikacionet serioze. Bashkëpunimi ndërmjet stafit mjekësor dhe infermieror, së bashku me monitorimin e vazhdueshëm, kontribuon në rritjen e sigurisë së nënës dhe fetusit dhe në përmirësimin e rezultateve perinatale.

Fjalë kyçe: *Placenta previa, shtatzënia, hemorragjia, menaxhimi infermieror, diagnostikimi, komplikacionet.*

FOLLOW-UP OF WOMEN WITH PLACENTA PREVIA

Entela Kampula, Ivia Elezi, Bukurie Çullhaj, Edlira Bashmeta
[1] Pathology Service, Maternity Hospital "Koço Gliozheni" Tirana
E-mail: entelakampula@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Placenta previa is a significant obstetric complication in which the placenta partially or completely covers the internal cervix, obstructing normal vaginal delivery. This condition is often associated with painless vaginal bleeding in the third trimester and poses considerable risks to both the mother and the fetus. With the increasing prevalence of risk factors such as prior cesarean sections, advanced maternal age, and multiple pregnancies, its incidence has been rising.
Objective: The aim of this study is to analyze the clinical and nursing management of women with placenta previa, emphasizing the importance of early diagnosis, appropriate management, and prevention of complications.
Methodology: This study is based on a literature review and analysis of clinical practices related to the management of placenta previa. It examines pathophysiology, risk factors, classifications, symptoms, diagnostic methods such as ultrasound and MRI, as well as medical and nursing interventions used in patient care.
Results / Discussion: Findings indicate that early diagnosis through imaging and continuous monitoring are essential in reducing complications such as hemorrhage, prematurity, and hypovolemic shock. Nursing care plays a crucial role in assessing patient condition, monitoring vital signs, and providing emotional support. A multidisciplinary approach significantly improves clinical outcomes.
Conclusion: Placenta prevails a careful and integrated management approach to prevent serious complications. Collaboration between medical and nursing staff, along with continuous monitoring, enhances maternal and fetal safety and improves perinatal outcomes.

Keywords: *Placenta previa, pregnancy, hemorrhage, nursing management, diagnosis, complications.*

CILËSIA E JETËS TEK PACIENTËT ME ASTMË BRONKIALE

Arta Zogu[1]
[1]Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës,
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shkodër, Shqipëri
E-mail: artazogu@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Astma është një sëmundje kronike globale që prek rreth 300 milionë njerëz në mbarë botën, me rritje të incidencës gjatë dekadave të fundit, veçanërisht në vendet e zhvilluara. Ajo prek rreth 10 - 12% të të rriturve dhe 15% të fëmijëve. Simptomat e astmës janë të ndryshueshme dhe ndikojnë në cilësinë e jetës së pacientëve, duke përfshirë gjumin, aktivitetin fizik dhe funksionimin e përditshëm.
Qëllimi: Të vlerësohet ndikimi i astmës bronkiale në jetën e përditshme dhe niveli i kontrollit të saj tek pacientët e ndjekur në kujdesin parësor.
Metodologjia: Ky është një studim përshkrues transversal (cross-sectional), i realizuar në Qendrën Shëndetësore Nr. 4 në Shkodër. Popullata përfshiu pacientë të diagnostikuar me astmë bronkiale që u paraqitën për vizitë dhe marrje të mjekimit periodik. U shpërndanë 50 pyetësorë me pyetje të mbyllura, bazuar në testin ndërkombëtar Asthma Control Test (ACT), të vetëadministruar nga pacientët. Të dhënat u analizuan me programin SPSS version 15.0 gjatë periudhës Janar - Shkurt 2025.
Rezultatet: Në studim morën pjesë 50 pacientë, nga të cilët 62% ishin femra dhe 38% meshkuj. Rezultatet treguan se një pjesë e konsiderueshme e pacientëve paraqesin kontroll jo optimal të astmës, duke ndikuar në aktivitetet e përditshme, cilësinë e gjumit dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike. Simptomat më të shpeshta të raportuara ishin dispnea dhe wheezing.
Përfundimi: Astma bronkiale mbetet një sëmundje kronike me ndikim të rëndësishëm në cilësinë e jetës së pacientëve. Vlerësimi i rregullt i kontrollit të astmës dhe menaxhimi efektiv janë thelbësorë për përmirësimin e funksionimit të përditshëm dhe mirëqenies së pacientëve.

Fjalë kyçe: *Astma, Asthma Control Test, cilësia e jetës, dispnea, wheezing.*

THE PATIENT`S LIFE QUALITY THAT LIVE WITH ASTMA

Arta Zogu[1]
[1]Department of Nursing, Faculty of Natural Sciences,
University of Shkodra "LuigjGurakuqi", Shkoder, Albania
E-mail: artazogu@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Asthma is a global chronic disease affecting approximately 300 million people worldwide, with an increasing trend over the last decades, particularly in developed countries. It affects about 10–12% of adults and 15% of children. Asthma symptoms are variable and significantly impact patients' quality of life, including sleep, physical activity, and daily functioning.

Aim: To assess the impact of bronchial asthma on daily life and the level of asthma control among patients in primary healthcare settings.

Methods: This is a descriptive cross-sectional study conducted at Health Center No. 4 in Shkodra. The study population included patients diagnosed with bronchial asthma who attended follow-up visits and medication collection. A total of 50 structured questionnaires with closed-ended questions were distributed, based on the standardized Asthma Control Test (ACT), self-administered by patients. Data were analyzed using SPSS version 15.0 during January–February 2025.

Results: The study included 50 participants, of whom 62% were female and 38% male. The findings indicate that a considerable proportion of patients had suboptimal asthma control, negatively affecting daily activities, sleep quality, and physical and psychological well-being. The most frequently reported symptoms were shortness of breath and wheezing.

Conclusion: Bronchial asthma remains a chronic condition with a significant impact on patients' quality of life. Regular assessment of asthma control and effective management strategies are essential to improve daily functioning and overall well-being.

Keywords: *Asthma, asthma control test, quality of life, shortness of breath, wheezing.*

SESION PARALEL

SESIONI I

SALLA 4

ABSTRAKTET

IMPLEMENTIMI I SISTEMEVE TË STANDARDIZUARA TË TRIAZHIT NË SHËRBIMET E URGJENCËS: EVIDENCË NDËRKOMBËTARE DHE SFIDAT E APLIKIMIT NË SHQIPËRI

Arben Beja[1]

[1]Kryeinfermier i Përgjithshëm SRD
E-mail: arbenbeja964@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Triazhi përfaqëson një komponent thelbësor të menaxhimit klinik në shërbimet e urgjencës, duke mundësuar klasifikimin dhe prioritizimin e pacientëve sipas ashpërsisë së gjendjes klinike dhe rrezikut për jetën. Në kushtet e rritjes së vazhdueshme të fluksit të pacientëve dhe burimeve të kufizuara njerëzore e infrastrukturore, aplikimi i sistemeve të standardizuara të triazhit është thelbësor për sigurimin e kujdesit emergjent efikas dhe të sigurt.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rëndësinë e triazhit në organizimin e shërbimeve të urgjencës dhe të vlerësojë modelet kryesore ndërkombëtare të klasifikimit të pacientëve.

Metodologjia: Studimi bazohet në një rishikim të literaturës bashkëkohore mbi sistemet e triazhit dhe performancën e tyre në praktikën klinike. Modelet më të përdorura ndërkombëtarisht përfshijnë Emergency Severity Index (ESI), Manchester Triage System (MTS) dhe Canadian Triage and Acuity Scale (CTAS), të cilat bazohen kryesisht në klasifikimin me pesë nivele të urgjencës. Evidencat shkencore tregojnë se sistemet me 5 nivele rrisin saktësinë klinike në krahasim me modelet tradicionale me 3 nivele, duke reduktuar kohën e pritjes dhe duke përmirësuar sigurinë e pacientit. World Health Organization dhe International Federation for Emergency Medicine theksojnë se implementimi i protokolleve të standardizuara të triazhit është një element kyç për optimizimin e burimeve spitalore dhe për përmirësimin e vendimmarrjes klinike.

Konkluzione: Në kontekstin shqiptar, zhvillimet në organizimin e shërbimit të urgjencës, veçanërisht pas krijimit të Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, kanë kontribuar në përmirësimin e menaxhimit të rasteve emergjente. Megjithatë, implementimi i plotë dhe i unifikuar i një sistemi kombëtar të standardizuar të triazhit mbetet një sfidë për shumë institucione shëndetësore, sidomos në spitalet rajonale me fluks të lartë pacientësh. Sfidat kryesore përfshijnë mungesën e stafit të trajnuar, mbingarkesën e shërbimeve dhe nevojën për protokolle të përditësuara.

Përfundime: Institucionalizimi i një sistemi të standardizuar të triazhit me pesë nivele, i shoqëruar me trajnim të vazhdueshëm të personelit dhe monitorim të indikatorëve të performancës, përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së cilësisë, sigurisë dhe barazisë në ofrimin e kujdesit emergjent në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *Triazh, urgjencë, prioritet klinik, siguri e pacientit, menaxhim spitalor.*

IMPLEMENTATION OF STANDARDIZED TRIAGE SYSTEMS IN EMERGENCY SERVICES: INTERNATIONAL EVIDENCE AND IMPLEMENTATION CHALLENGES IN ALBANIA

Arben Beja [1]
[1] Chief General Nurse SRD
E-mail: arbenbeja964@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Triage represents a fundamental component of clinical management in emergency services, enabling the classification and prioritization of patients according to the severity of their clinical condition and the risk to life. In the context of the continuously increasing patient flow and limited human and infrastructural resources, the implementation of standardized triage systems is essential to ensure efficient and safe emergency care. The aim of this study is to analyze the importance of triage in the organization of emergency services and to evaluate the main international models used for patient classification.

Methodology: This study is based on a review of contemporary literature on triage systems and their performance in clinical practice. The most widely used international models include the Emergency Severity Index (ESI), the Manchester Triage System (MTS), and the Canadian Triage and Acuity Scale (CTAS), which are primarily based on a five-level classification of emergency severity. Scientific evidence indicates that five-level systems improve clinical accuracy compared with traditional three-level models, reducing waiting times and enhancing patient safety. The World Health Organization (WHO) and the International Federation for Emergency Medicine (IFEM) emphasize that the implementation of standardized triage protocols is a key element for optimizing hospital resources and improving clinical decision-making.

Conclusions: In the Albanian context, developments in the organization of emergency services—particularly following the establishment of the National Center for Medical Emergency—have contributed to improvements in the management of emergency cases. However, the full and unified implementation of a national standardized triage system remains a challenge for many healthcare institutions, especially regional hospitals with a high patient flow. The main challenges include the lack of adequately trained staff, overcrowding in emergency departments, and the need for updated protocols.

Final Remarks: The institutionalization of a standardized five-level triage system, accompanied by continuous training of healthcare personnel and monitoring of performance indicators, represents an important step toward improving quality, patient safety, and equity in access to emergency care in Albania.

Keywords: *Triage, emergency care, clinical priority, patient safety, hospital management.*

VLERËSIMI I STATUSIT TË VITAMINËS D SIPAS MOSHËS DHE GJINISË

Aleksandra Lamthi[1], Admir Nake[2]

[1] FSHMT-UMT, Teknike e Lartë Laboratori

[2] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT

E-mail: aleksandralamthi@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Vitamina D luan një rol të rëndësishëm në shëndetin e kockave, funksionin imunitar dhe procese të ndryshme metabolike. Mungesa ose pamjaftueshmëria e saj është një problem i shpeshtë shëndetësor në shumë popullata.

Qëllimi: Vlerësimi i statusit të vitaminës D, sipas të dhënave socio-demografike në një grup popullate të caktuar.

Materiale dhe Metoda: Matja e niveleve të vitaminës D në serum u realizua me anë të pajisjes i-Chroma™, duke përdorur metodën imunofluoreshente (Fluorescence Immunoassay – FIA) pranë Klinikës Toscana. U përfshinë 153 individë, prej të cilëve 92 femra dhe 61 meshkuj. Pjesëmarrësit u ndanë në katër grupe moshe: 0-20 vjeç (18 persona), 20-40 vjeç (59 persona), 40–60 vjeç (46 persona) dhe mbi 60 vjeç (30 persona). Nivelet e vitaminës D u matën në serum dhe u klasifikuan si pamjaftueshmëri e shprehur (<10 ng/ml), pamjaftueshmëri e moderuar (10–30 ng/ml) dhe mjaftueshmëri (>30 ng/ml).

Rezultatet: U vu re se 8 individë (5,2%) kishin pamjaftueshmëri të shprehur të vitaminës D, 128 individë (83,7%) kishin pamjaftueshmëri të moderuar, ndërsa vetëm 17 individë(11,1%) kishin nivele të mjaftueshme. Pamjaftueshmëria u vërejt më shpesh në grupmoshën 20-40 vjeç. Nuk u identifikua një ndryshim statistikisht i rëndësishëm midis meshkujve dhe femrave, megjithëse femrat paraqitën një numër pak më të lartë rastesh me pamjaftueshmëri.

Konkluzionet: Në këtë popullatë vërehet një prevalencë e lartë e mungesës dhe pamjaftueshmërisë së vitaminës D në popullatën e studiuar. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e monitorimit të niveleve të vitaminës D, edukimit të pacientëve për ekspozimin në diell dhe për një dietë të përshtatshme, si dhe rolin e rëndësishëm të profesionistëve shëndetësorë në parandalimin e komplikimeve të lidhura me mungesën e vitaminës D.

Fjalë kyçe: *itamina D, mungesa e vitaminës D, pamjaftueshmëri, popullatë, shëndeti publik.*

ASSESSMENT OF VITAMIN D STATUS ACCORDING TO AGE AND GENDER

Aleksandra Lamthi[1], Admir Nake[2]
[1] Faculty of Medical Technical Sciences (FSHMT-UMT), Senior Laboratory Technician
[2] Faculty of Medical Technical Sciences (FSHMT-UMT)
E-mail: aleksandralamthi@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Vitamin D plays an important role in bone health, immune function, and various metabolic processes. Its deficiency or insufficiency is a common health problem in many populations.
Aim: To assess vitamin D status according to socio-demographic data in a selected population group.
Materials and Methods: Serum vitamin D levels were measured using the i-Chroma™ device, applying the Fluorescence Immunoassay (FIA) method at Toscana Clinic. A total of 153 individuals were included, of whom 92 were female and 61 male. Participants were divided into four age groups: 0–20 years (18 individuals), 20-40 years (59 individuals), 40–60 years (46 individuals), and over 60 years (30 individuals). Vitamin D levels were measured in serum and classified as severe deficiency (<10 ng/ml), moderate insufficiency (10–30 ng/ml), and sufficiency (>30 ng/ml).
Results: It was observed that 8 individuals (5.2%) had severe vitamin D deficiency, 128 individuals (83.7%) had moderate insufficiency, and only 17 individuals (11.1%) had sufficient levels. Insufficiency was more frequently observed in the 20-40 age group. No statistically significant difference was identified between males and females, although females showed a slightly higher number of insufficiency cases.
Conclusions: A high prevalence of vitamin D deficiency and insufficiency was observed in the studied population. These findings highlight the importance of monitoring vitamin D levels, educating patients about sun exposure and appropriate diet, as well as the important role of healthcare professionals in preventing complications related to vitamin D deficiency.

Keywords: *Vitamin D, vitamin D deficiency, insufficiency, population, public health.*

HEMOLIZA NË KËNDVËSHTRIMIN E INFERMIERËVE

[1]Venemin Gega, [1]Brunilda Mëhilli, [2]Admir Nake, [1] Ylli Alicka, [1]Rajmonda Hida Oboni, [1]Arkida Skenderi, [1]Ilma Toci, [1]Gjergji Doka,[1]Andja Lala

[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
[2] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
E-mail: mini.gega@live.com

ABSTRAKT

Hyrje: Hemoliza përfaqëson një nga faktorët kryesorë pre-analitikë që ndikon në saktësinë dhe besueshmërinë e rezultateve laboratorike. Ajo lidhet ngushtë me procedurat e flebotomisë dhe praktikat infermierore gjatë marrjes dhe trajtimit të mostrave të gjakut. Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte nivelin e njohurive të infermierëve në lidhje me hemolizën, si dhe të identifikonte mangësitë në edukimin dhe trajnimin profesional.

Metodologjia: U realizua një studim përshkrues i tipit cross sectional, ku u përfshinë 89 pjesëmarrës nga institucione të ndryshme shëndetësore në Elbasan. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori të vetëstrukturuar, i hartuar për këtë studim, i cili u pilotua paraprakisht për të garantuar qartësi dhe vlefshmëri. Analiza statistikore u krye me metoda përshkruese.

Rezultatet: Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve (97.8%) raportuan se janë të njohur me termin hemolizë, ndërsa 91% e përkufizuan atë saktë. Për më tepër, 76.4% nuk kishin ndjekur asnjë trajnim specifik mbi këtë temë. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit (97.8%) shprehën nevojën për edukim shtesë mbi faktorët pre-analitikë, duke reflektuar një vetëdije të lartë profesionale mbi rëndësinë e këtij procesi në sigurimin e rezultateve të sakta laboratorike.

Konkluzionet: Infermierët paraqesin një nivel të mirë njohurish teorike mbi hemolizën; megjithatë, evidentohet një mungesë e konsiderueshme e trajnimit praktik dhe e edukimit të vazhdueshëm në këtë fushë. Përmirësimi i kompetencave praktike kërkon forcimin e moduleve edukative mbi hemolizën, organizimin e trajnimeve periodike dhe standardizimin e procedurave të marrjes dhe menaxhimit të mostrave të gjakut.

Fjalë kyçe: *Hemolizë, faza pre-analitike, infermierë, trajnim.*

HEMOLYSIS FROM THE PERSPECTIVE OF NURSES

[1]Venemin Gega, [1]Brunilda Mehilli, [2]Admir Nake, [1] Ylli Alicka, [1]Rajmonda Hida Oboni, [1]Arkida Skenderi, [1]Ilma Toci, [1]Gjergji Doka, [1]Andja Lala
[1]Faculty of Technical Medical Sciences, "Aleksander Xhuvani" University of Elbasan
[2] Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana
E-mail: mini.gega@live.com

ABSTRACT

Introduction: Hemolysis represents one of the main pre-analytical factors affecting the accuracy and reliability of laboratory results. It is closely related to phlebotomy procedures and nursing practices during the collection and handling of blood samples. This study aimed to assess nurses' knowledge of hemolysis and identify gaps in professional education and training.
Methodology: A descriptive cross-sectional study was conducted, including 89 participants from various healthcare institutions in Elbasan. Data were collected using a self-structured questionnaire developed for this study, which was pilot-tested beforehand to ensure clarity and validity. Statistical analysis was performed using descriptive methods.
Results: The vast majority of participants (97.8%) reported familiarity with the term hemolysis, and 91% defined it correctly. Furthermore, 76.4% had not attended any specific training on this topic. Almost all participants (97.8%) expressed the need for additional education on pre-analytical factors, reflecting a high level of professional awareness regarding the importance of this process in ensuring accurate laboratory results.
Conclusions: Nurses demonstrate a good level of theoretical knowledge of hemolysis; however, a significant lack of practical training and continuing education in this area is evident. Improving practical competencies requires strengthening educational modules on hemolysis, organizing periodic training sessions, and standardizing procedures for blood sample collection and management.

Keywords: *Hemolysis, pre-analytical phase, nurses, training.*

PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË MENAXHIMIN SHËNDETËSOR

Lindita Saja[1]
[1]Infermiere, Spitali Universitar i Traumës

ABSTRAKT

Hyrje: Inteligjenca artificiale (IA) po transformon menaxhimin shëndetësor duke ofruar zgjidhje inovative për përmirësimin e cilësisë së kujdesit dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve. Rritja e kërkesës për shërbime shëndetësore, së bashku me kompleksitetin në rritje të proceseve klinike dhe administrative, kërkon përdorimin e teknologjive të avancuara për një menaxhim më të mirë të burimeve dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës së sistemit.
Qëllimi: Të vlerësohet roli i inteligjencës artificiale në menaxhimin e sistemeve shëndetësore, duke analizuar përfitimet, aplikimet praktike dhe sfidat e implementimit të saj në praktikën klinike dhe administrative.
Metodologjia: Studimi bazohet në një analizë përshkruese të literaturës bashkëkohore dhe praktikave aktuale në fushën e menaxhimit shëndetësor, me fokus në përdorimin e IA në vendimmarrje, organizim të shërbimeve dhe menaxhim të të dhënave shëndetësore.
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se IA përmirëson vendimmarrjen klinike përmes analizës së të dhënave në kohë reale dhe ndihmon në optimizimin e burimeve si stafi, pajisjet dhe kapacitetet spitalore. Aplikimet kryesore përfshijnë telemjekësinë, analizat radiologjike të asistuara nga IA dhe përdorimin e chatbot-eve për orientimin e pacientëve dhe menaxhimin e fluksit të tyre. Përdorimi i IA kontribuon në reduktimin e gabimeve njerëzore, rritjen e sigurisë së pacientit, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe uljen e kostove operacionale. Megjithatë, identifikohen sfida si siguria dhe privatësia e të dhënave, kostot e larta të implementimit dhe nevoja për trajnim të vazhdueshëm të stafit shëndetësor.
Konkluzionet: Integrimi i inteligjencës artificiale në menaxhimin shëndetësor përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit dhe digjitalizimit të sistemit shëndetësor. Përdorimi i saj duhet të bazohet në parime etike dhe profesionale, duke garantuar sigurinë e pacientit, transparencën dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë në praktikën klinike.

Fjalë kyçe: *Inteligjenca artificiale, menaxhimi shëndetësor, telemjekësia, siguria e pacientit, inovacioni, digjitalizimi*

THE USE OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN HEALTHCARE MANAGEMENT

Lindita Saja[1]
[1]Nurse, University Hospital of Trauma

ABSTRACT

Introduction: Artificial Intelligence (AI) is transforming healthcare management by providing innovative solutions to improve the quality of care and increase service efficiency. The growing demand for healthcare services, along with the increasing complexity of clinical and administrative processes, requires the use of advanced technologies for better resource management and continuous system performance improvement.
Aim: To evaluate the role of artificial intelligence in healthcare management systems by analyzing its benefits, practical applications, and implementation challenges in both clinical and administrative practice.
Methodology: This study is based on a descriptive analysis of contemporary literature and current practices in healthcare management, with a focus on the use of AI in decision-making, service organization, and healthcare data management.
Results: The findings indicate that AI improves clinical decision-making through real-time data analysis and contributes to the optimization of resources such as staff, equipment, and hospital capacity. Key applications include telemedicine, AI-assisted radiological analysis, and the use of chatbots for patient guidance and flow management. The use of AI helps reduce human errors, enhance patient safety, improve service quality, and lower operational costs. However, significant challenges remain, including data privacy and security concerns, high implementation costs, and the need for continuous training of healthcare professionals.
Conclusions: The integration of artificial intelligence in healthcare management represents an important step toward the modernization and digitalization of the healthcare system. Its use should be guided by ethical and professional principles, ensuring patient safety, transparency, and responsible application of technology in clinical practice.

Keywords: *Artificial intelligence, healthcare management, telemedicine, patient safety, innovation, digitalization*

STANDARDET E CILËSISË DHE SIGURISË SË PACIENTIT NË RADIOLOGJINË INTERVENCIONUESE

Besmira Berdufi[1]

[1]QSUNT, Tiranë
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT
E-mail: besmiraimazheri@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Radiologjia intervencionuese përfaqëson një nga fushat më të avancuara dhe dinamike të imazherisë moderne, duke ofruar procedura minimalisht invazive me vlerë të lartë diagnostike dhe terapeutike. Megjithatë, kompleksiteti teknik dhe klinik i këtyre procedurave kërkon zbatim rigoroz të standardeve të cilësisë dhe sigurisë, me qëllim mbrojtjen e pacientit, minimizimin e rreziqeve dhe përmirësimin e rezultateve klinike.
Qëllimi: Të theksojë rëndësinë e standardeve të cilësisë dhe sigurisë së pacientit në radiologjinë intervencionuese, duke u mbështetur në përvojën klinike të përditshme të fituar ndër vite në praktikën profesionale.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një analizë përshkruese të praktikave themelore që lidhen me sigurinë e pacientit gjatë procedurave intervenuese. Në fokus janë përfshirë identifikimi korrekt i pacientit, përgatitja para procedurës, respektimi i teknikave aseptike, kontrolli funksional i pajisjeve, monitorimi intra- dhe post-procedural, menaxhimi i komplikacioneve, mbrojtja nga rrezatimi dhe dokumentimi i standardizuar i çdo procedure.
Rezultate: Përvoja klinike shumëvjeçare tregon se zbatimi i protokolleve të qarta dhe standardeve të mirëpërcaktuara ndikon drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë së pacientit, uljen e komplikacioneve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Bashkëpunimi multidisiplinar, komunikimi i saktë ndërmjet anëtarëve të ekipit, kontrolli i vazhdueshëm i pajisjeve dhe trajnimi profesional i stafit përbëjnë elemente thelbësore për suksesin procedural dhe për ruajtjen e standardeve të larta të kujdesit.
Përfundime: Standardet e cilësisë dhe sigurisë janë themelore në radiologjinë intervencionuese dhe duhet të jenë pjesë integrale e praktikës së përditshme. Respektimi i tyre kontribuon në mbrojtjen e pacientit, rritjen e efikasitetit klinik dhe forcimin e cilësisë së shërbimit.

Fjalë kyçe: *Radiologji intervencionuese, siguria e pacientit, cilësia, standardet, mbrojtja nga rrezatimi, protokollet.*

QUALITY STANDARDS AND PATIENT SAFETY IN INTERVENTIONAL RADIOLOGY

Besmira Berdufi[1]
[1] University Hospital Center "Mother Teresa"
Faculty of Medical Technical Sciences (FSHMT)
E-mail: besmiraimazheri@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Interventional radiology represents one of the most advanced and dynamic fields of modern medical imaging, offering minimally invasive procedures with high diagnostic and therapeutic value. However, the technical and clinical complexity of these procedures requires rigorous implementation of quality standards and patient safety measures in order to protect the patient, minimize risks, and improve clinical outcomes.
Aim: To emphasize the importance of quality standards and patient safety in interventional radiology, based on daily clinical experience gained over the years in professional practice.
Methodology: This paper is based on a descriptive analysis of the fundamental practices related to patient safety during interventional procedures. The main areas of focus include correct patient identification, pre-procedural preparation, adherence to aseptic techniques, functional equipment checks, intra- and post-procedural monitoring, complication management, radiation protection, and standardized documentation of each procedure.
Results: Long-term clinical experience demonstrates that the implementation of clear protocols and well-defined standards has a direct impact on improving patient safety, reducing complications, and enhancing the quality of care. Multidisciplinary collaboration, accurate communication among team members, continuous equipment control, and ongoing professional staff training constitute essential elements for procedural success and for maintaining high standards of care.
Conclusions: Quality standards and patient safety are fundamental in interventional radiology and must be an integral part of daily practice. Their consistent application contributes to patient protection, increased clinical efficiency, and strengthened service quality.

Keywords: *Interventional radiology, patient safety, quality, standards, radiation protection, protocols*

NJOHURITË E GRAVE SHQIPTARE PËR PAP TESTIN DHE KANCERIN E QAFËS SË MITRËS

Daniela Bimi[1]

[1]Spitali Universitar i Obstetrikës dhe Gjinekologjisë në Tiranë ,"Mbretëresha Geraldinë"
E-mail: bimidaniela@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Prevalenca e depistimit për kancerin e qafës së mitrës është e njohur gjerësisht në vendet e zhvilluara. Nga ana tjetër, është e pasigurt se si ndihet popullsia shqiptare në lidhje me depistimin për kancerin e qafës së mitrës në këtë vend me të ardhura të ulëta dhe të mesme.
Objektivat e studimit: Studimi është të përcaktojë ndërgjegjësimin e grave shqiptare për kancerin e qafës së mitrës dhe testin Papanicolau (Pap), si dhe çdo lidhje midis njohurive dhe karakteristikave demografike.
Metodat: Ky studim retrospektiv shqyrton të gjitha diagnozat e kancerit të qafës së mitrës dhe numrin e testeve Pap në Maternitetin e Tiranës "Mbretëresha Geraldinë", midis viteve 2015 dhe 2025. Të dhënat u mblodhën nëpërmjet analizës statistikore.
Rezultatet dhe diskutimet: Sipas rezultateve, ka 150 raste me kancer të qafës së mitrës dhe numri është ulur gjatë viteve të fundit. Numri i përgjithshëm i ekzaminimeve të testit Pap të kryera deri në shtator 2025 është afërsisht 5108.
Përfundim: Gratë shqiptare zakonisht kanë njohuri të kufizuara rreth kancerit të qafës së mitrës, faktorëve të tij të rrezikut dhe testit Pap. Në krahasim me vendet e zhvilluara, Shqipëria ka një prevalencë më të lartë të kancerit të qafës së mitrës, e cila mund t'i atribuohet pjesërisht kësaj mungese njohurish. Megjithatë, është vërejtur se një frekuencë më e lartë e ekzaminimeve të testit Pap mund të zvogëlojë incidencën e kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri.

Fjalët kyçe: *Gratë shqiptare, kanceri i qafës së mitrës, Pap testi.*

KNOWLEDGE OF ALBANIAN WOMEN ABOUT THE PAP TEST AND CERVICAL CANCER

Daniela Bimi[1]
Tirana University Hospital of Obstetrics and Gynecology – The "Queen Geraldine"
E-mail: bimidaniela@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: The prevalence of cervical cancer screening is well established in developed countries. However, it remains unclear how the Albanian population perceives cervical cancer screening in this lower- and middle-income country (LMIC).
Aims of the study: The aim of this study was to assess Albanian women's awareness of cervical cancer and the Papanicolaou (Pap) test, as well as to examine the association between knowledge and demographic characteristics.
Methods: This retrospective study examines all cervical cancer diagnoses and the number of Pap tests performed at the "Queen Geraldine" Maternity Hospital in Tirana between 2015 and 2025. Data were collected through statistical analysis.
Results and discussion: According to the findings, there were 150 cases of cervical cancer, with a decreasing trend observed in recent years. The total number of Pap tests performed up to September 2025 was approximately 5,108.
Conclusion: Albanian women generally have limited knowledge about cervical cancer, its risk factors, and the Pap test. Compared to developed countries, Albania has a higher prevalence of cervical cancer, which may be partly attributed to this lack of awareness. However, increased frequency of Pap test screening has been shown to reduce the incidence of cervical cancer in Albania.

Keywords: *Albanian women, cervical cancer, pap test.*

KUJDESI DINJITOZ GJATË LINDJES: NJË QASJE GLOBALE

Aida Abdurrahmani[1]

[1]Departamenti i Obstetrikë/Gjinekologji, Spitali Rajonal Elbasan
E-mail: abdurrahmaniaida_@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Kujdesi dinjitoz gjatë lindjes përfaqëson një standard thelbësor në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për gratë, duke garantuar dinjitetin, autonominë dhe të drejtat e tyre themelore. Në dekadën e fundit, ky koncept ka fituar vëmendje të gjerë në nivel global si reagim ndaj raportimeve për trajtime jo të denja, ndërhyrje pa pëlqim dhe komunikim jo etik gjatë lindjes. Organizata ndërkombëtare si WHO dhe FIGO e konsiderojnë kujdesin dinjitoz si komponent kyç për një përvojë pozitive të lindjes dhe për përmirësimin e rezultateve shëndetësore.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë kujdesin dinjitoz gjatë lindjes nga një perspektivë globale, duke evidentuar format e mungesës së respektit, ndikimet e tij dhe rolin e profesionistëve shëndetësorë në promovimin e praktikave të sigurta dhe dinjitoze.

Metodologjia: Studimi bazohet në një rishikim të literaturës shkencore të publikuar gjatë 10 viteve të fundit (2015–2025). Janë përfshirë artikuj të indeksuar në databaza ndërkombëtare si PubMed, Scopus dhe Google Scholar, si dhe raporte nga organizata si WHO, UNFPA dhe Amnesty International. Kriteret e përzgjedhjes përfshinin studime që trajtojnë përvojat e grave gjatë lindjes, "disrespect and abuse", si dhe ndërhyrje për promovimin e kujdesit të respektueshëm.

Diskutime: Analiza e literaturës tregon se mungesa e kujdesit dinjitoz gjatë lindjes është një fenomen global, i pranishëm si në vendet me të ardhura të ulëta ashtu edhe në ato të zhvilluara. Format më të shpeshta përfshijnë mungesën e komunikimit, ndërhyrjet pa konsent dhe trajtimin jodinjitoz. Faktorët që kontribuojnë lidhen me mbingarkesën e sistemit shëndetësor, mungesën e trajnimit dhe normat kulturore. Në këtë kontekst, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë kanë një rol kyç në krijimin e një ambienti mbështetës dhe respektues.

Konkluzione: Kujdesi dinjitoz gjatë lindjes është thelbësor për cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe për mirëqenien e grave. Promovimi i tij kërkon ndërhyrje të integruara që përfshijnë përmirësimin e politikave, trajnimin e stafit dhe fuqizimin e grave për të njohur të drejtat e tyre. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse mund të sigurohet një përvojë e sigurt, dinjitoze dhe pozitive e lindjes.

Fjalët kyçe: *Kujdes dinjitoz, lindja, dhuna obstetrikale, të drejtat e grave, mamitë, shëndeti maternal.*

DIGNIFIED CARE DURING CHILDBIRTH: A GLOBAL APPROACH

Aida Abdurrahmani[1]
[1] Department of Obstetrics/Gynecology, Regional Hospital of Elbasan, Albania
E-mail: abdurrahmaniaida_@yahoo.com

ABSTRACT

Background: Dignified care during childbirth represents a fundamental standard in the provision of healthcare services for women, ensuring their dignity, autonomy, and basic human rights. Over the past decade, this concept has gained significant global attention in response to increasing reports of disrespectful and abusive practices, non-consented interventions, and unethical communication during childbirth. International organizations such as WHO and FIGO recognize dignified care as a key component of a positive childbirth experience and improved maternal and neonatal outcomes.

Aim: This paper aims to analyze dignified care during childbirth from a global perspective, highlighting forms of disrespect and abuse, their impact, and the role of healthcare professionals in promoting safe and respectful maternity care practices.

Methods: This study is based on a literature review of scientific publications from the last decade (2015–2025). Articles indexed in international databases such as PubMed, Scopus, and Google Scholar were included, along with reports from organizations such as WHO, UNFPA, and Amnesty International. Inclusion criteria focused on studies addressing women's experiences during childbirth, disrespect and abuse, and interventions aimed at promoting respectful maternity care.

Discussion: The literature indicates that the lack of dignified care during childbirth is a global phenomenon, present in both low- and high-income countries. The most common forms include poor communication, non-consented procedures, and undignified treatment. Contributing factors are related to health system overload, lack of professional training, and prevailing cultural norms. In this context, midwives and other healthcare professionals play a crucial role in creating a supportive and respectful environment for women during childbirth.

Conclusions: Dignified care during childbirth is essential for the quality of healthcare services and women's well-being. Its promotion requires integrated interventions, including policy improvement, staff training, and empowerment of women to understand and claim their rights. Only through a comprehensive approach can a safe, respectful, and positive childbirth experience be ensured.

Keywords: *Dignified care, childbirth, obstetric violence, women's rights, midwives, maternal health.*

MENAXHIMI I RASTEVE KOMPLEKSE DHE PATOLOGJIVE BASHKËSHOQËRUESE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR

Leonora Morava[1], Stela Kole[2]

[1,2] Qëndra Shëndetësore (Mollaj, Korçë), Shqipëri
E-mail: leonoramorava61@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Rritja e jetëgjatësisë dhe prevalenca e sëmundjeve kronike kanë shtuar ndjeshëm numrin e pacientëve me patologji bashkëshoqëruese në kujdesin shëndetësor parësor, duke rritur kompleksitetin e menaxhimit klinik dhe organizativ. Kjo situatë shoqërohet me rritje të kërkesës për shërbime të vazhdueshme, monitorim të afërt dhe koordinim më të mirë të kujdesit shëndetësor, duke vendosur sfida të reja për sistemin dhe profesionistët e shëndetësisë.
Objektivat: Të analizojë trendin e rasteve komplekse gjatë viteve 2021–2025 dhe ndikimin e tyre në ngarkesën e shërbimit infermieror, si dhe të evidentojë nevojën për përmirësimin e praktikave të menaxhimit në kujdesin parësor.
Metodologjia: Studim përshkrues retrospektiv, i bazuar në analizën e të dhënave mesatare mujore për periudhën 2021–2025 në një qendër shëndetësore parësore. Të dhënat janë përpunuar duke llogaritur mesataren mujore nga totalet vjetore dhe janë analizuar për të identifikuar ndryshimet në kohë dhe ndikimin në ofrimin e shërbimit.
Rezultatet: Gjatë periudhës së studimit, popullsia e mbuluar u ul me 4.3%. Megjithatë, numri mesatar mujor i pacientëve me patologji bashkëshoqëruese u rrit me 81%, ndërsa pesha e tyre ndaj totalit të pacientëve me sëmundshmëri u rrit nga 33% në 57%. Numri mesatar mujor i recetave u rrit me 15.8%, duke reflektuar rritjen e kompleksitetit terapeutik dhe nevojën për menaxhim më të kujdesshëm të trajtimeve afatgjata.
Konkluzionet: Pavarësisht rënies demografike, vihet re rritje progresive e multimorbiditetit dhe e barrës së rasteve komplekse. Këto gjetje theksojnë nevojën për qasje të integruar, koordinim multidisiplinar dhe forcim të rolit të infermierit në menaxhimin afatgjatë të pacientëve kronikë. Gjithashtu, është e rëndësishme implementimi i strategjive të reja organizative dhe përdorimi i teknologjive shëndetësore për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e kujdesit.

Fjalë kyçe: *raste komplekse; patologji bashkëshoqëruese; multimorbiditet; kujdes shëndetësor parësor; rol i infermierit; menaxhim klinik; koordinim i kujdesit.*

MANAGEMENT OF COMPLEX CASES AND COMORBIDITIES IN PRIMARY HEALTH CARE

Leonora Morava [1], Stela Kole[2]
[1,2] Primary Health Care Center (Mollaj, Korçë), Albania
E-mail: leonoramorava61@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: The increase in life expectancy and the prevalence of chronic diseases have significantly increased the number of patients with comorbid pathologies in primary health care, increasing the complexity of clinical and organizational management. This situation is associated with an increase in demand for continuous services, close monitoring, and better coordination of health care, posing new challenges for the system and health professionals.
Objectives: To analyze the trend of complex cases during the years 2021–2025 and their impact on the workload of the nursing service, as well as to highlight the need for improvement of management practices in primary care.
Methodology: A descriptive retrospective study, based on the analysis of average monthly data for the period 2021–2025 in a primary health care center. The data were processed by calculating the monthly average from the annual totals and were analyzed to identify changes over time and the impact on service delivery.
Results: During the study period, the covered population decreased by 4.3%. However, the average monthly number of patients with comorbid pathologies increased by 81%, while their proportion relative to the total number of patients with morbidity increased from 33% to 57%. The average monthly number of prescriptions increased by 15.8%, reflecting the increase in therapeutic complexity and the need for more careful management of long-term treatments.
Conclusions: Despite demographic decline, a progressive increase in multimorbidity and the burden of complex cases is observed. These findings highlight the need for an integrated approach, multidisciplinary coordination, and strengthening of the nurse's role in the long-term management of chronic patients. Additionally, the implementation of new organizational strategies and the use of health technologies are important to improve the quality and efficiency of care.

Keywords: *Complex cases; comorbid pathologies; multimorbidity; primary health care; nurse's role; clinical management; care coordination.*

USHQYERJA ME QUMËSHT GJIRI: PËRFITIMET DHE SFIDAT GJATË GJIDHËNIES – NJË ANALIZË E FAKTORËVE PENGUES DHE PËRVOJAVE TË NËNAVE

Jurgena Lila[1]

[1]Klinika e Neonatologjisë, Spitali Rajonal Durrës
E-mail: jurishtrepi@yahoo.com

ABSTRAKTI

Hyrje: Ushqyerja me qumësht gjiri mbetet standardi më i lartë i ushqyerjes foshnjore, me përfitime të shumta për shëndetin fizik dhe emocional të fëmijës dhe nënës. Megjithatë, shumë nëna hasin vështirësi të konsiderueshme gjatë këtij procesi, që shpesh çojnë në ndërprerje të parakohshme të gjidhënies.
Objektivi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë natyrën dhe përhapjen e këtyre sfidave, si dhe të vlerësojë rolin e mbështetjes profesionale dhe informimit në përballimin e tyre.
Metodologjia: U zhvillua një studim përmes një ankete të strukturuar me 85 nëna të cilat kishin fëmijë të moshës 0-12 muaj. Të dhënat u mblodhën përmes pyetësorëve të shpërndarë në qendra shëndetësore, maternitet dhe online. Pyetjet përfshinin përvojat e tyre gjatë javëve të para të gjidhënies, vështirësitë e hasura, burimet e informacionit dhe nivelin e mbështetjes së marrë nga stafi mjekësor apo familjar.
Rezultatet: 70% e pjesëmarrëseve raportuan se kishin përjetuar të paktën një problem gjatë gjidhënies, ndër më të zakonshmet ishin: dhimbjet në thitha (48%), kapja jo e duhur e gjirit nga foshnja (39%) dhe ndjenja e mungesës së qumështit (33%). Vetëm 26% kishin pasur kontakt me një konsulent laktacioni ose personel të trajnuar për gjidhënien. Nënat që kishin pasur mbështetje profesionale kishin më shumë gjasa të vazhdonin ushqyerjen me gji për më shumë se 6 muaj.
Përfundime: Rezultatet tregojnë qartë se mungesa e informacionit praktik dhe mbështetjes profesionale janë faktorë kyç që ndikojnë negativisht në zgjatjen e gjidhënies. Rekomandohet përfshirja e konsulentëve të laktacionit në shërbimet bazë shëndetësore dhe zhvillimi i programeve edukative për gratë që në fazën antenatale.

Fjalë kyçe: *qumështi i gjirit, gjidhënia, vështirësitë gjatë gjidhënies, edukimi për nënat, mbështetja profesionale.*

BREASTFEEDING: BENEFITS AND CHALLENGES DURING LACTATION – AN ANALYSIS OF BARRIERS AND MOTHERS' EXPERIENCES

Jurgena Lila[1]
[1]Neonatology Clinic, Durres Regional Hospital
E-mail: jurishtrepi@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Breastfeeding is considered the gold standard of infant nutrition, providing numerous physical, immunological, and emotional benefits for both the child and the mother. According to the World Health Organization, exclusive breastfeeding is recommended for the first six months of life. However, despite well-documented recommendations and benefits, a significant number of mothers face various challenges during the breastfeeding process, which often lead to early discontinuation.

Objective: The aim of this study is to analyze the nature and prevalence of the challenges encountered by mothers during breastfeeding and to assess the impact of professional support and level of information on coping with and overcoming these difficulties.

Methodology: The study was conducted through a structured survey involving 85 mothers with children aged 0–12 months. Data were collected using questionnaires distributed in healthcare centers, maternity hospitals, and online platforms. The questionnaire included questions regarding mothers' experiences during the first weeks of breastfeeding, the difficulties encountered, sources of information, and the level of support received from healthcare professionals and family members.

Results: The results showed that 70% of participants reported experiencing at least one problem during breastfeeding. The most reported difficulties included nipple pain (48%), improper latch (39%), and the perception of insufficient milk supply (33%). Only 26% had contact with a lactation consultant or trained breastfeeding professional. Mothers who received professional support were more likely to continue breastfeeding for more than six months.

Conclusions: The findings clearly indicate that a lack of practical information and professional support are key factors negatively affecting the duration of breastfeeding. The inclusion of lactation consultants in primary healthcare services and the development of educational programs for women during the antenatal period are strongly recommended.

Keywords: *Breast milk, breastfeeding, breastfeeding difficulties, maternal education, professional support.*

INTEGRIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE (AI) NË INTERPRETIMIN E RADIOGRAFIVE, ME QËLLIM DETEKTIMIN E FRAKTURAVE KOCKORE

Sidorela Rexhepi[1], Bukurie Halili[1], Grejsi Axhi[2], Erneda Kaziu[3]

[1] Spitali Universitar i Traumës
[2] Studente Teknik Imazherie viti III.
[3] Spitali Universitar i Traumës
E-mail: sidorelarexhepi@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Diagnostikimi në kohë i frakturave kockore përbën një element thelbësor në parandalimin e komplikacioneve. Radiografia, megjithëse mbetet metoda imazherike e linjës së parë për vlerësimin e tyre, jo gjithmonë arrin të identifikojë linjat e frakturave në momentin fillestar të traumës. Në këtë kontekst, zhvillimet e fundit në inteligjencën artificiale (AI), veçanërisht algoritmet e deep learning dhe convolutional neural networks (CNN), kanë demonstruar performancë të lartë diagnostike në detektimin dhe lokalizimin e frakturave. Integrimi i këtyre programeve në praktikën radiografike paraqet një qasje premtuese për rritjen e ndjeshmërisë diagnostike dhe reduktimin e gabimeve.

Objektivat: Kjo temë synon të shqyrtojë potencialin e aplikimit të software-ve të inteligjencës artificiale (AI) në radiografi, me qëllim diagnostikimin e frakturave kockore. Në një rishikim të literaturës shkencore do të paraqitet performanca e këtyre software-ve, duke përfshirë Gleamer, Azmed, Boneview Trauma dhe Radiobotics, me fokus në ndjeshmërinë (sensitivity) dhe specifikën (specificity) në diagnostikim. Qëllimi është të ofrohet një pamje gjithëpërfshirëse e mënyrës se si algoritmat AI mund të asistojnë profesionistët e shëndetit në diagnostikimin më të shpejtë dhe më të saktë të frakturave kockore.

Konkluzionet: Inkorporimi i software-ve të inteligjencës artificiale (AI), duke përdorur algoritme deep learning dhe *CNN*, në radiografi ka rritur ndjeshëm specifikën për diagnostikimin e frakturave kockore. Megjithatë, në rastet e frakturave komplekse dhe të dislokuar, ky efekt nuk u vu re në të njëjtën mënyrë. Kjo tregon se algoritmet e deritanishme nuk janë ende të përgatitura për të zëvendësuar plotësisht mjekun radiolog; prandaj, ato duhet të konsiderohen si një mbështetje për mjekun, dhe jo si një mënyrë për ta zëvendësuar atë.

Fjalë kyçe: *AI (inteligjenca artificiale), deep learning, machine learning, convolutional neural networks, radiografi, fraktura kockore, software.*

INTEGRATION OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE SOFTWARE IN RADIGRAPHIC X-RAY IN ORDER TO DETECT BONE FRACTURES

Sidorela Rexhepi[1], Bukurie Halili[1], Grejsi Axhi[2], Erneda Kaziu[3]

[1] University Trauma Hospital
[2] Student Radiologic technologist, grade III
[3] University Trauma Hospital
E-mail: sidorelarexhepi@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Accurate diagnosis of bone fractures represents a fundamental element in preventing complications. Even though radiography remains the first-line imaging method for their evaluation, it may happen a miss diagnosis of fracture at first moment of trauma. In this context, recent developments in AI (artificial intelligence), particularly deep learning algorithms and convolutional neural networks (CNN), have demonstrated high diagnostic performance in the detection and localization of fractures. The integration of these systems into radiographic practice represents a promising approach for increasing diagnostic sensitivity and reducing diagnostic errors.

Purpose: This study aims to examine the potential application of AI software in radiography to diagnose bone fractures. During a review of the scientific literature, we will evaluate the performance of AI software (Gleamer, Azmed, Boneview trauma, Radiobotics), including their impact on the sensitivity and specificity of bone fracture detection during radiographic examinations. The purpose is to provide a comprehensive overview of how AI algorithms can assist healthcare professionals in achieving a faster and accurate diagnosis of bone fractures.

Conclusion: The integration of AI software with deep learning algorithms and CNN into radiographic workstations has significantly improved the sensitivity and specificity of bone fracture detection. However, in cases of complex fractures and dislocations this was less evident. This suggests that current algorithms aren't sufficiently developed to fully replace radiologists, this is why they should be considered a supportive tool that assist radiologists rather than a way to replace them.

Keyword: *AI (artificial intelligence), deep learning, machine learning, convolutional neural networks, radiography, bone fracture, software.*

TRAJNIMI ME SIMULIM PËR INFERMIERËT NË SISTEMIN EMERGJENT MJEKËSOR: INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË DHE INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË KUJDESIN EMERGJENT

Nuhi Mucmata[1], Skënder Brataj[2], Indrit Jaupaj[2], Ermal Haxhiasi[2]

[1]Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM), Tiranë, Shqipëri
[2]Shoqata Shqiptare e Urgjencës Mjekësore dhe Katastrofave (SHSHUMK-AAEMD), Shqipëri
E-mail: nuhimucmata@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Trajnimi i bazuar në simulim është bërë një qasje thelbësore në edukimin e kujdesit emergjent paraspitalor, duke ofruar një mjedis të sigurt dhe të kontrolluar për zhvillimin e aftësive klinike dhe përmirësimin e vendimmarrjes. Për infermierët e shërbimit emergjent (EMS), të cilët operojnë shpesh në situata me rrezik të lartë dhe presion kohor, simulimi përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të forcuar kompetencat teknike dhe besimin profesional.
Objektivi: Ky studim synon të vlerësojë ndikimin e trajnimit me simulim në performancën klinike dhe saktësinë e vendimmarrjes tek infermierët e shërbimit emergjent, si dhe përputhshmërinë e tij me standardet operative të sistemit EMS 127 në Shqipëri.
Metodologjia: Është përdorur një qasje vëzhguese e bazuar në praktikë, duke kombinuar literaturën ndërkombëtare me të dhëna empirike nga trajnimet me simulim të realizuara nga QKUM dhe SHSHUMK-AAEMD. Rezultatet janë vlerësuar përmes krahasimeve para dhe pas trajnimit, duke u fokusuar në performancën klinike, saktësinë e vendimmarrjes dhe menaxhimin ekipor të skenarëve emergjentë me kompleksitet të lartë, si dhe në përputhjen me protokollet e EMS 127.
Rezultatet: Trajnimi me simulim u shoqërua me përmirësime të dukshme në performancën individuale dhe saj në ekip. Kompetenca klinike u rrit me rreth 40% krahasuar me trajnimin tradicional, ndërsa saktësia në vendimmarrje u përmirësua nga 68% në 91% pas përdorimit të skenarëve të strukturuar. Gabimet klinike u reduktuan me 25-38%, veçanërisht në situata komplekse. Gjithashtu, u vu re përmirësim në koordinimin e ekipit, respektimin e protokolleve dhe standardizimin e praktikës klinike.
Konkluzione: Zbatimi sistematik i trajnimit me simulim në nivel kombëtar në kuadër të sistemit EMS 127 ka potencial të standardizojë edukimin profesional, të përmirësojë performancën klinike dhe të rrisë cilësinë e kujdesit ndaj pacientit. Integrimi i metodologjive të avancuara të simulimit, përfshirë teknologjitë dhe skenarët e mbështetur nga inteligjenca artificiale, përfaqëson një qasje moderne për forcimin e shërbimeve emergjente.

Fjalë kyçe: *Trajnim me simulim, infermierë EM, performancë klinike, vendimmarrje, Shqipëri.*

SIMULATION-BASED TRAINING FOR EMERGENCY HEALTH SYSTEM NURSES: INTEGRATING TECHNOLOGY AND AI IN EMERGENCY CARE

Nuhi Mucmata[1], Skender Brataj[2], Indrit Jaupaj[2], Ermal Haxhiasi[2]
[1]National Emergency Medical Center (QKUM), Tirana, Albania
[2]Albanian Association of Emergency Medicine and Disasters (SHSHUMK-AAEMD), Albania
E-mail: nuhimucmata@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Simulation-based training has become an essential educational approach in prehospital emergency care, offering a safe and controlled environment for developing clinical skills and enhancing decision-making. For EMS nurses, who frequently operate in high-risk and time-critical situations, simulation provides a valuable opportunity to strengthen both technical competencies and professional confidence.

Objective: This study aims to evaluate the impact of simulation-based training on clinical performance and decision-making accuracy among EMS nurses, as well as its alignment with the operational standards of the EMS 127 system in Albania.

Methodology: An observational, practice-based evaluation combined recent international literature with empirical data from simulation training sessions conducted by QKUM and SHSHUMK-AAEMD. Outcomes were assessed through pre- and post-training comparisons, focusing on clinical performance, decision-making accuracy, and team management of high-acuity scenarios, alongside alignment with EMS 127 protocols.

Results: Simulation-based training was associated with clear improvements in both individual and team performance. Clinical competence increased by approximately 40% compared to traditional training, while decision-making accuracy improved from 68% to 91% following structured simulation (SCENEM). Clinical errors decreased by 25-38%, particularly in complex situations. Improvements were also observed in team coordination, protocol adherence, and overall standardization of practice.

Conclusions: The systematic implementation of simulation-based training at a national level within the EMS 127 system has the potential to standardize professional education, enhance clinical performance, and improve the overall quality of patient care. Integrating advanced simulation methodologies, including technology-supported and AI-enhanced scenarios, represents a forward-looking approach to strengthening emergency medical services.

Keywords: *Simulation training; EMS nurses; clinical performance; decision-making; Albania.*

STRESI PROFESIONAL DHE SINDROMA E BURNOUT-IT NË PROFESIONET SHËNDETËSORE

Eralda Dervishi[1], Elisabeta Çaushi [2]

[1] Shërbimi i Nefrologjisë, QSUT, Tiranë
[2] Qendra e Konsultave Ambulatore
E-mail: eraldadervishi85@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Stresi profesional dhe burnout përbëjnë një sfidë të rëndësishme në profesionet shëndetësore, veçanërisht në infermieri, ku kërkesat fizike dhe emocionale janë të vazhdueshme. Burnout-i përkufizohet si një sindromë e karakterizuar nga lodhja emocionale, depersonalizimi dhe reduktimi i ndjenjës së arritjes personale si pasojë e ekspozimit të zgjatur ndaj stresit në punë. Studimet e fundit tregojnë një rritje të ndjeshme të prevalencës së këtij fenomeni në nivel global.
Objektivat: Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë prevalencën, faktorët kontribues dhe pasojat e stresit profesional dhe burnout-it në profesionet shëndetësore, me fokus tek infermierët.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim narrativ të literaturës shkencore të publikuar gjatë viteve 2020–2025. U analizuan artikuj nga databaza ndërkombëtare si PubMed, Scopus dhe revista të indeksuara, duke përfshirë studime observacionale, meta-analiza dhe raporte institucionale.
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se burnout-i është shumë i përhapur ndër profesionistët shëndetësorë. Prevalenca e lodhjes emocionale varion rreth 30–40%, ndërsa depersonalizimi rreth 25–30%. Gjatë pandemisë COVID-19, nivelet e burnout-it tek infermierët u rritën ndjeshëm. Faktorët kryesorë përfshijnë ngarkesën e lartë të punës, mungesën e stafit, oraret e zgjatura dhe mungesën e mbështetjes organizative. Pasojat përfshijnë rritjen e gabimeve klinike, uljen e cilësisë së kujdesit dhe ndikime negative në shëndetin mendor dhe fizik të profesionistëve.
Konkluzionet: Burnout-i mbetet një problem kritik për sistemet shëndetësore dhe kërkon ndërhyrje të strukturuara në nivel individual dhe institucional. Përmirësimi i kushteve të punës, mbështetja psikologjike dhe promovimi i mirëqenies janë thelbësore për reduktimin e këtij fenomeni dhe për ruajtjen e cilësisë së kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyçe: *stresi profesional, burnout, profesionet shëndetësore, mirëqenia psikologjike, lodhja emocionale, menaxhimi i stresit.*

OCCUPATIONAL STRESS AND BURNOUT IN HEALTHCARE PROFESSIONS

Eralda Dervishi[1], Elisabeta Çaushi[2]
[1] Nephrology Service, QSUT, Tirana, Albania
[2] Outpatient Consultation Center
E-mail: eraldadervishi85@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Occupational stress and burnout represent a significant challenge in healthcare professions, particularly in nursing, where physical and emotional demands are continuous. Burnout is defined as a syndrome characterized by emotional exhaustion, depersonalization, and a reduced sense of personal accomplishment, resulting from prolonged exposure to workplace stress. Recent studies indicate a substantial increase in the prevalence of this phenomenon at a global level.

Objectives: The aim of this study is to evaluate the prevalence, contributing factors, and consequences of occupational stress and burnout in healthcare professions, with a particular focus on nurses.

Methodology: This study is based on a narrative review of the scientific literature published between 2020 and 2025. Articles from international databases such as PubMed, Scopus, and indexed journals were analyzed, including observational studies, meta-analyses, and institutional reports.

Results: Findings indicate that burnout is highly prevalent among healthcare professionals. The prevalence of emotional exhaustion ranges from approximately 30–40%, while depersonalization ranges from 25–30%. During the COVID-19 pandemic, burnout levels among nurses increased significantly. Key contributing factors include high workload, staff shortages, extended working hours, and lack of organizational support. Consequences include increased clinical errors, reduced quality of care, and negative impacts on the mental and physical health of professionals.

Conclusions: Burnout remains a critical issue for healthcare systems and requires structured interventions at both individual and institutional levels. Improving working conditions, providing psychological support, and promoting well-being are essential for reducing this phenomenon and maintaining the quality of healthcare delivery.

Keywords: *Professional burnout, emotional exhaustion, nursing workforce, healthcare systems, workplace stress.*

SESION PARALEL

SESIONI II

SALLA 4

ABSTRAKTET

SHËNDETËSIA DIGJITALE DHE TRANSFORMIMI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Luljeta Habilaj [1], Juljana Xhindoli [2]

[1] Master Shkencor në Shkenca Infermierore,

[2] Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës, Albania.

E-mail: luljetahabilaj123@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Shëndetësia digjitale i referohet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mjekësi. Shëndetësia digjitale po transformon ndjeshëm shërbimet e kujdesit shëndetësor duke përmirësuar cilësinë, aksesin dhe efikasitetin e tyre, ndërsa në Shqipëri kjo fushë po zhvillohet gradualisht si pjesë e modernizimit të sistemit shëndetësor.

Qëllimi: Shqyrtimi i literaturës në lidhje me shëndetësinë digjitale dhe transformimin e shërbimeve shëndetësore.

Metodologjia: Ky punim është një rishikim literature, ku materialet që u përdorën për realizimin e këtij studimi janë gjetur nëpërmjet kërkimit elektronik sistematik për artikuj të botuar në vitetet e fundit, 2023-2025 duke përfshirë libraritë online të PubMed. U identifikuan 10 artikuj, por në shqyrtim u përfshin rezultatet e 4 studimeve që kishin lidhje me tematikën, duke përfshirë dhe rishikime të literaturës.

Rezultatet: Studimi i parë tregon ndikimet pozitive që u raportuan në sistemet shëndetësore (n=4, 25), studimi i dytë tregon ndikimin e shëndetësisë digjitale në 8 fusha të identitetit profesional, në studimin e tretë tregohet efektiviteti i ndërhyrjeve digjitale shëndetësore për menaxhimin e sëmundjeve kronike dhe në studimin e katërt tregohet se transformimi digjital i shërbimeve mjekësore ka një ndikim pozitiv në kënaqësinë e pacientit ($B = 0.387$, $t = 8.476$, $P < 0.001$).

Konkluzionet: Bazuar në analizën e studimeve, shihet se shëndetësia digjitale ka sjellë ndryshime duke pasur një qasje pozitive nga ana e pacientëve, por pa harruar vështirësitë dhe sfidat që ka në vetvete kjo risi.

Fjalë kyçe: *Shëndetësia digjitale, transformim, teknologji, pacient, benefite.*

DIGITAL HEALTH AND THE TRANSFORMATION OF HEALTH SERVICES

LuljetaHabilaj[1] , JuljanaXhindoli[2] .
[1] Master of Science in Nursing,
[2] Department of Health Care, Faculty of Health, University of Vlora, Albania.
E-mail: luljetahabilaj123@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Digital health refers to the use of information and communication technologies in medicine. It is significantly transforming healthcare services by improving quality, accessibility, and efficiency. In Albania, this field is gradually developing as part of the modernization of the healthcare system.
Objective: To review the literature related to digital health and the transformation of healthcare services.
Methodology: This study is a literature review. The materials used were identified through a systematic electronic search for articles published in recent years (2023–2025), including online databases such as PubMed. A total of 10 articles were identified, of which 4 studies relevant to the topic were included in the final analysis, including literature reviews.
Results: The first study highlights positive impacts on healthcare systems (n = 4, 25). The second study demonstrates the influence of digital health on eight domains of professional identity. The third study shows the effectiveness of digital health interventions in the management of chronic diseases. The fourth study indicates that the digital transformation of healthcare services has a positive impact on patient satisfaction ($B = 0.387$, $t = 8.476$, $P < 0.001$).
Conclusions: Based on the analysis of the selected studies, digital health has introduced significant changes and is generally associated with a positive patient perspective. However, challenges and limitations remain and should be addressed to ensure sustainable implementation.

Keywords: *Digital health, transformation, technology, patient, benefits.*

BARRIERA DHE MUNDËSI NË IMPLEMENTIMIN E TEKNOLOGJISË NË FIZIOTERAPI NË ZONAT RURALE TË QARKUT BERAT DHE QARKUT FIER: NJË QASJE E BAZUAR NË PRAKTIKËN KLINIKE

Fatjon Hajdari [1 3], Erina Hilaj [1], Lorenc Cili [2]

[1.] Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, FSHMT, Albanian University.
[2.] Infermier, Spitali Rajonal Berat
[3.] Alma Mater Europaea – University ECM, Maribor, Slloveni
E-mail: fatjonhajdari@live.com

ABSTRAKT

Hyrje: Zonat rurale në Qarku Berat dhe Qarku Fier përballen me kufizime të konsiderueshme në aksesin ndaj shërbimeve të fizioterapisë. Zhvillimi i teknologjive digjitale, përfshirë tele-rehabilitimin dhe aplikacionet mobile, ofron potencial të madh për të reduktuar këto pabarazi në kujdesin shëndetësor.

Qëllimi: Ky studim synon të analizojë barrierat dhe mundësitë për implementimin e teknologjisë në fizioterapi në zonat rurale të dy qarqeve, duke u bazuar në të dhëna të mbledhura nga praktika klinike dhe perceptimi i pacientëve.

Metodologjia: Studimi është realizuar duke përdorur një dizajn mixed-method. Të dhënat janë mbledhur nga pacientë që kanë ndjekur trajtim në një klinikë fizioterapie në Berat dhe nga komunitete rurale përreth, si dhe nga zona rurale të Fierit. Janë përdorur anketa të strukturuara dhe intervista për të vlerësuar aksesin në teknologji, përdorimin e smartphone-ve, gatishmërinë për tele-rehabilitim dhe pengesat kryesore. Gjithashtu, është analizuar një model pilot i konsultave online dhe ndjekjes së ushtrimeve në distancë.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë se mbi 70% e pacientëve posedojnë smartphone, por vetëm një pjesë e kufizuar kanë njohuri të mjaftueshme për përdorimin e aplikacioneve shëndetësore. Barrierat kryesore përfshijnë mungesën e internetit cilësor në zona të thella, mungesën e trajnimit për profesionistët dhe rezistencën fillestare të pacientëve të moshuar. Megjithatë, implementimi i një modeli të thjeshtë tele-rehabilitimi (video-konsulta + programe ushtrimesh të personalizuara) tregoi përmirësim të aderencës dhe reduktim të vizitave fizike të panevojshme.

Përfundime: Integrimi i teknologjisë në fizioterapi në zonat rurale të Shqipërisë është i realizueshëm dhe efektiv, veçanërisht përmes modeleve hibride të kujdesit. Investimet në edukimin digjital, infrastrukturën dhe trajnimin profesional janë thelbësore për një implementim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm

Fjalë kyçe: *Fizioterapi, tele-rehabilitim, teknologji digjitale, zona rurale, qarku Berat, qarku Fier, rehabilitim në distancë.*

BARRIERS AND OPPORTUNITIES IN THE IMPLEMENTATION OF TECHNOLOGY IN PHYSIOTHERAPY IN RURAL AREAS OF BERAT AND FIER REGIONS: A PRACTICE-BASED APPROACH

Fatjon Hajdari [1 3], Erina Hilaj [1], Lorenc Cili [2]

[1] Department of Nursing and Physiotherapy, Faculty of Health Sciences and Medical, Albanian University

[2] Nurse, Regional Hospital of Berat

[3] Alma Mater Europaea – University ECM, Maribor, Slovenia

E-mail: fatjonhajdari@live.com

ABSTRACT

Introduction: Rural areas in Berat and Fier regions face significant limitations in access to physiotherapy services. The development of digital technologies, including telerehabilitation and mobile applications, offers considerable potential to reduce these inequalities in healthcare delivery.

Aim: This study aims to analyze the barriers and opportunities for the implementation of technology in physiotherapy in rural areas of these two regions, based on data collected from clinical practice and patient perceptions.

Methodology: The study was conducted using a mixed-method design. Data were collected from patients who received treatment in a physiotherapy clinic in Berat, as well as from surrounding rural communities and rural areas of Fier. Structured questionnaires and semi-structured interviews were used to assess access to technology, smartphone usage, readiness for telerehabilitation, and the main barriers. Additionally, a pilot model of online consultations and remote exercise monitoring was analyzed.

Results: The findings indicate that over 70% of patients own a smartphone; however, only a limited proportion possess sufficient knowledge to use health-related applications effectively. The main barriers include poor internet connectivity in remote areas, lack of professional training, and initial resistance among elderly patients. Nevertheless, the implementation of a simple telerehabilitation model (video consultations combined with personalized exercise programs) demonstrated improved adherence and a reduction in unnecessary in-person visits.

Conclusions: The integration of technology in physiotherapy services in rural areas of Albania is feasible and effective, particularly through hybrid care models. Investments in digital education, infrastructure, and professional training are essential for successful and sustainable implementation.

Keywords: *Physiotherapy, telerehabilitation, digital technology, rural areas, Berat region, Fier region, remote rehabilitation.*

ROLI KRITIK I MAMISË NË IDENTIFIKIMIN E HERSHËM DHE MENAXHIMIN E HEMORRAGJISË POSTPARTUM GJATË FAZËS SË KATËRT TË LINDJES

Blerina Bracellari [1]

[1] Spitali Rajonal Korçë
E-mail: b.agolli@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Faza e katërt e lindjes, e përcaktuar si dy orët e para pas daljes së placentës, përfaqëson periudhën më kritike për zhvillimin e komplikacioneve maternale, veçanërisht hemorragjinë postpartum (PPH), e cila mbetet një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë maternale në nivel global sipas World Health Organization. Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja e menjëhershme janë thelbësore për parandalimin e morbiditetit dhe mortalitetit maternal të rëndë.
Qëlimi: Ky prezantim synon të theksojë rolin thelbësor të mamisë në monitorimin sistematik, vlerësimin klinik dhe menaxhimin e hershëm të hemorragjisë postpartum gjatë fazës së katërt të lindjes.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një qasje të bazuar në evidencë, në përputhje me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare të International Confederation of Midwives. Theksi vendoset në praktikat klinike kyçe si vlerësimi i tonusit uterin, monitorimi i shenjave vitale çdo 15 minuta, vlerësimi i gjakderdhjes vaginale dhe identifikimi i hershëm i instabilitetit hemodinamik, të mbështetura nga literatura shkencore bashkëkohore mbi menaxhimin e hemorragjisë postpartum.
Konkluzione: Mamija përfaqëson linjën e parë të mbrojtjes në parandalimin dhe menaxhimin e hemorragjisë postpartum gjatë fazës së katërt të lindjes. Monitorimi i strukturuar, vendimmarrja e shpejtë klinike dhe zbatimi rigoroz i protokolleve standarde janë masa jetike që reduktojnë ndjeshëm morbiditetin dhe mortalitetin maternal, duke forcuar njëkohësisht autonominë profesionale të mamisë në sistemin shëndetësor.

Fjalë kyçe: *Hemorragjia postpartum, faza e katërt e lindjes, mamia, monitorimi klinik, uterotonikët, vdekshmëria maternale.*

THE CRITICAL ROLE OF THE MIDWIFE IN THE EARLY IDENTIFICATION AND MANAGEMENT OF POSTPARTUM HEMORRHAGE DURING THE FOURTH STAGE OF LABOR

Blerina Bracellari [1]
[1] Korca Regional Hospital
E-mail: b.agolli@yahoo.com

ABSTRACT

Background: The fourth stage of labor, defined as the first two hours following placental delivery, represents the most critical period for maternal complications, particularly postpartum hemorrhage (PPH), which remains one of the leading causes of maternal mortality worldwide according to the World Health Organization. Early recognition and prompt intervention are essential to prevent severe maternal morbidity and mortality.

Objective: This presentation aims to highlight the pivotal role of the midwife in systematic monitoring, clinical assessment, and early management of postpartum hemorrhage during the fourth stage of labor.

Methodology: This work is based on an evidence-based approach aligned with international professional standards and recommendations from the International Confederation of Midwives. The focus is on key clinical practices including uterine tone assessment, monitoring of vital signs every 15 minutes, evaluation of vaginal bleeding, and early detection of hemodynamic instability, supported by current scientific literature on postpartum hemorrhage management.

Conclusions: The midwife represents the first line of defense in the prevention and management of postpartum hemorrhage during the fourth stage of labor. Structured monitoring, rapid clinical decision-making, and strict adherence to standardized protocols are essential measures that significantly reduce maternal morbidity and mortality and reinforce the professional autonomy of midwives within the healthcare system.

Keywords: *Postpartum hemorrhage, fourth stage of labor, midwife, clinical monitoring, uterotonic agents, maternal mortality.*

MENAXHIMI I TALASEMISË NË PRAKTIKËN KLINIKE: RËNDËSIA E DIAGNOSTIKIMIT TË HERSHËM DHE TERAPIVE MODERNE

Franceska Gjyshja[1]
[1] Qendër Shëndetesore
E-mail: francakurti12@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Talasemia është një çrregullim gjenetik i trashëguar që ndikon në sintezën e hemoglobinës, duke shkaktuar prodhim të reduktuar ose jonormal të saj. Si pasojë, eritrocitet kanë jetëgjatësi të shkurtuar dhe aftësi të kufizuar për transportin e oksigjenit, duke çuar në anemi kronike. Kjo patologji mbetet një problem i rëndësishëm shëndetësor publik, veçanërisht në rajonin mesdhetar.
Objektivat: Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një përmbledhje të përditësuar mbi talasemine, duke përfshirë patofiziologjinë, klasifikimin, manifestimet klinike, diagnostikimin dhe opsionet e trajtimit, si dhe për të theksuar rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe menaxhimit efektiv.
Metodologjia: Ky studim bazohet në një rishikim narrativ të literaturës shkencore të publikuar gjatë 5–10 viteve të fundit, duke përfshirë artikuj nga revista ndërkombëtare, udhëzime klinike dhe databaza të njohura si PubMed dhe WHO.
Rezultatet: Analiza tregon se talasemia klasifikohet në alfa dhe beta talasemi, me një spektër të gjerë klinik nga forma asimptomatike deri në forma të rënda që kërkojnë transfuzione të rregullta gjaku. Diagnostikimi i hershëm, përmes testeve hematologjike dhe gjenetike, luan rol kyç në përmirësimin e prognozës. Trajtimi përfshin transfuzione periodike, terapi keluese për hekurin dhe transplant të palcës së kockës në raste të përzgjedhura. Terapia gjenike paraqitet si një alternativë inovative me rezultate premtuese.
Konkluzione: Talasemia vazhdon të jetë një sfidë e rëndësishme në kujdesin shëndetësor. Megjithatë, përparimet në diagnostikim dhe trajtim kanë përmirësuar ndjeshëm mbijetesën dhe cilësinë e jetës së pacientëve. Strategjitë parandaluese dhe këshillimi gjenetik janë thelbësore për reduktimin e incidencës.

Fjalë kyçe: *Talasemia, menaxhimi klinik, diagnostikimi i hershëm, terapi moderne, transfuzion gjaku, terapi me kelatorë të hekurit, komplikacione, kujdes multidisiplinar.*

MANAGEMENT OF THALASSEMIA IN CLINICAL PRACTICE: THE IMPORTANCE OF EARLY DIAGNOSIS AND MODERN THERAPIES

Franceska Gjyshja[1]
[1] Primary Health Care Center
E-mail: francakurti12@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Thalassemia is an inherited genetic disorder that affects hemoglobin synthesis, leading to reduced or abnormal production. As a result, red blood cells have a shortened lifespan and limited oxygen-carrying capacity, resulting in chronic anemia. This condition remains a significant public health concern, particularly in the Mediterranean region.
Objectives: The aim of this paper is to provide an updated overview of thalassemia, including its pathophysiology, classification, clinical manifestations, diagnosis, and treatment options, while emphasizing the importance of early diagnosis and effective management.
Methodology: This study is based on a narrative review of scientific literature published over the past 5–10 years, including articles from international journals, clinical guidelines, and well-known databases such as PubMed and WHO.
Results: Analysis shows that thalassemia is classified into alpha and beta thalassemia, with a wide clinical spectrum ranging from asymptomatic forms to severe cases requiring regular blood transfusions. Early diagnosis, through hematological and genetic testing, plays a key role in improving prognosis. Treatment includes periodic transfusions, iron chelation therapy, and bone marrow transplantation in selected cases. Gene therapy emerges as an innovative alternative with promising outcomes.
Conclusions: Thalassemia continues to be a significant challenge in healthcare. However, advances in diagnosis and treatment have substantially improved patient survival and quality of life. Preventive strategies and genetic counseling are essential for reducing incidence.

Keywords: *Thalassemia, clinical management, early diagnosis, modern therapy, blood transfusion, iron chelation therapy, complications, multidisciplinary care.*

VLERËSIMI DHE ROLI I INFERMIERËVE LIDHUR ME KUJDESIN NDAJ FOSHNJAVE QË VUAJNË NGA HIDROCEFALIA

Sabirkë (Çollaku) Bogdani[1]
[1] Reparti o Reanimacionit dhe Terapisë Intensive Neonatologjike, Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni"
E-mail: sabicollaku@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Hidrocefalia është anomalia kongjenitale më e zakonshme e sistemit nervor qendror tek foshnjat. Shumë raste të fëmijëve hidrocefalikë janë përshkruar që nga kohërat e lashta. Karakterizohet nga akumulimi i tepërt i lëngut cerebrospinal (LSF) në tru, i cili mund të rrisë presionin intrakranial (ICP). Simptomatologjia e saj gjatë foshnjërisë ose fëmijërisë së hershme karakterizohet nga ënjtje e kokës, zgjatje e ballit dhe atrofi e trurit. Të gjitha këto simptoma shfaqen për shkak të rritjes së vëllimit të lëngut cerebrospinal, rritjes së presionit intrakranial dhe zgjerimit të mureve të ventrikulave.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të përshkruajë ndërlikimet e shuntit ventrikuloperitoneal tek pacientët pediatrikë dhe të nxjerrë në pah rolin e stafit infermieror në parandalimin e tyre.

Metodat: Kjo përfshin kërkimin e literaturës në bazën e të dhënave Medline dhe organizatat ndërkombëtare relevante të hidrocefalias për të identifikuar studime në lidhje me ndërlikimet e shuntit ventrikuloperitoneal dhe kujdesin infermieror për secilin ndërlikim.

Rezultatet: Shunti ventrikuloperitoneal është trajtimi i foshnjave hidrocefalikë, në vend të ventrikulostomisë së tretë endoskopike. Edhe pse vendosja e shuntit ventrikuloperitoneal është e suksesshme, pacientët zakonisht vuajnë nga ndërlikimet e mëvonshme. Ndërlikimet përfshijnë infeksionin postoperativ të shuntit, dështimin e vendosjes së shuntit, bllokimin - mosfunksionimin e shuntit, ndërlikimet abdominale - peritonitin, ndërlikimet e valvulave, sindromën e ventrikulit të çarë dhe krizat. Roli i stafit infermieror është jetik, veçanërisht në javët postoperative.

Përfundim: Një vlerësim i duhur infermieror përfshin identifikimin e vlefshëm të ndërlikimeve dhe trajtimin e tyre të shpejtë. Gjithashtu, infermierët duhej të zbatonin kujdes të saktë infermieror, në mënyrë që të parandalonin çdo ndërlikim.

Së fundmi, mësimdhënia prindërore nga infermierët është thelbësore në procesin e rezultateve shëndetësore për pacientin pediatrik.

Fjalë kyçe: *hidrocefalus, fëmijë, ndërlikime, shunt ventrikuloperitoneal, kujdes infermieror.*

ASSESSMENT AND THE ROLE OF NURSES IN THE CARE OF INFANTS WITH HYDROCEPHALUS

Sabirkë (Çollaku) Bogdani[1]
[1] Neonatal Resuscitation and Intensive Care Unit, University Obstetric-Gynecological Hospital "Koço Gliozheni"
E-mail: sabicollaku@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Hydrocephalus is the most common congenital anomaly of the central nervous system in infants. Many cases of hydrocephalic children have been described since ancient times. It is characterized by excessive accumulation of cerebrospinal fluid (CSF) in the brain, which can increase intracranial pressure (ICP). Its symptomatology during infancy or early childhood is characterized by swelling of the head, forehead protrusion and brain atrophy. All these symptoms appear due to an increase in the volume of cerebrospinal fluid, increased intracranial pressure and dilation of the ventricular walls.

Aim: The aim of this paper is to describe the ventriculoperitoneal shunt complications in pediatrics patients and to point out the role of nursing staff in the prevention of them. Methods: This includes literature search on the database Medline and relevant with that issue international hydrocephalus organizations to identify studies regarding the complications of ventriculoperitoneal shunt and the nursing care for each complication.

Results: Ventriculoperitoneal shunt is the treatment of hydrocephalic infants, rather than endoscopic third ventriculostomy. Although the success of the ventriculoperitoneal shunt's placement, the patients usually suffer from its afterwards complications. The complications involve postoperative shunt infection, shunt placement failure, shunt obstruction – malfunction, abdominal complications – peritonitis, valve complications, slit-ventricle syndrome and seizures. The role of nursing stuff is vital, particularly in the postoperative weeks.

Conclusion: A proper nursing assessment includes valid identification of complications and their prompt treatment. Also, nurses had to implement accurate nursing care, in order to prevent any complication. Finally, parental teaching from the nurses is crucial in the process of health outcomes for pediatric patients.

Keywords: *Hydrocephalus, children, complications, ventriculoperitoneal shunt, nursing care.*

ROLI I CALPROTEKTINES FEKALE NË SINDROMËN E ZORRËS SË IRRITUAR

Jona Bërdufi[1]

[1] Laborator "BioCare " Elbasan
E-mail: jonaberdufi6@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Sindroma e zorrës së irrituar është një çrregullim gastro-intestinal që ndikon në funksionimin normal të zorrës. Zakonisht lokalizohet në pjesën e poshtme të abdomenit dhe shoqërohet me një sërë shenjash karakteristike si dhimbje barku, fryrje dhe konstipacion/diarre. Nga ana tjetër, kalprotektina fekale është një proteinë që gjendet në neutrofile dhe gjatë proceseve inflamatore këto qeliza migrojnë drejt zorrës duke çliruar këtë proteinë.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë rolin e kalprotektinës fekale si marker jo invaziv në diferencimin e sindromës së zorrës së irrituar nga patologjitë inflamatore të zorrëve.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një përshkrim teorik dhe analizë të të dhënave laboratorike mbi përdorimin e kalprotektinës fekale si test diagnostik në pacientët me simptoma gastro-intestinale.
Rezultatet: Kalprotektina fekale njihet si një marker jo invaziv për vlerësimin e proceseve inflamatore në zorrë dhe ndihmon në reduktimin e nevojës për ekzaminime invazive si kolonoskopia. Në sindromën e zorrës së irrituar nuk ka prezencë të inflamacionit, prandaj kalprotektina zakonisht rezulton negative në testet laboratorike. Megjithatë, ajo ka një rol të rëndësishëm në pre-diagnostikim duke ndihmuar në diferencimin nga sindromat inflamatore të zorrës.
Konkluzione: Kalprotektina fekale, kur rezulton negative, është një marker i rëndësishëm diagnostik që ndihmon në përjashtimin e patologjive inflamatore të zorrëve dhe orienton drejt diagnozës së sindromës së zorrës së irrituar. Gjithashtu, ajo kontribuon në reduktimin e analizave dhe ekzaminimeve të panevojshme.

Fjalë kyçe: *Kalprotektina fekale, sindroma e zorrës së irrituar, neutrofile, diagnostikim.*

THE ROLE OF FECAL CALPROTECTIN IN IRRITABLE BOWEL SYNDROME

Jona Bërdufi[1]
"BioCare" Laboratory, Elbasan, Albania
E-mail: jonaberdufi6@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Irritable bowel syndrome (IBS) is a gastrointestinal disorder that affects the normal functioning of the intestine. It is usually localized in the lower abdomen and is associated with a range of characteristic symptoms such as abdominal pain, bloating, and constipation/diarrhea. On the other hand, fecal calprotectin is a protein found in neutrophils, and during inflammatory processes these cells migrate to the intestine and release this protein.
Objective: The aim of this study is to evaluate the role of fecal calprotectin as a non-invasive marker in differentiating irritable bowel syndrome from inflammatory bowel diseases.
Methodology: This paper is based on a theoretical description and analysis of laboratory data regarding the use of fecal calprotectin as a diagnostic test in patients with gastrointestinal symptoms.
Results: Fecal calprotectin is recognized as a non-invasive marker for assessing inflammatory processes in the intestine and helps reduce the need for invasive procedures such as colonoscopy. In irritable bowel syndrome, there is no presence of inflammation; therefore, fecal calprotectin typically yields negative results in laboratory tests. However, it plays an important role in pre-diagnosis by aiding in the differentiation from inflammatory bowel conditions.
Conclusions: Fecal calprotectin, when negative, is an important diagnostic marker that helps exclude inflammatory bowel diseases and supports the diagnosis of irritable bowel syndrome. Furthermore, it contributes to reducing unnecessary tests and procedures.

Keywords: *Fecal calprotectin, irritable bowel syndrome, neutrophils, diagnosis.*

PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË INTERPRETIMIN E IMAZHEVE RADIOLOGJIKE DHE DETEKTIMIN E FRAKTURAVE

Kristina Çako[1]
[1]Spitali Rajonal "Xhaferr Kongoli" Elbasan, Shqipëri.
E-mail: kristina.cakoo@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Radiologjia ka qenë një fushë lider në inovacionin digjital brenda kujdesit shëndetësor. Integrimi i sistemeve të imazheve dixhitale, PACS dhe teleradiologjisë ka transformuar rrjedhat diagnostikuese gjatë tre dekadave të fundit. Aktualisht, radiologjia po evoluon drejt shërbimeve diagnostikuese gjithëpërfshirëse, ku AI dhe teknologjitë e "Machine Learning" (ML) ofrojnë përmirësimin e saktësisë diagnostike, efikasitetit dhe integrimit të të dhënave klinike.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë ndikimin e AI në radiologji, duke vlerësuar përdorimin e "Convolutional Neural Networks" (CNN) dhe variantet e tyre në njohjen e modeleve në imazhet mjekësore, optimizimin e rrjedhave të punës radiologjike dhe zhvillimin e metodave radiomike për integrimin multimodal të të dhënave diagnostikuese.
Metodologjia: përfshiu zhvillimin dhe implementimin e një sistemi AI për detektimin automatik të frakturave të strukturave skeletore. Sistemi u testua për saktësinë diagnostike dhe reduktimin e kohës së interpretimit të imazheve, duke vlerësuar performancën e modeleve CNN në kontekste klinike të ndryshme dhe ndikimin e tyre në efikasitetin e rrjedhave të punës.
Rezultatet: demonstruan përmirësim të ndjeshëm të saktësisë diagnostike dhe reduktim të konsiderueshëm të kohës së interpretimit. Modelet CNN treguan aftësi të avancuara për përgjithësimin e diagnostikimit dhe përmirësimin e produktivitetit të shërbimeve radiologjike.
Përfundimet: Në përfundim, AI ka potencialin për të revolucionarizuar praktikën radiologjike duke mundësuar analiza gjithëpërfshirëse, integrim multimodal të të dhënave dhe rritje të efikasitetit. Megjithatë, adoptimi klinik kërkon vëmendje ndaj sfidave teknike dhe çështjeve etike për të siguruar përfitime optimale dhe siguri të pacientëve.

Fjalët kyçe: *AI, imazhe mjekësore, CNN, efikasitet, rrjedha e procesit.*

APPLICATION OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN THE INTERPRETATION OF RADIOLOGICAL IMAGES AND FRACTURE DETECTION

Kristina Çako [1]
[1] "Xhaferr Kongoli" Regional Hospital, Elbasan, Albania.
E-mail: kristina.cakoo@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Radiology has historically been a leading field in digital innovation within healthcare. The integration of digital imaging systems, PACS, and teleradiology has significantly transformed diagnostic workflows over the past three decades. Currently, radiology is evolving toward comprehensive diagnostic services, where AI and ML technologies provide advanced capabilities to enhance diagnostic accuracy, efficiency, and the integration of clinical data.
Objective: The purpose of this study is to examine the impact of AI in radiology, evaluating the use of Convolutional Neural Networks (CNN) and their variants for pattern recognition in medical images, optimizing radiology workflow efficiency, and developing radiomic approaches for multimodal data integration in diagnostic models.
Methodology: The methodology involved the development and implementation of an AI-based system for the automatic detection of skeletal fractures. The system was tested for diagnostic accuracy and reduction in image interpretation time, assessing the performance of CNN models in diverse clinical contexts and their effect on workflow efficiency.
Results; demonstrated a significant improvement in diagnostic accuracy and a substantial reduction in interpretation time. CNN models exhibited advanced generalization capabilities for diagnosis and enhanced productivity within radiology services.
Conclusion: AI has the potential to revolutionize radiological practice by enabling comprehensive analysis, multimodal data integration, and increased efficiency. However, clinical adoption requires careful consideration of technical challenges and ethical issues to ensure optimal benefits and patient safety.

Keywords: *AI, medical imaging, CNN, efficiency, workflow.*

KUJDESI RUTINË TË PORSALINDURIT NË 2 ORËT E PARA PAS LINDJES

Rigela Jatagani[1]
[1] Materniteti "Shtëpia e Lindjes", Korçë, Shqipëri
E-mail: rigeladine97@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Dy orët e para pas lindjes përbëjnë një periudhë kritike për adaptimin ekstrauterin të të porsalindurit. Stabilizimi i frymëmarrjes, ruajtja e temperaturës trupore dhe fillimi i ushqyerjes me gji janë faktorë kyç për mbijetesën dhe mirëqenien neonatale. Kujdesi i strukturuar dhe i bazuar në evidencë gjatë kësaj faze redukton ndjeshëm mortalitetin dhe morbiditetin neonatal.
Qëllimi: Të përshkruhen ndërhyrjet kryesore të kujdesit rutinë gjatë 120 minutave të para të jetës, në përputhje me udhëzimet më të fundit ndërkombëtare.
Metodologjia: Ky punim është një rishikim përshkrues i bazuar në analizën e udhëzimeve të fundit (2022–2025) nga organizata ndërkombëtare si OBSH dhe UNICEF mbi kujdesin esencial neonatal dhe menaxhimin e menjëhershëm pas lindjes.
Rezultatet: Praktikat thelbësore përfshijnë tharjen e menjëhershme të foshnjës dhe sigurimin e kontaktit lëkurë më lëkurë me nënën për të ruajtur temperaturën dhe për të nxitur lidhjen emocionale. Vlerësimi i frymëmarrjes dhe parametrave vitalë është i domosdoshëm për identifikimin e hershëm të komplikacioneve. Lidhja e vonuar e kordonit umbilikal përmirëson rezervat e hekurit, ndërsa fillimi i ushqyerjes me gji brenda orës së parë mbështet imunitetin dhe zhvillimin. Gjithashtu, rekomandohet administrimi i vitaminës K dhe profilaksisë okulare. Monitorimi i vazhdueshëm gjatë kësaj periudhe mundëson ndërhyrje të shpejtë në rast rreziku.
Përfundimi: Zbatimi sistematik i kujdesit rutinë në dy orët e para pas lindjes përmirëson ndjeshëm stabilitetin fiziologjik të të porsalindurit dhe redukton komplikacionet e hershme. Standardizimi i këtyre praktikave sipas udhëzimeve ndërkombëtare është thelbësor për përmirësimin e rezultateve perinatale.

Fjalë kyçe: *kujdes neonatal, të porsalindur, ushqyerja me gji, kontakt lëkurë më lëkurë, vitamina K.*

ROUTINE CARE OF THE NEWBORN IN THE FIRST 2 HOURS AFTER BIRTH

Rigela Jatagani[1]
[1] Maternity Hospital "Shtëpia e Lindjes", Korçë, Albania
E-mail: rigeladine97@gmail.com

ABSTRACT

Background: The first two hours after birth represent a critical period for newborn adaptation to extrauterine life. Stabilization of breathing, maintenance of body temperature, and initiation of breastfeeding are essential for neonatal survival and well-being. Evidence-based care during this phase significantly reduces neonatal mortality and morbidity.
Aim: To describe the key routine care interventions during the first 120 minutes of life in accordance with the latest international recommendations.
Methods: This study is a descriptive review based on recent guidelines (2022–2025) from international organizations such as WHO and UNICEF on essential newborn care and immediate postnatal management.
Results: Key practices include immediate drying of the newborn and skin-to-skin contact with the mother to maintain thermal regulation and promote bonding. Assessment of breathing and vital signs is crucial for early detection of complications. Delayed umbilical cord clamping improves iron stores, while early initiation of breastfeeding within the first hour supports immunity and development. Additionally, administration of vitamin K and ocular prophylaxis is recommended. Continuous monitoring during this period enables prompt intervention in case of risk.
Conclusions: Systematic implementation of routine care in the first two hours after birth significantly improves physiological stability and reduces early neonatal complications. Standardizing these practices according to international guidelines remains essential for improving perinatal outcomes.

Keywords: *Newborn care, neonatal, breastfeeding, skin-to-skin contact, vitamin K.*

MENAXHIMI I URGJENCAVE NË DEPARTAMENTIN E RADIOLOGJISË GJATË SEZONIT VEROR NË QARKUN E SARANDËS

Flogert Rraku[1]

[1] Spitali Rajonal i Sarandës, Sarandë, Shqipëri
E-mail: f.rraku@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Sezoni veror në Sarandë karakterizohet nga një rritje e ndjeshme e fluksit turistik, e cila shoqërohet me shtim proporcional të rasteve urgjente që kërkojnë vlerësim radiologjik të menjëhershëm. Këto urgjenca përfshijnë kryesisht trauma nga aksidentet rrugore, dëmtime gjatë aktiviteteve detare dhe incidente nga rëniet në lartësi. Kjo situatë krijon një ngarkesë të konsiderueshme për shërbimet radiologjike lokale, duke kërkuar organizim efikas, koordinim ndërdisiplinor dhe optimizim të burimeve ekzistuese.
Qëllimi: Qëllimi i këtij abstrakti është të paraqesë sfidat kryesore dhe strategjitë e menaxhimit të urgjencave radiologjike gjatë sezonit veror në këtë rajon. Metodologjia bazohet në përshkrimin e praktikës klinike dhe analizën e fluksit të pacientëve gjatë periudhave me ngarkesë të lartë.
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se përdorimi i protokolleve të standardizuara për trauma, prioritarizimi i rasteve sipas urgjencës klinike dhe implementimi i teknikave të shpejta diagnostike si radiografia dhe tomografia e kompjuterizuar (CT) janë thelbësore për menaxhimin efektiv. Gjithashtu, bashkëpunimi i ngushtë midis ekipeve të urgjencës, radiologëve dhe teknikëve të imazherisë përmirëson ndjeshëm kohën e përgjigjes dhe cilësinë e kujdesit.
Konkluzion: Si konkluzion, menaxhimi i suksesshëm i urgjencave radiologjike gjatë sezonit veror në Sarandë kërkon një qasje të integruar, fleksibilitet operacional dhe përkushtim maksimal nga personeli shëndetësor për të përballuar fluksin e lartë të pacientëve dhe kompleksitetin e rasteve traumatike.

Fjalë kyçe: *urgjenca radiologjike, trauma, sezon veror, Sarandë, menaxhim, CT, radiografi.*

MANAGEMENT OF EMERGENCIES IN THE RADIOLOGY DEPARTMENT DURING THE SUMMER SEASON IN THE SARANDA REGION

Flogert Rraku
Regional Hospital of Saranda, Saranda, Albania
E-mail: f.rraku@gmail.com

ABSTRACT

Itroduction: The summer season in Saranda is characterized by a significant increase in tourist flow, which is accompanied by a proportional rise in emergency cases requiring immediate radiological evaluation. These emergencies mainly include trauma from road traffic accidents, injuries related to marine activities, and incidents resulting from falls from height. This situation creates a considerable burden on local radiology services, requiring efficient organization, interdisciplinary coordination, and optimization of available resources.

The aim of this abstract is to present the main challenges and management strategies of radiological emergencies during the summer season in this region. The methodology is based on the description of clinical practice and the analysis of patient flow during peak periods.

The results show that the use of standardized trauma protocols, prioritization of cases based on clinical urgency, and the implementation of rapid diagnostic techniques such as radiography and computed tomography (CT) are essential for effective management. Furthermore, close collaboration between emergency teams, radiologists, and radiologic technologists significantly improves response time and quality of care.

Conclusion: In conclusion, the successful management of radiological emergencies during the summer season in Saranda requires an integrated approach, operational flexibility, and strong commitment from healthcare professionals to cope with the high patient volume and the complexity of traumatic cases.

Keywords: *Radiological emergencies, trauma, summer season, Saranda, management, CT, radiography.*

NDIKIMI I TEKNOLOGJISË DIGJITALE NË PËRMIRËSIMIN E KUJDESIT INFERMIEROR TEK PACIENTËT ME DIABET MELLITUS

Arjeta Bajraktari[1]

[1] Qendra Shëndetësore Postribë, Shkodër, Shqipëri
E-mail: bajraktariarjeta@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Diabeti mellitus përfaqëson një ndër sëmundjet kronike më të përhapura globalisht dhe kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe një qasje të strukturuar në kujdesin infermieror. Integrimi i teknologjive digjitale në praktikën shëndetësore ka krijuar mundësi të reja për përmirësimin e menaxhimit të sëmundjes, duke lehtësuar komunikimin ndërmjet infermierit dhe pacientit, duke mundësuar monitorim më të saktë të parametrave klinikë dhe rritje të përfshirjes së pacientit në vetë-menaxhim.

Qëllimi i studimit: Të vlerësohet ndikimi i përdorimit të teknologjisë digjitale në përmirësimin e cilësisë së kujdesit infermieror tek pacientët me diabet mellitus.

Objektivat: Të analizohet roli i teknologjisë në monitorimin e glicemisë; të vlerësohet ndikimi në përputhshmërinë me terapinë; të identifikohen përfitimet dhe sfidat e përdorimit të saj në praktikën infermierore.

Metodologjia: Studimi bazohet në rishikim të literaturës shkencore nga databaza ndërkombëtare si PubMed, Scopus dhe Google Scholar, duke përfshirë publikime të periudhës 2019–2025.

Rezultatet: Përdorimi i teknologjisë digjitale kontribuon në përmirësimin e kontrollit të glicemisë, rritjen e komunikimit infermier–pacient dhe përfshirjen e pacientit në vetë-menaxhim. Evidentohet gjithashtu reduktim i hospitalizimeve. Sfidat përfshijnë aftësi të kufizuara digjitale, vështirësi në akses ndaj teknologjisë dhe nevojën për trajnim profesional të vazhdueshëm.

Konkluzioni: Teknologjia digjitale është një komponent thelbësor në përmirësimin e kujdesit infermieror tek pacientët me diabet mellitus, duke kontribuar në menaxhim më efektiv të sëmundjes dhe rritjen e përfshirjes së pacientit në procesin e kujdesit. Integrimi i saj kërkon zhvillim të kompetencave profesionale dhe mbështetje infrastrukturore.

Fjalë kyç: *Teknologjitë digjitale, kujdesi infermieror, diabeti mellitus, vetë-menaxhimi i pacientit.*

THE IMPACT OF DIGITAL TECHNOLOGIES ON IMPROVING NURSING CARE IN PATIENTS WITH DIABETES MELLITUS

Arjeta Bajraktari [1]
[1] Postribë Health Center, Shkodër, Albania
E-mail: bajraktariarjeta@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Diabetes mellitus is one of the most prevalent chronic diseases worldwide, requiring continuous monitoring and a structured approach to nursing care. The integration of digital technologies into healthcare practice has created new opportunities for improving disease management by enhancing nurse–patient communication, enabling more accurate monitoring of clinical parameters, and increasing patient engagement in self-management.
Aim of the Study: To evaluate the impact of digital technologies on the quality of nursing care in patients with diabetes mellitus.
Objectives: To analyze the role of digital technologies in blood glucose monitoring; to assess their impact on treatment adherence; and to identify the benefits and challenges associated with their use in nursing practice.
Methodology: This study is based on a literature review of scientific publications from international databases such as PubMed, Scopus, and Google Scholar, including studies published between 2019 and 2025.
Results: The use of digital technologies contributes to improved glycemic control, enhanced nurse–patient communication, and increased patient involvement in self-management. Additionally, a reduction in hospital admissions has been observed. Challenges include limited digital literacy, restricted access to technology, and the need for ongoing professional training.
Conclusion: Digital technologies represent a key component in improving nursing care for patients with diabetes mellitus, contributing to more effective disease management and increased patient participation in care processes. Successful integration requires development of professional competencies and adequate infrastructural support.

Keywords: *Digital technologies, nursing care, diabetes mellitus, patient self-management.*

HIPERBILIRUBINEMIA NEONATALE: INCIDENCA, FAKTORËT E RREZIKUT DHE MENAXHIMI

Emrije Gjata[1]

[1] Neonatologjia, Spitali Rajonal Durrës, Shqipëri
E-mail: emriegjat@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Hiperbilirubinemia neonatale është një nga gjendjet më të shpeshta klinike tek të porsalindurit, e karakterizuar nga rritja e niveleve të bilirubinës në gjak. Edhe pse në shumicën e rasteve është fiziologjike dhe kalimtare, në disa raste mund të çojë në komplikacione serioze si kernikterusi, nëse nuk diagnostikohet dhe trajtohet në kohë.
Objektivat: Qëllimi i këtij studimi është të analizojë incidencën e hiperbilirubinemisë neonatale, të identifikojë faktorët kryesorë të rrezikut dhe të vlerësojë strategjitë aktuale të menaxhimit për parandalimin e komplikacioneve.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim të literaturës shkencore të publikuar gjatë viteve të fundit (2019–2025), duke përfshirë studime klinike, meta-analiza dhe udhëzime ndërkombëtare mbi diagnostikimin dhe trajtimin e hiperbilirubinemisë neonatale.
Rezultatet: Studimet tregojnë se incidenca e hiperbilirubinemisë neonatale është e lartë, duke prekur mbi 60% të të porsalindurve në ditët e para të jetës. Faktorët kryesorë të rrezikut përfshijnë prematuritetin, incompatibilitetin ABO/Rh, ushqyerjen e pamjaftueshme me gji, infeksionet neonatale dhe faktorët gjenetikë. Menaxhimi bazohet kryesisht në monitorimin e niveleve të bilirubinës, përdorimin e fototerapisë dhe, në raste të rënda, transfuzionin e shkëmbimit. Evidenca tregon se ndërhyrja e hershme dhe ndjekja e protokolleve standarde redukton ndjeshëm rrezikun e komplikacioneve neurologjike.
Konkluzione: Hiperbilirubinemia neonatale mbetet një sfidë e rëndësishme në kujdesin neonatal, por menaxhimi i hershëm dhe i strukturuar mund të parandalojë komplikacionet serioze. Identifikimi i faktorëve të rrezikut dhe zbatimi i udhëzimeve klinike janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve shëndetësore tek të porsalindurit.

Fjalë kyçe: *Hiperbilirubinemia neonatale, bilirubina, fototerapia, kernikterus, të porsalindurit, menaxhim klinik.*

NEONATAL HYPERBILIRUBINEMIA: INCIDENCE, RISK FACTORS AND MANAGEMENT

Emrije Gjata[1]
[1]Neonatology Department, Regional Hospital of Durrës, Albania
E-mail: emriegjat@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Neonatal hyperbilirubinemia is one of the most common clinical conditions in newborns, characterized by elevated levels of bilirubin in the blood. Although in most cases it is physiological and transient, in some cases it may lead to serious complications such as kernicterus if not diagnosed and treated in time.

Objectives: The aim of this study is to analyze the incidence of neonatal hyperbilirubinemia, identify the main risk factors, and evaluate current management strategies for the prevention of complications.

Methodology: This study is based on a review of scientific literature published in recent years (2019–2025), including clinical studies, meta-analyses, and international guidelines on the diagnosis and treatment of neonatal hyperbilirubinemia.

Results: Studies show that the incidence of neonatal hyperbilirubinemia is high, affecting more than 60% of newborns in the first days of life. The main risk factors include prematurity, ABO/Rh incompatibility, inadequate breastfeeding, neonatal infections, and genetic factors. Management is mainly based on monitoring bilirubin levels, the use of phototherapy, and in severe cases, exchange transfusion. Evidence shows that early intervention and adherence to standard protocols significantly reduce the risk of neurological complications.

Conclusions: Neonatal hyperbilirubinemia remains an important challenge in neonatal care; however, early and structured management can prevent serious complications. Identification of risk factors and implementation of clinical guidelines are essential for improving health outcomes in newborns.

Keywords: *Neonatal hyperbilirubinemia, bilirubin, phototherapy, kernicterus, newborns, clinical management.*

SESION PARALEL

SESIONI I

SALLA 5

ABSTRAKTET

RENDI I MBUSHJES SË TUBAVE ME GJAK NË FLEBOTOMI: RËNDËSIA PËR CILËSINË PRE - ANALITIKE

[1]Emirela Cenomeri, [2]Venemin Gega

[1]Shërbimi i Laboratorit Klinik-Biokimik, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
E-mail: emirelacenomeri@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Rendi i mbushjes së tubave "order of draw", përfaqëson një komponent kyç të fazës pre-analitike në flebotomi, duke luajtur rol të rëndësishëm në parandalimin e kontaminimit ndërmjet tubave me aditivë të ndryshëm dhe në sigurimin e saktësisë së rezultateve laboratorike. Sipas World Health Organization (WHO), kontaminimi i mostrave mund të çojë në interpretim të gabuar klinik dhe misdiagnostikim. Qëllimi i këtij punimi është të përmbledhë rëndësinë praktike dhe klinike të rendit të mbushjes së tubave gjatë venopunksionit, në kontekstin e parandalimit të gabimeve pre-analitike.

Metodologjia: U realizua një rishikim i literaturës duke përfshirë udhëzime ndërkombëtare dhe studime të publikuara mbi "order of draw", kontaminimin me EDTA dhe dallimet ndërmjet sistemeve të hapura dhe të mbyllura të marrjes së gjakut.

Rezultatet: Rendi i rekomanduar i mbushjes së tubave përfshin: kulturat e gjakut, tubat me citrat, tubat për serum (me ose pa aktivator koagulimi), tubat me heparinë, tubat me EDTA dhe, në fund, tubat me inhibitor të glikolizës. Evidenca bashkëkohore sygjeron se mosrespektimi i "order of draw" ka ndikim minimal në sistemet e mbyllura, ndërsa në sistemet e hapura mbetet një faktor i rëndësishëm rreziku për kontaminim, veçanërisht me EDTA, duke ndikuar potencialisht në interpretimin klinik të rezultateve.

Konkluzionet: Respektimi i "order of draw" përfaqëson një praktikë të thjeshtë, por thelbësore për standardizimin e procedurave të flebotomisë, reduktimin e gabimeve pre-analitike dhe garantimin e sigurisë së pacientit, veçanërisht në kushte jo optimale ose në përdorimin e teknikave të hapura të mbledhjes së gjakut.

Fjalë kyçe: *Flebotomi; faza pre-analitike; order of draw.*

ORDER OF DRAW IN PHLEBOTOMY: IMPORTANCE FOR PRE-ANALYTICAL QUALITY

[1]Emirela Cenomeri, [2]Venemin Gega[1]
[1]Department of Clinical-Biochemical Laboratory, University Hospital Center "Mother Teresa"
[2]Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"
E-mail: emirelacenomeri@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: The order of draw represents a key component of the pre-analytical phase in phlebotomy, playing an important role in preventing cross-contamination between tubes with different additives and in ensuring the accuracy of laboratory results. According to the World Health Organization (WHO), sample contamination can lead to incorrect clinical interpretation and misdiagnosis. The aim of this paper is to summarize the practical and clinical importance of the order of draw during venipuncture, in the context of preventing pre-analytical errors.
Methodology: A literature review was conducted including international guidelines and published studies on the order of draw, EDTA contamination, and differences between open and closed blood collection systems.
Results: The recommended order of draw includes blood culture bottles, citrate tubes, serum tubes (with or without clot activator), heparin tubes, EDTA tubes, and finally, glycolysis inhibitor tubes. Contemporary evidence suggests that non-compliance with the order of draw has minimal impact in closed systems, whereas in open systems it remains a significant risk factor for contamination, particularly with EDTA, potentially affecting clinical interpretation of results.
Conclusions: Adhering to the order of draw represents a simple yet essential practice for standardizing phlebotomy procedures, reducing pre-analytical errors, and ensuring patient safety, especially under suboptimal conditions or when using open blood collection techniques.

Keywords: *Phlebotomy; pre-analytical phase; order of draw.*

ANALIZA RETROSPEKTIVE E SHTRIMEVE SPITALORE NË QARKUN E ELBASANIT (2022–2025)

Adrian Beti[1], Alion Sejdini[2], Klea Karumi[3]

[1] Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Elbasan.
[2] President i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, Qarku Elbasan
[3]Infermiere në Spitalin Rajonal të Elbasanit
E-mail: a_beti@hotmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Hospitalizimet urgjente përfaqësojnë një komponent thelbësor të funksionimit të spitaleve rajonale dhe një indikator të rëndësishëm të ngarkesës së sistemit shëndetësor.
Objektivi: Ky studim synon të analizojë fluksin dhe tendencat e hospitalizimeve urgjente në Spitalin Rajonal Elbasan gjatë periudhës 2022–2025, me fokus në identifikimin e modeleve epidemiologjike dhe implikimeve për menaxhimin e shërbimit të urgjencës.
Metodologjia: U realizua një studim retrospektiv, bazuar në të dhëna administrative spitalore, të analizuara përmes statistikës përshkruese dhe krahasuese. Variablat kryesore përfshinin karakteristikat demografike, grupmosha, gjinia, diagnozat kryesore, pavijonin e shtrimit. Nga analiza u përjashtuan urgjencat kirurgjikale, materniteti, ortopedia, pediatria dhe psikiatria, pasi këto shërbime disponojnë regjistrim të veçantë dhe funksionojnë si sektorë të ndarë nga urgjenca qëndrore, e cila përbënte burimin e të dhënave të studimit.
Rezultatet: Gjatë periudhës së studimit u analizuan gjithsej 9,214 hospitalizime urgjente. Viti 2025 paraqiti numrin më të lartë të shtrimeve me 2,713 hospitalizime. Ndër diagnozat kryesore të evidentuara u përfshinë patologjitë neurologjike, kardiovaskulare dhe respiratore. Aksidenti vaskular cerebral (AVC) rezultoi një ndër diagnozat më të shpeshta të regjistruara gjatë periudhës së studimit. U konstatuan gjithashtu variacione sezonale dhe një ngarkesë e qëndrueshme e shërbimit.
Përfundime: Hospitalizimet urgjente përbëjnë një sfidë strukturore për spitalet rajonale. Rezultatet e studimit mbështesin domosdoshmërinë e planifikimit strategjik të burimeve dhe të politikave të bazuara në evidencë për përmirësimin e menaxhimit

Fjalë kyçe: *Hospitalizime urgjente, urgjencë spitalore, spital rajonal, studim retrospektiv, menaxhim shëndetësor.*

RETROSPECTIVE ANALYSIS OF HOSPITALIZATIONS IN THE ELBASAN REGION (2022–2025)

Adrian Beti[1], Alion Sejdini[2], Klea Karumi[3]
[1] Order of Nurses of Albania, Elbasan Region.
[2] President of the Order of Nurses of Albania, Elbasan Region.
[3] Nurse at the Elbasan Regional Hospital
E-mail: a_beti@hotmail.com

ABSTRACT

Introduction: Emergency hospitalizations represent an essential component of the functioning of regional hospitals and an important indicator of the burden on the health system.
Objective: This study aims to analyze the flow and trends of emergency hospitalizations in the Elbasan Regional Hospital during the period 2022–2025, with a focus on identifying epidemiological patterns and implications for emergency service management.
Methodology: A retrospective study was conducted, based on hospital administrative data, analyzed through descriptive and comparative statistics. The main variables included demographic characteristics, age group, gender, main diagnoses, hospitalization ward, Surgical emergencies, maternity, orthopedics, pediatrics and psychiatry were excluded from the analysis, as these services have separate registration and operate as sectors separate from the central emergency, which constituted the source of the study data.
Results: During the study period, a total of 9,213 emergency hospitalizations were analyzed. The year 2025 presented the highest number of hospitalizations with 2,712 hospitalizations. Among the main diagnoses identified were neurological, cardiovascular and respiratory pathologies. Cerebral vascular accident (CVA) resulted to be one of the most frequent diagnoses registered during the study period. Seasonal variations and a stable service load were also found.
Conclusions: Emergency hospitalizations constitute a structural challenge for regional hospitals. The results of the study support the necessity of strategic resource planning and evidence-based policies to improve management.

Keywords: *Emergency hospitalizations, hospital emergency, regional hospital, retrospective study, health management.*

REHABILITIMI I ECJES NËPËRMJET ROBOTIKËS TEK PACIENTËT POST-STROKE

Kejdi Keci[1]

[1]Fizioterapist & Psikonutricionist
E-mail: kejdi1@icloud.com

ABSTRAKT

Hyrje: Stroke është një patologji me incidencë të lartë në popullatë dhe përbën një nga shkaqet kryesore të paaftësisë afatgjatë dhe mortalitetit në mbarë botën. Simptomat klinike dhe pasojat funksionale kërkojnë ndërhyrje të specializuara rehabilituese, ku teknologjitë moderne si robotika po marrin një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Përdorimi i metodave inovative në rehabilitim synon të rrisë efikasitetin e trajtimit dhe të përmirësojë rezultatet klinike në mënyrë të qëndrueshme.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të analizojë efektivitetin e përdorimit të robotikës në rehabilitimin e pacientëve post-Stroke dhe të vlerësojë ndikimin e saj në përmirësimin e funksioneve motorike dhe pavarësisë funksionale, duke kontribuar në rikthimin e cilësisë së jetës së pacientëve.

Metodologjia: Në studim u përfshinë pesë pacientë të diagnostikuar me Stroke në stadin akut, të cilët iu nënshtruan një programi rehabilitimi robotik për 30 ditë me seanca të përditshme. Vlerësimi u bazua në parametrat klinikë dhe funksionalë, duke analizuar ndryshimet para dhe pas trajtimit, si dhe progresin individual të secilit pacient gjatë periudhës së ndjekjes.

Rezultatet treguan se përdorimi i robotikës pati një ndikim pozitiv në përmirësimin e gjendjes së pacientëve, duke rritur forcën muskulore, koordinimin, ekuilibrin dhe aftësinë për të kryer aktivitetet e përditshme. U vu re gjithashtu përmirësim në ecje dhe në funksionalitetin e gjymtyrëve të prekura, si dhe një rritje e motivimit të pacientëve gjatë procesit rehabilitues.

Konkluzionet: Robotika rezulton një metodë efektive dhe premtuese në rehabilitimin post-Stroke. Megjithatë, prania e disa defiçiteve tregon nevojën për vazhdim të rehabilitimit dhe ndjekje afatgjatë për të arritur rezultate optimale dhe për të siguruar rikuperim funksional sa më të plotë.

Fjalë kyçe: *Stroke, pacient, robotika, rehabilitim, funksion motorik, cilësia e jetës, rikuperim funksional, terapi inovative.*

REHABILITATION OF WALKING THROUGH ROBOTICS IN POST-STROKE PATIENTS

Kejdi Keci[1]
[1]Physiotherapist & Psychonutritionist
E-mail: kejdi1@icloud.com

ABSTRACT

Introduction: Stroke is a pathology with a high incidence in the population and constitutes one of the main causes of long-term disability and mortality worldwide. Clinical symptoms and functional consequences require specialized rehabilitative interventions, where modern technologies such as robotics are taking an increasingly important role. The use of innovative methods in rehabilitation aims to increase the effectiveness of treatment and to improve clinical outcomes in a sustainable way.
The aim: This study is to analyze the effectiveness of the use of robotics in the rehabilitation of post-stroke patients and to evaluate its impact on the improvement of motor functions and functional independence, contributing to the restoration of patients' quality of life.
Methodology: The study included five patients diagnosed with stroke in the acute stage, who underwent a robotic rehabilitation program for 30 days with daily sessions. The evaluation was based on clinical and functional parameters, analyzing the changes before and after treatment, as well as the individual progress of each patient during the follow-up period.
The results: Showed that the use of robotics had a positive impact on improving the condition of patients, increasing muscle strength, coordination, balance, and the ability to perform daily activities. An improvement was also observed in walking and in the functionality of the affected limbs, as well as an increase in patient motivation during the rehabilitation process.
Conclusions: Robotics prove to be an effective and promising method in post-stroke rehabilitation. However, the presence of some deficits indicates the need for continuation of rehabilitation and long-term follow-up to achieve optimal results and to ensure as complete functional recovery as possible.

Keywords: *Stroke, patient, robotics, rehabilitation, motor function, quality of life, functional recovery, innovative therapy*

STUDENTËT E INFERMIERISË DHE UDHËHEQËSIT KLINIK NË SHQIPËRI: SI NDIKOJNË MARRËDHËNIET NË TË NXËNIT DHE REZULTATET E PRAKTIKËS KLINIKE

Valbona Lici[1]

[1]Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni"
E-mail: valilici392@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Praktikat klinike përbëjnë një nga komponentët më të rëndësishëm të edukimit në infermieri, pasi u mundësojnë studentëve të kalojnë nga teoria në praktikën reale. Në Shqipëri, ku sistemi shëndetësor është në zhvillim të vazhdueshëm, marrëdhënia midis studentëve të infermierisë dhe udhëheqësve klinikë merr një rëndësi të veçantë. Një marrëdhënie mbështetëse dhe respektuese ndihmon në rritjen e vetëbesimit, angazhimit dhe përgatitjes profesionale të studentëve, ndërsa një marrëdhënie e dobët mund të krijojë pasiguri dhe stres gjatë trajnimit.
Qëllimi: Ky studim synon të eksplorojë se si marrëdhënia midis studentëve të infermierisë dhe udhëheqësve klinikë në Shqipëri ndikon në perceptimin e studentëve për rolin e udhëheqësit dhe në përvojën e tyre të përgjithshme gjatë praktikës klinike.
Metodologjia: U realizua një studim transversal me studentë të infermierisë në nivel bachelor, të cilët kryenin praktikat klinike në institucione të ndryshme shëndetësore në Shqipëri. Të dhënat u mblodhën përmes intervistave të drejtëpërdrejta. Pyetjet u fokusua në përvojat e studentëve lidhur me mbështetjen nga udhëheqësit klinikë, komunikimin, feedback-un dhe udhëzimin klinik. Të dhënat u analizuan për të identifikuar lidhjet midis këtyre faktorëve dhe rezultateve të perceptuara të të nxënit.
Rezultatet: Studentët që e përshkruan marrëdhënien me udhëheqësit klinikë si mbështetëse dhe komunikative raportuan një kënaqësi më të lartë nga praktika klinike, vetëbesim më të madh në aftësitë e tyre dhe një ndjenjë më të fortë zhvillimi profesional. Feedback-u i rregullt dhe udhëzimi i qartë rezultuan elementë kyç të përvojave pozitive. Në të kundërt, studentët që përjetuan ndërveprim të kufizuar ose pritshmëri të paqarta raportuan më pak vetëbesim dhe më shumë stres gjatë praktikës.
Konkluzione: Gjetjet theksojnë se cilësia e marrëdhënies student-udhëheqës klinik në Shqipëri luan një rol vendimtar në formësimin e përvojës së të nxënit dhe rezultateve të praktikës klinike. Nxitja e mentorimit cilësor dhe përmirësimi i komunikimit midis udhëheqësve klinikë dhe studentëve mund të kontribuojë ndjeshëm në përmirësimin e edukimit infermieror dhe në përgatitjen më të mirë të profesionistëve të ardhshëm.

Fjalë kyçe: *Edukim infermieror, praktikë klinike, marrëdhënie student-udhëheqës klinik, Shqipëri, mentorim, përvojë e të nxënit.*

NURSING STUDENTS AND CLINICAL SUPERVISORS IN ALBANIA: HOW RELATIONSHIPS SHAPE LEARNING AND CLINICAL INTERNSHIP OUTCOMES

Valbona Lici [1]
[1] University Hospital of Obstetrics and Gynecology "Koço Gliozheni"
E-mail: valilici392@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Clinical internships are a fundamental component of nursing education, enabling students to transition from theoretical knowledge to real-world practice. In Albania, where the healthcare system is continuously evolving, the relationship between nursing students and clinical supervisors holds particular importance. A supportive and respectful relationship can enhance students' confidence, engagement, and professional readiness, whereas a weaker relationship may lead to uncertainty and stress during training.

Aim: This study aims to explore how the relationship between nursing students and clinical supervisors in Albania influences students' perceptions of the supervisor's role and their overall clinical internship experience.

Methodology: A cross-sectional study was conducted among undergraduate nursing students undertaking clinical internships in various healthcare institutions across Albania. Data were collected through face-to-face interviews. The questions focused on students' experiences regarding support from clinical supervisors, communication, feedback, and clinical guidance. The data were analyzed to identify relationships between these factors and perceived learning outcomes.

Results: Students who described their relationship with clinical supervisors as supportive and communicative reported higher satisfaction with their clinical internships, greater confidence in their clinical skills, and a stronger sense of professional development. Regular feedback and clear guidance emerged as key elements of positive experiences. In contrast, students who experienced limited interaction or unclear expectations reported lower confidence and higher levels of stress during their training.

Conclusions: The findings highlight that the quality of the student–clinical supervisor relationship in Albania plays a crucial role in shaping both learning experiences and clinical internship outcomes. Promoting effective mentorship and improving communication between supervisors and students can significantly enhance nursing education and better prepare future healthcare professionals.

Keywords: *Nursing education, clinical internship, student–clinical supervisor relationship, Albania, mentorship, learning experience.*

RËNDËSIA E METODËS SCHROTH NË TRAJTIMIN E PACIENTËVE ME SKOLIOZË IDIOPATIKE TEK MOSHA E ADOLESHENCËS

Shefqet Çullhaj[1]

[1]Master i shkencave në fizioterapi

E-mail: shefqetcullhaj44@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje dhe qëllimi: Skolioza idiopatike është një deformim tridimensional i shtyllës kurrizore që shfaqet kryesisht gjatë adoleshencës dhe mund të ndikojë negativisht në funksionin fizik, posturën dhe cilësinë e jetës. Metoda Schroth përfaqëson një qasje konservative fizioterapeutike, e bazuar në ushtrime specifike tridimensionale dhe teknika të frymëmarrjes, që synojnë korrigjimin postural dhe stabilizimin e shtyllës kurrizore. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë efektivitetin e metodës Schroth në reduktimin e dhimbjes dhe përmirësimin e funksionit tek pacientët me skoliozë idiopatike në moshën e adoleshencës.

Metodologjia: Studimi përfshiu 47 pacientë të diagnostikuar me skoliozë idiopatike, të ndjekur gjatë vitit 2024 në Spitalin Universitar të Traumës (SUT), Tiranë. Prej tyre, 59.58% ishin femra dhe 40.42% meshkuj. Diagnostikimi u realizua nëpërmjet rezonancës magnetike (55.32%) dhe radiografisë (44.68%). Pacientët u monitoruan sipas periudhave tremujore gjatë vitit. Të dhënat u analizuan për të vlerësuar ndikimin e metodës Schroth në reduktimin e dhimbjes dhe përmirësimin e funksionit fizik dhe cilësisë së jetës.

Rezultatet: Rezultatet treguan një përmirësim të ndjeshëm klinik pas aplikimit të metodës Schroth. Mbi 80% e pacientëve raportuan reduktim të konsiderueshëm të dhimbjes dhe rritje të kapacitetit funksional. Gjithashtu, u vu re përmirësim i cilësisë së jetës dhe rikthim më i shpejtë në aktivitetet e përditshme pas një periudhe trajtimi 6-javore.

Përfundime: Metoda Schroth rezulton një ndërhyrje efektive në menaxhimin konservativ të skoliozës idiopatike tek adoleshentët. Ajo kontribuon në reduktimin e dhimbjes, përmirësimin e funksionit dhe rritjen e cilësisë së jetës. Përfshirja e saj në një qasje multidisiplinare rekomandohet për optimizimin e rezultateve terapeutike.

Fjalë kyçe: *Skoliozë idiopatike, metoda Schroth, adoleshentë, dhimbje, cilësia e jetës.*

THE IMPORTANCE OF THE SCHROTH METHOD IN THE TREATMENT OF PATIENTS WHITH IDIOPATHIC SCOLIOSIS IN ADOLESCENCE

Shefqet Çullhaj[1]
[1]Master of Science in Physiotherapy
E-mail: shefqetcullhaj44@gmail.com

ABSTRACT

Purpose: This scientific research aims to critically evaluate the effectiveness of the Schroth method in the treatment of patients with idiopathic scoliosis, through an analysis of a study group of patients monitored in the last year, respectively throughout 2024 at the University Hospital of Trauma, (SUT) Tirana.
Methodology: This study included 47 patients diagnosed with Idiopathic Scoliosis, of whom 59.58% are female and 40.42% are male. Patients were classified according to the period and method of diagnosis: In the period (January-March), we have a participation of 25.53%, in (April-June) 21.28%, in (July-September) 27.66% and in the last period of the year (October-December), 25.53%. According to the method of diagnosis, we are dealing with 55.32%, MRI examination and 44.68% X-ray examination. The data were collected and analyzed to evaluate the effectiveness of the therapies applied in reducing pain and improving the function of the patients.
Results: The results show that treating patients with the Schroth method has had a positive impact on improving pain and function in patients with Idiopathic Scoliosis. Patients reported a significant reduction in pain in over 80% of cases and an increase in quality of life after the application of these therapeutic techniques, enabling a return to daily activities for a 6-week treatment period.
Conclusions: The use of the Schroth method has an effect on pain management and improving quality of life in patients with Idiopathic Scoliosis. This study supports the use of this method as part of a multidisciplinary treatment for this pathology.

Keywords: *Idiopathic Scoliosis, ADAMs, Schroth Method, pain, quality of life.*

KUJDESI PËR PACIENTËT E IMOBILIZUAR NGA TRAUMA: IMPAKTI NË STAFIN INFERMIEROR DHE QASJET INOVATIVE NË MENAXHIM

Erdjesa Sena[1], Rezarta Tota[2] Xhejni Kurti[3]

[123]Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri
E-mail: senaerdjesa@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Aksidentet nga shkaku i nëntë thelbësor i mortalitetit dhe imobilitetit (1999) janë zhvendosur në shkakun e tretë në vitin 2020 në botë sipas OBSH. Nga viti 2014-2020 në Shqipëri në total janë regjistruar 12366 aksidente rrugore me pasojë në lëvizshmëri dhe fatalitete ku numri më i lartë rezulton në vitin 2016 dhe më i ulët në 2020. Pacientët e imobilizuar paraqesin një kategori me nevoja komplekse.

Objektivat: Të vlerësohet ndikimi i punës me pacientë të imobilizuar nga aksidentet në mirëqenien fizike, emocionale dhe profesionale te stafit infermieror në repartin e reanimacionit te Spitalit Universitar te Traumës.

Materiale dhe metoda: Studimi i kryer është një studim i llojit transversal. Ai është ndërmarrë në vitin 2025 në qytetin e Tiranës në Spitalin Universitar të Traumës në repartin e reanimacionit dhe ortopedisë. Pyetësori është zhvilluar për stafin infermieror me tematiken e ndikimit të punës me pacientë të imobilizuar nga aksidentet. Numri i pyetësorëve të plotësuar nga stafi është 79. Kampioni është llogaritur duke marrë në konsideratë IC = 95%, Proporcioni i popullatës = 7%, N=107, marzhin e gabimit = 5%. Gjithashtu u përdor regjistri i pacientëve të imobilizuar në këto pavione.

Rezultate: 48,1% e infermierëve raportuan gjendje emocionale të vështirë gjatë punës me pacientë të imobilizuar; 44,9% raportuan lodhje fizike të vazhdueshme, (mbi 5 vite përvojë në repartin e reanimacionit/ortopedisë) 53,2% e konsideronin punën me pacientë të imobilizuar si një nga faktorët kryesorë që ndikonin drejtpërdrejt në mirëqenien e jetesës së tyre. Eksperienca në punë ka një ndikim thelbësor në gjendjen emocionale të stafit infermieror. Rritja e eksperiencës në punë me 2 vite çon në zvogëlimin me 40% të stresit emocional dhe fizik të vetëperceptuar nga stafi infermieror. ($R=-0.49$ $p\leq0.001$)

Përfundime: Ky studim evidentoi se puna me pacientë të imobilizuar si pasojë e aksidenteve ka ndikim të theksuar psikologjik dhe emocional mbi stafin infermieror.

Fjalë kyç: *Pacientë të imobilizuar, stafi infermieror, stresi në punë.*

THE IMPACT OF WORKING WITH IMMOBILIZED PATIENTS FROM ACCIDENTS ON NURSING STAFF

Erdjesa Sena[1], Rezarta Tota[2] Xhejni Kurti[3]
[123]Department of Nursing and Physiotherapy, Faculty of Technical Medical Sciences, Aldent University,
E-mail: senaerdjesa@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Accidents, which ranked as the ninth leading cause of mortality and immobility in 1999, have shifted to the third leading cause globally by 2020, according to the WHO. From 2014 to 2020, a total of 12,366 road accidents were recorded in Albania, resulting in impaired mobility and fatalities, with the highest number reported in 2016 and the lowest in 2020.
Immobilized patients represent a category with complex needs. This study aims to evaluate the impact of working with accident-related immobilized patients on the physical, emotional, and professional wellbeing of nursing staff.
Materials and Methods: This is a cross-sectional study conducted in 2025 in the city of Tirana, at the University Trauma Hospital, in the departments of reanimation and orthopedics. A questionnaire focusing on the impact of working with immobilized patients was administered to nursing staff. A total of 79 complete questionnaires were collected.
The sample was calculated considering a 95% confidence interval, a population proportion of 7%, a population size (N) of 107, and a 5% margin of error. Additionally, patient registries for immobilized individuals in these departments were used.
Results: 48.1% of nurses reported emotional distress while working with immobilized patients; 44.9% reported continuous physical fatigue (with over 5 years of experience in the reanimation/orthopedic departments); and 53.2% considered working with immobilized patients as one of the main factors directly affecting their quality of life.
Work experience has a significant impact on the emotional state of nursing staff. An increase of 2 years in work experience leads to a 40% reduction in self-perceived emotional and physical stress among nursing staff ($R = -0.49$, $p \leq 0.001$).
Conclusions*:* This study highlighted that working with immobilized patients as a result of accidents has a significant psychological and emotional impact on nursing staff.

Keywords: *Immobilized patients, nursing staff, work-related stress*.

SKANIMET ME REZONANCË MAGNETIKE NË DISTANCË SI ZGJIDHJE STRATEGJIKE PËR MUNGESËN GLOBALE TË FUQISË PUNËTORE TË TEKNIKËVE TË IMAZHERISË: PËRVOJA E OMRIA NË SHQIPËRI

Elona Dybeli [1], Alexander Uwer [2], Alket Collaku [3]

[1] Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani", Elbasan, Shqipëri
[2] OMRIA, Berlin, Gjermani
[3] European Hospital Tirana, GVM Care & Research Group, Tiranë, Shqipëri
E-mail: elona.dybeli@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Sistemet e kujdesit shëndetësor në mbarë botën po përballen me mungesë të teknikëve të imazherisë për shkak të rritjes së kërkesës, lodhjes së stafit dhe shpërndarjes së pabarabartë të ekspertëve. Rezonanca Magnetike (MRI), si një metodë komplekse dhe e varur nga operatori, është veçanërisht e prekur. Në këtë kontekst, skanimi MRI në distancë është shfaqur si një zgjidhje inovative, duke lejuar ekspertët të mbështesin ekipet lokale dhe të ruajnë cilësi të lartë të imazhit.
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë rolin e skanimeve MRI në distancë në përballimin e mungesës globale të teknikëve të imazherisë, me fokus në praktikat ndërkombëtare dhe implementimin e sistemit OMRIA në Shqipëri, i cili mundëson kontroll në kohë reale dhe përmirëson bashkëpunimin midis stafit lokal dhe atij në distancë.
Metodologjia: U përdor një qasje deskriptive dhe observacionale, duke kombinuar përvojën ndërkombëtare të MRI në distancë me vlerësimin e zbatimit të sistemit OMRIA në Shqipëri. Analiza u fokusua në organizimin e rrjedhës së punës, komunikimin ndërmjet operatorëve lokalë dhe në distancë, cilësinë e imazhit, efikasitetin operacional dhe përshtatshmërinë në praktikën klinike.
Rezultatet: Skanimi MRI në distancë përmirësoi përdorimin e burimeve njerëzore në dispozicion duke lejuar ekspertizën e centralizuar për të mbështetur vende të shumta. Përvoja në Shqipëri demonstroi rrjedhe pune efikasë, më pak vonesa në ekzaminime dhe cilësi imazhi të shumë të mirë. Komunikimi i qartë midis operatorëve në distancë dhe atyre lokalë rezultoi të ishte thelbësor në sigurimin si të sigurisë së pacientit ashtu edhe të vazhdimësisë së kujdesit.
Konkluzione: Skanimi MRI në distancë ofron një zgjidhje efikase për mungesën globale të teknikëve të imazherisë. Përvoja shqiptare konfirmon fizibilitetin dhe vlerën klinike të saj, duke treguar se efikasiteti mund të përmirësohet pa kompromentuar cilësinë diagnostikuese. Ndërsa teknologjia dhe protokollet vazhdojnë të evoluojnë, skanimi në distancë ka të ngjarë të bëhet një pjesë integrale e praktikës moderne të radiologjisë.

Kyçe kyçe: *OMRIA, MRI në distancë, teleradiologji, mungesë fuqie punëtore,* teknikë imazherie*, efikasitet i rrjedhës së punës.*

REMOTE MRI SCANNING AS A STRATEGIC SOLUTION TO THE GLOBAL SHORTAGE OF RADIOGRAPHERS: THE EXPERIENCE OF OMRIA IN ALBANIA

Elona Dybeli [1], Alexander Uwer [2], Alket Collaku [3]
[1] University of Elbasan "Aleksander Xhuvani", Elbasan, Albania
[2] OMRIA, Berlin, Germany
[3] European Hospital Tirana, GVM Care & Research Group, Tirana, Albania
E-mail: elona.dybeli@uniel.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Healthcare systems worldwide are facing a growing shortage of radiographers, driven by increasing demand for imaging services, workforce burnout, and uneven distribution of experts. Magnetic Resonance Imaging (MRI), as a complex and highly operator-dependent modality, is particularly affected. In this context, remote MRI scanning has emerged as a promising and innovative solution, allowing experienced radiographers to operate scanners from a distance while supporting on-site teams and maintaining high standards of image quality.
Objective: This study aims to explore the role of remote MRI scanning as a practical response to the global shortage of radiographers, focusing on its impact on workflow efficiency, resource utilization, and diagnostic quality. Particular attention is given to international practices and to the integration of OMRIA in Albania, which enables real-time remote control of MRI examinations and strengthens collaboration between remote and on-site staff.
Methodology: A descriptive and observational approach was adopted, combining insights from international experience in remote MRI operations with an evaluation of the OMRIA implementation in Albania. The analysis focused on workflow organization, communication between remote and local operators, image quality, operational efficiency, and adaptability in routine clinical practice.
Results: Remote MRI scanning improved the use of available human resources by allowing centralized expertise to support multiple locations. The experience in Albania demonstrated smoother workflows, fewer examination delays, and image quality comparable to conventional on-site scanning. Clear communication between remote and local operators proved essential in ensuring both patient safety and continuity of care.
Conclusion: Remote MRI scanning offers a realistic and scalable solution to the global shortage of radiographers. The Albanian experience confirms its feasibility and clinical value, showing that efficiency can be improved without compromising diagnostic quality. As technology and protocols continue to evolve, remote scanning is likely to become an integral part of modern radiology practice.

Keywords: *OMRIA, remote MRI, teleradiology, workforce shortage, radiographers, workflow efficiency.*

AFRIMI I KUJDESIT PALIATIV: NGA DISTANCA TE KUJDESI ME DHEMBSHURI NË ZONAT RURALE TË SHQIPËRISË

Kristjana Sheshmina[1], Klea Gjata, Vasien Xhelili, Thimaq Karapanxho
[1]Qendra e Kujdesit Paliativ "Mary Potter" Korçë, Shqipëri
E-mail: kristjanasheshmina@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Miliona pacientë me sëmundje që i kufizojnë jetën jetojnë në zona të largëta rurale, duke u përballur me barriera të konsiderueshme në aksesin ndaj kujdesit paliativ. Zgjidhjet teknologjike ofrojnë një mundësi të rëndësishme për ta kapërcyer këtë hendek, duke siguruar dinjitet, komoditet dhe cilësi jetese për pacientët që kanë nevojë për këto shërbime.
Objektivat: Ky studim synon të tregojë se si teknologjia mund të përmirësojë ofrimin e kujdesit paliativ në zonat më të thella rurale të Shqipërisë, duke forcuar lidhjen ndërmjet pacientëve, familjarëve/kujdestarëve, ekipeve të hospice-it dhe shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor.
Metodologjia: Ky studim bazohet në përvojën e "Mary Potter" Hospice Albania, duke përdorur konsultat përmes telemjekësisë, monitorimin e simptomave dhe komunikimin digjital me ekipet e kujdesit shëndetësor parësor. Studimi përfshiu 77 pacientë që jetojnë në zona shumë të thella rurale gjatë periudhës 2020–2024. Të dhënat u mblodhën nga vëzhgimet e stafit, kartelat e pacientëve, rezultatet e shërbimit dhe feedback-u i pacientëve dhe familjarëve.
Rezultatet: Janë realizuar gjithsej 564 konsultime me video, me një mesatare prej 7.3 konsultimesh për pacient. Pacientët arritën të kalojnë më shumë kohë në shtëpi, duke ruajtur rehatinë dhe autonominë e tyre. Telemjekësia mundësoi komunikim në distancë me ekipin e hospice-it, duke lejuar raportimin e simptomave dhe ndryshimeve në gjendjen shëndetësore. Teknologjia përmirësoi aksesin në kujdes, mundësoi monitorim të vazhdueshëm dhe forcoi bashkëpunimin me ekipet e kujdesit shëndetësor parësor. U vu re një rritje e ndjeshme e përdorimit të telemjekësisë dhe ndjekjes së pacientëve gjatë viteve 2023–2024. Sfida kryesore mbetën kufizimet infrastrukturore dhe nevoja për përmirësimin e aftësive digjitale të pacientëve dhe profesionistëve.
Konkluzionet: Telemjekësia dhe mjetet digjitale janë thelbësore për zgjerimin e kujdesit paliativ te grupet me akses të kufizuar në kujdesin shëndetësor. Integrimi i tyre me trajnim të vazhdueshëm të stafit, bashkëpunim me kujdesin shëndetësor parësor dhe politika mbështetëse mund të transformojë ofrimin e kujdesit dhe të përmirësojë mirëqenien e pacientëve. Teknologjia shërben si një urë e rëndësishme për përmirësimin e aksesit në kujdesin paliativ në zonat rurale të largëta.

Fjalë kyçe: *Kujdesi paliativ; Telemjekësia; Shëndeti rural; Shëndeti digjital; Aksesi në kujdes*

BRINGING PALLIATIVE CARE CLOSER: FROM DISTANCE TO COMPASSION IN RURAL ALBANIA

[1] Kristjana Sheshmina, Klea Gjata, Vasien Xhelili, Thimaq Karapanxho
[1] Palliative Care Center "Mary Potter", Korçë, Albania
E-mail: kristjanasheshmina@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Millions of patients with life-limiting illnesses live in remote rural areas, facing significant barriers to accessing palliative care. Innovative technological solutions offer a unique opportunity to bridge this gap, ensuring dignity, comfort, and quality of life for patients in need of these services.

Objectives: To demonstrate how technology can enhance palliative care delivery for patients in Albania's most remote rural regions, strengthening connections between patients and family members/caregivers, hospice teams, and Primary Health Care providers.

Methodology: This study draws on the experience of "Mary Potter" Hospice Albania, implementing telemedicine consultations, symptom monitoring, and digital communication with Primary Health Care teams. The study included 77 patients living in very remote rural areas during the period 2020–2024. Data were collected from staff observations, patient records, service outcomes, and feedback from patients and caregivers.

Results: A total of 564 video consultations were conducted, with an average of 7.3 consultations per patient. Patients were able to spend more of their disease trajectory at home, preserving comfort and autonomy. Telemedicine enabled remote communication with the hospice team, allowing reporting of symptoms and changes in condition. Technology improved access to care, facilitated ongoing assessment and monitoring, and strengthened collaboration with Primary Health Care teams. A notable increase in telemedicine use and follow-up intensity was observed during 2023–2024. Challenges included infrastructure limitations and the need for improved digital literacy among patients and providers.

Conclusions: Telemedicine and digital tools are vital for extending palliative care to underserved rural populations. Integrating technology with staff training, collaboration with Primary Health Care providers, and supportive health policies can transform care delivery and improve patient well-being. Technology acts as a critical bridge in improving access to palliative care services in remote rural areas.

Keywords: *Palliative care, telemedicine, reural health, digital health, access to care.*

STRATEGJITË, NDËRHYRJET PËR TË PËRMIRËSUAR MIRËQENIEN E PROFESIONISTËVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE PËR TË REDUKTUAR BURNOUT-IN

Gjergji Mance[1], Mimoza Llavdaniti[2]
[1] Spitali Rajonal "Omer Nishani"Gjirokastër
[2] Universiteti "Eqerem Çabej" Gjirokastër
E-mail: mancegjergji@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Mirëqenia e profesionistëve të kujdesit shëndetësor ka marrë vëmendje të rëndësishme në vitet e fundit, veçanërisht për shkak të rritjes së stresit dhe ndikimeve negative që kanë lindur nga faktorë të ndryshëm, si ngarkesa e punës, kushtet e vështira dhe situatat emergjente, si pandemia COVID-19. Vërejtjet e shumta mbi nivelin e burnout-it në këtë sektor çojnë në pasiguri të lartë emocionale dhe fizike.

Objektivat: Të identifikohen strategjitë dhe ndërhyrjet aktuale të zbatuara për të përmirësuar mirëqenien e profesionistëve të kujdesit shëndetësor. Të vlerësohet efektiviteti i strategjive në reduktimin e burnout-it dhe përmirësimin e shëndetit mendor dhe fizik. Të eksplorohen faktorët që kontribuojnë tek profesionistët e shëndetësisë. Të jepen rekomandime të bazuara në evidencë për zhvillimin dhe zbatimin e programeve të qëndrueshme.

Metodologjia: Ky studim përdor një rishikim sistematik të literaturës për të analizuar kërkimet ekzistuese mbi strategjitë dhe ndërhyrjet për mirëqenien e profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe reduktimin e burnout-it. Përzgjedhja e studimeve u bazua në kritere të përcaktuara qartë për të identifikuar tendencat, boshllëqet dhe praktikat bashkëkohore.

Rezultatet: Gjetjet e këtij punimi tregojnë se ndërhyrjet e bazuara në mindfulness, programet e mbështetjes kolegjiale dhe strategjitë organizative, si përmirësimi dhe fleksibiliteti i orareve, reduktojnë nivelin e burnout-it dhe përmirësojnë mirëqenien psikologjike dhe fizike të profesionistëve. U identifikua se mungesa e burimeve, ngarkesa e lartë e punës dhe mbështetja e pamjaftueshme institucionale mbeten pengesat kryesore në funksionimin e shërbimit shëndetësor.

Konkluzionet: Duke zbatuar praktikat më bashkëkohore dhe ndërkombëtare, mund të reduktohet burnout-i në sistemin shëndetësor në Shqipëri, në mënyrë që të mos mbetet pengesë për të ardhmen dhe të mos ndikojë negativisht në brezin e ri në shërbimin shëndetësor dhe në mjekësinë moderne.

Fjalët kyçe: *Burnout, mindfulness, mbështetje kolegjiale, strategji, COVID-19*

STRATEGIES, INTERVENTIONS TO IMPROVE THE WELL-BEING OF HEALTH CARE PROFESSIONALS AND TO REDUCE BURNOUT

Gjergji Mance[1], Mimoza Llavdaniti[2]
[1] Ministry of Health, Regional Hospital "Omer Nishani", Gjirokastër
[2] University "Eqerem Çabej", Gjirokastër
E-mail: mancegjergji@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: The well-being of health care professionals has received significant attention in recent years, especially due to the increase in stress and negative impacts that have arisen from various factors, workload, difficult conditions and in emergency situations such as the covid-19 pandemic. The high level of burnout in this sector leads to high emotional and physical insecurity.
Objectives: To identify the current strategies and interventions implemented to improve the well-being of health care professionals. To assess the effectiveness of strategies in reducing burnout and improving mental and physical health. Evidence-based recommendations for the development and implementation of sustainable programs are important to health professionals.
Methodology: This study uses a systematic review of the literature to analyze existing research on strategies and interventions for the well-being of health care professionals towards reducing burnout. The selection of studies was based on clearly defined criteria to identify trends, gaps and contemporary practices
Results: This work shows that interventions based on mindfulness, peer support programs and organizational strategies, improvement and flexibility of schedules, reductions in burnout levels in psychological and physical well-being of professionals. It was identified that lack of resources, high workload and insufficient institutional support remain the main obstacles to the functioning of the health service.
Conclusions: By mentioning the most contemporary and global practices, burnout in the health system in Albania can be reduced so that it does not remain an obstacle for the future and is attributed to the new generation in the health service in modern medicine.

Keywords: *Burnout, mindfulness, peer support, strategy, Covid-19.*

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË IMAZHERINË E GJIRIT: ROLI NË VLERËSIMIN E HERSHËM TË KARCINOMËS SË GJIRIT - RISHIKIM I LITERATURËS

Irena Piroli[1], Gentian Zervoi[2], Erla Mullalli[1], Elian Shehi[3], Enkeleda Karanxha[3]

[1] Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazherisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Western Balkans University
[2] Spitali Amerikan
[3] Western Balkans University
E-mail: irenapiroli@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Karcinoma e gjirit mbetet tumori më i përhapur në popullatën femërore në mbarë botën dhe një prej shkaktarëve kryesor të vdekjeve nga sëmundjet malinje. Modalitet imazherike si mamografia, ekografia, tomografia digjitale e gjirit (DBT) dhe MRI luajnë një rol kyç në screenining, diagnostikim dhe vlerësim e sëmundjes. Në vitet e fundit, inteligjenca artificiale (AI) po përdoret gjithnjë e më shumë në imazherinë e gjirit, duke mundësuar zbulimin e hershëm të lezioneve të dyshimta tek individët me faktorë rreziku të lartë si dhe si gjetje incidentale gjatë ekzaminimeve rutinë.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë rolin e AI në vlerësimin e hershëm të karcinomës së gjirit përmes modaliteteve imazherike, duke theksuar efikasitetin, përfitimet dhe kufizimet e saj në praktikën klinike.

Metodologjia: Për këtë studim u analizuan 31 studime klinike të publikuara në databaza shkencore si PubMed, NIH dhe Google Scholar. Kërkimi i literaturës u bë duke përdorur fjalët kyçe: kancer i gjirit, radiologji, mamografia, US, DBT, MRI dhe inteligjencë artificiale. U përfshinë studime që vlerësonin performancën e algoritmeve të AI me fokus në zbulimin e hershëm të kancerit.

Konklzuione: Inteligjenca artificiale po zë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në vlerësimin e hershëm të karcinomës së gjirit, duke identifikuar lezione të vogla dhe të vështira për t'u dalluar me metoda tradicionale. Algoritmet e radiomikës dhe të mësimit të thellë (DL) mund të zbulojnë modele teksturale dhe hapësinore në imazhe që lidhen me natyrën malinje të tumoreve. Megjithatë, përdorimi i gjerë kërkon kalibrim, validim në popullata të ndryshme dhe integrim të sigurt në praktikën klinike. Gjetjet aktuale sugjerojnë se IA mund të bëhet një mjet standard ndihmës, por nevojiten më shumë studime të mirëdizajnuara.

Fjalë kyçe: *Diagnozë, inteligjenca artificiale, kanceri i gjirit, radiologji.*

ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN BREAST IMAGING: THE ROLE IN EARLY ASSESSMENT OF BREAST CARCINOMA – A LITERATURE REVIEW

Irena Piroli[1], Gentian Zervoi[2], Erla Mullalli[1], Elian Shehi[3], Enkeleda Karanxha[3]
[1] Department of Medical Laboratory Sciences and Imaging, Faculty of Technical Medical Sciences, Western Balkans University, Tirana, Albania
[2] American Hospital
[3] Western Balkans University
E-mail: irenapiroli@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Breast carcinoma remains the most common cancer among women worldwide and one of the leading causes of death from malignant diseases. Imaging modalities such as mammography, ultrasound, digital breast tomosynthesis (DBT) and MRI play a key role in screening, diagnosis and assessment of disease stages. In recent years, artificial intelligence (AI) has been increasingly used in breast imaging, enabling the early detection of suspicious lesions in individuals with high-risk factors as well as incidental findings during routine examinations.
The aim: This study is to analyze the role of AI in the early evaluation of breast carcinoma through imaging modalities, emphasizing its effectiveness, benefits and limitations in clinical practice.
Methodology: This study analyzed 31 clinical studies published in scientific databases such as PubMed, NIH and Google Scholar. The literature search was performed using the keywords: breast cancer, radiology, mammography, US, DBT, MRI and artificial intelligence. Studies that evaluated the performance of AI algorithms with a focus on early cancer detection were included.
Conclusions: Artificial intelligence is taking an increasingly important place in the early evaluation of breast carcinoma, identifying small and difficult-to-distinguish lesions compared with traditional methods. Radiomics and deep learning (DL) algorithms can detect textural and spatial patterns in images related to the malignant nature of tumors. However, broad use requires careful calibration, validation in different populations and safe integration into clinical practice. Current findings suggest that AI may become a standard assistive tool, but more well-designed studies are needed.

Keywords: *Diagnosis, artificial intelligence, breast cancer, radiology.*

KUJDESI I PËRQENDRUAR TEK PACIENTI DHE FAMILJA NË PRAKTIKËN LOGOPEDIKE: APLIKIMI NË ÇRREGULLIMET E KOMUNIKIMIT ME ORIGJINË NEUROLOGJIKE TEK ADULTËT

Andreson Vrapi[1]
[1] Shërbimi i Neurologjisë, Spitali Rajonal Durrës
E-mail: andivrapi12@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Kujdesi i përqendruar tek pacienti dhe familja përfaqëson një model bashkëkohor të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, i cili zhvendos fokusin nga modeli tradicional biomjekësor drejt një qasjeje biopsikosociale. Në praktikën logopedike, kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme për pacientët adultë me çrregullime të komunikimit me origjinë neurologjike, si afazia, disartria, apraksia e të folurit dhe çrregullimet konjitive-komunikative, të cilat ndikojnë ndjeshëm në funksionimin e përditshëm dhe cilësinë e jetës.
Objektivat: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rëndësinë e integrimit të kujdesit të përqendruar tek pacienti dhe familja në ndërhyrjet logopedike për adultët me çrregullime neurologjike të komunikimit, si dhe të identifikojë faktorët që lehtësojnë ose pengojnë zbatimin e kësaj qasjeje në praktikë.
Metodologjia: Punimi mbështetet në një rishikim të literaturës dhe në të dhëna nga studime deskriptive mbi perceptimet e logopedëve lidhur me kujdesin e përqendruar tek pacienti.
Rezultatet: Gjetjet tregojnë se kujdesi i përqendruar tek pacienti dhe familja përmirëson rezultatet funksionale, rrit përfshirjen e pacientit në vendimmarrje dhe fuqizon rolin e familjes në procesin rehabilitues. Në kontekstin e çrregullimeve neurologjike te adultët, përfshirja aktive e familjes është thelbësore për gjeneralizimin e aftësive të komunikimit në jetën e përditshme.
Konkluzione: Integrimi i kujdesit të përqendruar tek pacienti dhe familja në praktikën logopedike është thelbësor për menaxhimin efektiv të çrregullimeve të komunikimit me origjinë neurologjike tek adultët. Zbatimi i suksesshëm i kësaj qasjeje kërkon zhvillimin e kompetencave klinike, mbështetje institucionale dhe përshtatje ndaj kontekstit individual të pacientit dhe familjes.

Fjalë kyçe: *Kujdesi i përqendruar tek pacienti dhe familja, logopedi, komunikimi.*

PATIENT- AND FAMILY-CENTERED CARE IN SPEECH-LANGUAGE PATHOLOGY PRACTICE: APPLICATION IN ADULT NEUROGENIC COMMUNICATION DISORDERS

Andreson Vrapi[1]
[1] Neurology Service, Regional Hospital of Durrës
E-mail: andivrapi12@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Patient- and family-centered care represents a contemporary model of healthcare delivery that shifts the focus from the traditional biomedical model toward a biopsychosocial approach. In speech-language pathology practice, this approach is particularly important for adult patients with neurogenic communication disorders, such as aphasia, dysarthria, apraxia of speech, and cognitive-communication disorders, which significantly impact daily functioning and quality of life.
Objectives: The aim of this paper is to analyze the importance of integrating patient- and family-centered care into speech-language pathology interventions for adults with neurogenic communication disorders, as well as to identify the factors that facilitate or hinder the implementation of this approach in clinical practice.
Methodology: This study is based on a literature review and data derived from descriptive studies on speech-language pathologists' perceptions of patient-centered care.
Results: Findings indicate that patient- and family-centered care improves functional outcomes, enhances patient involvement in decision-making, and strengthens the role of the family in the rehabilitation process. In the context of adult neurogenic communication disorders, active family involvement is essential for the generalization of communication skills into everyday life.
Conclusions: The integration of patient- and family-centered care in speech-language pathology practice is essential for the effective management of neurogenic communication disorders in adults. Successful implementation of this approach requires the development of clinical competencies, institutional support, and adaptation to the individual context of the patient and their family.

Keywords: *Patient- and family-centered care, Speech-Language Pathology, Communication.*

MRI E EKSTREMITETEVE: ROLI I COIL-EVE TË NDRYSHME, DIFERENCAT, POZICIONIMI DHE PËRSHTATJA KLINIKE

Oresti Radaku[1]

[1]Spitali Italian "Salus", Tiranë, Shqipëri
E-mail: o.radaku@salus.al

ABSTRAKT

Hyrje: Rezonanca magnetike (MRI) është një nga metodat më të avancuara për vlerësimin e patologjive të ekstremiteteve, duke ofruar imazhe me rezolucion të lartë pa ekspozim ndaj rrezatimit jonizues. Cilësia e imazhit në MRI ndikohet ndjeshëm nga përdorimi i coil-eve (spiraleve) të ndryshme, të cilat janë përgjegjëse për marrjen e sinjalit nga indet. Zgjedhja e coil-it të përshtatshëm, së bashku me pozicionimin korrekt të pacientit, është thelbësore për optimizimin e rezultateve diagnostike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin e coil-eve të ndryshme në MRI të ekstremiteteve, të identifikojë dallimet kryesore ndërmjet tyre, si dhe të theksojë rëndësinë e pozicionimit dhe përshtatjes për përmirësimin e cilësisë së imazhit dhe saktësisë diagnostike.

Metodologjia: Ky studim bazohet në një rishikim të literaturës shkencore bashkëkohore në fushën e rezonancës magnetike. Janë analizuar burime akademike dhe tekste standarde të MRI-së për të krahasuar llojet e coil-eve (sipërfaqësore, volumetrike dhe fleksibël), përdorimin e tyre në zona të ndryshme anatomike dhe ndikimin në parametrat e imazhit si raporti sinjal/zhurmë (SNR) dhe rezolucioni hapësinor. Gjithashtu, janë shqyrtuar praktikat më të mira për pozicionimin e pacientit.

Rezultate: Analiza tregon se coil-et sipërfaqësore ofrojnë SNR më të lartë dhe rezolucion më të mirë për struktura të vogla anatomike, ndërsa coil-et volumetrike sigurojnë mbulim më të gjerë, por me cilësi më të ulët të sinjalit. Flex- coil-et ofrojnë një kompromis optimal midis komoditetit dhe cilësisë së imazhit. Pozicionimi i saktë i pacientit në qendër të magnetit dhe coil-it redukton artefaktet dhe përmirëson uniformitetin e sinjalit. Stabilizimi i ekstremitetit është një faktor kyç për minimizimin e lëvizjeve dhe për rritjen e qartësisë së imazhit.

Konkluzione: Zgjedhja e coil-it të duhur dhe pozicionimi korrekt i pacientit janë faktorë vendimtarë në arritjen e imazheve MRI me cilësi të lartë për ekstremitetet. Përshtatja individuale e protokollit sipas zonës anatomike dhe nevojës klinike kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e saktësisë diagnostike dhe efikasitetit të ekzaminimit.

Fjalë kyçe: *MRI, ekstremitetet, coil, pozicionimi, SNR, rezolucioni hapësinor, diagnostikimi.*

MRI OF THE EXTREMITIES: THE ROLE OF DIFFERENT COILS, DIFFERENCES, POSITIONING, AND CLINICAL ADAPTATION

Oresti Radaku[1]
[1]Italian Hospital "Salus", Tirana, Albania
E-mail: o.radaku@salus.al

ABSTRACT

Introduction: Magnetic Resonance Imaging (MRI) is one of the most advanced methods for evaluating extremity pathologies, providing high-resolution images without exposure to ionizing radiation. Image quality in MRI is significantly influenced by the use of different coils, which are responsible for signal reception from tissues. The selection of an appropriate coil, along with proper patient positioning, is essential for optimizing diagnostic outcomes.
Objective: The aim of this study is to analyze the role of different coils in extremity MRI, identify their main differences, and emphasize the importance of positioning and protocol adaptation in improving image quality and diagnostic accuracy.
Methodology: This study is based on a review of contemporary scientific literature in the field of magnetic resonance imaging. Academic sources and standard MRI textbooks were analyzed to compare different types of coils (surface, volumetric, and flexible), their use in various anatomical regions, and their impact on imaging parameters such as signal-to-noise ratio (SNR) and spatial resolution. Best practices for patient positioning were also reviewed.
Results: The analysis shows that surface coils provide higher SNR and better resolution for small anatomical structures, while volumetric coils offer broader coverage but lower signal quality. Flexible coils provide an optimal balance between patient comfort and image quality. Proper patient positioning at the center of both the magnet and the coil reduces artifacts and improves signal uniformity. Stabilization of the extremity is a key factor in minimizing motion and enhancing image clarity.
Conclusion: The selection of the appropriate coil and correct patient positioning are critical factors in achieving high-quality MRI images of the extremities. Individualized protocol adaptation based on the anatomical region and clinical needs directly contributes to improved diagnostic accuracy and examination efficiency.

Keywords: *MRI, extremities, coil, positioning, SNR, spatial resolution, diagnosis.*

SESION PARALEL

SESIONI II

SALLA 5

ABSTRAKTET

HARTËZIMI I PRAKTIKAVE TË TELEMEDICINËS SË INFERMIERISË: NJË RISHIKIM I PËRFSHIRË I MODELEVE, REZULTATEVE DHE ROLEVE PROFESIONALE

Blerina Duka[1], Jola Çini [2] Armela Zylfo[3], Fabiola Mane[4], Kujtime Vakeflliu[5], Alta Arapi [6], Armela Kapaj [7]

[1] Presidente e Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë.

[2345] Departamenti i Mjekësisë, Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri.

[6] Urdhri i Infermierëve i Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri

[7] Univeristetit "Aleksandër Xhuvani"

E-mail: dep.mjeksi-tek@umb.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Zgjerimi i telemjekësisë ka çuar në një transformim të rëndësishëm në modelet e kujdesit, duke e bërë teleinfermierinë një komponent qendror në vazhdimësinë e kujdesit dhe menaxhimin e pacientëve në mjedise të shumëfishta.

Qëllimi: Qëllimi i këtij shqyrtimi të fushëveprimit është të hartëzojë sistematikisht provat e disponueshme mbi praktikat e infermierisë së telekujdesit, duke identifikuar modelet organizative, rolet profesionale dhe rezultatet kryesore klinike dhe organizative.

Metodologjia: U krye në pesë baza të dhënash ndërkombëtare (PubMed, Scopus, Web of Science, CINAHL dhe PsycINFO) duke ndjekur kuadrin metodologjik të Arksey dhe O'Malley, zgjerimet interpretuese të Levac dhe kolegëve të tij dhe udhëzimet e Institutit Joanna Briggs, duke integruar indikacionet e PRISMA- ScR për raportim. Kërkimi dha 1760 të dhëna, nga të cilat 1215 pas heqjes së dublikatave; Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të tekstit të plotë, u përfshinë 27 studime.

Rezultatet: Rrzultatet tregojnë se teleinfermieria aplikohet në mjedise të ndryshme klinike, me rëndësi në sëmundjet kronike, trajtimin onkologjik, periudhën postoperatore dhe situata emergjente. Studimet raportojnë përmirësime në menaxhimin e simptomave, respektimin e terapisë, cilësinë e jetës dhe uljen e ndërlikimeve, si dhe ndikim pozitiv në nivel klinik dhe organizativ. Literatura thekson nevojën për aftësi dixhitale, komunikimi dhe marrëdhënie profesionale, si dhe trajnime specifike për zhvillimin e rolit të infermierit në telenurgji. Tendencat e fundit tregojnë vazhdimësi më të madhe të kujdesit, autonomi më të lartë të pacientëve dhe kujdestarëve, integrim më të mirë spital–territor dhe reduktim të kostove.

Konkluzione: Ky rishikim ofron një pasqyrë të azhurnuar të telenurgjisë, duke nxjerrë në pah fleksibilitetin, përshtatshmërinë në kontekste të ndryshme klinike dhe rolin strategjik të infermierit në kujdesin dixhital. Evidencat sugjerojnë nevojën për njohuri të mëtejshme për konsolidimin e modeleve organizative, përcaktimin e aftësive të avancuara dhe integrimin e telenurgjisë në sistemet bashkëkohore shëndetësore.

Fjalët kyçe: *Teleinfermieri; Telemjekësi, Kujdesi Infermieror Dixhital, Kompetencat Infermierore; Edukimi Infermieror, Shëndeti Dixhital.*

MAPPING NURSING TELEMEDICINE PRACTICES: A SCOPING REVIEW OF MODELS, OUTCOMES, AND PROFESSIONAL ROLES

Blerina Duka[1], Jola Çini [2] Armela Zylfo[3], Fabiola Mane[4], Kujtime Vakeflliu[5], Alta Arapi [6], Armela Kapaj [7]

[1] Professor, President of the Albanian Order of Nurses

[2345] Department of Medicine, Barleti University, Tirana, Albania.

[6] Albanian Order of Nurses, Tirana, Albania.

[7] "Aleksandër Xhuvani" University

E-mail: dep.mjeksi-tek@umb.edu.al

ABSTRACT

The expansion of telemedicine has led to a significant transformation in care models, making telenursing a central component in continuity of care and patient management in multiple settings. **The aim** of this scoping review is to systematically map the available evidence on telecare nursing practices, identifying organizational models, professional roles and main clinical and organizational outcomes.

The research was conducted in five international databases (PubMed, Scopus, Web of Science, CINAHL and PsycINFO) following the methodological framework of Arksey and O'Malley, the interpretative extensions of Levac and colleagues and the guidelines of the Joanna Briggs Institute, integrating the indications of the PRISMA-ScR for reporting. The search yielded 1760 records, of which 1215 after the removal of duplicates; Following screening and full-text evaluation, 27 studies were included.

Results: Tele-nursing is applied across diverse clinical settings, with particular relevance in chronic diseases, oncology care, the postoperative period, and emergency situations. Studies report improvements in symptom management, therapy adherence, quality of life, and reduction of complications, as well as positive impacts at both clinical and organizational levels. The literature highlights the need for digital skills, effective communication, and professional relationship-building, along with specific training to support the development of the nurse's role in telecare. Recent trends indicate greater continuity of care, increased autonomy for patients and caregivers, better hospital–community integration, and reduced care-related costs.

Conclusions: This review provides an updated overview of tele-nursing, emphasizing its flexibility, adaptability across different clinical contexts, and the strategic role of nurses in digital care. The evidence suggests a need for further knowledge to consolidate organizational models, define advanced competencies, and support the integration of tele-nursing into contemporary healthcare systems.

Keywords: *Telenursing, telemedicine, digital nursing care, nursing competencies, nursing education, digital health.*

ANALIZAT BAKTEROLOGJIKE: ÇELËSI PËR ZBULIMIN E INFEKSIONEVE

Marinela Zeqiri[1], Shkëlqim Zeqiri[2]

[1] Laboratori Bakterologjik, NJVKSH Vlorë.
[2] President i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, QarkuVlorë.
E-mail: marinelazeqiri@icloud.com

ABSTRAKT

Hyrje: Bakteriologjia është një degë themelore e mikrobiologjisë që merret me studimin e baktereve, duke përfshirë identifikimin, klasifikimin dhe karakterizimin e tyre. Analizat bakteriologjike përbëjnë një element kyç në diagnostikimin e infeksioneve, duke ndikuar drejtpërdrejt në zgjedhjen e trajtimit të duhur dhe në përmirësimin e rezultateve klinike. Saktësia e këtyre analizave varet në mënyrë të konsiderueshme nga mënyra e marrjes, transportit dhe përpunimit të mostrës biologjike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të theksojë rëndësinë e marrjes korrekte të mostrës në analizat bakteriologjike, duke evidentuar faktorët që ndikojnë në saktësinë diagnostike dhe në reduktimin e rezultateve të pasakta.

Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim përshkrues të praktikave standarde laboratorike dhe protokolleve të rekomanduara për marrjen e mostrave. U analizuan elementë kyç si koha optimale e marrjes së mostrës, sasia e materialit biologjik, përdorimi i teknikave aseptike dhe shmangia e faktorëve ndërhyrës si përdorimi paraprak i antibiotikëve apo antimikotikëve. Gjithashtu, u mor në konsideratë rëndësia e njohjes së patogjenezës dhe manifestimeve klinike për përcaktimin e momentit të duhur të marrjes së mostrës.

Rezultatet: Respektimi i protokolleve standarde për marrjen dhe trajtimin e mostrës çon në rritjen e ndjeshmërisë dhe specifikës së analizave bakteriologjike. Mostrat e marra në mënyrë korrekte reduktojnë ndjeshëm rastet e rezultateve fals negative ose fals pozitive, duke përmirësuar besueshmërinë e diagnozës mikrobiologjike.

Përfundime: Marrja e saktë dhe në kohën e duhur e mostrës është një faktor vendimtar për suksesin e analizave bakteriologjike. Zbatimi rigoroz i protokolleve laboratorike dhe bashkëpunimi ndërmjet stafit klinik dhe laboratorik janë thelbësore për vendosjen e një diagnoze të saktë dhe për menaxhimin efektiv të infeksioneve.

Fjalë kyçe: *Analiza bakteriologjike, mostra biologjike, diagnozë mikrobiologjike, infeksione, asepsi.*

BACTERIOLOGICAL ANALYSES: THE KEY TO DETECTING INFECTIONS

Marinela Zeqiri [1], Shkëlqim Zeqiri [2]
[1] Bacteriological Laboratory, NJVKSH Vlora, Albania
[2] President of the Order of Nurses of Albania, Vlora Region
E-mail: marinelazeqiri@icloud.com

ABSTRACT

Introduction: Bacteriology is the study of bacteria. This subdivision of microbiology includes the identification, classification, and characterization of bacterial species. Microbiology (from Greek μικρός, mikrós – "small"; βίος, víos – "life"; and λόγος, lógos – "word," "study," "knowledge") is a branch of biology that deals with the study of microorganisms (microbes), their structure, function, and their impact on other living organisms.
Objective: Proper sample collection, in accordance with established protocols, minimizes errors and contributes to establishing an accurate diagnosis.
Methodology: Samples must be collected at the appropriate time. Knowledge of the pathogenesis of infectious diseases, as well as clinical manifestations according to disease stages, are prerequisites for determining the optimal timing of sample collection. In infectious diseases accompanied by fever, the sample should be collected when the patient has a high temperature. The amount of material must be sufficient. A quantity below the required standard for analysis may lead to false-negative results or inaccurate outcomes. Sample collection should be performed using sterile equipment and by following aseptic rules. This is an essential requirement. Appropriate sterile tools should be used without contact with disinfectants, as these may lead to false results. It is important to emphasize that sample collection must be performed before initiating antibiotics or antifungal therapy.
Results: Based on proper guidelines for sample collection, accurate results are expected.
Conclusions: Correct sample collection reduces the risk of diagnostic errors.

Keywords: *Sample, strains, microbiological diagnosis, bacteria.*

PËRMIRËSIMI I PRAKTIKËS KLINIKE NË EDUKIMIN E FIZIOTERAPISË PËRMES REALITETIT VIRTUAL DHE INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË EPOKËN DIGJITALE

Alta Arapi[1], Sidita Haxholli[2], Roxhensa Sula[3], Alisia Maliqi[4]

[1] Urdhri i Infermierit të Shqipërisë
[2] Mjekësia Sportive dhe Rehabilitimi
[3] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Universiteti Aldent
[4] Universiteti Aldent
E-mail: alta_arapi@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Praktika klinike përbën një komponent thelbësor në edukimin e studentëve të fizioterapisë, duke mundësuar zhvillimin e aftësive praktike, arsyetimit klinik dhe kompetencave profesionale. Megjithatë, praktikat tradicionale klinike shpesh shoqërohen me sfida si ekspozimi i kufizuar ndaj rasteve klinike, variabiliteti i përvojave mësimore dhe nevoja për garantimin e sigurisë së pacientit. Në këtë kontekst, teknologjitë digjitale si realiteti virtual (VR) dhe inteligjenca artificiale (IA) po përdoren gjithnjë e më shumë për të mbështetur studentët gjatë praktikës klinike dhe për të përmirësuar përvojën e të nxënit.

Qëllimi: Punimi synon të analizojë rolin e realitetit virtual dhe inteligjencës artificiale në mbështetjen e studentëve të fizioterapisë gjatë praktikës klinike, si dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e kompetencave klinike, rritjen e besimit profesional dhe garantimin e sigurisë së pacientit.

Metodologjia: Është realizuar një rishikim narrativ i literaturës shkencore, duke përfshirë studime që trajtojnë përdorimin e realitetit virtual, inteligjencës artificiale dhe simulimit digjital në edukimin klinik të studentëve të fizioterapisë. Analiza është fokusuar në efektivitetin e këtyre teknologjive në zhvillimin e aftësive praktike dhe arsyetimit klinik

Rezultatet: Gjetjet tregojnë se përdorimi i realitetit virtual dhe simulimeve të bazuara në inteligjencën artificiale u mundëson studentëve të fizioterapisë të praktikojnë aftësitë klinike në një mjedis të sigurt dhe të kontrolluar, para dhe gjatë praktikës klinike. Këto teknologji përmirësojnë besimin e studentëve, rrisin aftësitë e vendimmarrjes klinike dhe mundësojnë përsëritjen e situatave klinike komplekse. Gjithashtu, platformat digjitale ofrojnë mundësi për mësim të personalizuar, feedback të vazhdueshëm dhe zhvillim progresiv të kompetencave profesionale.

Konkluzionet: Integrimi i realitetit virtual dhe (AI) në praktikën klinike të studentëve të fizioterapisë përfaqëson një qasje inovative që plotëson praktikat tradicionale të mësimdhënies. Këto teknologji kontribuojnë në përgatitjen e fizioterapistëve më kompetentë dhe më të gatshëm për sfidat e kujdesit shëndetësor modern.

Fjalë kyçe: *Fizioterapi, studentë në praktikë klinike, realitet virtual, inteligjencë artificiale, edukim digjital, kompetenca klinike.*

ENHANCING CLINICAL PRACTICE IN PHYSIOTHERAPY EDUCATION THROUGH VIRTUAL REALITY AND ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN THE DIGITAL ERA

Alta Arapi[1], Sidita Haxholli[2], Roxhensa Sula[3], Alisia Maliqi[4]
[1] Order of Nurses of Albania
[2] Sports Medicine and Rehabilitation
[3] Faculty of Technical Medical Sciences, Department of Nursing and Physiotherapy, Aldent University
[4] Aldent University
E-mail: alta_arapi@yahoo.com

ABSTRACT

Background: Clinical practice is a fundamental component of physiotherapy education, allowing students to develop clinical reasoning, hands-on skills, and professional competencies. However, traditional clinical placements may present challenges such as limited patient exposure, variability in learning opportunities, and concerns related to patient safety. Digital technologies, including virtual reality (VR) and artificial intelligence (AI), are increasingly being integrated into healthcare education to support students during clinical training and enhance experiential learning.
Aim: This study aims to explore the role of virtual reality and artificial intelligence in supporting physiotherapy students during clinical practice and improving clinical competencies, confidence, and patient safety.
Methods: A narrative review of recent literature was conducted, focusing on studies that examine the use of virtual reality, artificial intelligence, and digital simulation in physiotherapy students' clinical education. The analysis explored the effectiveness of these technologies in enhancing students' practical skills, clinical reasoning, and learning experiences during clinical placements.
Results: Evidence suggests that virtual reality and AI-based simulation tools allow physiotherapy students to practice clinical skills in a safe and controlled environment before and during clinical placements. These technologies improve students' confidence, enhance clinical reasoning, and support the development of decision-making skills. Furthermore, digital platforms enable personalized learning experiences, continuous feedback, and repeated practice, which contribute to improved clinical performance and readiness for real-world patient care.
Conclusion: Integrating virtual reality and artificial intelligence into physiotherapy clinical education can strengthen students' learning experiences and better prepare them for clinical practice. These digital tools offer innovative approaches to complement traditional clinical placements and support the development of competent physiotherapy professionals ready to meet modern healthcare challenges.

Keyworvds: *Physiotherapy education, clinical practice, virtual reality, artificial intelligence, students, clinical competence.*

NDIKIMI I DIXHITALIZIMIT NË SAKTËSINË DHE SIGURINË E TRAJTIMIT RADIOTERAPEUTIK ME ORTOVOLTAZH NË TUMORET E LËKURËS

Marsela Prendi[2], Enes Hafizi[1], Daniela Bega[1], Andri Gorjani[2], Sander Kola[3]

[1]Shërbimi Onkologjik, Njësia e Radioterapisë, QSUNT, Tiranë, Shqipëri
[2] Shërbimi Onkologjik, Njësia e Radioterapisë, QSUNT, Tiranë, Shqipëri
[3] Shërbimi i Imazherisë, Spitali Qendror, Tiranë, Shqipëri
E-mail: marselaprendi1@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Radioterapia me ortovoltazh është një metodë efektive për trajtimin e tumoreve sipërfaqësore të lëkurës. Përdor rreze X me nivele energjie nga 50-300 kV. Planet e trajtimit janë të personalizuara për çdo pacient. Në shërbimin Onkologjik, në QSUNT, Shqipëri, nga viti 2024, radioterapia me Ortovoltazh realizohet përmes aparaturës moderne 'X ray therapy unit T-300' nga Womed.

Qëllimi: Vlerësimi i ndikimit të dixhitalizimit të aparaturave ortovoltazh në saktësinë e trajtimit, sigurinë e pacientit dhe efikasitetin e dokumentimit krahasuar me aparaturën konvencionale.

Materiale dhe Metoda: Është bërë një studim observues krahasues në proçesin e punës të aparaturës konvencionale Pantax me aparaturën modern Womed, duke vlerësuar:
ndërtimin e aparatures dhe aksesorët, regjistrimin dhe kartelizimin e pacientëve, planifikimin dhe ruajtjen elektronike të planit të trajtimit, saktësinë e riprodhimit të parametrave të trajtimit në çdo seance, mundësinë e gabimeve ose devijimeve procedurale, monitorimin e pacientëve gjatë trajtimit, aksesibilitetin e dokumentimit elektronik për ndjekje (follow up).

Rezultate: Implementimi i sistemit të dixhitalizuar rezultoi shumë pozitiv në riprodhim më të saktë të parametrave të trajtimit dhe reduktim të gabimeve procedurale. Dixhitalizimi ka ndihmuar në sigurinë dhe lehtesimin e punës së stafit radioterapeutik në realizimin e terapisë. Dokumentimi elektronik lehtësoi aksesin në historikun e pacientit dhe ndjekjen klinike.

Konkluzion: Sistemet elektronike të menaxhimit të të dhënave dhe kontrollit të parametrave të trajtimit minimizojne gabimet, përmirësojnë standartizimin e praktikës klinike dhe kontribuojnë në kujdesin më të mirë për pacientin dhe në lehtësimin e punës të stafit mjekësor.

Fjalë kyçe: *Radioterapi, ortovoltazh, dixhitalizim, plane trajtimi, siguri në trajtim.*

THE IMPACT OF DIGITALIZATION ON ACCURACY AND SAFETY OF ORTHOVOLTAGE RADIOTHERAPY TREATMENT IN SKIN TUMORS

Marsela Prendi[2], Enes Hafizi[1], Daniela Bega[1], Andri Gorjani[2], Sander Kola[3]
[1] Oncology Service, Radiotherapy Unit, QSUNT, Tirana, Albania
[2] Oncology Service, Radiotherapy Unit, QSUNT, Tirana, Albania
[3] Radiology Service, Central Hospital, Tirana, Albania
E-mail: marselaprendi1@gmail.com

ABSTRACT

Background: Orthovoltage radiotherapy is an effective modality for treating superficial skin tumors, using X-rays with energy levels between 50 and 300 kV. Treatment plans are individualized for each patient. Since 2024, the Oncology Department at QSUNT has implemented orthovoltage radiotherapy using the modern X-ray therapy unit T-300 (Womed).
Objective: Evaluation of the impact of digitalization of orthovoltage equipment on treatment accuracy, patient safety, and documentation efficiency compared to conventional systems.
Materials and Methods: A comparative observational study was conducted to assess workflows using a conventional Pantax unit and a modern Womed system. Evaluated parameters included: equipment design and accessories, patient registration and record management, treatment planning and electronic storage, reproducibility of treatment parameters every session, risk of procedural errors, patient monitoring, and accessibility of electronic documentation for follow-up.
Results: Digitalization improved the accuracy of treatment parameter reproducibility and reduced procedural errors. It enhanced patient safety and facilitated the workflow of radiotherapy staff. Electronic documentation enabled easier access to patient records and improved clinical follow-up.
Conclusion: Digital data management and treatment control systems minimize errors, improve standardization of clinical practice, and contribute to better patient care while optimizing staff workflow.

Keywords: *Radiotherapy, orthovoltage, digitalization, treatment planning, patient safety.*

ROLI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË KUJDESIT INFERMIEROR: NJË STUDIM EMPIRIK MBI NJOHURITË, QËNDRIMET DHE PRAKTIKAT E PERSONELIT INFERMIEROR

Gloria Bengaj[1], File Braçja[1,2], Rajmonda Milloshi[3], Erind Thartori[4,5]

[1] Shoqata Brainstorm.
[2]Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
[3]Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
[4] Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza, Tiranë
[5] Departamenti i Infermierisë, Fakulteti Shkencave Mjekësore, Albanian University
E-mail: gloriabengaj894@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Inteligjenca artificiale (IA) po integrohet gjithnjë e më shumë në shërbimet shëndetësore, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të kujdesit infermieror. Ajo ofron mbështetje në monitorimin e pacientëve, organizimin e punës dhe vendimmarrjen klinike. Megjithatë, niveli i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të infermierëve lidhur me përdorimin e IA mbetet ende i paqartë në shumë mjedise klinike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e personelit infermieror lidhur me inteligjencën artificiale dhe ndikimin e saj në cilësinë e kujdesit infermieror.

Metodologjia: Studimi është përshkrues transversal dhe u realizua përmes një pyetësori të strukturuar bazuar në modelin KAP (Knowledge, Attitudes, Practices). Në studim morën pjesë 96 infermierë nga institucione të ndryshme shëndetësore. Të dhënat u analizuan me metoda të statistikës përshkruese.

Rezultate: Shumica e pjesëmarrësve ishin femra (72%), ndërsa grupmosha më e përfaqësuar ishte 25–34 vjeç (38%). Rreth 68% e infermierëve raportuan se kishin njohuri paraprake për IA në shëndetësi, ndërsa 54% besonin se ajo përmirëson monitorimin e pacientëve dhe zbulimin e hershëm të ndryshimeve klinike. Qëndrimet ishin kryesisht pozitive (61%), megjithatë 47% shprehën shqetësime etike dhe nevojën për rregullore të qarta. Vetëm 22% raportuan përdorim praktik të teknologjive të lidhura me IA, ndërsa 74% shprehën interes për trajnim.

Përfundime: Personeli infermieror shfaq njohuri mesatare dhe qëndrime pozitive ndaj inteligjencës artificiale, por përdorimi praktik mbetet i kufizuar. Kjo nënvizon nevojën për trajnime të strukturuara, zhvillim të infrastrukturës digjitale dhe hartim të udhëzimeve për integrimin e IA në praktikën infermierore.

Fjalë kyçe: *Inteligjenca artificiale, kujdes infermieror, njohuri, qëndrime, praktika.*

THE ROLE OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN IMPROVING THE QUALITY OF NURSING CARE: AN EMPIRICAL STUDY ON THE KNOWLEDGE, ATTITUDES AND PRACTICES OF NURSING STAFF.

Gloria Bengaj[1] ,File Braçja[1,2], Rajmonda Milloshi[3], Erind Thartori[4,5]
[1]Coordinator, Brainstorm Association
[2]Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana
[3] Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana
[4] University Hospital Center "Mother Teresa", Tirana
[5] Department of Nursing, Faculty of Medical Sciences, Albanian University
E-mail: gloriabengaj894@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Artificial intelligence (AI) is increasingly being integrated into healthcare services, contributing to the improvement of the quality and efficiency of nursing care. It provides support in patient monitoring, workflow organization, and clinical decision-making. However, the level of knowledge, attitudes, and practices of nurses regarding the use of AI remains unclear in many clinical settings.

Aim: The aim of this study is to assess the knowledge, attitudes, and practices of nursing staff regarding artificial intelligence and its impact on the quality of nursing care.

Methodology: This is a descriptive cross-sectional study conducted through a structured questionnaire based on the KAP (Knowledge, Attitudes, Practice) model. A total of 96 nurses from various healthcare institutions participated in the study. Data were analyzed using descriptive statistical methods.

Results: The majority of participants were female (72%), with the most represented age group being 25–34 years (38%). About 68% of nurses reported having prior knowledge of AI in healthcare, while 54% believed it improves patient monitoring and early detection of clinical changes. Attitudes were mostly positive (61%); however, 47% expressed ethical concerns and the need for clear regulations. Only 22% reported practical use of AI-related technologies, while 74% expressed interest in training.

Conclusions: Nursing staff demonstrate moderate knowledge and positive attitudes toward artificial intelligence, but practical use remains limited. This highlights the need for structured training, development of digital infrastructure, and the establishment of guidelines for integrating AI into nursing practice.

Keywords: Artificial intelligence, nursing care, knowledge, attitudes, practices.

TELE-TRIAZHIMI DHE DISPEÇERIZIMI DIGJITAL NË SISTEMIN EMS 127: NDIKIMI NË KOHËN E REAGIMIT DHE EFIKASITETIN OPERACIONAL NË SHQIPËRI

Llukan Koti[1], Skënder Brataj[2] Indrit Jaupaj[2], Klejdi Cankja, Gentjana Rexha[2].

[1] Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM), Tiranë, Shqipëri
[2] Shoqata Shqiptare e Urgjencës Mjekësore dhe Katastrofave (SHSHUMK-AAEMD), Shqipëri
E-mail: llukankoti@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Tele-triazhimi dhe dispeçerizimi digjital përfaqësojnë komponentë thelbësorë të inovacionit në menaxhimin modern të urgjencave mjekësore, duke synuar përmirësimin e kohës së reagimit, rritjen e saktësisë në vendimmarrje dhe optimizimin e përdorimit të burimeve në sistemet e shërbimit emergjent mjekësor (EMS).

Objektivi: Qëllimi i këtij studimi është të analizojë ndikimin e tele-triazhimit dhe dispeçerizimit digjital në reduktimin e kohës së përgjigjes dhe përmirësimin e performancës së sistemit EMS, duke marrë në konsideratë veçoritë e kontekstit shqiptar dhe funksionimin e sistemit EMS 127.

Metodologjia: Studimi u bazua në një rishikim të literaturës ndërkombëtare të publikuar gjatë viteve 2021-2023 mbi tele-triazhimin dhe dispeçerizimin digjital, të kombinuar me analizën e të dhënave operative nga Njësia e Koordinimit 127 në kuadër të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM), si dhe aktivitetet profesionale dhe trajnuese të SHSHUMK-AAEMD. U analizuan indikatorë kyç, përfshirë kohën e reagimit, saktësinë e kategorizimit të rasteve dhe efikasitetin operacional.

Rezultatet: Implementimi i tele-triazhimit dhe dispeçerizimit digjital u shoqërua me një reduktim të kohës mesatare të reagimit me rreth 2.1 minuta dhe një rritje të dërgimit në kohë optimale të ekipeve me afërsisht 30%. Gjithashtu, u evidentua përmirësim i ndjeshëm në saktësinë e kategorizimit të urgjencave dhe reduktim i gabimeve njerëzore. Të dhënat nga Njësia e Koordinimit 127 trego jnë një përmirësim të dukshëm në menaxhimin e thirrjeve, optimizimin e shpërndarjes së burimeve dhe rritjen e efikasitetit operacional, të mbështetur nga përdorimi i teknologjive digjitale dhe protokolleve të standardizuara, si dhe nga aktivitetet trajnuese të vazhdueshme.

Konkluzione: Integrimi i tele-triazhimit me dispeçerizimin digjital përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit dhe rritjes së performancës së sistemit EMS 127 në Shqipëri. Megjithatë, për të vlerësuar plotësisht qëndrueshmërinë, kost-efektivitetin dhe ndikimin klinik afatgjatë, nevojiten studime të mëtejshme pilot dhe analiza të thelluara në nivel kombëtar.

Fjalë kyçe: *Tele-triazhim; dispeçerizim digjital; EMS; kohë reagimi; Shqipëri; QKUM 127; SHSHUMK-AAEMD; AAEMD.*

TELE-TRIAGE AND DIGITAL DISPATCHING IN THE EMS 127 SYSTEM: IMPACT ON RESPONSE TIME AND OPERATIONAL EFFICIENCY IN ALBANIA

Llukan Koti[1], Skender Brataj[2], Indrit Jaupaj[2], Klejdi Cankja, Gentjana Rexha[2]
[1] National Emergency Medical Center (NEMC), Tirana, Albania
[2] Albanian Association of Emergency Medicine and Disasters (AAEMD), Albania
E-mail: llukankoti@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Tele-triage and digital dispatch represent key innovations in the modern management of medical emergencies. These approaches aim to improve response times, enhance decision-making accuracy, and optimize resource allocation within Emergency Medical Services (EMS) systems.
Objective: This study aims to evaluate the impact of tele-triage and digital dispatch on reducing response times and improving EMS performance, with particular attention to the Albanian context and the EMS 127 system.
Methodology: The study was based on a review of international literature published between 2021 and 2023 on tele-triage and digital dispatch, combined with an analysis of operational data from the Coordination Unit 127 within the National Emergency Medical Center (QKUM). Additional insights were drawn from the professional and training activities of the Albanian Association of Emergency Medical Services and Disasters (SHSHUMK-AAEMD). Key performance indicators analyzed included response time, accuracy of case prioritization, and overall operational efficiency.
Results: The implementation of tele-triage and digital dispatch was associated with a reduction in average response time of approximately 2.1 minutes, along with an estimated 30% increase in timely team deployment. A notable improvement was also observed in the accuracy of emergency categorization, accompanied by a reduction in human error. Data from the Coordination Unit 127 indicate enhanced call management, more efficient resource allocation, and improved operational performance, supported by the use of digital tools, standardized protocols, and continuous professional training.
Conclusions: The integration of tele-triage with digital dispatch represents a significant step toward the modernization and improved performance of the EMS 127 system in Albania. However, further pilot studies and long-term evaluations are needed to assess sustainability, cost-effectiveness, and clinical impact.

Keywords: *Tele-triage, digital dispatch, EMS, response time, Albania, QKUM 127, SHSHUMK-AAEMD, AAEMD.*

URGJENCAT E SËMUNDJEVE INFEKTIVE: ROLI I INFERMIERISË NË PËRGATITJE, NJOHJE TË HERSHME DHE REZULTATET E PACIENTËVE

Suzana Sinakoli [1]

[1] Urgjenca e Shërbimit Infektiv, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë, Shqipëri
E-mail: suzanasinakoli@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Urgjencat e sëmundjeve infektive, si epidemitë dhe infeksionet e rënda, përbëjnë sfida të mëdha për sistemet shëndetësore. Infermierët kanë rol kyç në njohjen e hershme, triazhin dhe menaxhimin e pacientëve, ndërsa ngjarjet e fundit kanë theksuar nevojën për përgatitje më të mirë dhe protokolle të standardizuara për reagim efektiv.
Qëllimi: Ky studim synon të eksplorojë rolin e infermierisë në menaxhimin e urgjencave të sëmundjeve infektive, duke u përqendruar në përgatitjen, zbulimin e hershëm, ndërhyrjet klinike dhe ndikimin e tyre në rezultatet e pacientëve.
Metodat: U krye një rishikim narrativ i literaturës së fundit (2021-2026), duke përfshirë studime të rishikuara nga kolegët, udhëzime klinike dhe raporte ndërkombëtare. Analiza u fokusua në praktikat e infermierisë në mjediset e urgjencës, duke përfshirë triazhin, parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve (IPC), zbatimin e protokolleve të sepsis dhe koordinimin multidisiplinor gjatë urgjencave të sëmundjeve infektive.
Rezultatet: Gjetjet tregojnë se infermierët luajnë një rol kyç në identifikimin e hershëm të gjendjeve infektive dhe fillimin në kohë të kujdesit. Respektimi i protokolleve të bazuara në prova, siç janë paketat e sepsis dhe masat e IPC, u shoqërua me rezultate të përmirësuara të pacientëve dhe rreziqe të reduktuara të transmetimit. Ndërhyrjet e udhëhequra nga infermierët, duke përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të pacientit, përshkallëzimin e shpejtë të kujdesit dhe edukimin e pacientit, ishin thelbësore në menaxhimin e përkeqësimit klinik. Megjithatë, sfida të tilla si ngarkesa e punës, burimet e kufizuara dhe ndryshueshmëria në trajnim u identifikuan si pengesa për ofrimin optimal të kujdesit. Forcimi i kompetencave të infermierëve dhe sigurimi i aksesit në protokollet e standardizuara përmirësuan ndjeshëm efikasitetin e reagimit në mjediset e urgjencës.
Konkluzione: Praktika e infermierisë është qendrore për menaxhimin efektiv të urgjencave të sëmundjeve infektive. Përmirësimi i edukimit të infermierëve, promovimi i respektimit të udhëzimeve klinike dhe investimi në përgatitjen e fuqisë punëtore janë thelbësore për të përmirësuar rezultatet e pacientëve dhe rezistencën e sistemit të kujdesit shëndetësor. Fuqizimi i infermierëve përmes trajnimit dhe mbështetjes organizative duhet të jetë një përparësi në adresimin e kërcënimeve të ardhshme të sëmundjeve infektive.

Fjalë kyçe: *Urgjenca të sëmundjeve infektive, Infermier, Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve, Kujdesi emergjent,*

INFECTIOUS DISEASE EMERGENCIES: THE ROLE OF NURSING IN PREPAREDNESS, EARLY RECOGNITION, AND PATIENT OUTCOMES

Suzana Sinakoli [1]

[1] Infectious Diseases Department, University Hospital Center "Mother Teresa", Tirana, Albania

E-mail: suzanasinakoli@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Infectious disease emergencies, including epidemics, and severe infections pose significant challenges to healthcare systems worldwide. Nurses are at the forefront of emergency care, playing a critical role in early recognition, triage, infection prevention, and patient management. Recent global health events have highlighted the need for strengthened nursing preparedness and standardized care pathways to ensure timely and effective responses in high-pressure clinical environments.

Aim: This study aims to explore the role of nursing in the management of infectious disease emergencies, focusing on preparedness, early detection, clinical interventions, and their impact on patient outcomes.

Methods: A narrative review of recent literature (2021-2026) was conducted, including peer-reviewed studies, clinical guidelines, and international reports. The analysis focused on nursing practices in emergency settings, including triage, infection prevention and control (IPC), implementation of sepsis protocols, and multidisciplinary coordination during infectious disease emergencies.

Results: The findings demonstrate that nurses play a pivotal role in the early identification of infectious conditions and the timely initiation of care. Adherence to evidence-based protocols, such as sepsis bundles and IPC measures, was associated with improved patient outcomes and reduced transmission risks. Nursing-led interventions, including continuous patient monitoring, rapid escalation of care, and patient education, were essential in managing clinical deterioration. However, challenges such as workload, limited resources, and variability in training were identified as barriers to optimal care delivery. Strengthening nursing competencies and ensuring access to standardized protocols significantly improved response efficiency in emergency settings.

Conclusions: Nursing practice is central to the effective management of infectious disease emergencies. Enhancing nursing education, promoting adherence to clinical guidelines, and investing in workforce preparedness are essential to improve patient outcomes and healthcare system resilience. Empowering nurses through training and organizational support should be a priority in addressing future infectious disease threats.

Keywords: *Infectious disease emergencies, nurses, infection prevention and control, emergency caree, patient outcomes.*

ROLI I CBCT NË PLANIFIKIMIN E IMPLANTEVE DENTARE DHE VLERËSIMIN E PATOLOGJIVE SHOQËRUESE

Sara Memaj[1]

[1] Spitali Rajonal Berat, Berat, Shqipëri
E-mail: saramemaj28@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Implantet dentare janë bërë një domosdoshmëri funksionale dhe estetike në stomatologjinë moderne. Vendosja e tyre e suksesshme kërkon një vlerësim të plotë para operacionit, pasi procedura është delikate dhe kërkon planifikim të saktë klinik. Imazhet tredimensionale (3D), veçanërisht tomografia e kompjuterizuar me rreze konike (CBCT), konsiderohen sot si një mjet thelbësor diagnostikues para vendosjes së implantit. CBCT mundëson vlerësimin e saktë të strukturës kockore dhe anatomisë, duke përmirësuar cilësinë e planifikimit terapeutik.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë rolin e CBCT në planifikimin e implanteve dentare dhe në identifikimin e patologjive shoqëruese të nofullës, duke kontribuar në rritjen e saktësisë dhe sigurisë së trajtimit.

Metodologjia: Ky studim bazohet në një rishikim të literaturës shkencore, si dhe në vlerësimin klinik të rasteve në të cilat pacientët iu nënshtruan ekzaminimit radiografik për vendosjen e implanteve dentare dhe për praninë e lezioneve nodulare të nofullës në klinikën tonë. Saktësia diagnostike e imazheve panoramike dy-dimensionale (2D) u krahasua me atë të imazheve tridimensionale (3D) të CBCT. Parametrat specifikë të vlerësuar përfshinin lartësinë dhe gjerësinë e kockës, trajektoren e nervit alveolar inferior, gjendjen anatomike të sinuseve maksilare në rastet e përshtatshme për vendosjen e implanteve, si dhe rëndësinë e vlerësimit të rrezikut në parandalimin e komplikimeve patologjike.

Rezultatet: CBCT u identifikua si modaliteti kryesor i imazherisë për planifikimin e implanteve dentare. Krahasuar me radiografinë panoramike konvencionale dy-dimensionale (2D), CBCT demonstroi saktësi diagnostike superiore, ofroi parashikueshmëri më të lartë kirurgjikale dhe precizion të përmirësuar klinik.

Diskutime: Për vendosjen e besueshme të implantit, CBCT është e domosdoshme, pasi ofron një pamje diagnostike transparente dhe gjithëpërfshirëse për klinicistët. Ndërsa radiografia panoramike 2D ofron një pasqyrë të përgjithshme të kavitetit oral, CBCT ofron vizualizim të detajuar të strukturave të kockave dhe pikave të referimit anatomik kritik. Për më tepër, CBCT rrit saktësinë klinike, zvogëlon rrezikun e komplikimeve jatrogjene dhe përmirëson rezultatet e përgjithshme të trajtimit në implantologjinë dentare.

Fjalë kyçe: *Implante dentare, CBCT, imazhe 3D, radiografi panoramike, vlerësim i kockave, planifikim i implantit, saktësi diagnostikuese, patologji orale.*

THE ROLE OF CBCT IN DENTAL IMPLANT PLANNING AND ASSESSMENT OF ASSOCIATED PATHOLOGIES

Sara Memaj [1]
[1] Berat Regional Hospital, Berat, Albania
E-mail: saramemaj28@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Dental implants have become a functional and aesthetic necessity in modern dentistry. Their successful placement requires a comprehensive preoperative assessment, as the procedure is delicate and demands precise clinical planning. Three-dimensional (3D) imaging, particularly cone-beam computed tomography (CBCT), is now considered an essential diagnostic tool prior to implant placement. CBCT enables accurate evaluation of bone structure and anatomy, thereby improving the quality of treatment planning.
Aim: The aim of this study is to assess the role of CBCT in planning dental implants and in identifying associated jaw pathologies, contributing to increased accuracy and safety in treatment.
Methods: This study is based on a scientific literature review as well as clinical evaluation of cases in which patients underwent radiographic assessment for implant placement and for nodular jaw lesions at our clinic. The diagnostic accuracy of two-dimensional (2D) panoramic imaging was compared with that of 3D CBCT imaging. Specific parameters evaluated included bone height and width, the trajectory of the inferior alveolar nerve, the anatomical condition of the maxillary sinuses in cases favorable for implant placement, and the importance of risk assessment in avoiding pathological complications.
Results or Findings: CBCT was identified as the gold standard imaging modality for implant planning. Compared to conventional 2D panoramic radiography, CBCT demonstrated superior diagnostic accuracy, provided greater surgical predictability, and enhanced medical-hygienic precision.
Conclusion: For reliable implant placement, CBCT is indispensable, as it offers a transparent and comprehensive diagnostic view for clinicians. While panoramic 2D radiography provides a general overview of the oral cavity, CBCT delivers detailed visualization of bone structures and critical anatomical landmarks. Furthermore, CBCT enhances clinical accuracy, reduces the risk of iatrogenic complications, and improves overall treatment outcomes in dental implantology.

Keywords: *Dental implants, CBCT, 3D imaging, panoramic radiography, bone assessment, implant planning, diagnostic accuracy, oral pathology.*

PËRDORIMI I REALITETIT VIRTUAL DHE INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË EDUKIMIN E INFERMIERËVE

Fabjon Aliaj[1]

[1] Spitali Rajonal Fier
E-mail: fabionaliaj89@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Edukimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor po përballet me transformime të mëdha për shkak të zhvillimit të teknologjive digjitale. Realiteti virtual (VR) dhe inteligjenca artificiale (AI) ofrojnë mundësi të reja për simulime klinike, trajnime interaktive dhe mësim të personalizuar, duke përmirësuar aftësitë praktike dhe teorike të infermierëve.
Objektivi: Ky studim synon të shqyrtojë rolin e VR dhe AI në edukimin e infermierëve, të vlerësojë efektivitetin e tyre në përvetësimin e kompetencave klinike dhe të analizojë perceptimet e studentëve dhe praktikantëve mbi këtë teknologji!
Metodologjia: Është realizuar një rishikim ndërkombëtar i literaturës mbi përdorimin e VR dhe AI në edukimin e infermierëve gjatë dekadës së fundit (2015–2025). Janë analizuar studime nga SHBA, Kanada, Australia, dhe vendet e Evropës që përdorin trajnim VR dhe AI në praktikën klinike dhe edukimin profesional. Të dhënat u përpunuan për të identifikuar avantazhet, sfidat dhe perceptimet e stafeve infermierore mbi këto teknologji.
Konkluzionet: Megjithëse në Shqipëri përdorimi i VR dhe AI në edukimin e infermierëve është ende i kufizuar, gjetjet ndërkombëtare sugjerojnë se implementimi i tyre mund të përmirësojë ndjeshëm përgatitjen klinike dhe aftësitë praktike. Rekomandohet zhvillimi i pilot programeve lokale për të adaptuar këto teknologji në trajnimet dhe programet e zhvillimit profesional të infermierëve në vend. Studimet ndërkombëtare tregojnë përmirësim të ndjeshëm të aftësive praktike, sigurisë klinike dhe angazhimit të studentëve. VR mundëson simulime të sigurta të situatave emergjente, ndërsa AI ndihmon në personalizim të mësimit dhe identifikim të dobësive individuale. Pjesëmarrësit e vlerësuan përvojën si motivuese dhe interaktive, duke rritur mbajtjen e njohurive.

Fjalë kyçe: *Realitet virtual, inteligjenca artificiale, edukimi digjital, trajnimi i infermierëve.*

USE OF VIRTUAL REALITY AND ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN NURSING EDUCATION

Fabjon Aliaj[1]
[1] Fier Regional Hospital
E-mail: fabionaliaj89@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Healthcare education is undergoing significant transformation due to advancements in digital technology. Virtual reality (VR) and artificial intelligence (AI) provide new opportunities for clinical simulations, interactive training, and personalized learning, enhancing nurses' practical and theoretical competencies. Their use in Albania, however, remains limited.
Objective: This study aims to examine the impact of VR and AI on nursing education, evaluate their effectiveness in skill development, and explore student perceptions based on international experiences.
Methodology: A review of international literature from 2015–2025 was conducted, analyzing studies from the USA, Canada, Australia, and Europe that applied VR and AI in clinical training and professional education. Data were synthesized to identify benefits, challenges, and student perceptions of these technologies.
Conclusions: International studies demonstrate significant improvements in practical skills, clinical confidence, and student engagement. VR enables safe simulations of emergency scenarios, while AI supports personalized learning and identification of individual weaknesses. Participants rated the experience as engaging and motivating, enhancing knowledge retention.
Although VR and AI use in Albania is limited, international evidence suggests these technologies can significantly improve clinical preparation and practical competencies. Implementing pilot programs locally is recommended to adapt digital tools to nursing education and professional development in Albania.

Keywords: *Virtual reality, artificial intelligence, digital education, nursing training*

INTEGRIMI I KUJDESIT PALIATIV NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR NË SHQIPËRI: GATISHMËRIA, MËSIMET DHE SFIDAT

Estela Skërmo[1], Klea Gjata, Irena Laska

[1] Qendra e Kujdesit Paliativ "Mary Potter" Korçë, Shqipëri

E-mail: Skermoestela@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Kujdesi shëndetësor parësor (KShP) luan një rol thelbësor në ofrimin e kujdesit bazë paliativ, duke siguruar cilësi për jetën e pacientëve me sëmundje që ia kufizojnë jetesën. Kujdesi paliativ po njihet gjithnjë e më shumë si një prioritet i shëndetit publik, dhe integrimi i tij në KShP është thelbësor për të garantuar akses të hershëm, vazhdimësi të kujdesit dhe mbështetje në komunitet për pacientët dhe familjet e tyre. Pavarësisht rëndësisë së tij, kontributi i KShP në kujdesin paliativ në Shqipëri mbetet ende i paeksploruar mjaftueshëm.

Objektivat: Ky studim synon të theksojë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e integrimit të kujdesit paliativ në kujdesin shëndetësor parësor dhe të analizojë rolin e tij në përmirësimin e mirëqenies së pacientëve.

Metodologjia: Ky studim bazohet në përvojën e "Mary Potter" Hospice Albania, duke përfshirë programet e trajnimit të stafit, iniciativat e edukimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimin me ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor. Të dhënat u mblodhën nga feedback-u i trajnimeve, vëzhgimet në terren dhe përvoja institucionale gjatë periudhës 2020–2024.

Rezultatet: Gjetjet tregojnë njohuri të kufizuara ndër profesionistët e KShP mbi parimet e kujdesit paliativ, si dhe mungesa në burime njerëzore dhe materiale. Shumica e pacientëve me sëmundje të cilat kufizojnë jetesën kalojnë një pjesë të konsiderueshme të ecurisë së sëmundjes në shtëpi, ku ofrohen shërbime të kujdesit paliativ. Kjo nënvizon rolin kyç të KShP në ofrimin e kujdesit bazë paliativ dhe nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet ekipeve të hospice-it dhe profesionistëve të KShP. Pavarësisht sfidave, profesionistët e shëndetit treguan gatishmëri për të mësuar dhe për të përmirësuar cilësinë e kujdesit.

Konkluzionet: Integrimi efektiv i kujdesit paliativ në KShP kërkon përfshirjen e tij në politikat shëndetësore, integrimin në kurrikulat universitare, bashkëpunimin me shërbimet e specializuara dhe trajnime të vazhdueshme profesionale. Forcimi i kapaciteteve të KShP është thelbësor për përmirësimin e mirëqenies së pacientëve, zgjerimin e aksesit në kujdes, reduktimin e hospitalizimeve dhe zhvillimin e një kujdesi paliativ të qëndrueshëm në komunitet, në Shqipëri.

Fjalët kyçe: *Kujdesi paliativ; Kujdesi shëndetësor parësor; Sistemet shëndetësore; Zhvillimi i kapaciteteve; Kujdesi në komunitet*

INTEGRATING PALLIATIVE CARE INTO PRIMARY HEALTH CARE IN ALBANIA: READINESS, LESSONS, AND CHALLENGES

Estela Skërmo[1], Klea Gjata, Irena Laska
[1] Palliative Care Center "Mary Potter", Korçë, Albania
E-mail: Skermoestela@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Primary Health Care (PHC) plays a critical role in delivering basic palliative care, ensuring quality of life for patients with life-limiting illnesses. Palliative care is increasingly recognized as a public health priority, and its integration into PHC is essential to ensure early access, continuity, and community-based support. Despite its importance, the contribution of PHC to palliative care in Albania remains underexplored.
Objectives: To highlight the importance and necessity of integrating palliative care into Primary Health Care and to examine its role in improving patient well-being.
Methodology: This study draws on the experience of "Mary Potter" Hospice Albania, including staff training programs, ongoing education initiatives, and collaboration with PHC providers. Data were collected from training feedback, observational insights, and institutional experience during the period 2020–2024.
Results: Findings indicate limited knowledge among PHC providers regarding palliative care principles, along with shortages in human and material resources. Most patients with life-limiting illnesses spend a significant portion of their disease trajectory at home, where palliative care services are provided. This highlights the crucial role of PHC in delivering basic palliative care and the need for stronger collaboration between hospice teams and PHC professionals. Despite existing challenges, healthcare providers demonstrated willingness to learn and improve the quality of care.
Conclusions: Effective integration of palliative care into PHC requires inclusion in health policies, incorporation into academic curricula, integration with specialized services, and continuous professional training. Strengthening PHC capacity is essential to improve patient well-being, expand access to care, reduce hospitalizations, and support sustainable community-based palliative care in Albania.

Keywords: *Palliative care, primary health care, health systems, capacity building, community care.*

MENAXHIMI I PLAGËVE POST-OPERATORE BAZUAR NË EVIDENCË: ROLI KYÇ I INFERMIERIT NË PARANDALIMIN E KOMPLIKACIONEVE DHE SIGURINË E PACIENTIT

Elvira Qosja[1]
[1] Spitali Rajonal "Xhaferr Kongoli", Elbasan
E-mail: Elvira.Qosja@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Plagët post-operatore përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të kujdesit kirurgjikal dhe menaxhimi i tyre efektiv është thelbësor për rikuperimin e pacientit dhe reduktimin e komplikacioneve. Infeksionet e vendit kirurgjikal, dehiscenca e plagës dhe vonesa në shërim ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës së pacientëve dhe rrisin kostot e kujdesit shëndetësor. Infermieri ka një rol kyç në vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e plagëve post-operatore, duke zbatuar praktika të bazuara në evidencë.

Qëllimi: Ky abstrakt synon të evidentojë rëndësinë e menaxhimit të plagëve post-operatore bazuar në evidencë dhe rolin e infermierit në parandalimin e komplikacioneve dhe promovimin e sigurisë së pacientit.

Metodologjia: Është realizuar një rishikim i literaturës bashkëkohore mbi praktikat infermierore në kujdesin e plagëve post-operatore, duke analizuar udhëzues ndërkombëtarë dhe rekomandime të bazuara në evidencë për parandalimin e infeksioneve dhe optimizimin e shërimit të plagës.

Rezultatet: Evidenca tregon se zbatimi i protokolleve të standardizuara infermierore, teknikat aseptike gjatë ndërrimit të fashove, vlerësimi sistematik i plagës, dokumentimi klinik dhe edukimi i pacientit ndikojnë në uljen e komplikacioneve post-operatore. Infermierët kontribuojnë në identifikimin e hershëm të shenjave të infeksionit, menaxhimin e faktorëve që ndikojnë në shërim dhe koordinimin e kujdesit multidisiplinar.

Përfundimi: Menaxhimi i plagëve post-operatore kërkon njohuri të avancuara dhe zbatim të praktikave të bazuara në evidencë. Roli aktiv i infermierit është thelbësor për përmirësimin e rezultateve klinike, reduktimin e komplikacioneve dhe garantimin e sigurisë së pacientit. Investimi në edukimin e vazhdueshëm profesional të infermierëve mbetet një faktor kyç për rritjen e cilësisë së kujdesit kirurgjikal.

Fjalë kyçe: *Plagë post-operatore; kujdes infermieror; infeksion i vendit kirurgjikal; praktikë e bazuar në evidencë; siguria e pacientit.*

EVIDENCE-BASED POSTOPERATIVE WOUND MANAGEMENT: THE KEY ROLE OF NURSES IN PREVENTING COMPLICATIONS AND ENSURING PATIENT SAFETY

Elvira Qosja[1]
[1] "Xhaferr Kongoli", Elbasan Hospital
E-mail: Elvira.Qosja@uniel.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Postoperative wounds represent an important aspect of surgical care, and their effective management is essential for patient recovery and the prevention of complications. Surgical site infections, wound dehiscence, and delayed healing negatively affect patients' quality of life and increase healthcare costs. Nurses play a key role in the assessment, monitoring, and management of postoperative wounds by implementing evidence-based practices throughout the patient care process.

Aim: This abstract aims to highlight the importance of evidence-based postoperative wound management and to emphasize the role of nurses in preventing complications and promoting patient safety.

Methodology: A review of contemporary scientific literature was conducted to analyze nursing practices related to postoperative wound care, focusing on international guidelines and evidence-based recommendations for infection prevention, wound assessment, and optimization of the healing process.

Results: Current evidence demonstrates that the implementation of standardized nursing protocols, adherence to aseptic techniques during dressing changes, systematic wound assessment, accurate clinical documentation, and patient education contribute significantly to reducing postoperative complications. Nurses have a fundamental role in the early identification of infection signs, management of factors affecting wound healing, and coordination of multidisciplinary care. Evidence-based nursing interventions improve clinical outcomes and enhance the overall quality and safety of surgical care.

Conclusion: Effective postoperative wound management requires advanced knowledge, clinical skills, and the consistent application of evidence-based practices. The active involvement of nurses is essential for improving patient outcomes, reducing complications, and ensuring patient safety. Continuous professional development and specialized education in wound care are key factors in strengthening nursing competencies and improving the quality of surgical care.

Keywords: *Postoperative wounds; nursing care; surgical site infection; evidence-based practice; patient safety.*

VLERËSIMI INFERMIEROR I MODELIT DIETETIK DHE STILIT TË JETESËS QË LIDHEN ME MARRJEN E VITAMINËS D TEK TË MOSHUARIT DHE IMPAKTI I TYRE NË SHËNDET

Irisa Amiti[1], Anjeza Sejdiraj[2]
[12] Spitali Rajonal Vlorë
E-mail: irisaamiti@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Mungesa e Vitaminës D është një çështje globale që mund t'i atribuohet faktorëve të ndryshëm si zakonet dietike, ekspozimi në diell, mosha, raca dhe gjendja shëndetësore që mund të jetë kronike. Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë lidhjen midis frekuencës dhe llojit të marrjes së Vitaminës D dhe faktorëve të rrezikut të lidhur me mungesën e vetë-raportuar të Vitaminës D nëpërmjet marrjes dietetike tek të moshuarit pranë shtëpisë së të moshuarve në qytetin e Fierit.
Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të vlerësojë modelin dietetik dhe stilin e jetesës që lidhen me marrjen e vitaminës D tek të moshuarit, në mënyrë që të përmirësohet gjendja e vitaminës D dhe impakti i saj në shëndetin e tyre nëpërmjet strategjive të kujdesit.
Metodologjia: Ky është një studim kros-seksional, i cili do të realizohet në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë. Në këtë studim do të përfshihen individët që jetojnë në shtëpinë e të moshuarve në qytetin e Fierit gjatë periudhës korrik–tetor 2024. Do të përgatitet një pyetësor me disa artikuj të vlefshëm për vitaminën D, që përfshin demografinë, ekspozimin ndaj dritës së diellit, përdorimin e suplementeve dhe ushqimet/pijet e konsumuara. Të dhënat do të përpunohen në programin statistikor SPSS, versioni 20, dhe do të interpretohen sipas rezultateve.
Rezultatet: Nga 70 individë të intervistuar (meshkuj dhe femra), pjesa më e madhe ishin meshkuj (61.4%) dhe i përkisnin grupmoshës (70–79 vjeç). Për sa i përket treguesve të BMI-së, rreth 50% kanë peshë normale, 42.9% janë mbipeshë dhe 7.1% janë obezë. Ndërsa qëndrimi në diell ishte i njëjtë për të dyja gjinitë, rreth 1 orë gjatë ditës. Variablat që shoqëroheshin me lidhje të rëndësishme statistikore me kohën që qëndrojnë në diell ishin: (p=0.597), sipas sëmundjeve shoqëruese: sëmundje kardiovaskulare (p=0.469), probleme me veshkat (p=0.298), diabet (p=0.446) dhe probleme me mëlçinë (p=0.000). Vërehet se nga personat që përdorin suplemente (multivitamina, kalcium, vitaminë D), pjesa më e madhe, rreth 99%, kanë mungesë të vitaminës D. Kjo vë në dyshim suplementet, por edhe përgjigjet e të anketuarve.
Konkluzione: Rezultatet e këtij studimi përfaqësues në Shtëpinë e të Moshuarve në qytetin e Fierit tregojnë se obeziteti, pasiviteti fizik, marrja e varfër dietike e vitaminës D dhe përdorimi jo i rregullt i kremit mbrojtës tregojnë se rreziku i mungesës së vitaminës D është gjithnjë në rritje. Vlerësimi i statusit të vitaminës D është me interes të veçantë tek të moshuarit.

Fjalë kyçe: *Vitamina D, shëndet, stili i jetesës, suplemente, qëndrimi në diell, moshat e treta.*

NURSING ASSESSMENT OF DIETARY AND LIFESTYLE PATTERNS RELATED TO VITAMIN D INTAKE IN THE ELDERLY AND THEIR IMPACT ON HEALTH

Irisa Amiti[1], Anjeza Sejdiraj[2]
[12] Vlora Regional Hospital
E-mail: irisaamiti@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Vitamin D plays an important role in the health of active individuals, ëhich can affect health performance through its influence on immune function, inflammatory modulation, bone health and skeletal muscle function.
Purpose: This study aims to evaluate the dietary model and lifestyle related to the intake of vitamin D in the elderly in order to improve the state of vitamin D and its impact on their health through care strategies.
Methodology: This is a cross-sectional study, ëhich ëill be carried out at Ismail Qemali University, Vlore. This study ëill include individuals living in the home of the elderly in the city of Fier during the period July-October 2024.
A questionnaire ëill be prepared ëith several valid items for Vitamin D, including demographics, exposure to sunlight, and use of supplements and foods/beverages consumed. The data ëill be processed in the statistical program SPSS version 21 and ëill be interpreted according to the results.
Results: Of the 70 individuals intervieëed (men and ëomen), the majority ëere men (61.4%) and belonged to the age group (70-79 years old). In terms of BMI indicators, about 50% have a normal ëeight, 42.9% are overëeight and 7.1% are obese. Ëhile staying in the sun ëas the same for both sexes, about 1 hour during the day. The variables that ëere associated ëith a statistically significant relationship ëith the time spent in the sun ëas (p=0.597), according to accompanying diseases: cardiovascular disease (p=0.469), kidney problems (p=0.298), diabetes (p=0.446) and liver problems (0.000). It is observed that of the people ëho use supplements (Multivitamins, Calcium, Vit D), the majority, about 99%, have a deficiency of Vitamin D. This casts doubt on the supplements and the responses of the respondents.
Conclusions: The results of this representative study in the Home of the Elderly in the city of Fier shoë that obesity, physical inactivity, poor dietary intake of vitamin D, Vitamin D insufficiency among these groups and the irregular use of protective cream, shoë that the risk of vitamin D deficiency is alëays increasing. Assessment of vitamin D status is of particular interest in the elderly.

Key words: *Vitamin D, health; lifestyle, supplements, staying in the sun, the third age.*

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Ky libër abstraktesh përfaqëson përkushtimin, profesionalizmin dhe kontributin shkencor të të gjithë autorëve dhe pjesëmarrësve në këtë aktivitet. Çdo punim i përfshirë në këtë përmbledhje pasqyron përpjekjet e vazhdueshme për avancimin e njohurive dhe përmirësimin e praktikës në kujdesin shëndetësor.

Shpresojmë që ky material të shërbejë si një burim i vlefshëm informacioni, frymëzimi dhe bashkëpunimi për profesionistët e shëndetësisë, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e shërbimeve dhe mirëqenien e pacientëve.

"Kujdesi shëndetësor fillon me dijen dhe përfundon me humanizmin."

Komiteti Organizator dhe Shkencor

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Edukimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në epokën digjitale : teknologjia, realiteti virtual, inteligjenca artificiale : konferenca kombëtare e profesionistëve të shëndetësisë : Tiranë, 12 Maj 2026 : libri i abstrakteve = National conference of healthcare professionals : education of healthcare professionals in the digital era : technology, virtual reality, artificial intelligence : Tirana, May 12, 2026 : abstract book. - Elbasan : PENK Print, 2026.
... f. ; ... cm.
ISBN 9789928485168
1.Infermieria 2.Kujdesi mjekësor 3.Konferenca 4.Shqipëri

616 -083(496.5) (062

Adresa: Sheshi Skenderbej, Tirane
Tel. +355 422 238 43/+355422 57 670
www.bksh.al

ISBN 9789928485168